



Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

## PËRKATËSIA GJINORE dhe

- Të drejtat e njeriut
- Qytetaria
- Dhuna në familje
- Integrimi evropian
- Media
- Shëndeti riprodhues
- Zhvillimi i karrierës
- Mjedisi

**Libër për mësuesit**

Tiranë, Tetor 2009



Ky publikim u realizua në kuadër të projektit “Barazia Gjinore në Kurrikulat e shkollave të mesme”, mundësuar falë mbështetjes së AECID (Agjencia Spanjolle e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim). Opinionet dhe sugjerimet e paraqitura në këtë komunikatë i përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht këndvështrimet e AECID apo të çdo organizate tjetër ku AECID është anëtare.

Autorët:

Prof.Dr. Milika Dhamo

Prof.Asoc.Dr. Marjana Sinani

Prof.Asoc.Dr. Mihallaq Qirjo

Dr. Eglantina Gjermeni

Dr. Manuela Bello

Ermira Lubani D.E.A. International Programme Management

Admir Meko, MA

Arla Gruda, MA

Konsulente: Dr. Saemira Pino

Botim i: Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

P.O. Box 2418 Tiranë, Shqipëri

Rr. “Abdyl Frashëri”, P.10, Ap.3, Shk.1

Tel./Fax: 00355 42 255514/5

E-mail: [gadc@gadc-al.org](mailto:gadc@gadc-al.org)

Këtë botim mund ta gjeni në formë elektronike në adresën: [www.gadc-al.org](http://www.gadc-al.org)

© 2009. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për “Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë, Shqipëri.

Faqësja & Kopertina: Elvira Çiraku (Osmani)

Shtëpia Botuese: Media Print

ISBN: 978-99956-18-88-9

SHTËPIA BOTUESE  
**mediaprint**  
Sh.p.k.  
info.mediaprint@gmail.com

## Përmbajtja

Në vend të hyrjes .....	5
Përkatësia gjinore dhe të drejtat e njeriut.....	6
Prof.Asoc.Dr. Marjana Sinani	
Përkatësia gjinore dhe qytetaria.....	20
Ermira Lubani D.E.A. International Programme Management	
Përkatësia gjinore dhe dhuna në familje.....	41
Prof.Dr. Milika Dhamo	
Përkatësia gjinore dhe integrimi europian.....	54
Admir Meko, MA	
Përkatësia gjinore dhe media.....	70
Dr. Eglantina Gjermani	
Përkatësia gjinore dhe shëndeti riprodhues.....	87
Dr. Manuela Bello	
Përkatësia gjinore dhe zhvillimi i karrierës.....	114
Arla Gruda, MA	
Përkatësia gjinore dhe mjedisi.....	129
Prof.Asoc.Dr. Mihallaq Qirjo	
Bibliografia.....	142



## ***Të dashur lexues,***

Ky botim i Qendrës Aleanca Gjimore për Zhvillim ka në fokus marrëdhëniet gjimore, që përbëjnë një nga çështjet më të rëndësishme për zhvillimet demokratike të botës së sotme.

Ende bota, popujt, individët, gratë dhe burrat, fëmijët dhe të rriturit, njerëzit me ngjyrë ose jo, ndeshen me pabarazi të shumta. Trajtesat teorike, filozofike dhe politike si dhe praktikrat e institucioneve ndërkombëtare dhe të shteteve demokratike janë të orientuara gjithnjë e më shumë drejt eliminimit të të gjitha llojeve të pabarazive sociale, ekonomike, politike dhe asaj gjimore. Një prirje e tillë është reflektuar edhe në procesin e të mësuarit në shkolla, në programe dhe tekste shkollore.

Libri që keni në duar është me vlera njohëse dhe praktike për çdo qytetar dhe qytetare të interesuar për barazinë dhe drejtësinë gjimore. Por në mënyrë të veçantë ai u vjen në ndihmë nxënësve duke qenë njëkohësisht edhe një udhëzues praktik për mësuesit për të rritur eficiencën në procesin e edukimit të të rinjve e të rejave, përfshirë edhe edukimin gjinor. Ky i fundit është tashmë pjesë e procesit të arsimimit në të gjitha shoqëritë e qytetëruara.

Botimi është përgatitur nga një grup i kualifikuar autorësh të njohur në fushat përkatëse. Ai është i ndarë në 8 kapituj, që trajtojnë përkatësinë gjimore lidhur me çështje të tilla aktuale si të drejtat e njeriut, dhuna në familje, media, shëndeti riprodhues, qytetaria, mjedisi, zhvillimi i karrierës dhe integrimi evropian.

Parashtrimi i ideve të rëndësishme, i legjislacionit bashkëkohor, i informacionit të ri apo statistikave domethënëse, ndjek pothuajse të njëjtën strukturë në secilin prej kapitujve. Pas një hyrjeje të shkurtër, parashtrohen konceptet kryesore me të cilat operohet në fushën përkatëse të studimit nga këndvështrimi gjinor si dhe dokumentet ndërkombëtarë dhe ato kombëtarë lidhur me të. Trajtimi vazhdon me të dhëna dhe fakte nga vendi dhe bota, që ndihmojnë kuptimin e problematikës në trajtim dhe analizohen disa prej dilemave dhe stereotipave gjinorë që vazhdojnë të gjallojnë në jetën tonë të përditshme. Më pas paraqiten disa studime rasti që nxisin aftësitë analitike dhe shprehitë praktike të nxënësve dhe në fund bëhet një përmbledhje për të rikujtuar gjithçka të mësuar gjatë kapitullit.

Autorët kanë përdorur burime të shumta informacioni për shtjellimin e materialit të çdo kapitulli, burime që janë bërë të njohura edhe për përdoruesit e këtij botimi, me qëllim thellimin e mëtejshëm të njohurive.

Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim ka bindjen se lexuesit e këtij libri që nesër do të jenë përfaqësuesit e institucioneve tona, mësueset dhe mësuesit e ardhshëm, hartuesit dhe zbatuesit e politikave kombëtare të zhvillimit do të japin ndihmesën e tyre aktive për një shoqëri të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët dhe qytetaret.

## Përkatësia gjinore dhe të drejtat e njeriut

### Hyrje

Në këtë kapitull trajtohen disa çështje të përkatësisë gjinore në raport me të drejtat e njeriut. Me rëndësi të veçantë është analiza e dimensionit gjinor në dokumentet universale, globalë dhe lokalë, si përthyeret ky dimension në Kushtetutë dhe në legjislacionin vendas.

Nëse shoqëria njerëzore ka identifikuar nevojën për të formuluar dokumente për liritë dhe të drejtat themelore të individit si qenie njerëzore, përse krahas këtyre ka lindur edhe nevoja për të prodhuar dokumente që fokusohen te liritë dhe të drejtat e gruas? A nuk gjejmë përgjigje liritë dhe të drejtat e gruas në Deklaratën Universale të Të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), që është dokumenti universal i liritë dhe të drejtave të njeriut?

Gjatë trajtimit do të përpiqemi të sjellim argumente se përse të drejtat e grave janë përtej të drejtave dhe liritë të individit. Pse u identifikua nevoja për një dokument fokusuar posaçërisht te gruaja, siç është konventa në mbrojtje të grave? Cilat janë liritë dhe të drejtat e grave që qëndrojnë përtej të qenit të drejta njerëzore?

A nuk i përmbush DUDNJ-ja edhe të drejtat e gruas? Po? Jo? Pse?

Pse gruaja meriton një trajtim të posaçëm në dokumente të posaçme? Çfarë e bën krejt të veçantë qenien-grua? Funkzioni riprodhues...statusi që shoqëria ka përcaktuar për të gjatë gjithë historisë...? Kode morale dhe fetare në shoqëri e kultura të ndryshme projektuan ndër shekuj për gruan nënshtrimin ndaj mashkullit, duke e konsideruar si vlerë deri në nivelin e kulturës këtë nënshtrim<sup>1</sup>.

Është ky fakt i prodhuar nga historia, që e identifikon nevojën për një dokument të posaçëm për gruan?

*Le të sjellim së bashku komente rreth çështjeve të mësipërme, pasi besojmë se:*

Shkolla si institucion dhe mësuesi si profesionist në përcjellje të dijes shkollore, kanë

<sup>1</sup> Nënshtrimi i gruas ndaj mashkullit është konsideruar vlerë e gruas dhe e shoqërisë, deri në nivelet e zakonit.

potencialin e nevojshëm për të transmetuar te të rinjtë, përfaqëse të çështjeve gjinore që lidhen me retrospektivën historike dhe projeksionet e të ardhmes.

### Objektiva që lidhen me çështjen

Në përfundim të kësaj trajtëse kërkohet që nxënësit të jenë të aftë të:

- Identifikojnë dokumentet globalë dhe lokalë që kanë krijuar frymë universale për statusin e gruas,
- Identifikojnë statet strategjike për realizimin e të drejtave të grave, nga e drejta e votës tek e drejta e abortit dhe e divorcit,
- Listojnë disa nga dokumentet që kanë përcjellë frymë dhe sjellë risi duke ndryshuar kahet e zhvillimit potencial të gruas,
- Sjellin kuptimin e tyre për konceptet kyç si: e drejtë gjinore, barazi/pabarazi gjinore, diskriminim gjinor, diskriminim pozitiv gjinor, integrim gjinor, emancipim, etj.
- Identifikojnë dokumente kombëtare që vendosin dhe garantojnë ekuilibër gjinor,
- Identifikojnë institucione vendore që garantojnë barazi gjinore,
- Interpretojnë mesazhet që përcjellin nene të caktuara për ekuilibrin gjinor,
- Identifikojnë koherencat midis dokumenteve ndërkombëtarë dhe kombëtarë në aspektin gjinor.

### Inventar i besimeve fillestare

Kur trajtojmë çështje që lidhen me të drejtat e njeriut ballafaquar me përkatësinë gjinore, jemi të prirur të besojmë se:

- Fabula e Evës dhe Adamit dhe morali që kjo fabul ka përcjellë është kapërcyer<sup>2</sup>.
- Shoqëria njerëzore sot është në nivele të tilla zhvillimi, që ka të gjitha përvojat e duhura historike, për të mos humbur shanset dhe për të potencuar realisht zhvillim të dy gjinive, për të garantuar kohezion gjinor.
- Barazia gjinore<sup>3</sup> dhe nevoja për ta shndërruar barazinë në realitet është përtej të qenit e drejtë themelore dhe detyrim themelor.
- Barazia gjinore dhe nevoja për ta shndërruar barazinë në realitet funksional është përtej nevojës për ta pranuar atë si vlerë dhe e mirë e përbashkët.
- Barazia gjinore dhe nevoja për ta bërë barazinë një realitet të prekshëm është kusht për rritjen ekonomike dhe kohezionin<sup>4</sup> social të shoqërisë.

<sup>2</sup> Fabula që cilësonte gruan “djall” dhe mashkullin “naiv” të joshur drejt mëkatit dhe se gruaja duhej sunduar dhe kontrolluar përndryshe do ta manipulonte përjetësisht mashkullin.

<sup>3</sup> Barazia gjinore është koncept social, potencimi i të dy gjinive për t’u zhvilluar përtej ndryshimeve biologjike. Ligji, institucionet, potencojnë të dyja gjinitë për realizimin e të drejtave dhe lirive të tyre.

<sup>4</sup> Kohezioni social në këndvështrimin gjinor, presupozon përafrim të qëllimeve strategjike të të dy gjinive, për të bashkëjetuar në emër të cilësisë së jetës dhe realizimit të pritshmërive burrë/grua, vetjake dhe shoqërore.

- Barazia gjinore dhe nevoja për ta shndërruar barazinë në frymë është parakusht për të rritur pjekurinë politike të shoqërisë.
- Instalimi i barazisë gjinore në të gjitha aspektet e veprimtarisë njerëzore është sa i mundshëm po aq edhe i domosdoshëm.

### Koncepte kryesore

- e drejtë njerëzore
- e drejtë gjinore
- barazi gjinore
- drejtësi gjinore
- diskriminim gjinor
- diskriminim pozitiv
- integrim gjinor
- fuqizim gjinor
- politika gjinore
- buxhetim gjinor.

- **E drejtë njerëzore** është e drejta e çdo individi, pjesë e bashkësisë njerëzore, për t'i jetuar me dinjitet të gjitha stadet e jetës deri në mbyllje të ciklit biologjik, pavarësisht nga raca, gjinia, besimi, statusi social.

Po ju si mendoni?

- **E drejtë gjinore** është e drejta e çdo individi, pjesë e bashkësisë njerëzore, për të përmbushur të gjitha nevojat biologjike, sociale nga këndvështrimi burrë/grua, konform stadeve të jetës, në intimitet të plotë në përmbushje jo vetëm të pritshmërive të shoqërisë për burrin/gruan, por edhe në përmbushje të vetvetes, identitetit gjinor.

Po ju si mendoni?

- **Barazi gjinore** është koncept social i përpunuar nga shoqëria në plotësim të nevojës për t'u lënë hapësirat e nevojshme të dy gjinive respektive për t'u përmbushur dhe vetërealizuar konform prishmërive personale dhe pritshmërive të shoqërisë. Barazia gjinore funksionon kryesisht në fushën e ligjit dhe më ngadalë dhe përmes barrierave, edhe në praktikën e përditshme. Barazia gjinore duhet trajtuar me kujdes pasi nuk mund të identifikohet lehtësisht.

Po ju si mendoni?

- **Drejtësi gjinore** është jo vetëm ekzistenca e legjisllacionit në funksion të arritjes së ekuilibrit gjinor, por shtrihet përtej ligjit, është praktika dhe morali deri në nivelet e zakonit që përcjell një shoqëri, në raport me statusin e gruas në një stad të caktuar.

Po ju si mendoni?

- **Diskriminim gjinor** është përjashtimi i grave nga të drejtat themelore të njeriut dhe nga të drejtat specifike për shkak dhe në përmbushje të statusit të saj. Izolimi



i gruas në kushtet e shtëpisë, mungesa e arsimit, kufizimi i jetës private janë disa nga format e konservuara të diskriminimit. Mohimi i të drejtës së votës, të abortit, të divorcit mbeten format klasike të diskriminimit.

Po ju si mendoni?

- **Diskriminim pozitiv** është koncept relativisht i vonë që u përdor fuqishëm në OKB gjatë procesit të përgatitjes së Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave në vitin 1979. Fillimisht si koncept, por më pas fitoi trajtat e parimit mbi të cilin u ndërtuan politika dhe dokumente ligjorë që “favorizonin” gruan qoftë edhe për shkak të të qenit me përkatësi gjinore femërore. I përdorur në funksionin e parimit, diskriminimi pozitiv ka shërbyer fuqishëm në identifikimin dhe politikat mbështetëse për gratë. Si parim ka qenë i debatuar. Si praktikë ka qenë dhe vazhdon të jetë funksionale. Kundërshtarët përdorin argumente se veçimi i gruas në nivel ligji dhe politikash rrezikon të përcjellë te vetë gruaja ndjesinë e “viktimit” që pret dhe ka nevojë për strehë. Praktikrat globale nuk e vërtetojnë ende këtë.

Po ju si mendoni?

- **Integritim gjinor** është procesi i gjithëpërfshirjes së grave në jetën e shoqërisë, në emër të potencialit njerëzor që ato përfaqësojnë dhe në emër të përmbushjes së aspiratës së tyre për t’u vetërealizuar edhe përtej angazhimit familjar. Integritimi gjinor është proces që tenton ta potencojë gruan në arsimim, punësim, trajnim të vazhdueshëm, vendimmarrje.
- **Fuqizim gjinor** janë nisma sinergjike që vijnë në nivele politike, legjislativ dhe të shoqërisë civile, me qëllim prurjen e një “masë kritike” të gruas, në vendimmarrjen publike dhe politike, që tentojnë instalimin e kohezionit social. Fuqizimin gjinor e synon shteti dhe shoqëria jonë. Ligjet e reja në mbështetje dhe përfshirje të grave, vendosja e kuotës 30% të pjesëmarrjes në politikë është një nga instrumentet që çon drejt fuqizimit të gruas.

Po ju a mendoni kështu?

- **Politika gjinore** janë nisma parlamentare dhe institucionale për të hartuar ligje të reja (dhe/ose amenduar) për të përmbushur detyrimet që vijnë nga dokumentet e ratifikuar dhe në respektim të Kushtetutës për mbështetjen e grave në vetërealizimin e tyre. Politikat gjinore përcjellin dimensionin global, por i referohen dhe kontekstit lokal. Politikat gjinore shndërrohen në realitet nëse ndërtohen edhe institucionet përkatëse dhe përfshihet shoqëria civile.

Po ju a mendoni kështu?

- **Buxhetim gjinor** është parim mbi të cilin një shtet harton buxhetin e tij vjetor. Ndërtimi i buxhetit bëhet duke ju referuar çështjeve që prekin shërbime psiko-sociale dhe shëndetësore posaçërisht për gruan, arsimimin, punësimin, trajnimin e vazhdueshëm, pjesëmarrjen e gruas në jetën publike dhe duke planifikuar që një pjesë e buxhetit të shkojë për realizimin e të drejtave të grave. Buxhetimi gjinor përmirëson nivelin arsimor të grave dhe mbështet shtresat e marginalizuara të tyre.

Po ju si mendoni?

## Dokumente ndërkombëtare

- **DUDNJ** - Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- **KEFDG** - Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)
- **KEDNJ** - Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

**DUDNJ**-ja është dokument universal. Kjo deklaratë është ratifikuar nga mbi 180 vende të botës, të cilat i hartojnë ligjet lokale në frymën e këtij dokumenti me fuqi universale. Misioni i këtij dokumenti për të identifikuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, në emër të përmbushjes së dinjitetit të tij/saj, ka hapur rrugën për të prodhuar dokumente të tjerë në përmbushje të të drejtave të individëve me status special, si të drejtat e grave dhe të fëmijëve.

**KEFDG**-ja është dokumenti që derivon dhe është në përmbushje të frymës së **DUDNJ**-së, por në respekt të individit - grua. Duke besuar se **DUDNJ**-ja nuk i përfshinte të drejtat e gruas plotësisht në aspektin gjinor, me bindjen se gruaja meritonte vëmendje të posaçme dhe se ishte e diskriminuar në rrjedhën e historisë nga faktorë përtej historikë dhe kulturorë, u formulua ky dokument.

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave u ratifikua nga Shqipëria në vitin 1993. Ky dokument përbën aktin më të rëndësishëm që sjell në vëmendjen e shteteve dhe të shoqërive gruan, potencialet dhe perspektivat e saj në tri dimensione: arsimim-punësim-vendimmarrje.

Dokumenti u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1979, si rezultante e përpjekjeve 30 vjeçare të ekspertëve për të sjellë për gratë një status të ri. Statusi i ri synohej në: politikë, fushat e punësimit, sigurimet shëndetësore.

Parimet mbi të cilat u ndërtua dokumenti i mësipërm dhe fjala kyçe ishte *diskriminimi*. Tre parimet e konventës janë: riprodhimi njerëzor (funksioni riprodhues që përcillet dhe realizohet nga grua, si dhe çështje të shëndetit që lidhen me vendimmarrjen e riprodhimit), dimensionin kulturor (statusi që gruaja merr në varësi të kulturës, traditave dhe kodeve morale të shoqërisë ku jeton), dimensionin ligjor (fryma e legjislacionit në mbështetje apo jo të gruas për shkak të të qenit grua).

Paraqet interes veçmas, neni 7 i **KEFDG**-së i cili përcakton qartë se ... “Shtetet palë zotohen të ndërmarrin masat e nevojshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe atë publike të vendit dhe marrin përsipër të sigurojnë të drejta të barabarta ndërmjet grave dhe burrave për të votuar në zgjedhje dhe referendume publike, për të marrë pjesë në formulimin dhe implementimin e politikave qeveritare dhe për rrjedhojë të mbajnë pozicione publike dhe të performojnë në të gjitha nivelet qeverisëse të një vendi....”

**KEDNJ**-ja, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Këshilli i Europës në vitin 1950 në Romë, është një dokument me fuqi brenda kontinentit evropian që ka ndikuar në politikat tona lokale. Nga ky dokument kanë rrjedhur më pas edhe **Karta Sociale Europiane** (1961), **Karta Sociale e Rishikuar Europiane** (1999), që

garantojnë posaçërisht një sërë të drejtash të grave, ku vlen të veçojmë si shumë domethënëse të drejtën e mëmësisë, si e drejtë e posaçme, për realizimin e së cilës shtetet detyrohen të japin mbështetje institucionale dhe ligjore.

## Dokumente kombëtarë

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi i Familjes, Kodi Penal, Kodi i Punës
- Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
- Ligji nr. 8876, datë 4.04.1995 “Mbi shëndetin riprodhues”(i rishikuar)
- Ligji nr. 8045, datë 7.12.1995 “Për ndërprerje të shtatzënisë”(i rishikuar)

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998)** gjen përputhje të plotë me frymën e DUDNJ-së, ku të drejtat e njeriut konsiderohen: të pandashme, të patjetërsueshme, të pacënueshme.

Është e rëndësishme të përcjellim përmbajtjen e termave: të drejta deklarative, të drejta të aplikueshme, të drejta të patjetërsueshme, të drejta të pandashme, të drejta të pacënueshme.

Nga Kushtetuta është me interes të theksohen dy nene: 18 dhe 54. Neni 18 i Kushtetutës garanton se “Të gjithë shtetasit janë të barabartë para ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si: gjinia, raca, feja, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike dhe sociale” duke qenë kështu pikënisje për ligjet e tjera kundër diskriminimit të gruas.

Ndërsa neni 54 shpall se: “...Gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti”.

## Kodi i Familjes i RSH (2003)

Është dokumenti ligjor që konsideron, rregullon dhe merr në mbrojtje familjen dhe martesën si institucion. Parimi mbi të cilin është ndërtuar i gjithë Kodi është se martesë dhe familja janë institucione që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve në Kodin e Familjes janë në përputhje, koherente e komplementare dhe nuk prekin thelbin e të drejtave të tyre njerëzore.

Kodi është hartuar dhe funksionon në përputhje me Konventën Ndërkombëtare të Grave, në harmoni me ligjin për shëndetin riprodhues dhe garanton të drejtat e gruas si individ dhe si grua. Kodi i Familjes pasurohet vazhdimisht me ligje të reja me qëllim realizimin e të drejtave të bashkëshortëve dhe sidomos të gruas për garantimin e familjes si institucion. Në këtë kod mund të identifikohen klauzola specifike ku në dukje favorizohet gruaja për shkak të të qenit grua, si p.sh. vendimmarrja për ndërprerjen e shtatzënisë, e drejta për të

ushtruar mëmësinë, etj. Kodi parashikon dhe reciprocitetin në disa prej të drejtave dhe detyrimeve të bashkëshortëve në familje, disa prej të cilave klasifikohen si detyrime fakultative dhe disa si jo fakultative. Vendbanimi, kontributi, mbiemri i fëmijëve, mbiemri i bashkëshortëve klasifikohen si të drejta fakultative, të cilat negociohen mes vetë bashkëshortëve. Por Kodi parashih rastin kur bashkëshortët nuk merren vesh për mbiemrin e fëmijës, atëherë ai detyron që fëmija të marrë mbiemrin e të atit.

Kodi i Familjes parashikon gjithashtu se në kushtet e divorcit duhet të merren në konsideratë edhe investimet jomonetare të gruas në dobi të familjes. Kjo kryesisht është e lidhur me kohën e shpenzuar nga gruaja për përmbushjen e kërkesave të jetës familjare. Kjo frymë e Kodit të Familjes është një këndvështrim i ri që zgjeron të drejtat dhe liritë e gruas dhe kërkon që në një të ardhme të afërt koha dhe energjia e shpenzuar brenda sferës familjare të konsiderohet si punë e paguar.

Ligji për statusin e ushtarakut është një përpjekje e parë në këtë drejtim. Bashkëshortet e ushtarakëve marrin një pagesë të konsideruar si pension që njih investimin e tyre në familje, në kushtet kur bashkëshortët e tyre për arsye objektive janë të detyruar të shpenzojnë shumë kohë jashtë familjes.

*Diskutoni rreth këtij fakti. Si vjen te ju kjo frymë e ligjit? Si përmbushje e të drejtave të grave, si diskriminim pozitiv...apo...?*

Ligji nr. 9669/18.12.2006 **“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”**, qëndron përtej njëres apo tjetres gjini, duke mos lehtësuar asnjëherë palë në çështje që lidhen me dhunën në familje.

### **Përpikuni të argumentoni qëndrimin e ligjvënësit.**

Ligji **“Për ndërprerjen e shtatzënisë”** është një tjetër mbështetje që i ofrohet gruas dhe që kontribuon drejtpërdrejt në shëndetin e saj riprodhues dhe në administrimin prej saj të rolit të mëmësisë. Ky ligj i jep të drejtën vetëm gruas (jo burrit) si subjekt kryesor dhe i vetëm në dhënien e pëlqimit për ndërprerjen e shtatzënisë.

Cili është gjykimi juaj për këtë çështje?

### **Kodi Penal**

Është dokument ligjor që përmban tërësinë e akteve që trajtojnë çështjet penale. Ai është ndërtuar në respekt të frymës së Kushtetutës dhe konventave ndërkombëtare, kundër diskriminimit dhe në mbrojtje të gruas edhe në rastet kur ajo gjendet e përfshirë në çështje penale.

Paraqet interes trajtimi i gruas në këtë kod. Sipas tij, ajo është e përjashtuar nga dënimi me burgim të përjetshëm, pavarësisht përmasave dhe llojit të çështjes ku ajo është përfshirë.

Kodi Penal ka disa dispozita që marrin gruan në mbrojtje, vetëm për shkak të të qenit grua. Kështu:

Nëse një person kryen vepër penale ndaj gruas shtatëzënë, veprimi në fjalë dhe personi i përfshirë trajtohen në rrethana rënduese për këtë të fundit.

*Arsyetoni dispozitën në fjalë.*

Nëse kryhet vrasja e një gruaje shtatëzënë, konsiderohet si vrasje në rrethana cilësuese...

Arsyetoni kuptimin e termit "rrethana cilësuese". Cila është baza e formulimit të kësaj dispozite... të drejtat e gruas përtej të drejtave të individit ... apo...?

Nëse një person inicion dhe realizon procese që lidhen me trafikimin e femrave për prostitucion, kodi parashikon dënimin me burg.

Kur një grua është shtatëzënë ose me fëmijë në gji, kodi parashikon se gruaja, nuk mund të vendoset në gjendje arresti ose në burg. Nëse një grua ka marrë vendimin e gjykatës për ekzekutim të dënimit, vendimi shtyhet deri sa fëmija të mbushë moshën 1 vjeç.

*Arsyetoni logjikën e këtyre dispozitave dhe identifikoni parimet mbi të cilat funksionojnë ato.*

Vuajtja e dënimit të një gruaje bëhet në burgjet e sigurisë së ulët dhe parashikohet mundësia që ajo të mbajë me vete fëmijët deri në moshën tre vjeç kundrejt një shërbimi shëndetësor dhe social të specializuar në kushtet e dënimit.

*Arsyetoni logjikën e dispozitës dhe identifikoni parimet mbi të cilat funksionon kjo dispozitë.*

Kodi Penal parashikon një dispozitë të veçantë, për një grua të dënuar që ajo të mund të mbajë lidhje periodike me familjen.

*Arsyetoni logjikën e dispozitës në fjalë.*

## **Kodi i Punës**

Është ndërtuar në frymën e Kushtetutës dhe në zbatim të konventave të ratifikuara nga shteti. Dimensionin gjinor është i dallueshëm në këtë kod. Ka një grup dispozitash që janë të fokusuar te gruaja në mënyrë të posaçme.

Vlen të ndalemi në kreun me titull "Mbrojtje e veçantë për gratë", për të trajtuar kontratën e punës, sigurimin në punë dhe turnet në punë duke ju referuar statusit të gruas.

**Kontrata e punës.** Nuk vlen zgjidhja e kontratës së punës nga punëdhënësi kur një grua është në periudhën e lejes së lindjes ose të lejes së birësimit.

*Arsyetoni logjikën e kësaj dispozite.*

**Puna me turne.** Nëse një grua është shtatëzënë, ligji nuk lejon përfshirjen e saj në punën në turnet e natës.

*Arsyetoni logjikën e kësaj dispozite.*

**Sigurimi i shëndetit në punë.** Nëse një grua shtatzënë është e përfshirë në procese pune me lodhje fizike, ligji ndalon mbajtjen e peshave mbi 20 kg.

*Arsyetoni logjikën e kësaj dispozite.*

Neni 115 i Kodit të Punës, parashikon shpërblim të njëjtë si për gratë edhe për burrat përkundrejt një pune të barabartë.

## Të dhëna dhe fakte

### E drejta e votës

- Gratë kanë votuar për herë të parë në Zelandën e Re, më 1893<sup>5</sup>
- Zvicra është shteti i fundit në Evropë që u dha grave të drejtën e votës, 1971.
- Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gratë e fituan të drejtën e përgjithshme të votës më 1920.
- Republikat e ish-Bashkimit Sovjetik më 1917.
- Shqipëria më 1946.

### Gratë dhe politika

- Ruanda më 2008 ishte shteti me përfaqësimin më të madh të grave në parlament, 45 gra nga 80 deputetë gjithsej.
- Irani - konsiderohet vendi ku sundon kultura e heshtjes dhe revolucioni i buzëkuqit.
- Afganistani - shoqëria ku gratë e kanë për turp të rrëfejnë dhunën që vjen nga bashkëshorti.
- Viti 1913 është viti kur Alice Paul në SHBA, krijoi organizatën e grave, Bashkimi Kongresist për të Drejtën e Votës, që më 1917 mori emrin Partia Kombëtare e Grave. Më pas, në Norvegji dhe Islandë, në vitet '90, krijohen dhe funksionojnë me sukses partitë politike të grave.
- Shqipëria, 2008, sanksionimi me ligj i përfaqësimit të gruas në kuotën jo më pak se 30% në listat shumëemërore të partive politike për zgjedhjet parlamentare dhe vendore.

## Dilema, tabu, stereotipe gjinore

Procesi i formulimit të KEFDG-së ka kaluar përmes një debati që solli ndarjen në dy grupe të ekspertëve, përse i përket argumenteve *pro* dhe *kundër* krijimit të këtij dokumenti.

<sup>5</sup> Është fjala për të drejtën e përgjithshme dhe të barabartë të votës. Para kësaj date, në vende të ndryshme kategori të kufizuara grash (në varësi të arsimit, statusit civil etj.) kishin fituar të drejtën të votonin, veçanërisht në zgjedhjet vendore.

Nga njëri grup vinin argumente *kundër* me idenë se formulimi i një dokumenti enkas për gratë, megjithë predispozitat pozitive për t'i mbështetur ato, mund të përforconte ndjesinë e "viktimës" dhe të inferioritetit të gratë. Ky këndvështrim nuk gjente argumente për një dokument të posaçëm, pasi të drejtat e grave, sipas tyre, merrnin zgjidhje dhe garantoheshin nga DUDNJ-ja, si dokument universal për të drejtat e individit.

Grupi me këndvështrim tjetër sillte argumente se gruaja dhe të drejtat e saj, meritonin vëmendje edhe me një dokument të veçantë, pasi liritë dhe të drejtat e tyre *ishin mbi dhe përtej* të drejtave të individit.

Funksioni riprodhues i gruas, statusi që kodet morale dhe fetare i kishin dhënë gruas ndër shekuj, kishin shndërruar në zakon statusin e saj. Shoqëria kishte ndërtuar pritshmëritë e saj për gruan duke e parë atë kryesisht brenda familjes.

Më tej ky grup ekspertësh solli në fokus një dukuri tjetër, "rrethprerjen femërore", rit poshtëruar i praktikuar në disa kultura, si dhe faktin që sillnin studime të shumta se në botë një grua në 24 orë kryen periodikisht 37 procese pune të panjohura dhe të paidentifikuara në ndonjë kod moral, kulturë dhe legjislacion sado i qytetëruar.

*Ndaluni dhe diskutoni:*

- *Po ju, në cilin nga grupet e ekspertëve do dëshironit të aderonit?*
- *Listoni argumente pro/kundër nga grupi ku keni aderuar.*

### **Rrethprerja femërore si e "drejtë primitive"**

Fjala është për një rit pothuajse primitiv, që kryhet në disa komunitete me kultura specifike, por që konsiderohet nga anëtarët e këtyre komuniteteve si i shenjtë. Në vendet ku vazhdon të ushtrohet ky rit institucionet sociale dhe shtetërore ndihen të pajtuara me situatën, në emër të faktit se ky rit është shndërruar në zakon dhe se nuk mund të ballafaqohen me një dukuri që sipas tyre, është pjesë e kulturës së shoqërisë dhe që konsiderohet e shenjtë. Femrat i nënshtrohen një masakre gjinekologjike, prerjes së klitorit. Organizma të OKB-së sjellin statistika që numërojnë deri në 92 milion vajza në vit që i nënshtrohen këtij riti.

Një gazetare nga Siera Leone, që guxoi të publikonte këtë fakt në media, u dënua nga organizata të fshehta të shëtiste në rrugët e qytetit krejt e zhveshur. Poshtërimi publik i saj ishte rruga që u përdor për të ndaluar përpjekjet kundër këtij riti. Gazetarja kishte blasfemuar<sup>6</sup>, ajo mbeti e vetme në përpjekjen e saj. I mungoi mbështetja publike dhe ajo e shtetit. Parlamentarë të këtij vendi të pyetur nga ekspertë lokalë të OKB-së refuzuan të ofrojnë komente, aq më pak zgjidhje për një dukuri që sipas tyre shoqëria e ka kthyer në zakon.

<sup>6</sup> Blasfemi konsiderohet çdo tentativë për të dalë kundër asaj që konsiderohet e shenjtë.

Ndaluni dhe diskutoni:

- Ballafaqoni dukurinë e lartpërmendur, me dokumente globale ku sanksionohen të drejtat dhe liritë e gruas.
- Listoni argumente pro dhe kundër kësaj dukurie.
- Shkruani një pamflet për këtë rit që mban akoma peng gruan në mijëvjeçarin e ri.
- Çfarë ndodh atje ku një rit i këtij lloji kthehet në zakon?
- Ballafaqoni të drejtën zakonore/të drejtën e gruas/të drejtën njerëzore.

### **Disa çështje me interes për diskutim**

Dukuria e ashtuquajtur “vajzat - barbi”. Jo rrallë gruaja vlerësohet dhe ekspozohet si një objekt dekorativ. Edhe sot, shoqëria në segmente apo shtresa të caktuara të saj tenton të konkurrojë strategjitë dhe politikat globale apo lokale që e identifikojnë gruan si potencial intelektual dhe njerëzor, përtej asaj që është identifikuar tradicionalisht. Në këtë rast sfida vjen nga një tjetër kah. Industria e kozmetikës, produktet që vihen në funksion të të qenit “vitrinë” janë ana tjetër e këndvështrimit mbi gruan.

Sillni këndvështrimin tuaj rreth këtij fakti. Debatoni mes jush perspektivën e zgjedhur nga secili/secila.

*Sipas opinionit tuaj:*

A ka kuptim të fokusohemi në çështjen se...

...cila e drejtë është më e rëndësishme, po më e përmbushur?

- E drejta e divorcit - mundësoi lirinë civile të gruas dhe konfirmoi statusin e saj si individ për të jetuar e pavarur nga bashkëshorti, i cili konsiderohej ombrella e gruas dhe garancia ekonomike e saj.
- E drejta e abortit - mundësoi gruan të qeverisë vetë lirinë vetjake dhe mëmësinë si rol social, duke shënuar hapin e parë faktik të çlirimit të saj.
- E drejta e votës - mundësoi pjesëmarrje në jetën politike dhe ndërtimin e legjislacioneve në mbështetje të gruas.

*Debat i hapur:*

A kontribuon dhe deri në çfarë mase.... në përmbushjen e të drejtave të grave...

- Teknologjia e zhvilluar – çoi në ....
- Sjellja e ujit të rrjedhshëm në shtëpi – çliron gruan nga orët e shpenzuara për ...
- Makina larëse në familje – kontribuoi për...
- Zëvendësimi i gatimit me dru zjarri me atë me energji elektrike, gaz - solli ...



## Pak informacion

Dekadat e fundit të shekullit që lamë pas dhe dekada e parë e shekullit 21 tregojnë se çështjet gjinore dhe të drejtat e gruas të ballafaquara me të drejtat njerëzore, kanë hyrë në një stad të ri.

Aktualisht, përpjekjet dhe strategjitë për emancipimin<sup>7</sup> e gruas u kanë lënë vendin strategjive të reja. Shoqëria nuk priret të operojë më me termat *emancipim i gruas*, por me termat *integrim* dhe *fuqizim* të saj. Është stadi kur janë artikuluar dhe fituar *liritë* themelore<sup>8</sup> të gruas si individ, por ende nuk janë zbatuar të *drejtat*<sup>9</sup> themelore të saj si grua. Ende, shoqëria dhe institucionet e saj janë larg për të garantuar të drejtat.

Gjysma e shekullit të 20-të dhe dekada e parë e shekullit tonë projektuan dhe hodhën bazat filozofike të lirisë dhe të drejtave të grave. Dokumente me fuqi universale si: DUDNJ-ja dhe KKFG-ja, sollën mjaft argumente në mbështetje të integritit dhe fuqizimit të gruas. Iniciuan procese e strategji që dilnin përtej të drejtave dhe lirive të individit, drejt përmbushjes së të drejtave të grave. Ky gjysëmshkulli nuk foli aq për barazi gjinore, sesa për drejtësi gjinore, integrim dhe fuqizim. OKB-ja dhe institucionet në përbërje të saj, përcollën frymën e nevojshme dhe potencuan institucione lokale që tentuan ta shndërrojnë në filozofi veprimi frymën e dokumenteve. Kushtetutat e vendeve anëtare të OKB-së përcollën deri në institucionalizim frymën e dokumenteve universale.

Realizimi i të drejtave të grave mund të shndërrohet në realitet, jo nga angazhimi vetëm i komunitetit mashkullor qoftë edhe me përfshirjen maksimale dhe serioze të tij, por përmes angazhimit cilësor të gruas në tri korsi: arsimim-trajnim i vazhdueshëm-vendimarrje. Arsimimi redukton varfërinë, trajnimi mundëson autonomi financiare, vendimarrja garanton integrim dhe fuqizim të gruas. Këto procese në koherencë dhe në sinergji mund ta bëjnë kohezionin shoqëror - fakt.

Është stadi kur po identifikohen të gjitha korsitë e mundshme *ku mund dhe duhet* të integrohet dhe fuqizohet gruaja jo thjesht si individ. Shoqëria globale ka pranuar liritë e grave por ende nuk është gati të realizojë plotësisht dhe kudo të drejtat e tyre. Ende shoqëria prodhon barriera në rrugën për respektimin e të drejtave të grave në jetën e përditëshme. Ende shoqëria nuk i ka garantuar dhe kompensuar<sup>10</sup> gruas (institucionalisht dhe në veprime praktike) funksionin natyror, riprodhues, që garanton mbijetesën e species njerëzore – riprodhimin e vetvetes.

<sup>7</sup> Emancipimi është procesi ku individ i grua/burrë, pëson ndryshime esenciale brenda vetes dhe bëhet i gatshëm për ta deklaruar, mbrojtur dhe arsyetuar, nivelin e tij/saj të emancipimit.

<sup>8</sup> Liritë themelore janë të njëjta për të dyja gjinitë.

<sup>9</sup> Të drejtat themelore të grave janë specifike dhe përtej të drejtave themelore të njeriut. Ato lidhen me funksionin riprodhues të saj.

<sup>10</sup> Kompensimi në forma të tjera i gruas për energjinë dhe kohën e shpenzuar gjatë funksioneve riprodhuese.

Revolucioni në emër të të drejtës së gruas për divorc përfundoi. E drejta e abortit ka triumfuar duke i garantuar asaj të drejtën për të mos u konsumuar në rolet vetëm riprodhuese.

E drejta e gruas për të dhe për t'u votuar është realizuar, duke i dhënë asaj mundësinë të ketë pushtet përtej mjedisit familjar, megjithëse është fakt se kudo gruaja vazhdon të jetë më pak e votuar. Por sot potencialisht gratë përfaqësojnë në shkallë të mjaftueshme ndërgjegje globale qytetare të konsoliduar dhe mekanizma e strategji për t'u integruar dhe fuqizuar. Është kapërcyer stadi kur gruas i duhej të priste komunitetin mashkullor të hapte portat për të hyrë në jetën aktive dhe në vendimarrje.

Proceset e integritit dhe fuqizimit të bashkësisë së grave filluan të marrin zgjidhje në kushtet e shoqërisë industriale. Teknologjia është identifikuar si aleate e fuqishme për realizimin e të drejtave të grave. Futja e teknologjisë në jetën e familjes i kompensoi gruas orët e shpenzuara për kryerjen e detyrimeve familjare duke i kthyer asaj kohën dhe vëmendjen për veten.

Në dekadat e fundit të shekullit 20-të, shoqëria globale fitoi dimensionin “shoqëri e hapur”. Ky proces mundësoi ballafaqimin e statusit të gruas në kultura dhe kode morale të ndryshme. Ky proces ballafaqimi dhe interferimi kulturor ka shënuar ndryshime dhe perspektiva të reja sociale, *rreth* dhe *për* fuqizimin e gruas.

*Diskriminimi pozitiv*<sup>11</sup> kaq i debatuar në fillimet e veta, përcolli dhe plotësoi nevojat imediate të grave për t'u afirmuar, integruar dhe fuqizuar. Rreziku që diskriminimi pozitiv si parim dhe si praktikë, të krijonte psikozën e “viktimitës” te gratë u evitua, duke rezultuar parim dhe praktikë produktive.

## Institucionalizimi<sup>12</sup>

Çështjet politike, sociale, ekonomike, arsimore dhe administrative që lidhen me integrimin gjinor janë në një proces institucionalizimi.

Institucionalizimi po vjen si një proces i qëllimshëm, objektiv dhe përmes strategjish në nivel global dhe lokal.

Konventat ndërkombëtare, të përhlyera në objektiva dhe strategji lokale, në përputhje me specifikat lokale dhe që përcjellin nevojat në nivelin lokal, konstatohen dukshëm në kushtetutat dhe legjislacionet lokale. Këto të fundit, të formuluar në frymën e dokumenteve globale, platformave globale për veprim dhe strategji, si ajo e Pekinit 1995, Samiti i Nju

<sup>11</sup> Diskriminimi pozitiv, shfaqet si parim i ndërtimit të legjislacioneve ku gruaja veçohet për efekte pozitive mbështetëse dhe inkurajuese.

<sup>12</sup> Institucionalizimi është sinkronizimi i veprimit të gjithë faktorëve: fryma dhe konventa globale, ligji lokal, institucionet lokale në identifikim dhe mbështetje të gruas, platformat mediatike në funksion të identifikimit të çështjeve gjinore, promovim, të gruas, avokatit të çështjeve gjinore, studime dhe polemika në nivele intelektuale.

Yorkut (2000), tentojnë ta bëjnë pjesë të *ndërgjegjjes politike* dhe morale të shoqërisë, çështjen e integritimit gjinor<sup>13</sup>.

Në dekadën e parë të shekullit tonë, çështjet *për* dhe *në* funksion të integritimit gjinor janë bërë pjesë e *vullnetit politik* të shteteve, që përkthyer në gjuhën e institucioneve, do të thotë se po ndërtohen dhe institucione (instrumente & ekspertizë, oponentë) në funksion dhe në zbatim të frymës së legjislacionit.

Në mënyrë të vendosur gruaja po mbështetet institucionalisht dhe veçanërisht shoqëria civile është bërë një aleate e fuqishme për integritimin gjinor. Në nivelin lokal, amendimet që i janë bërë Kodit të Punës, Kodit të Familjes, Kodit Penal, hartimi i ligjit “Për shëndetin riprodhues”, i ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i ligjit “Për masa mbrojtëse në marrëdhëniet familjare”, etj. në frymën e konventave globale, tregojnë se procesi i institucionalizimit të çështjeve gjinore në vendin tonë, po bëhet gjithnjë dhe më i pandalshëm.

Media vizive dhe ajo e shkruar në vendin tonë pritet të jetë aleate konstante e çështjeve gjinore, por shpesh duket se nuk e luan në cilësinë e kërkuar këtë rol dhe se media dhe stafet e saj ende janë larg frymës që përcjellin konventat globale. Në momentin kur edhe media bëhet aleate e çështjeve për integritim gjinor, procesi i institucionalizimit ngrihet në një stad më të lartë.

- *Sillni këndin tuaj të shikimit rreth institucionalizimit të çështjeve gjinore në përgjithësi dhe në vendin tonë në veçanti.*
- *Identifikoni në median lokale dhe kombëtare sa emisione fokusuar tek integritimi gjinor keni ndjekur dhe si pasqyrohen çështjet gjinore në media, në mënyrë sporadike apo me frekuencë të lartë.*
- *Sa shoqata në mbështetje dhe që promovojnë gruan ka në qytetin tuaj?*

<sup>13</sup> Ende nuk janë bërë pjesë e ndërgjegjjes morale dhe sociale të shoqërisë dhe ende nuk janë bërë pjesë e nevojës për ndryshim te vetë gruaja si individ.

## Përkatësia gjinore dhe qytetaria

### Hyrje

Ky kapitull do të përforcojë njohuritë teorike dhe praktike të nxënësve mbi konceptet kryesore të qytetarisë, rëndësinë dhe lidhjet e saj me gjininë. Nxënësit do të mësojnë të ndërmarrin aksione konkrete në mbrojtje të çështjeve gjinore si qytetarë të mirëinformuar dhe aktivë me të drejta dhe detyra të qarta.

- ♦ *Nëse i referohemi konceptit të mëposhtëm mbi barazinë gjinore, le të diskutojmë se çfarë është dhe çfarë nuk është barazia gjinore?*

Barazia mes grave dhe burrave i referohet të drejtave, përgjegjësive dhe mundësive të barabarta të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve.

Barazia midis grave dhe burrave shihet edhe si një çështje e të drejtave të njeriut edhe si një parakusht për/dhe tregues i zhvillimit me qendër njerëzit.

Barazia nuk është një “çështje e grave” por duhet të shqetësojë dhe të angazhojë burrat ashtu si edhe gratë. Barazia nuk nënkupton që gratë dhe burrat do të bëhen njësoj, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe shanset e burrave dhe grave nuk do të varen nga fakti nëse janë lindur meshkuj apo femra.

Barazia shtrihet në perspektivën sasiore edhe atë cilësore:

- Perspektiva sasiore ka të bëjë me shpërndarjen e barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e shoqërisë.
- Perspektiva cilësore i referohet nevojës për t'i dhënë peshë të barabartë dijeve, përvojës dhe vlerave si të grave ashtu edhe të burrave si një mjet për të pasuruar dhe drejtuar të gjitha fushat e zhvillimit të shoqërisë.

Kuptimi social i të qenit burrë apo grua:

**I referohet karakteristikave të përdorura nga një grup social për të përcaktuar të qenit burrë ose grua.**

**Rolet gjinore janë:** role sociale, të mësuara, janë dinamike që ndryshojnë në kohë dhe në kultura të ndryshme.

**Seksi është:** biologjikisht i përcaktuar, universal dhe i pandryshueshëm.

Bazuar në çfarë u tha më sipër lind pyetja, pse përkatësia gjinore është marrëdhënie sociale?

Përkatësia gjinore është marrëdhënie sociale, sepse të qenit burrë apo grua është marrëdhënie e përcaktuar nga faktorë socialë.

Përpara se të thellohemi në këtë kapitull mbi barazinë dhe qytetarinë le të përpiqemi të diskutojmë dhe t'i japim një përkufizim pyetjeve të mëposhtme:

Pyetje	Përgjigje
♦ Çfarë kuptojmë me shoqëri me të drejta të barabarta?	♦
♦ Çfarë do të thotë individë me mundësi të barabarta?	♦
♦ Pse gjinia është marrëdhënie sociale?	♦
♦ Çfarë është qytetaria aktive?	♦

## Koncepte kryesore

Qytetaria është një nga termat që kuptohet nga çdo njeri, por është vështirë për të arritur në një përkufizim të përbashkët. Arsyeja e kësaj vështirësie pjesërisht është, sepse tradita të ndryshme kanë sjellë argumente të ndryshëm dhe pjesërisht sepse mënyra se si ne e përkufizojmë qytetarinë reflekton mjedisin social dhe politik të cilit ne i përkasim. Sipas Lister (1998) qytetaria mund të kuptohet si *lëvizje të ndryshme sociale duke përfshirë edhe lëvizjet feministe për t'i bërë të dukshme dhe politike nevojat e tyre*. Kuptimi i qytetarisë në politikën feministe shikohet në katër dimensione:

- Politik,
- Ekonomik (barazia ekonomike substanciale që lidhet me të drejtën e pronës, tregun e punës dhe punën e papaguar),
- Kulturor (normat dhe vlerat sociale),
- Personal, në familje, shtëpi dhe marrëdhënie.

Të katër dimensionet janë shumë të rëndësishme në mënyrë që qytetarët të mirëfunksionojnë në shoqëri. Procesi i ndërtimit të të drejtave në një shtet gjithëpërfshirës, ku qytetarët kanë mundësi dhe të drejta të barabarta, është një proces që ndihmon në ripërcaktimin e kuptimit të kombit dhe qytetarisë.

Sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe shpjegimi i termit *qytetari* është:

**QYTETARI, - A f.** Të qënit qytetar i ligjshëm i një shteti të caktuar; vetëdija e njeriut të lirë për të drejtat e detyrat që ka në një shtet; mënyra e jetesës në një qendër të banuar sipas rregullave e detyrave shoqërore; drejt.civil. *Ndjenja e qytetarisë. Normat e qytetarisë.*

2. *libr.* Që është tipar dallues i njeriut të lirë, i cili është i vetëdijshëm për të drejtat dhe detyrat që ka në një shoqëri dhe në një shtet; që ka të bëjë me jetesën sipas rregullave e detyrave shoqërore; drejt. Civil. *Detyrë qytetare. Edukata qytetare. Të drejtat qytetare.*<sup>14</sup>

**QYTETARËSI, - A f.** Njohja zyrtare e të drejtave të atij që është banor i një qyteti të caktuar; të qenit zyrtarisht banor i një qyteti. *Mori qytetarësinë.*

Përkufizimi i *qytetarisë* sipas fjalorit Webster's New World College Dictionary<sup>15</sup>

- statusi ose kushtet e një qytetari,
- detyrimet, të drejtat dhe privilegjet e këtij statusi,
- sjellja e një personi si qytetar.

Qytetaria ka të bëjë me atë se kujt i përket individi në një grup, në një komunitet dhe cilat janë të drejtat dhe përgjegjësitë e shoqëruara me të.

### Përse sot flitet për qytetarinë dhe gjininë?

Pabarazia dhe përjashtimi social për gratë dhe vajzat, si dhe grupe të tjera të rrezikuara janë rritur dukshëm në dekadën e fundit. Të studiosh qytetarinë do të thotë të shikosh se si njerëzit të cilët përbëjnë një grup, komunitet apo komb punojnë së bashku për të vendosur mënyrën sesi të funksionojnë. Duke marrë parasysh aktivitetin e tyre, rolet, përgjegjësitë si pikënisje të parë qytetaria hap mundësi të reja për të adresuar apo ndrequr përjashtimin e grupeve të rrezikuara pjesë e të cilave janë edhe gratë dhe vajzat.

### Dokumente ndërkombëtarë

Qytetaria dhe barazia gjinore synojnë të krijojnë mundësitë dhe të drejtat të barabarta, të ngrenë shqetësimet themelore në debatet dhe praktikatat e qeverisjes në të gjitha nivelet. Janë një kornizë për të lehtësuar iniciativa të reja në vende të ndryshme të botës. Janë koncepte gjithëpërfshkues në dokumente të ndryshëm globalë. Edhe për këtë lëvizjet feministe në vende të ndryshme të botës kanë përdorur në mënyrë krijuese **Konventën**

<sup>14</sup> Fjalor i gjuhës së sotme shqipe © Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë Tiranë, 1984.

<sup>15</sup> Webster's New World College Dictionary Copyright © 2005 by Wiley Publishing, Inc., Cleveland, Ohio.

për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Platformën e Pekinit, konferencat për popullsinë dhe zhvillimin, samitet sociale, konferencat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe instrumentet e tjerë ndërkombëtare për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet që lidhen me drejtësinë sociale dhe barazinë.

Shqipëria e ka ratifikuar Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) nëpërmjet ligjit nr.7767, datë 09.11.1993.

Që nga ky moment qeveria shqiptare dhe institucionet e saj në respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo konventë, kanë filluar të integrojnë standardet ligjore ndërkombëtare në kuadrin e brendshëm ligjor. Gjithashtu nëpërmjet Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sigurohet zbatimi i kuadrit ligjor dhe angazhimi i institucioneve qeveritare që të garantojnë të drejtat gjinore të individit në bazë të kësaj konvente. Politikat evropiane të barazisë gjinore bazohen në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Gjashtë fushat prioritare të BE-së për barazinë gjinore (2006-2010) janë: pavarësi ekonomike e barabartë për gratë dhe burrat, përputhje e jetës private me atë profesionale, përfaqësim i barabartë në vendimmarrje, zhdukje e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, eliminimi i stereotipave gjinorë, promovimi i barazisë gjinore në politikat e jashtme dhe të zhvillimit.

## Dokumente kombëtare

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, neni 18, garanton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individit dhe ndalon çdo lloj diskriminimi. Kushtetuta gjithashtu siguron mbrojtje të veçantë për familjen, fëmijët dhe të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja.  
Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, (në nenin 18, pika 2) parimi i mosdiskriminimit formulohet në këtë mënyrë: “Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja”. Kushtetuta ka parashikuar që marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat RSH është palë bëhen pjesë e legjislacionit të brëndshëm, madje kanë epërsi mbi legjislacionin vendas.
- Kuvendi i Shqipërisë, në korrik 2008, miratoi ligjin nr. 9970 **“Për barazinë gjinore në shoqëri”**, i cili synon zbatimin e të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat, të garantuara nga Kushtetuta, në nenin 18 të saj. Në të parashikohet ngritja e strukturës së plotë shtetërore për barazinë gjinore dhe përcaktohen qartë detyrat dhe kompetencat përkatëse të çdo institucioni.
- **Kodi Penal** i miratuar më mars 1995, ligji nr. 7905, siguron barazinë mes burrit dhe gruas në të gjitha fushat e jetës, shëndetit, pronës dhe dinjitetit. Sipas këtij kodi, për krime të njëjta, gratë marrin të njëjtat dënime si burrat.
- **Kodi Civil** i miratuar me ligjin nr 8781, datë 03.05.2001, u njeh grave të drejta të barabarta në të gjitha proceset ligjore, siç është e drejta për të ngritur padi ndaj dikujt apo për t’u gjykuar.
- **Kodi i Familjes** i miratuar në maj 2003, ligji nr. 9062, parashikon të drejta të barabarta midis burrit dhe gruas që të zgjedhin lirisht për t’u martuar apo divorcuar si dhe të drejtat dhe detyrat e ndërsjella në familje për edukimin dhe rritjen e fëmijëve.

Legjislacioni shqiptar i barazisë gjinore mbështetet në disa konventa të Kombeve të Bashkuara të tilla si: Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut; Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave; Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; Konventa për Parandalimin e Torturës dhe Mizorive, Ndëshkimit ose Trajtitimit Çnjerëzor e Poshtërues. Shqipëria gjithashtu ka ratifikuar një varg traktatesh të Këshillit të Evropës, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me barazinë gjinore, si: Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Karta Sociale Europiane dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Këto instrumente ndërkombëtarë, të ratifikuar nga qeveria shqiptare, përmbajnë detyrime për shtetin shqiptar për plotësimin e standardeve të caktuara që sigurojnë mbrojtjen e duhur nga diskriminimi me bazë gjinore.

- **Mekanizmi kombëtar për sigurimin e barazisë gjinore**

Ligji për barazinë gjinore në shoqëri, përcakton Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB), si autoritetin përgjegjës për sigurimin e barazisë gjinore në Shqipëri. Ligji vë theksin në nevojën e forcimit të mekanizmave shtetërorë për integrimin gjinor. Që prej 2006, MPÇSSHB-ja e ka ushtruar veprimtarinë e saj në fushën e barazisë gjinore, nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të Shanseve të Barabarta (DPSHB). Mandati i DPSHB-së është zgjeruar dhe përfshin përpunimin dhe zhvillimin e politikave për nxitjen e barazisë gjinore, trajtimin e çështjeve të pakicave etnike, etno-kulturore dhe gjuhësore si dhe luftën kundër diskriminimit racial. Përsa i përket çështjeve gjinore në veçanti, DPSHB-ja punon për të nxitur barazinë gjinore dhe për rritjen e pjesëmarrjes së gjerë të grave në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të vendit.

Nga viti 2006 e këtej janë bërë hapa të rëndësishëm përpara me caktimin e pikave fokale të barazisë gjinore (PFBGJ) në nivel qendror dhe vendor, në 14 ministri të linjës, 12 prefektura dhe 58 bashki.

Caktimi i PFBGJ-ve dëshmon rëndësinë në rritje të barazisë gjinore në punën e institucioneve shtetërore. PFBGJ-të janë përfshirë, në një farë shkalle, në procesin e përpunimit të politikave qeverisëse, duke ndikuar kështu në rritjen e rëndësisë së çështjes së barazisë gjinore në të gjithë vendin.

Në Kuvend është ngritur Nënkomisioni për Barazinë Gjinore, të Rinjtë dhe të Drejtat e Fëmijëve pranë Komisionit Parlamentar për Shëndetësinë, Punën dhe Çështjet Sociale. Nënkomisioni bashkëpunon me MPÇSSHB-në për çështjet e barazisë gjinore dhe të të drejtave të fëmijëve. Ai ka një rol të rëndësishëm në shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve lidhur me barazinë gjinore.

- **Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe eliminimin e dhunës në familje**

Këshilli i Ministrave në dhjetor të 2007, miratoi Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje, si dhe Planin e Veprimit, që përbëjnë dokumente të rëndësishme për progresin e barazisë gjinore në Shqipëri.



Synimi i Strategjisë është të paraqesë rrugët dhe mekanizmat institucionalë për përfshirjen e çështjeve gjinore në politikat publike, për zbutjen e dallimeve gjinore dhe dekurajimin e parandalimin e dhunës në familje.

Strategjia është konceptuar në dy pjesë: Barazia gjinore dhe Lufta kundër dhunës në familje, të cilat janë të ndërthurura ngushtë me njëra - tjetrën, por kanë edhe specifikat e tyre. Drejtimet kryesore të strategjisë janë përcaktuar mbështetur në kushtet aktuale të vendit dhe i referohet problemeve më shqetësuese me të cilat përballet shoqëria shqiptare. Këtij qëllimi i shërben analiza e situatës aktuale në 12 qarqet e vendit, analiza e studimeve të fundit të realizuara nga institucionet qeveritare, shoqëria civile dhe ekspertët të barazisë gjinore dhe dhunës në familje, mbështetur në standardet ndërkombëtare si Plani i veprimit i Pekinit, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), Objektivat e Mijëvjeçarit etj.

Qëllimet strategjike të këtij dokumenti janë formuluar duke u bazuar në zbrëthimin e prioritetëve strategjike. Për çdo fushë, qëllimet strategjike janë detajuar më tej dhe në objektiva specifike e veprime konkrete që duhet të ndërmerren. Më poshtë keni një pasqyrë të qëllimeve strategjike:

#### **Qëllimi 1**

Forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë mbrojtës me qëllim sigurimin e barazisë gjinore në Shqipëri.

#### **Qëllimi 2**

Fuqizimi i gruas nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së saj në vendimmarrje.

#### **Qëllimi 3**

Fuqizimi ekonomik i gruas dhe rritja e mundësive të saj për punësim dhe kualifikim profesional.

#### **Qëllimi 4**

Promovimi i aksesit të barabartë të grave dhe vajzave në arsimin cilësor.

#### **Qëllimi 5**

Përmirësimi i situatës sociale të grave dhe vajzave në risk nëpërmjet rritjes së qasjes së tyre ndaj shërbimeve sociale cilësore.

#### **Qëllimi 6**

Përmirësimi i shëndetit të popullsisë duke rritur përgjigjen e sistemit shëndetësor ndaj nevojave të veçanta shëndetësore të grave/vajzave dhe burrave/djemve.

#### **Qëllimi 7**

Përmirësimi i rolit të medias për një mentalitet të ri, që i përgjigjet zhvillimit të kohës, lidhur me barazinë gjinore në shoqëri dhe rritjen e përfaqësimit të grave dhe vajzave në këtë profesion.

**Qëllimi 8**

Të rritet dhe zhvillohet ndërgjegjësimi i shoqërisë kundër dhunës në familje dhe masave për të ndihmuar viktimat nëpërmjet ndryshimit të qëndrimeve.

**Qëllimi 9**

Kuadri ligjor dhe struktura drejtësie - garante për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

**Qëllimi 10**

Të përmirësohen shërbimet dhe mbështetja për të gjitha viktimat e dhunës në familje.

**Të dhëna dhe fakte**

Indeksi i barazisë gjinore 2008

Shqipëria renditet e 87 midis 130 vendeve

Popullsia (milion), 2006	3.18
Rritja e popullsisë (%)	0.58
GDP (PPP) për frymë	5.705
Mosha mesatare e martesës për femrat	23
Shkalla e pjellorisë (lindje për femra)	2.1
Viti në të cilin gratë fituan të drejtën e votës	1946
Raporti i përgjithshëm i popullatës (meshkuj/femra)	1.04

Treguesit plotësues për përcaktimin e indeksit për Shqipërinë:	Renditja botërore	%Femra / Meshkuj	Rezultati renditës (1 = barazi)
Mundësite dhe angazhimi ekonomik	62		0.649
Pjesëmarrja në tregun e punës	73	55 / 75	0.72
Barazia në pagesë për punë të ngjashme	57		0.68
Arritja akademike	68		0.991
Shkalla e edukimit	55	99 / 99	0.99
Regjistrimi në ciklin e ulët	79	93 / 94	0.99
Regjistrimi në ciklin e mesëm	90	72 / 74	0.97
Regjistrimi në ciklin e lartë	1	23 / 15	1
Kujdesi shëndetësor	118		0.995
Raporti në lindje (femra/meshkuj)	125		0.91
Fuqia politike	119		0.041
Femra në parlament	114	7 / 93	0.08
Femra në poste ministrore	106	7 / 93	0.07
Vitet nën udhëheqjen femërore (50 vitet e fundit)	40	0 / 50	0

## Fakte mbi gratë në botë

- ◆ Gratë kryejnë rreth 66% të punës në botë dhe marrin si këmbim vetëm 11% të të ardhurave,
- ◆ Gratë zotërojnë vetëm 1% të tokës në botë,
- ◆ Gratë përbëjnë 66% të të rriturve të pashkolluar,
- ◆ Gratë drejtojnë 83% të familjeve me një prind,
- ◆ Gratë janë 6 milion më shumë se meshkujt në botë,
- ◆ Dhuna mbi baza gjinore vret gati një në tre gra në botë, duke përbërë shkakun më të madh të vdekjeve për gratë në mbarë botën.

## DILEMA, STEREOTIPA GJINORË

### Të gjithë të barabartë

Barazia e parë në kontekstin e trajtimit të barabartë të qytetarëve nuk ka shumë kuptim për gratë dhe grupet e prekura që dallojnë nga standardet që përcaktojnë qytetarinë. Në realitet, grupe të ndryshme kanë nevoja të ndryshme. Për shembull, ndërsa një burrë dhe një grua kanë të drejtën të punojnë, gratë kanë më tepër nevojë për mbështetje që të ushtrojnë këtë të drejtë. Gratë në punë kanë nevojë për leje lindje, kushte shtesë gjatë shtatzënisë dhe ditë pushim në lidhje me nevojat e tyre femërore. Pabarazia vjen si pasojë e mungesës së mirëkuptimit të këtyre diferencave midis grupeve të ndryshëm. Gratë rezultojnë të jenë më tepër të punësuar në fushën e edukimit, kujdesit shëndetësor, ndërsa burrat më tepër në fushën e ndërtimit, transportit, etj.

### Të drejtat e grave dhe vajzave, përfshirja dhe përjashtimi

Arritja e të drejtave të gruas është një betejë globale e bazuar në të drejtat njerëzore dhe shtetin e ligjit. Kjo kërkon bashkimin e të gjithëve për t'i dhënë fund praktikave, traditave, zakoneve dhe ligjeve të cilat cënojnë gruan. Beteja për të drejtat e gruas në praktikë nënkupton pjesëmarrjen aktive të të gjithë qytetarëve në aksione për të ndaluar diskriminimin dhe dhunën kundër saj.

Përjashtimi i grave nga të drejtat dhe detyrimet qytetare është i njohur në disa shoqëri në botë, në të shkuarën dhe në të tashmen. Pas shpalljes së pavarësisë në SHBA, gratë e martuara sipas ligjit nuk njiheshin si individë të pavarur, sepse konsideroheshin të ishin nën mbrojtjen e burrit të tyre. Gratë nuk mund të zotëronin pronë, të kontrakttoheshin dhe të merrnin në mbrojtje fëmijët e tyre. Këto kushte të pabarazisë në fakt përjashtojnë gratë të ushtrojnë të plota të drejtat e tyre qytetare.

### Si diskriminohen gratë dhe vajzat?

Diskriminimi është i pranishëm në të gjitha moshat dhe stadet e zhvillimit për gratë në botë.

## Embrioni dhe foshnjëria:

Sipas UNICEF-it kur kemi të bëjmë me preferencat ekonomike dhe/ose kulturore për djem, mjetet diagnostikuese keqpërdoren gjatë shtatzënisë për të abortuar. Kjo do të thotë që në shumë vende prindërit vendosin të abortojnë ose ta japin fëmijën për t'u birësuar nëse është vajzë.

### **Të ardhurat:**

Në shkallë botërore, gratë kultivojnë më tepër se gjysmën e produkteve ushqimore bujqësore. Në Afrikë dhe Karaibe ato prodhojnë deri në 80% të të gjithë ushqimeve. Pavarësisht kontributit, puna e grave paguhet shumë pak dhe në disa raste nuk paguhet fare sepse, në të tilla shoqëri mbizotërojnë rolet tradicionale mbi punën e papaguar të gruas. Sipas një raporti të Departamentit Amerikan të Shtetit gratë paguhen vetëm 72 cent për çdo dollar që fiton një burrë. Raporti citon se rreth 11% e kësaj diference shkaktohet nga diskriminimi në pagesë për gratë.

### **Mëmësia dhe pleqëria:**

Këto janë dy periudhat në jetën e shumë grave, kur efektet dëmtoese të varfërisë dhe pabarazisë bashkohen dhe ndikojnë negativisht. Është vlerësuar se çdo vit më tepër se gjysëm milioni gra, pra afërsisht një grua në minutë, vdes si rezultat i komplikimeve dhe pasojave të shtatzënisë dhe lindjes së foshnjës, 99% e rasteve të tilla ndodhin në vendet në zhvillim. Më tej, gratë e moshuara ndeshen me diskriminimin e dyfishtë mbi bazën e moshës dhe të gjinisë. Shumë gra zhyten në varfëri gjatë jetës së tyre atëherë kur janë më të brishta.

## NJË VËSHTRIM TEORIK

### **Qytetaria në këndvështrimin gjinor**

Sikurse u përmend edhe më sipër qytetaria ka të bëjë me pjesëmarrjen e një grupi ose komuniteti që diskuton të drejtat dhe përgjegjësitë si rezultat i kësaj pjesëmarrjeje. Qytetaria është status - identitet - praktikë ose proces i marrëdhënieve të botës sociale përmes ushtrimit të të drejtave dhe përbushjes së detyrimeve.

---

#### *Diskutim për nxënësit*

- *Listoni të drejtat themelore të qytetarëve.*
  - *Listoni detyrimet e qytetarëve.*
- 

Teoria e qytetarisë i ka rrënjët e saj në politikën perëndimore dhe është bazuar në *qytetarin e përbotshëm*, një individ me të drejta, që angazhohet në insitucionet qeveritare, debatet politike dhe në arenën publike shtetërore. Forma e qytetarisë ndryshon në kontekstin historik dhe kulturor. Njerëzit e përcaktojnë qytetarinë e tyre në mënyra të ndryshme, në marrëdhënie me vendbanimin, kombin ose komunitetin botëror. Një aspekt i rëndësishëm në të cilën qytetaria është ripërshtatur ka qënë futja e një perspektive gjinore nga aktivistët e lëvizjeve feministe dhe të atyre në mbrojtje të barazisë. Kjo ka sjellë shmangie në shumë interpretime dhe ndryshime të statusit dhe praktikave të qytetarisë.

Përjashtimi dhe marginalizimi nga qytetaria e plotë nuk ka të bëjë vetëm me të qenit gjeografikisht jashtë një procesi. Grupe të tilla si gratë, minoritetet etnike, të varfërit, fëmijët, etj., mund të jenë jashtë qytetarisë. Përvojat qytetare janë gjithashtu të varura nga pozicioni social, rolet e përcaktuara në marrëdhëniet sociale, të diktuar nga format e pabarabarta të fuqisë në bazë të racës, etnicitetit, kastës, klasës dhe gjinisë. Rolet dhe marrëdhëniet në shoqëri diktojnë gjithashtu kush është “brenda” dhe kush “jashtë” aktivitetit shoqëror si dhe diktojnë lloje të ndryshme të përjashtimit krahasuar me avantazhet që anëtarët e tjerë zotërojnë.

Barazia gjinore dhe kuptimi i qytetarisë janë të ndërthurura dhe të varura nga njëra-tjetra sepse konteksti kulturor, politik dhe institucional përcakton prioritetet strategjike dhe vendos kriteret dhe kufijtë se çfarë mund të bëhet për të promovuar barazinë gjinore. Qytetaria është një koncept që është zhvilluar e pasuruar ndër vite si pasojë e zhvillimeve sociale dhe lëvizjeve demokratike. Sot, qytetaria ka një kuptim të gjerë si për të drejtat që ofron për qytetarët ashtu dhe për domethënien që ka për ta. E parë në këtë këndvështrim, qytetaria si themeli ligjor i shoqërisë dhe duke u nisur nga shumëllojshmëria e ligjeve, zakoneve, kulturave dhe për më tepër, nga përkatësia gjinore, domethënia e qytetarisë dhe të drejtat përkatëse janë të ndryshueshme për kontekstin ku jetojmë.

Demokratizimi dhe zhvillimi e shikojnë qytetarinë si një element kyç i demokracisë dhe përgjegjshmërisë dhe si një kuadër të rëndësishëm për të kuptuar mundësitë e njerëzve në nevojë për të marrë pjesë në strukturat vendimmarrëse, si dhe për të vendosur për veten e tyre. Ndërsa ndeshemi me disa përkufizime të konceptit të qytetarisë, koncepti që duhet t'i referohemi në kontekstin e zhvillimit dhe të barazisë gjinore është ai se qytetaria formulohet nga të drejta të arritshme dhe pjesëmarrje të plotë në qeverisje.

### Roli gjinor në jetën publike dhe private

Ndarja në termin publik dhe privat e shikon rolin gjinor dhe përgjegjësinë e gruas të shtrirë në familje, duke u kujdesur për rritjen e fëmijëve dhe rolin e burrit të shtrirë në vendimmarrje, politikë, ekonomi familjare dhe marrëdhënie pune. Ndarja e roleve dhe punës është e rëndësishme për të kuptuar qytetarinë, që tradicionalisht e shikon burrin si mbajtës të të drejtave qytetare në varësi të pozicionit të tyre në jetën publike. Burrat janë dalluar si politikanë dhe gratë nën mbrojtjen e tyre. Gratë dhe shqetësimet e tyre kanë qenë jashtë sferës së qytetarisë dhe roli i

### Diskutim për nxënësit

- *Diskuto mbi të drejtat qytetare.*
- *Diskuto mbi mundësitë qytetare.*
- *Diskuto mbi vlerat qytetare.*

### Diskutim për nxënësit

- *Rolet e ndryshme në jetën publike të gruas dhe burrit.*
- *Perceptimi i komunitetit mbi rolin e gruas dhe rolin e burrit në shoqëri.*
- *Pse burrat janë më tepër të angazhuar në politikë?*
- *Diskuto mbi mundësitë dhe kontributet në jetën publike dhe private të grave dhe burrave.*

tyre kontribues në shoqëri, nuk është vlerësuar i rëndësishëm në kontekstin e vendimmarrjes dhe aktivitetit publik.

Kjo ndarje midis jetës publike dhe private ka sjellë disa implikime si:

- Çështjet që shqetësojnë gratë dhe vajzat mund të shihen si familjare dhe jo si publike apo komunitare. Për shembull, dhuna në familje dhe përdhunimi nuk konsiderohen shpesh si krime. Publiku i gjerë dhe qeveritë e shumë vendeve janë përpjekur që vendimmarrësit të hartojnë dhe aprovojnë një seri ligjesh dhe politikash që parandalojnë dhe luftojnë këto fenomene, megjithatë perceptimi dhe vullneti i zyrtarëve vazhdon të sfidojë zbatimin e këtyre ligjeve në shumë vende të botës.
- Të drejtat dhe “e mira e përbashkët” e komunitetit janë projektuar në interesin e burrave dhe grupeve shoqërore me rëndësi.
- Gratë shpesh nuk konsiderohen aktore të rëndësishme politike. Përpjekjet për të drejtat e gruas dhe aktivizimi i tyre në nivel komunitar nuk marrin rëndësinë e duhur politike. Edhe formave politike në të cilat gratë shpesh angazhohen si organizata me bazë komunitare nuk u jepet rëndësia e duhur politike.

---

### **Diskutim për nxënësit**

- *Cilat janë shifrat e përfaqësimit të gruas në Kuvendin e Shqipërisë?*
  - *qeveri,*
  - *përfaqësitë diplomatike,*
  - *qeverisjen vendore,*
  - *këshillat e qarkut,*
  - *këshillat bashkiake.*
- 

Analiza të shumta tregojnë se pjesëmarrja e burrave në politikë ka qënë e mundur si pasojë e punës së gruas në jetën private e familjare. Gratë e kanë më të vështirë të përfshihen në jetën publike, sepse i kushtojnë kohë të konsiderueshme jetës familjare dhe për më tepër autoriteti i burrave e kushtëzon pavarësinë e gruas dhe mundësinë e saj për të marrë pjesë aktivisht në politikë. Ndërsa në shumë vende gratë i kanë kaluar këto pengesa dhe kanë arritur një barazi të kënaqshme në vendimmarrje, ne jemi ende larg në këtë drejtim.

Sipas statistikave gratë përbëjnë rreth 15% të parlamenteve në mbarë botën.

### **Qytetaria dhe individët**

Koncepti i qytetarisë e ka origjinën në politikat perëndimore të demokracisë dhe liberalizimit dhe është i bazuar në konceptin e individit si pjesëtar i shoqërisë demokratike. Qytetaria përshkruan marrëdhëniet midis individit dhe shtetit në të cilin individi është në gjendje të sigurojë mbrojtje dhe të marrë pjesë në jetën publike dhe vendimmarrjet e vendit të tij. Koncepti *qytetar i vërtetë* në origjinën e tij ishte ai/ajo që ishte i/e gatshëm/e të sakrifikoje jetën për atdheun e tij/saj. Me ndryshimet historike ky/kjo qytetar/e luftarak/e bëhet një votues/e në kontekstin e luftës për të drejtën për të votuar dhe në shekullin që kaloi të një qytetari/eje që mund të shkëmbejë në treg – tashmë një qytetar konsumator. Të gjithë

këta *qytetarë/e* kanë qënë në kohë të ndryshme të “vërtetë dhe “plotësisht” anëtarë të komunitetit apo grupit, ku rolet kishin përcaktuar anëtarësinë e tyre dhe ishin të vlerësuar dhe pranuar.

Të drejtat e qytetarisë në përfundim ishin ato të drejta të cilat tradicionalisht perceptoheshin si civile dhe të drejta politike që lejonin qytetarët dhe qytetaret të përfshiheshin në debate politike dhe në vendimmarrje në arenën publike. Qytetaria u jepte status legal këtyre të drejtave, ju jepte individëve kuptimin për të pretenduar për to, rrugën në të cilën duhet t’i adresonin.

Qytetaria, si një e drejtë për barazi për të gjithë njerëzit të cilët kanë arritur sukses të jenë anëtarë të një kombi, është e bazuar në paanësinë, personin abstrakt, pa gjini, racë, klasë, etnicitet ose ndonjë marrëdhënie tjetër shoqërore. Barazia përfshin të gjithë qytetarët dhe qytetaret si të njëjtë. Ligji i cili garanton të drejtat e tyre, në vetvete është parë si neutral dhe zbatohet për të gjithë njëllor. Koncepteve të tilla ju referohemi si *qytetari universale*.

Qytetaria është bazuar më tepër te individët sesa në veprimin e komunitetit. Vëzhgimet tregojnë se për shumë njerëz marrëdhëniet dhe lidhjet me komunitetin janë një mundësi efektive për të shprehur pozicionin e tyre sesa identitetin personal. Shumë njerëz, veçanërisht gratë dhe vajzat, mendojnë se të drejtat e tyre si individë vijnë pas detyrimeve për fëmijët dhe familjen. Më tej, bazat e qytetarisë mbi mundësinë e individëve për të adresuar çështjet që i shqetësojnë ndoshta nuk reflektojnë rolin e gruas në vendimmarrje brenda familjes ose marrëdhëniet nëpërmjet tyre në komunitet. P.sh. në shumë komunitete tradicionale gratë e ushtrojnë pushtetin e tyre “pas kuintave”, dmth nëpërmjet mblesërisë, negociimit midis dy burrave, etj. Influenca e tyre jo detyrimisht nënkupton ngritjen në postet publike si një individ, por punën dhe marrëdhëniet me komunitetin.

Rolet dhe detyrimet e ndryshme sociale që janë formuar mbi gratë, mund të pengojnë individët, veçanërisht gruan, për t’u përfshirë në aktivitete dhe role të tjera të shumëllojshme në të cilat një individ mund të përfshihet. Realisht, gratë dhe burrat luajnë role të shumta në shoqëri, gratë mund të jenë dhe janë politikane, ashtu si dhe burrat mund të jenë dhe janë infermierë.

### Diskutim

- Nëse qytetaria është një mjet i dobishëm për të kuptuar të drejtat dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri, atëherë si do ta përdorim atë?
- Cilat janë format me të fuqishme të ushtrimit të qytetarisë nga individët?
- Cilat janë fushat për të cilat mund të kontribuojnë individët?

### Qytetaria aktive

Qytetari aktive do të thotë që njerëzit, qytetarët e një komuniteti mbartin disa role dhe përgjegjësi kundrejt shoqërisë dhe mjedisit ku jetojnë, pavarësisht se këta mund të mos

jenë në pozicione specifike udhëheqëse. Nëse një organ qeveritar apo institucion i akordon disa të drejta këtyre qytetarëve, atëherë këta duhet të kenë përgjegjësi të mbajnë këto të drejta. Një qytetar aktiv është ai/ajo që ushtron si të drejtat ashtu dhe përgjegjësitë në mënyrë të balancuar. Sfidat e këtij koncepti janë se megjithëse të drejtat janë të shkruara në ligje, përgjegjësitë nuk janë të mirëpërcaktuara. P.sh. qytetarët kanë të drejtën e kujdesit shëndetësor falas dhe të drejtën e votës, por votimi në zgjedhje nuk është i detyrueshëm, megjithatë disa qytetarë e përcaktojnë votimin si një përgjegjësi madhore. Të shkruash një përkufizim të qartë të përgjegjësisë së një qytetari aktiv është më e vështirë sesa të shkruash një listë të gjatë të të drejtave. P.sh. megjithëse pjesëmarrja në votime konsiderohet si përgjegjësi themelore për shumë njerëz, për personat me aftësi të kufizuara kjo përgjegjësi mund të mos realizohet plotësisht për shkak të aftësisë së kufizuar.

Për shkak të mungesës së interesit në çështje si p.sh. pjesëmarrja në zgjedhje, shumë qeveri e kanë përfshirë edukimin qytetar në sistemin arsimor. Në Kanada dhe Britaninë e Madhe kurset mbi qytetarinë aktive jepen në shkollat e ciklit të ulët dhe të mesëm. Shumë organizata të shoqërisë civile kanë integruar qytetarinë aktive në mandatin e tyre dhe ndërrmarin shumë programe për edukimin qytetar.

*Ide për pjesëmarrje:*

- *Organizoni një konkurs pikturë ose fotografie me temë: **dhunën dhe diskriminimin.***
- *Organizoni një konkurs poezie ose eseje në shkollën tuaj me temë: **dhunën dhe diskriminimin.***
- *Bëni një përmbledhje të kuadrit ligjor dhe politikave kombëtare mbi pjesëmarrjen qytetare, dhunën dhe barazinë gjinore.*
- *Diskutoni me nxënësit dhe studentët për të ndaluar gjuhën ofensive, fyese me bazë gjinore.*
- *Negocioni me mësuesit dhe drejtorinë e shkollës për të rishikuar rregulloret dhe udhëzimet mbi politikën diskriminuese për të vendosur një ekuilibër gjinor.*

## Studime rasti

*Rasti: Përjashtimi mbi bazë gjinore në Afrikën e Jugut.*

Në shumë raste në Afrikën e Jugut, përjashtimi ndikon te grate si pasojë e një tradite të fortë të përcaktimit të roleve gjinore. Në zona të ndryshme të Afrikës së Jugut, pavarësisht pretendimeve të barazisë sipas shtetit dhe ligjeve, gratë janë të përjashtuara nga pronësia e tokës dhe nga pjesëmarrja në strukturat vendimmarrëse.

Qytetaria në konceptin tradicional në Afrikën e Jugut është e lidhur me ndarjen e tokës. Toka kushtëzon perceptimin e ndryshëm midis burrit dhe gruas. Për burrat, toka përcakton shtyllën e marrëdhënieve sociale dhe fuqisë politike, ndërsa për gratë, toka përcakton një mundësi për mbijetesë dhe sigurimin e ushqimit. Burrat hezitojnë të



japin të drejtat e tyre të tokës, sepse mendojnë që gratë nuk do të mund ta përdorin atë ashtu siç duhet. Në këtë rast qytetaria i njihet familjes, jo individëve, dhe një familje që meriton qytetarinë është ajo që udhëhiqet nga një burrë.

### Diskutim me nxënësit

Si është e konstruktuar e drejta e pronësisë familjare midis burrit dhe gruas?

### Çfarë janë stereotipat?

Stereotipat janë përgjithësime të forta për njerëzit që i përkasin një kategorie të caktuar sociale. Të tilla besime kanë tendencën të shpërndahen në mënyrë universale brenda një shoqërie të dhënë dhe mësohen si pjesë e procesit të zhvillimit në atë shoqëri.

Kur flasim për stereotipa të rolit gjinor, ne flasim për grupe të strukturuar bindjesh rreth cilësive personale të grave dhe burrave. Megjithatë dallimet midis seksëve mund të mos i përshtaten individëve, vetë stereotipat kanë pushtetin si standard, të cilit mund t'i përshtaten, kundër të cilit të rebelohen, me të cilin mund t'i vlerësojnë të tjerët.

### Ushtrim - Proverbat

*Objektivat:*

- Të përshkruajnë stereotipat dhe rolet gjinore.
- Të analizojnë sa të vërteta dhe thellësisht të rrënjësura janë këto stereotipa.
- Të ndërgjegjësojnë pjesëmarrësit për ekzistencën dhe rolin e këtyre stereotipave dhe roleve gjinore

*Koha:* 30-40 min

*Metoda:* Ndarje përvojash dhe pjesëmarrje aktive

*Hapat:*

- Ndahen pjesëmarrësit në grupe. Nëqoftëse ka përfaqësues vajza dhe djem, ndahen veç vajzat dhe veç djemtë.
- Grupeve u ndahet nga një letër (flipchart), në të cilën pjesëmarrësit duhet të rendisin proverba, fjalë të urta popullore, thënie, pjesë nga poezi, vjersha, vargje apo këngë për burrat dhe gratë.
- Zakonisht grupit të djemve i kërkohet të rendisë proverbat dhe fjalët e urta që ekzistojnë për gratë dhe e anasjellta. Në qoftë se nuk ka përfaqësues burra, atëherë grupet punojnë me të njëjtën logjikë, por të ndarë përsëri: një grup shkruan proverbat dhe fjalët e urta për gratë dhe tjetri për burrat, ose për të dy.

- D. Pasi puna e grupeve ka përfunduar, mësuesi tërheq vëmendjen e pjesëmarrësve në interpretimin e çdo proverbe, fjale të urtë, pjesë nga vargje këngësh etj.

*Fokusohuni dhe ndaluni në fjalë të urta si: "Gruaja i ka flokët e gjata dhe mendjen e shkurtër" apo "Burrat nën hije lozin, kuvendojnë; pika që s'u bie se nga gratë rrojnë!", etj.*

### Ushtrim për nxënësit: Projekti juaj!

Le të supozojmë se ju të gjithë keni ndjekur një leksion mbi qytetarinë sot në mëngjes. Lektorë dhe të ftuar të ndryshëm ju folën për rëndësinë e marrjes së përgjegjësive në komunitet. Më pas, ju kërkuan të mendoni rreth disa çështjeve në komunitet për të cilat ne duam të bëjmë diçka.

1. Në grupe të vogla *diskutoni dhe mendoni se cilat mund të jenë disa ide për projekte të ndryshme në komunitetin tuaj?* Idetë mund të variojnë nga projekt për bibliotekë, internet kafe, një buletin, vizitë studimore, debat publik, aktivitet sportiv, etj. *Votoni dhe përzgjidhni ato më të mundshmet në lidhje me nevojën, rrethanat, mundësitë, burimet në dispozicion.*

2. *Bëni një listë të pyetjeve dhe çështjeve që duhet të keni parasysh për projektin tuaj? Ku dhe si do t'i gjeni përgjigjet e këtyre pyetjeve?*

3. Plotësoni fletën e mëposhtme:

Shkolla:	
Klasa:	
Projekti:	
Fusha e studimit:	Çfarë mendojmë për komunitetin tonë? Për çfarë është i shqetësuar komuniteti? Si mund të ndikojmë në ndryshimin e pritsëm?
Idetë për planifikimin: Gjeneroni ide! <i>Diskutoni mbi projektin:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Çfarë presin nxënësit?</li> <li>- Për cilat gjëra duhet të kërkojnë ata?</li> <li>- Çfarë kanë kërkuar ata?</li> <li>- Çfarë kanë gjetur ata?</li> <li>- Si i gjetën?</li> <li>- Çfarë metodash përdorën?</li> <li>- Çfarë gjetën se ju duhet?</li> <li>- Çfarë duhet të bëjnë ndryshe dhe pse?</li> </ul>	

<p><i>Kërkoni!</i> Si grup mendoni për një metodë kërkimi që mund të aplikoni në klasë, shkollë apo komunitet. Hartoni një plan ku të përfshihen: a) metoda e kërkimit, e mbledhjes së informacionit; b) afati kohor; c) burimet; ç) objektivat e kërkimit; d) rezultatet e pritshme.</p>	
<p><i>Inkurajoni nxënësit të mendojnë rreth vlerave të komunitetit kur planifikojmë një projekt!</i></p>	<p>Zhvilloni lidhjet me komunitetin, biznesin vendor, këshillin vendor, si dhe autoritetet arsimore.</p>
<p>Zhvillimi i aftësive për pjesëmarrje: Vlerësimi:</p>	<p>Vetëvlerësoni dhe konsultoni vlerësimin me shokët tuaj.</p>

## Metodologjitë kryesore të sjelljes së çështjes gjinore në ekstrakurrikul

I gjithë kapitulli është konceptuar në formën e bashkëbisedimit me nxënësit. Ushtrimet, rastet studimore etj. janë vënë me qëllim për ta bërë sa më praktik dhe të thjeshtë për t'u kuptuar.

## Ndryshimi

Edukimi luan një rol të rëndësishëm në mënyrën sesi ne e shikojmë botën përreth. Edukimi influencon atë çfarë ne shikojmë si të mundshme dhe si të veprojmë. Prandaj është e rëndësishme të sfidojmë jo vetëm praktikën, por edhe të kuptuarit tradicional mbi pabarazinë. Qytetaria synon të shtyjë përpara bazat e shoqërisë, rregullat që përcaktojnë shpërndarjen e burimeve dhe sistemet që krijojnë pabarazinë. Riformulimi i qytetarisë nga një perspektivë gjinore ka mundësuar shumë aktorë të ndryshëm të adresojnë çështje të rëndësishme të zhvillimit si varfëria dhe pabarazia.

**Aktivitet: Ndryshimi i pritshëm**

Qëllimi i këtij aktiviteti është të përshkruani një ndryshim së fundmi në shkollën tuaj mbi qytetarinë dhe barazinë gjinore.

Përdorni tabelën e mëposhtme për të përshkruar ndryshimin:

Pyetje referuese	Përshkrimi i ndryshimit	
Shkruani mbi një ndryshim në shkollën tuaj mbi qytetarinë dhe barazinë gjinore.		
Si dhe çfarë e filloi këtë ndryshim? <ul style="list-style-type: none"> <li>politika, vendime dhe ligje nga qeveria e kuvendi;</li> <li>rregullore e drejtorisë arsimore ose e shkollës;</li> <li>këshilli i nxënësve dhe i mësuesve;</li> <li>të tjera.</li> </ul>		
Përshkruani procesin e ndryshimit. Si ndodhi?		
Cilat grupe brenda shkollës u përfshinë në proces?	E mirëpritën	E kundërshtuan
Kush përfitoi nga ky ndryshim? Kush u prek nga ky ndryshim? Si?	Përfituan	Humbën
Cilat janë rezultatet e këtij ndryshimi për njerëz të ndryshëm, si p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> <li>Ju,</li> <li>Shokët e klasës,</li> <li>Mësuesit,</li> <li>Drejtuesit e shkollës,</li> <li>Administrata e shkollës,</li> <li>Prindërit,</li> <li>Femrat,</li> <li>Meshkujt,</li> <li>Të tjerë.</li> </ul>		
Çfarë mësuat nga kjo përvojë ndryshimi?		
Çfarë do të donit të bënit ndryshe herë tjetër?		

## Rrugët për t'u bërë aktivë

- Informo miqtë e tu për të drejtat e grave në Shqipëri dhe në botë.
- Identifiko një çështje dhe merr përsipër për të bërë një fushatë ndërgjegjësimi në shkollë apo në komunitet.

Si të zhvillojmë një fushatë ndërgjegjësimi në komunitet apo në shkollë në lidhje me kauzën tuaj.

Shanset janë që ka shumë njerëz jashtë të cilët nuk dinë shumë rreth kauzës tuaj dhe sa shumë i ndikon ajo jetët e tyre. Shiko mundësinë për të bërë dhe shpërndarë fletëpalosje në mënyrë që ata të mund të mësojnë rreth saj dhe si ata mund të kontribuojnë.

## Kontrollo dy herë

Si fillim kontrollo nëse je i/e lejuar të vendosësh shenjat/posterat rreth shkollës, në kabinat e telefonave publikë dhe në vendet e tjera në qytet, bibliotekën publike, bizneset private, apo shkollën.

## Bëj disa kërkime

Grumbullo të dhëna me numra dhe fakte. Gjej sa më shumë të dhëna shokuese, tërheqëse, interesante duke përfshirë fakte dhe shkaqe, pasoja dhe rreziqe.

## Investigo

Gjej fakte dhe informacione në lidhje me kauzën tuaj, por që kanë ndodhur në zonën e komunitetit tuaj. P.sh. nëse kauza juaj është abuzimi me alkoolin merr në telefon shërbimin shëndetësor në zonën tuaj dhe pyet nëse ata kanë të dhëna të detajuara për këtë fenomen në qytetin tuaj. Përfshi këto të dhëna në posterat dhe materialet e tjera që do të përgatitësh për fushatë.

## Detaje

Shih nëse mund të gjesh ndonjë shprehje nga ekspertë të fushës. Shko në universitetin më të afërt dhe fol me ndonjë pedagog. Nëse tema juaj do të jetë për personat e droguar, për më shumë informacion pyet një person që është shëruar, pa i përmendur emrin. Historitë e vërteta janë gjithmonë shumë të fuqishme.

## Imazhet

Në shumë raste fotografitë flasin me tepër se fjalët dhe japin mesazhin më shpejt se fjalët.

Përdor sa më shumë fotografi. Përpiquni që fotografitë të jenë të lidhura me temën që ju trajtoni dhe mundësisht t'i përkasin rajonit ku ju operoni.

### **Fuqia është te njerëzit**

Tani që ju keni gjithë këtë informacion, merrni disa miq/shokë për t'ju ndihmuar për të dizenuar dhe kompletuar posterin ose fletëpalosjen që doni të bëni. Ata gjithashtu mund t'ju ndihmojnë t'i vendosni ato në stendë apo t'i shpërndani në shkollë dhe qytet, në rastin e fletëpalosjes.

### **Shumëllojshmëria është kyçi**

Mbani mend, në mënyrë që ta bëni këtë fushatë të efektshme, ju duhet ta plotësoni strategjinë tuaj me shumëllojshmëri aktivitësh. Kështu p.sh. mund të mendoni të bëni lloje të ndryshme fletushkash:

- Fletushka të vogla për t'i shpërndarë te njerëzit,
- Postera të mëdhenj me ngjyra, të cilët mund t'i vendosni në qendër të qytetit ose te kabinat e telefonit,
- Fletëpalosje informative, të cilat mund t'i shpërndani dhe ngjisni në vende të dukshme ku vendosen njoftimet në qytet.

### **Koha**

Koha është shumë e rëndësishme. Duhet gjetur momenti i përshtatshëm për të bërë fushatën tuaj. Datat e caktuara ndërkombëtare janë një moment shumë i mirë. Gjithsesi nëse e humbisni këtë datë përsëri mund të bëni një fushatë në një periudhë tjetër të përshtatshme.

### **Jini kurajoz**

Mendo për vende strategjike ku mund të vendosni posterat. Kujdesu për marrjen e lejës përpara se t'i vendosësh ato. Vendosja e posterave dhe fletëpalosjeve te supermarketet janë një vend strategjik ku njerëzit mund t'i gjejnë shumë shpejt. Stacionet e autobusit, trenit, baret e qytetit madje edhe në dyert e banjave. Proveni!

### **Vendos dhe rivendos**

Mbani mend që moti i keq mund t'i heqë posterat që ju keni vendosur pak ditë më parë. Parashikoni të ktheheni në të njëjtat vende disa ditë më pas për t'i rivendosur prapë dhe për të rishpërndarë fletëpalosje përsëri.

## Ndihmë nga të tjerë

Ju mund të ftoni folës të jashtëm të vijjnë dhe flasin me nxënësit në shkollën tuaj. Psh nëse tema për të cilën ju do të bëni fushatë është dhuna në familje, mund të ftoni një përfaqësues nga policia, i cili mund të flasë për situatën në rajonin tuaj dhe masat që duhet të merren. Ose nëse fushata juaj do të jetë për përfshirjen më të madhe të grave në politikë mund të parashikoni të thërrisni kryetarët/kryetaret e partive politike në qytet ose kryetarin apo anëtarë të këshillit bashkiak për të folur për rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje. Zakonisht ata janë të gatshëm të vijjnë dhe të flasin për ju.

Dhe mos harro, bëj diçka që t'ju tregosh të tjerëve se çfarë keni bërë!

## Ide të tjera të thjeshta

- Organizo një konkurs pikturë me temë për dhunën dhe pyet galerinë lokale të artit ose në ndonjë supermarket për të vendosur vizatimet fituese.
- Bëni një konkurs esesh në shkollë me temë *Dhuna dhe shëndeti*.
- Shiko nëse shkolla ka politika kundër diskriminimit ku përkatësia gjinore dhe seksualiteti janë pjesë e tij. Nëse nuk ka të tilla, përpiku të bësh një draft dhe ta sugjerosh në drejtorinë e shkollës.
- Mblidh donacione në shkollë dhe çoi ato në një organizatë lokale që mbron të drejtat për të cilat t'ji beson.
- Ndihmo miqtë e tu të ndjehen të lirë të flasin për lidhjet e dhunshme me njëri-tjetrin! Si?<sup>16</sup>
- Organizo një fushatë ndërgjegjësimi për të drejtat e njeriut. *Të drejtat universale dhe përse janë të rëndësishme për mua?*
- Mbështet aktivitetet e bashkisë kundër dhunës ndaj grave në komunitet.
- Fillo ngritjen e një klubi "BËJ DIÇKA" në shkollën tuaj.
- Shkruaj një pjesë rreth barazisë dhe luaje në shkollë.

## Mëngjesi i qytetarisë

Organizoni mëngjesin e qytetarisë në shkollë. Ftoni në shkollë persona publikë të ndryshëm të cilët të flasin për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve si dhe për përgjegjësitë në komunitet.

Në një sesion të veçantë nxënësit flasin se cilat janë disa nga fushat që ne do të donim të ndryshonin ose të sillnin një ndryshim pozitiv. Më pas në grupe pune më të vogla nxënësit ndahen për të shkruar projekte konkrete për aktivitetet. Dhe së bashku vendoset se cili aktivitet do të zbatohet në të ardhmen.

<sup>16</sup> Nëse na duhet të detajojmë se si mund të bëhet një fushatë për lidhjet e dhunshme tek adoleshentët <http://www.dosomething.org/node/add/1in3-abuse>

## Përmbledhje

**Reflekto mbi inventarin e besimeve fillestare! Identifiko ndryshimin mosndryshimin!**

Në këtë pjesë të programit është mirë që t'i rikthehemi dhe një herë përkufizimeve dhe perceptimeve të dhëna nga nxënësit. Ky ushtrim është në dobi të nxënësve, të cilët pasi janë njohur dhe diskutuar me shumë koncepte, praktika, raste studimore, njohuri dhe aftësi përgjatë këtij programi, kanë mundësinë të reflektojnë edhe njëherë mbi besimet fillestare të ndërthurjes së barazisë gjinore me qytetarinë.

Çështjet e diskutuara	Besimi fillestar	Besimi final
<p>Bazuar në çfarë u tha më sipër lind pyetja <i>pse gjinia është marrëdhënie sociale?</i></p> <p>Gjinia është marrëdhënie sociale sepse të qënit burrë apo grua është marrëdhënie e përcaktuar nga faktorë socialë.</p>	(I plotësuar në fillim të mësimit nga diskutimet)	Plotëso!
<p>◆ Nëse i referohemi konceptit të mëposhtëm mbi barazinë gjinore <i>le të diskutojmë se çfarë është dhe çfarë nuk është barazia gjinore?</i></p> <p>Barazia mes grave dhe burrave i referohet të drejtave, përgjegjësive dhe mundësive të barabarta të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve</p>	(I plotësuar në fillim të mësimit nga diskutimet)	
<p>◆ Çfarë nënkuptojmë me shoqëri me të drejta të barabarta?</p>	(Plotësuar në fillim të mësimit nga diskutimet)	
<p>◆ Çfarë do të thotë individë me mundësi të barabarta?</p>	(Plotësuar në fillim të mësimit nga diskutimet)	
<p>◆ Çfarë është qytetaria aktive?</p>	(Plotësuar në fillim të mësimit nga diskutimet)	



## *Përkatësia gjinore dhe dhuna në familje*

### **Hyrje**

Edukimi gjinor vitet e fundit ka arritur të tërheqë gjithnjë e më shumë vëmendjen e publikut. Sot ai i është përkushtuar një detyre të re dhe të vështirë, asaj të ndërhyrjes së qëllimshme me mënyra dhe forma të efektshme për të ndalur dhunën ndaj grave dhe vajzave në mjediset private dhe publike.

Ky material për mësuesit synon në rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve në shkollat e mesme, të ngarkuar me detyra të posaçme parashikuar në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", për të luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e kulturës me tolerancë zero ndaj dhunës. Ai do t'ju japë mundësi mësuesve dhe nxënësve për të përmirësuar reagimin dhe qëndrimin ndaj viktimave të dhunës, për të mos i riviktimizuar ato më tej.

Kapitulli sjell bazën e aksionit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar në mbrojtje të të drejtave të grave dhe vajzave. Po ashtu, ai bën të qartë përmasat e dhunës ndaj grave dhe vajzave, në mënyrë të veçantë të dhunës së ushtruar në marrëdhëniet familjare. Ai sjell më pranë shkollës punën e aktorëve të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të grave dhe vajzave, në fushën e shërbimeve, lobimit, avokatisë dhe aktiviteteve të tjera, duke dhënë mundësinë e koordinimit më të mirë të punës së përbashkët për të çrrënjësuar mentalitetet dhe stereotipat e sjelljes që ushqejnë dhunën.

### **Koncepte kryesore**

- Abort
- Asimilim kulturor
- Dominancë mashkullore
- Dhunë me bazë gjininë
- Fuqizim
- Identitet gjinor
- Intimitet
- Konstrukt social/gjinor

- Mjedis tipik femëror
- Padrejtësi gjinore
- Pavarësi
- Role gjinore
- Seksizëm
- Seksrole
- Stereotipa gjinorë
- Stereotipa sociale
- Strukturë psikike me bazë gjininë
- Urbanizim

Pavarësisht nga përvoja kombëtare dhe ajo ndërkombëtare për të siguruar dhe garantuar të drejtat dhe liritë e individit, dhunimi i lirive, të drejtave dhe integritetit fizik të grave dhe vajzave kuptohet dhe interpretohet ndryshe nga institucione të ndryshme. Shumëkush kujdeset që shteti të mos çenojë të drejtat e grave dhe pakkush kujtohet se gratë janë të dhunuara edhe në mjediset ku duhet të ishin më të sigurta: në familjet e tyre nga njerëzit më të afërt, bashkëshortët, prindërit dhe vëllezërit e tyre. Ndëshkimi i grave dhe vajzave përmes formash të hapura dhe të sofistikuar të dhunës si në jetën publike ashtu edhe në jetën private shihet në mënyrë tradicionale. Është e përhapur një pandjeshmëri e dukshme ndaj dhunës. Institucionet e të drejtës privilegjojnë të drejtat civile dhe politike kundrejt të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Ka vëmendje për liritë politike dhe civile të grave, por të drejtat ekonomike dhe sociale janë lënë shpesh pas dore.

Është koha që edukimi në shkolla të merret seriozisht me çështje të një edukimi të tillë gjinor që të pengojë dhunimin e të drejtave dhe integritetit të grave dhe vajzave në mjediset publike e private. E drejta kërkon që jo vetëm dhunuesit shtetërorë e publike, por edhe ata privatë, brenda familjes, të jenë njëjloj të penguar e të ndëshkuar nëse prekin të drejtat e grave dhe vajzave.

### Disa prej besimeve të sotme mbi çështjen

- Shkolla është instrument i sigurimit të drejtësisë sociale.
- Edukimi dhe shkolla inkurajojnë asimilimin kulturor të grave.
- Praktikata e fuqizimit të grave dhe vajzave në edukim janë të brishta, pasi mësuesit veprojnë pa mbështetje nga struktura të specializuara.
- Edukimi i gruas dështon pasi inkurajon strategji ideale jetese, larg realitetit, në një botë që bëhet përherë e më shumë pragmatike dhe materialiste.
- Edukimi gjinor duhet të vërtitet rreth funksioneve madhore të gruas në familje.
- Puna e shkollës nuk ka hapësira për të ndikuar në mënyrat e organizimit të kohës së lirë të djemve dhe vajzave.
- Shkolla e mesme nuk arrin të trajtojë çështje të tendencës që kanë nxënësit për të ruajtur kulturën, krahinarizmin, farefisninë apo të sfidës që ndiejnë për t'i ndryshuar ato.

- Edukimi i nxënësve vajza duhet të jetë i individualizuar.
- Shkolla duhet të punojë më shumë me nënat dhe gratë, pasi ato kanë rol në krijimin e komuniteteve të reja, që ndihmojnë nxënësit të ndjekin një stil të përgjegjshëm sjelljeje.
- Mësuesve u duhet të vetësfidojnë pikëpamjet mbi padrejtësitë gjinore.
- Një grua në karrierë nuk kujdeset shumë për rritjen e fëmijëve të saj.
- Fëmijët kanë përparësi ndaj karrierës së nënës.
- Dikush që gjykon një burrë në karrierë se ai nuk kujdeset shumë për rritjen e fëmijëve të tij nuk ka të drejtë, pasi rritja e fëmijëve është përgjegjësi e gruas.
- Gruaja nuk ka nevojë për marrëdhënie përmes botës virtuale të internetit e të e-mailit.

## Dokumente ndërkombëtare

Në dhjetëvjeçarët e fundit, dhuna ndaj grave ka fituar një vend të veçantë në axhendën e politikës globale dhe të politikave brenda vendit, si një çështje e lidhur me të drejtat themelore të njeriut, zhvillimin njerëzor dhe shëndetin mendor.

Republika e Shqipërisë është palë në konventat e miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Këshilli i Europës (KE) për gratë si:

- **Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave**<sup>17</sup> (Republika e Shqipërisë aderon në protokollin shtesë të konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave)<sup>18</sup>,
- **Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut**<sup>19</sup> dhe protokollin shtesë të saj (nr. 1, 2, 4, 6, 5, 11, 7, 12),
- **Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve Mizor, Çnjerëzor dhe Poshtëruesh dhe Ndëshkimit**<sup>20</sup>,
- **Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimeve Çnjerëzore apo Poshtëruesh**<sup>21</sup>,
- **Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore**<sup>22</sup>,
- **Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike**<sup>23</sup>.

<sup>17</sup> Ratifikuar me ligjin nr.7767, datë 9.11.1993 dhe hyrë në fuqi më 11 maj 1994

<sup>18</sup> Ligji nr. 9052, datë 17.4.2003

<sup>19</sup> Ratifikuar dhe hyrë në fuqi në 2.10.1996

<sup>20</sup> Hyrë në fuqi në 11.05.1994

<sup>21</sup> Nënshkruar në 2.10.1996 dhe hyrë në fuqi në 1.02.1997

<sup>22</sup> Aderuar në 4 tetor 1991

<sup>23</sup> Aderuar në 4 tetor 1991

Ndër këto dokumente, Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) zë një vend të veçantë. Ajo është quajtur ndryshe edhe si Konventa apo Kushtetuta e Grave. Në nenin 11 të saj parashikohet detyrimi i shteteve palë për marrjen e masave të nevojshme për të siguruar të drejta të barabarta mes grave dhe burrave.

Normat ndërkombëtare kanë ndikim shumë të rëndësishëm në sistemin ligjor dhe politikat kombëtare. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 5) parashikon se shteti "... zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të".

Nisur nga kjo, Konventa për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave është e detyrueshme për Shqipërinë.

Shteti është i detyruar t'i mbrojë gratë nga dhuna e ushtruar, jo vetëm nga agjentë të shtetit, por edhe nga individë apo grupe private.

## Shprehja e mbrojtjes së grave dhe vajzave nga dhuna në dokumentet ndërkombëtare

Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës kundër Grave është instrumenti i parë ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, që trajton ekskluzivisht dhunën kundër grave, si dhe jep kuptimin e togfjalëshit *dhunë kundër grave*. Ky akt e ka përcaktuar dhunën ndaj gruas si "çdo akt dhune mbi bazë gjinie që sjell ose mund të sjellë si pasojë dëmtimin fizik, seksual, psikologjik dhe që shkakton vuajtje te gratë". Ai përfshin akte dhune si kërcënimin, detyrimin apo privimin arbitrar të lirisë, që kryhen në mjedise publike apo në jetën private.

Platforma për Veprim e Pekinit u formulua dhe u miratua në Konferencën e IV Botërore të Kombeve të Bashkuara për Gratë (1995) dhe përfshiu si një nga çështjet më të rëndësishme të saj trajtimin e dhunës me bazë gjinore.

Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në nenin 14 të saj parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak gjinie.

E drejta e Bashkimit Europian, legjisllacioni parësor dhe dytësor i tij përshkohen nga parimi i barazisë gjinore.

*Ndaloni për të menduar:*

- *Ç'ndodh me legjisllacionin vendas pasi qeveria a parlamenti ratifikojnë një dokument ndërkombëtar?*
- *Provoni të ftoni një prej deputetëve të qarkut tuaj në shkollë, për të zhvilluar një bisedë mbi rrugën e hartimit të ligjeve në bazë të dokumenteve ndërkombëtare.*
- *Provoni të përfshihenit ju vetë si mësues dhe nxënësit rreth një aksioni apo nisme ligjore.*

- *Shkarkoni nga interneti dokumentet e sipërpërmendur dhe bëjini ato objekt analizash me nxënësit tuaj në orën e ekstrakurrikulës.*
- *Organizoni konkurse me nxënësit për esetë më të mira: Shqipëria po integrohet: kjo do të thotë më shumë qytetari aktive edhe kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave.*

## Shprehja e mbrojtjes nga dhuna në dokumentet kombëtare

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë** është akti ligjor më i lartë, i cili sanksionon parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, si parim përshkues i të gjithë legjisllacionit.
- **Kodi Penal** parashikon dispozita përsa i përket trajtimit të veprave penale të dhunshme, përfshirë këtu vrasjen, plagosjen etj. Në të nuk parashikohet dhuna në familje si vepër penale. Kodi Penal mbron në mënyrë të posaçme shëndetin e personit, pavarësisht nga përkatesia gjinore.

Plagosja e rëndë me dashje (neni 88), përveç elementeve të tjerë, përfshin edhe atë të ndërprerjes së shtatzënisë<sup>24</sup>. Plagosja e kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzënisë, ... dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Detyrimi i gruas nga bashkëshorti ose nga çdo pjesëtar i familjes për të ndërprerë shtatzëninë parashikohet si vepër penale (neni 93).

Rrahja është vepra më e përhapur në marrëdhëniet familjare<sup>25</sup>. Kodi Penal parashikon mbrojtjen nga kundërvajtjet penale ndaj gruas në marrëdhëniet familjare. Kodi Penal parashikon dënime alternative me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj në varësi të dhunës. Nëse një grua, si rrjedhojë e rrahjeve, fyerjeve të rënda, mundimeve apo formave të tjera të dhunës të ushtruara nga bashkëshorti i saj kryen tentativë për vetëvrasje ose vetëvritet<sup>26</sup>, Kodi Penal (neni 99) parashikon vepër penale për këtë rast dhe jep dënime alternative me gjobë ose burgim deri në pesë vjet. Kodi Penal parashikon mbrojtjen e femrës nga shfrytëzimi për prostitucion (neni 114/a).

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, liria seksuale mbrohet në mënyrë të posaçme. Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me një grua të rritur përbën krim (neni 102). Në rastet e përdhunimit të gruas nga bashkëshorti konfigurohet e njëjta vepër penale, por me ndryshimin se subjekti është i posaçëm. Dënimi i parashikuar për këtë vepër është tre gjer në dhjetë vjet burg.

<sup>24</sup> Nga i njëjti monitorim janë gjykuar 4 çështje me këtë objekt, që lidhen me dhunën në familje nga gjykata e shkallës së parë, Tiranë, për periudhën 2000-2004.

<sup>25</sup> Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Brendshme, mars 2006, nga 102 raste dhune në familje, të raportuara nga qytetarët, rezultoi se format mbizotëruese të dhunës në familje janë: rrahjet -23; vrasjet-21; kanosjet për vrasje -15 dhe tentativë për vrasje-10.

<sup>26</sup> Referuar të dhënave sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

Kodi Penal parashikon mbrojtjen nga shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë (neni 130). Kjo vepër parashikohet ndër veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes dhe dënohet me gjobë ose burgim gjer në tre muaj. Fyerja përbën një vepër penale për të cilën parashikohen masa alternative dënimi, me gjobë ose burgim deri në gjashtë muaj<sup>27</sup>.

Kodi Penal parashikon si rrethanë rënduese kryerjen e veprës penale duke përfituar nga marrëdhëniet familjare, të miqësisë dhe të mikpritjes<sup>28</sup>. Disa nga veprat penale të parashikuara në Kodin Penal, për të cilat e dëmtuara ka të drejtën e akuzës dhe që mund të ndodhin në kushtet e ushtrimit të dhunës në familje janë: rrahja (neni 90), plagosja e rëndë nga pakujdesia (neni 91), plagosja e lehtë nga pakujdesia (neni 92), dhunimi i banesës (neni 112, paragrafi i parë), fyerja (neni 119), shpifja (neni 120), ndërhyrjet e padrejta në jetën private (neni 121), përhapja e sekreteve vetjake (neni 122), mosdhënia e mjeteve për jetesë (neni 125), marrja e padrejtë e fëmijës (neni 127). Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me kërcënim (neni 104 i Kodit Penal) parashikohet si figurë e veçantë krimi që ...”dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet”.

Ndaloni për të vepruar:

- *Ftoni një gjykatës të rrethit në shkollën tuaj për të shpjeguar çështje të Kodit Penal lidhur me trajtimin ligjor të dhunës në familje.*
- *Sillni një punonjës policie në shkollën tuaj. Diskutoni me të çështje të mbrojtjes së posaçme të grave të dhunuara. Analizoni vështirësitë që has policia dhe prokuroria e gjykata në mbrojtje të vajzave të mitura ndaj dhunës në familje e shoqëri.*
- *Diskutoni me të rinjtë në shkollë nëse mosveprimi i shtetit për të mbrojtur vajzat e mitura nga dhuna dhe abuzimi në familje konsiderohet si një shkelje e të drejtave të grave mbështetur në përkufizimin e dhunës në familje sipas Konventës për Eliminimin e Formave të Dhunës ndaj Grave.*
- Për herë të parë, **Kodi i Familjes i RSH-së (2003)** në nenin 62 të tij, parashikoi largimin e bashkëshortit dhunues nga banesa bashkëshortore.
- Ligji nr. 8876, datë 4.4.2002, **«Për shëndetin riprodhues»** parashikon që çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë të kontrollohet e të vendosë lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin dhe shëndetin e saj seksual dhe riprodhues. Ky ligj parashikon mosdetyrimin e gruas për të qenë shtatzënë dhe çdo ndërhyrje lidhur me shëndetin riprodhues dhe seksual të kryhet me pëlqimin e saj. Në kuadrin e këtij ligji, grua

<sup>27</sup> Nga monitorimi i 189 procedimeve penale. Pranë gjykatës së shkallës së parë, Tiranë, gjatë periudhës 2000-2004 janë regjistruar vetëm 2 procedime penale për fyerjen.

<sup>28</sup> Kodi Penal, neni 50/g.

gëzon disa të drejta, si: mbrojtjen shëndetësore, edukimin shëndetësor, përfitimin nga shërbimet e planifikimit familjar, si dhe përfitimin falas të ekzaminimeve të paralindjes dhe të paslindjes.

- Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 «**Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare**», garanton anëtarët e familjes me mjete mbrojtjeje nga çdo veprim ose mosveprim që cënon integritetin fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik të individit.
- Me miratimin e këtij ligji dhe ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 «**Për barazinë gjinore në shoqëri**», Kuvendi i Shqipërisë hodhi hapa të sigurtë për përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi gjinor dhe dhuna në familje.
- Me vendimin nr.913, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave është miratuar **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Luftën kundër Dhunës në Familje**. Kjo strategji synon të përmirësojë reagimin e sistemit të drejtësisë dhe mbështetjen për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.
- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2007-2013)** ka si synim arritjen e barazisë gjinore nëpërmjet integritetit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave.

*Ndaloni për të ndihmuar nxënësit më shumë:*

- *Sillni në shkollë përfaqësues të një organizate në mbrojtje të grave apo përfaqësues të bashkisë dhe komunës për të mësuar rreth programeve që janë ngritur në mbrojtje të grave.*
- *Diskutoni me nxënësit tuaj mbi rrugët më efektive të ndërtimit të programeve për gratë dhe vajzat në komunitetin tuaj.*
- *Ndërtoni një hartë të shërbimeve për të rinjtë në komunitetin tuaj. Identifikoni të gjitha burimet e ndihmës në rast dhune për të rinjtë dhe të rejat apo dhunën në familje në zonën tuaj. Bëjini të njohura ato për nxënësit me postera të thjeshtë në muret e shkollës.*

Dhuna ndaj grave në marrëdhëniet familjare është një nga format e diskriminimit gjinor, e cila prek gëzimin e të drejtave themelore prej tyre dhe shpreh pushtetin e burrave mbi gratë në të gjitha aspektet. Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e Dhunës kundër Grave e përkufizon dhunën kundër grave, si një manifestim të pushtetit historikisht të pabarabartë midis burrave dhe grave.

Ndaloni për të analizuar shprehjet e vetëndihmës të gratë e abuzuara:

- Pse gratë-viktima të dhunës në familje i referohen pak ose aspak për mbrojtje kësaj dispozite? Sa gati janë anëtarët e komunitetit tuaj të gjykojnë drejt rreth koncepteve të përdhunimit bashkëshortor dhe të ngacmimeve seksuale?
- A e pranon mendësia e shoqërisë shqiptare si krim, marrëdhënien seksuale pa dëshirën e bashkëshortes apo me përdorim të dhunës?
- Nëse ju do të ishit gjykatës, çfarë provash do të kërkonit për këtë veprë penale?
- Po nëse do të ishit viktimë, si do t'i paraqisnit provat para gjykatës?
- Njihni lehtësira ligjore për viktimat e abuzimit seksual.
- A dini të identifikoni nxënës viktimat të dhunës seksuale?
- Sillni psikologun në klasën tuaj për të folur më shumë mbi dëmin psikologjik të dhunës seksuale.

Vështirësia e të provuarit të kësaj forme të dhunës së kryer në familje ka ndikimin e saj në numrin e kufizuar të denoncimeve të saj si veprë penale.

Gratë guxojnë të denoncojnë këtë veprë penale, përgjithësisht kur ndodhen në kushtet e zgjidhjes së martesës.

## Të dhëna dhe fakte

Megjithë mungesën e dukshme të diskriminimit gjinor në arsim, gratë në Shqipëri vuajnë diskriminim ekonomik dhe kanë më pak mundësi të realizojnë potencialin e tyre. Pagat e grave janë sa 20 deri 50 përqind të pagave të burrave, të cilët kanë në pronësi 92 përqind të pronave dhe rreth 84 përqind të produktit kombëtar bruto (GDP). Të drejtat ekonomike të grave janë zvogëluar deri në atë masë sa që jashtë qendrave urbane pak gra punojnë jashtë shtëpisë, sidomos në ekonominë formale. Gratë që kërkojnë të ndahen nga burra të dhunshëm janë shumë rrallë të afta për të siguruar financiarisht apo për të strehuar veten dhe fëmijët. Nuk ka masa të disponueshme nga shteti. Në rastet e divorceve vendimet në lidhje me anën financiare, përfshirë edhe rastet kur bëhet fjalë për fëmijët, zbatohen shumë rrallë nga gjykatat.

Gratë nuk janë të mirëpërfaqësuar në jetën politike. Në Kodin Zgjedhor të miratuar në dhjetor 2008, u përfshi norma e përfaqësimit të grave në masën 30% në listat shumëemërore për zgjedhjet qendrore apo vendore. Por megjithë progresin që solli, kjo normë nuk u shndërrua në 30% pjesëmarrje edhe në Kuvendin e ri që doli nga zgjedhjet e qershorit 2009.

Nga studimet e kryera rezulton se dhuna e ushtruar me armë ndaj pjesëtarëve të familjes është e pranishme, por raportimi i saj është në shifra të ulëta. Nga një studim i kryer më 2003 mbi "Dhunën ndaj grave në Shqipëri", del se 9 gra (16%) nga 55 viktimat e dhunës të intervistuar në qytetet Tiranë, Shkodër dhe Berat pohojnë se janë kërcënuar me armë vdekjeprurëse si revolver, granatë apo thikë.<sup>29</sup>

<sup>29</sup> A. Baban. Dhuna ndaj gruas në Shqipëri, studim eksplorues, Tiranë, 2003.



Të dhëna mbi dhunën e ushtruar në marrëdhëniet familjare me armë ofron edhe monitorimi i medias së shkruar dhe elektronike. Nga gazetatat e monitoruara mbi dhunën në familje në vitin 2001<sup>30</sup>, rezulton se nga 1130 artikuj të seleksionuar, 207 prej tyre kanë trajtuar problemin e dhunës në familje. 56 artikuj paraqesin raste të ushtrimit të dhunës fizike mbi anëtarët e familjes; në 48 artikuj dhuna e ushtruar ndaj viktimës përfundon me vrasje; në 5 artikuj mbetet në formën e tentativës dhe në 3 artikuj viktimat kishin zgjedhur rrugën e vetëvrasjes.

Në gazetën *Shekulli*, të datës 23.08.2007, publikohet ky lajm: “Në mbrëmje vonë, policia e Pukës arrestoi F.SH. banor në fshatin Bucaj. Disa ditë më parë ai kishte kërcënuar nënën e tij me një mitraloz pa leje. ....”<sup>31</sup>

Po në këtë gazetë në datën 30 gusht 2007 publikohet një tjetër lajm: “Në Durrës një 33 vjeçare, nënë e dy fëmijëve u qëllua për vdekje me mitraloz nga ish bashkëshorti i saj A.GJ. Çifti ishte ndarë ligjërisht 6 muaj më parë. Dhunuesi e kishte kërcënuar ish bashkëshorten e tij me vdekje disa herë...”<sup>32</sup>

Një varg të dhënash për vepra penale që lidhen me dhunën në marrëdhëniet familjare të ushtruar me armë, rezultojnë nga monitorimi i vendimeve penale të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë për periudhën 2000 - 2004, monitorim i kryer nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare<sup>33</sup>. Sipas këtij monitorimi, numri i përgjithshëm i akteve të procedimit në Prokurorinë e Rrethit Tiranë për vitet 2000 - 2004, është 189 kundrejt 122 çështjeve të gjykuara për veprat që mund të kenë lidhje me dhunën në familje, nga gjykata e shkallës së parë, Tiranë. Nga 189 procedime penale, regjistruar gjatë viteve 2000 - 2004 në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për vepra që kanë të bëjnë me dukurinë e dhunës brenda familjes, numrin më të madh të rasteve e përbëjnë rrahjet (47 %), plagosja e lehtë me dashje (19.6 %) dhe kanosjet serioze për vrasje (15.8 %).<sup>34</sup>

Nga raporti monitorues<sup>35</sup>, i kryer nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, për vendimet e lëshimit të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrave të mbrojtjes, në periudhën korrik - prill 2008 rezulton se dhuna fizike manifestohet në forma të ndryshme ku më të përhapura janë goditjet me grushte, goditjet me shkelma, goditjet me sende të forta (telekomandë etj.), thyerja e gotave në trup ose në kokë, si edhe janë identifikuar raste më të rrezikshme si ato kur përdoren armë të ftohta (thika).

<sup>30</sup> E.Gjermeni & M.Bregu, Monitorimi i shtypit mbi dhunën në familje, 2001&2002, Tiranë 2003, fq.19.

<sup>31</sup> Nga raporti monitorues i medias, “Small arms light weapons (SALW), 1-30 gusht 2007.

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> Ky monitorim është kryer në kuadër të projektit “Të përmirësojmë punën e organeve të procedimit dhe të gjykatës, përsa i përket zbatimit sa më të mirë të ligjeve që ndëshkojnë dhe parandalojnë dhunën në familje”, me mbështetjen e Komisionit European.

<sup>34</sup> QNL – “Për një zbatim më të mirë të ligjit në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje nga organet e drejtësisë”, Tiranë 2005, fq.32.

<sup>35</sup> A.Anastasi & A.Bozo, Mjetet ligjore që ofron ligji “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe ndikimi i tij në luftën kundër këtij fenomeni. Raporti është i vlefshëm në : [www.qag-al.org](http://www.qag-al.org).

Organizata Botërore e Shëndetësisë gjithashtu ofron të dhëna përmes studimit të kryer mbi përhapjen e dhunës në marrëdhëniet familjare në rajon, *Posedimi i armëve të zjarrit dhe dhuna në familje në Ballkanin Perëndimor - studim krahasues i legjislacionit dhe mekanizmave të zbatimit të tij*<sup>36</sup>. Studimi paraqet interes të veçantë në lidhje me analizën e legjislacionit dhe zbatimit të tij në vendet e Ballkanit Perëndimor, përmes krahasimit të mjeteve ligjore në adresimin e këtij fenomeni. Sipas këtij studimi vlerësohet se në Kroaci ka rreth 968.000 armë zjarri në duart e civilëve, duke përfshirë ato që mbahen me leje dhe pa leje; në Serbi 2.047.300; në Shqipëri 200.000; 175.000 në Mal të Zi dhe 400.000 në Kosovë...<sup>37</sup>

Në studim analizohet impakti i armëve të vogla mbi dhunën në familje dhe qëndrimi i qeverive për mbrojtjen e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare të shkaktuar nga përdorimi i armëve. Studimi paraqet praktikat më të mira në rajon në lidhje me adresimin e dhunës në marrëdhëniet familjare të shkaktuar nga përdorimi i armëve.

Ministria e Brendshme prej vitit 2005 ka siguruar të dhëna për përhapjen e dhunës në marrëdhëniet familjare, të cilat ofrojnë informacion lidhur me edukimin, gjininë, mjetin e përdorur për të kryer veprën penale, moshën, etj.

#### *Ndaloni për të reflektuar:*

Të dhënat në lidhje me përhapjen e vetëvrasjeve janë pasqyrë e qartë e pasojave të dhunës në jetën dhe shëndetin e individit. Nga analiza e veprimtarisë së punës së strukturave të policisë së Tiranës për vitin 2007, rezulton se gjatë atij viti janë regjistruar 75 vetëvrasje ose 5 me tepër se në 2006, nga të cilat: 12 me armë zjarri, 19 me varje, 23 me helmim, etj. dhe 16 me mjete të tjera<sup>38</sup>.

- *Hamendësoni shkaktarët e ndodhive të mësipërme.*
- *Ndërtoni skenarë për të shmangur situatat që mund t'i çojnë gratë dhe të rejtat në vetëvrasje.*
- *Tregoni ku qëndron fuqia juaj për të përballuar situata të vështira.*

Dhuna me armë në marrëdhëniet familjare është dhunë me bazë gjinore. Bazuar në analizat e kufizuara ndërrajonale, del se burrat përbëjnë rreth 99% të dhunuesve në krimet e

<sup>36</sup> Ky studim mbështetur nga SEESAC i referohet Shqipërisë, Bosnjë - Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Serbisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovës.

<sup>37</sup> Kjo referencë është marrë nga studimi. Këto të dhëna përfshijnë armët që mbahen me leje dhe pa leje nga civilët. Ato nuk përfshijnë të dhëna për armët që mbahen nga oficerët e policisë dhe të ushtrisë ose zyrtarëve të tjerë shtetërorë.

<sup>38</sup> Marrë nga faqja e internetit e Ministrisë së Brendshme

kryera me armë zjarri dhe shkaktojnë 85% të viktimave (plagosje dhe vdekje). Gratë përbëjnë rreth 1% të dhunuesve dhe 15% të viktimave.<sup>39</sup>

## Dilema, tabu, stereotipa gjinorë

Sipas Bankës Botërore, në Shqipëri nuk ka dallime gjinore në arsimim, përveç arsimit të lartë, ku përqindja e studenteve femra është pak më e lartë se ajo e meshkujve. Gjithsesi, në atë pjesë popullsie që është analfabete, femrat janë sa dyfishi i meshkujve dhe në disa zona ku ndjekja e arsimit nëntëvjeçar është vetëm 24.9 përqind, janë shumica vajza ato që e kanë lënë shkollën. Diskriminimi ndaj grave fillon që në lindje.

- *Diskutoni mbi tabu e stereotipa mbi dhunën ndaj vajzave dhe grave në zonën tuaj.*
- *Sillni artikuj gazetash për të parë se si i përcjellin gazetarët rastet e dhunës në familje.*
- *Identifikohuni hapur me qëndrimet tuaja.*
- *Analizoni ç'ndodh me vetë ju, kur diskutoni hapur rreth qëndrimeve dhe besimeve tuaja për dhunën ndaj grave dhe vajzave.*

## Përmbledhje

Reflekto mbi inventarin e besimeve fillestare! Identifiko ndryshimin/mosndryshimin te vetja! Përligji ata!

## Metodologjitë kryesore të sjelljes së çështjes gjinore në ekstrakurrikul

- Mësuesi bën kujdes në përzgjedhjen e teknikave të punës me djemtë dhe vajzat në orët ekstrakurrikulare si edhe në punën e tij të përditshme. Ai përdor përjasje të të kundërtave, situata inversi, simulime, lojën me role, diskutime, ese, konkurse, projekte, mbledhje historish gojore, mbledhje faktesh folklorike për trajtimin e grave dhe vajzave në zonën tuaj.
- Kur punon me metoda që i bëjnë nxënësit të prekin çështje të dhunës me bazë gjininë, mësuesi duhet të dijë se tek ata provokohet dhimbje.

Në vëmendje të mësuesve dhe edukatorëve:

- Fëmijët djem dhe vajza që kanë përjetuar dhunë në familje kanë pësuar një humbje serioze: humbjen e sigurisë, besimit dhe dashurisë për njerëzit e afërt. Ata vuajnë jo vetëm në shëndet, por edhe në vetëbesim. Në të shumtën e rasteve, ata vuajnë për një kohë të gjatë pasojat e neglizhimit, abuzimit fizik, seksual dhe emocional.

<sup>39</sup> SEESAC Strategy for gender issues in salw control and AVPP activities, 21 qershor 2007

- Disa fëmijë djem dhe vajza ndjehen të frikësuar emocionalisht pas vitesh dhune, ndëshkimi fizik dhe abuzimi në familje. Trauma nga ky abuzim nuk mund të kalohet lehtë. Shtimi i ndëshkimeve në shkollë nuk i ndihmon ata të kalojnë efektet e abuzimeve.
- Për disa fëmijë djem dhe vajza që kanë përjetuar ndëshkime të ashpra fizike, një fjalë ndëshkuese nuk i bën ata/ato të ndryshojnë sjelljen. Forma të tjera të ndëshkimit fizik dhe emocional nuk kanë kuptim për ta.
- Ndëshkimi fizik është i papranueshëm! Ata/ato kanë nevojë për teknika të inkurajimit të vetëvlerësimit pozitiv dhe suksesit të mundshëm.
- Shumë fëmijë që janë ndëshkuar në mënyrë mizore dhe/ose të jashtëzakonshme nuk i përgjigjen ndëshkimit në se nuk është abuziv ose i ashpër. Ka fëmijë të tjerë që mbivlerësojnë të tjera forma të ndëshkimit. Mësuesi në këto raste kërkon ndihmë të specializuar të shërbimi social dhe psikologjik në arsim.
- Qëllimi i arsimit është krahas të tjerave, t'ju japë djemve dhe vajzave të ardhur nga mjedise të dhunshme, një mjedis të sigurt edukues, ku ata të përjetojnë rritje fizike dhe emocionale, ndjenja sigurie dhe vetëbesim pozitiv.

## STRATEGJI PËR TË PUNUAR ME NXËNËSIT/NXËNËSET E DHUNUAR/A

### Kushtoji vëmendje të kujdesshme komunikimit

Fëmijët dhe të rinjtë e dhunuar dhe të traumatizuar mund të kenë vështirësi në përqendrimin e vëmendjes. Si pasojë, ata mund të mos dëgjojnë ose të mos kuptojnë rregullat dhe pritshmëritë.

- Jep orientime të qarta ose fol për rregullat duke përdorur gjuhë të kuptueshme!
- Shpjegoji rregullat, por mos jep shpjegime të zgjeruara ose arsye. Njëlloj edhe për pasojat!
- "Sintonizohu" me fëmijën e dhunuar! Sigurohu nëse ai/a jo është duke dëgjuar dhe kuptuar çfarë je duke thënë. Sigurohu që kuptimi është marrë ashtu si ke dashur ta japësh!
- Ji i/e qartë dhe i/e drejtpërdrejtë!

### Dëgjo me kujdes atë që thonë fëmijët dhe të rinjtë! Mos i minimizo përvojat e nxënësit!

Shumë situata krize mund të shmangen nëse iu kushtohet vëmendje nevojave të nxënësve. Fëmijët e dhunuar mund të humbin menjëherë ndjenjën e kontrollit dhe situata mund të dalë nga kontrolli. Një fëmijë që ka qenë neglizhuar kërkon të shprehë menjëherë nevojën e tij ose të saj.

- Përgjigju ndaj nevojës së fëmijëve të dhunuar sa më shpejt të jetë e mundur. Me kalimin e kohës, reagimet e tij/saj do të përshkallëzohen.
- Dëgjo me kujdes! Mos lër pas dore problemet e nxënësve. Përgjigju pyetjeve të tyre me ndershmëri!

- Shmang minimizimin e ndjenjave të nxënësve dhe filozofimin mbi to. Të gjitha këto zvogëlojnë respektin e nxënësit/es për veten. Në të vërtetë, djali dhe vajza i traumatizuar mund të ripërjetojë trauma edhe në situata më pak të rrezikshme si klasa. Ai mund të përvijojë mësuesin si figurën e dhunuesit.

### Ji objektiv/e, jo gjykues/e, i/e saktë, i/e qëndrueshëm/e dhe i/e qartë!

Nxënësit e traumatizuar emocionalisht reagojnë më mirë ndaj udhëzimeve të qarta dhe objektive.

- Vendos sa më pak rregulla të jetë e mundur, bëje të qartë se çfarë është më e rëndësishme dhe diskuto e përforco rregullat me ngadalë. Së paku, mos i turbullo djemtë dhe vajzat e dhunuar.
- Për një nxënës të rritur në kaos, lehtësimi i të diturit çfarë të presë është shërues. Kur nxënësit nuk sillen mirë ose lëndojnë të tjerët, mësuesi e kap veten duke reaguar me emocion. Vendoseni zemërimin tuaj diku tjetër!
- Diskuto dhe përforco rregullat në klasë në një mënyrë objektive dhe të qartë!
- Qartëso rregullat më të rëndësishme dhe pasojat!
- Mos i thyej rregullat. Jini i qëndrueshëm në një botë të paparashikueshme për nxënësit e dhunuar.
- Qëndro larg nga strategjitë emocionale të trajtimit të nxënësve të traumatizuar (*Si mund të ma bësh ti këtë mua? ose Unë u përpoqa të isha një mësues/e i/e mirë për ty*).
- Jep më të mirën për të zbuluar rrugë të tjera për të shprehur emocione. Mërzia mund të frikësojë fëmijët e traumatizuar ose madje mund t'i kënaqë. Edhe lumturia mund të ketë nevojë të zbutet. Një nxënës i dhunuar mund të ndiejë frikë që ai/ajo nuk do të jetë në gjendje të ndjekë pritshmëritë e mësuesve të tij/saj.

### Përpiqu të lehtësosh ankthin e nxënësit të dhunuar

Një simptomë e fëmijës së dhunuar është niveli i lartë i ankthit. Për këtë arsye, është e rëndësishme të mendohet rreth mënyrave për të ulur ankthin. Fatkeqësisht, natyra e vërtetë e disiplinës në fjalë është stresuese për fëmijët.

- Zgjidh kohën me nivel stresi më të ulët për të folur për rregullat, pritjet, dhe pasojat.
- Diskuto dhe përforco disiplinën me një zë të qetë dhe lehtësues.
- Shpjegoju që do të ketë pasoja nëse nuk ndiqen rregullat, por që nuk do të sjellë si pasojë një sjellje tënden të mërzitur, lënduese dhe ndëshkuese me notë.
- Gjatë episodeve me nivel të lartë stresi, përpiqu të injorosh ato sjellje që mund të injorohen.

## Përkatësia gjinore dhe integrimi europian

### Hyrje

Ky kapitull synon të paraqesë se si është trajtuar nga institucionet e Bashkimit Europian përkatësia gjinore dhe diskriminimi që mund të vijë prej saj. Duke qenë se Shqipëria është një vend që ka filluar procesin e anëtarësimit dhe aspirojnë të bëhet pjesë e këtij bashkimi ekonomik-politik, një analizë e shkurtër e këtyre çështjeve është me vlerë për të kuptuar dallimet dhe problemet e përbashkëta që vendi ynë ndan me shtetet e tjera anëtare të këtij bashkimi.

Kapitulli jep një paraqitje të shkurtër të organizimit të këtij institucioni, politikave dhe përpunuar në vite për trajtimin e pabarazive gjinore në vendet anëtare.

Në pjesën e fundit të tij paraqiten disa prej politikave që mendohet të ndiqen në të ardhmen. Tre studime rasti plotësojnë kapitullin.








### Bashkimi Europian

Bashkimi Europian (BE) është një njësi ekonomike dhe politike që u krijua me Traktatin e Maastricht (Maastricht, Hollandë) më 1 nëntor 1993, mbi bazën e strukturave ekzistuese të Komunitetit Ekonomik Europian (1957). Me një popullsi prej gati 500 milion banorësh, BE-ja siguron rreth 30% të prodhimit bruto botëror.

BE-ja ka zhvilluar një treg të përbashkët përmes një sistemi të standardizuar ligjesh që aplikohet nga të gjitha vendet anëtare, duke siguruar kështu një lëvizje të lirë të njerëzve, të të mirave të prodhuara, shërbimeve dhe kapitaleve financiare në të gjitha shtetet anëtare. BE-ja aplikon një politikë të përbashkët në tregti, bujqësi, peshkim dhe zhvillim rajonal. Një monedhë e përbashkët, *Euro*, është adoptuar nga 16 vende anëtare, duke krijuar kështu Eurozonën. BE-ja ka zhvilluar një rol të kufizuar në politikën e jashtme, duke u përfaqësuar në të njëjtën kohë në Organizatën Botërore të Tregtisë, grupimin G8 dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Legjislacioni i harmonizuar midis vendeve anëtare në aspektin juridik dhe në rendin publik, mund të ilustronet me heqjen e kontrollit të pasaportave për shtetasit e vendeve të përfshira në zonën Shengen.

Bashkimi Europian, që prej vitit 2007, përbëhet nga 27 vende anëtare.

Më poshtë janë paraqitur sipas rendit alfabetik 27 vendet anëtare të BE-së. Për secilin prej tyre renditja e të dhënave përfshin flamurin kombëtar, emblemën kombëtare, emrin tradicional të shtetit, emrin zyrtar, datën e hyrjes në BE, si dhe kryeqytetin e vendit.

-   Austri, Republika e Austrisë, 1 janar 1995, Vienë  
  Belgjikë, Mbretëria e Belgjikës, 25 mars 1957, Bruksel  
  Bullgari, Republika e Bullgarisë, 1 janar 2007, Sofie  
  Danimarkë, Mbretëria e Danimarkës, 1 janar 1973, Kopenhagen  
  Estoni, Republika e Estonisë, 1 maj 2004, Talin  
  Finlandë, Republika e Finlandës, 1 janar 1995, Helsinki  
  Francë, Republika Franceze, 25 mars 1957, Paris  
  Gjermani, Republika Federale e Gjermanisë, 25 mars 1957, Berlin  
  Greqi, Republika Helene e Greqisë, 1 janar 1981, Athinë  
  Hungari, Republika e Hungarisë, 1 maj 2004, Budapest  
  Irlandë, Irlanda, 1 janar 1973, Dublin  
  Itali, Republika Italiane, 25 mars 1957, Romë  
  Letoni, Republika e Letonisë, 1 maj 2004, Riga  
  Lituani, Republika e Lituanisë, 1 maj 2004, Vilnius  
  Luksemburg, Dukati i madh i Luksemburgut, 01957-03-25 25 mars 1957  
  Malta, Republika e Maltës, 1 maj 2004, Valeta  
  Mbretëria e Bashkuar, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, 1 janar 1973, Londër  
  Hollandë, Mbretëria e Hollandës, 25 mars 1957, Amsterdam  
  Poloni, Republika e Polonisë, 1 maj 2004, Varshavë  
  Portugali, Republika Portugeze, 1 janar, 1986, Lisbonë  
  Rumani, Rumania, 1 janar 2007, Bukuresht  
  Qipro, Republika e Qipros, 1 maj 2004, Nikozia  
  Çeki, Republika e Çekisë, 1 maj 2004, Pragë  
  Sllovakia, Republika Sllovaqe, 1 maj 2004, Bratislavë  
  Slloveni, Republika e Sllovenisë, 1 maj 2004, Ljubjanë  
  Spanjë, Mbretëria e Spanjës, 1 janar 1986, Madrid  
  Suedi, Mbretëria e Suedisë, 1 janar 1995, Stokholm  
 BE - 27 vende gjithsej prej vitit 2007. Popullsia është 498.926.165 banorë. Sipërfaqja territoriale, 4.456.304 km<sup>2</sup>.

BE-ja është një entitet krejt unik në llojin e vet. Mund të konsiderohet si një përzierje e një shteti federativ me një institucion mbi (supra) - kombëtar. Shtetet anëtare pjesërisht transferojnë disa nga të drejtat e tyre të sovranitetit kombëtar në duart e BE-së, por gjithsesi shtetet anëtare kanë të drejtën përfundimtare për të marrë vendimet. Sot shumë politika në këto vende realizohen nëpërmjet rregullave që përcaktohen nga legjislacioni europian. Megjithatë vlen të theksohet se ndërsa aspektet ekonomike marrin një peshë kryesore në këto rregulla, fusha të tjera sidomos ato që kanë të bëjnë me rregullimin e politikave sociale ende mbeten në një masë të madhe eskuziviteti i vendimeve në nivel kombëtar. Trajtimi i çështjeve të drejtësisë gjinore bën pjesë në këtë grup politikash, ku edhe pse ka një angazhim nga BE-ja për të harmonizuar përpjekjet, ende dallimet midis vendeve anëtare mbeten të konsiderueshme.

## Drejtësia gjinore dhe BE

Që prej formimit, BE-ja ka provuar disa mënyra për arritjen e drejtësisë gjinore në rradhët e shteteve anëtare. Tre janë drejtimit kryesore të ndjekura në rrjedhën e viteve - trajtimi i barabartë, ndërmarrja e veprimeve pozitive dhe integrimi gjinor. *Trajtimi i barabartë* do të thotë që “asnjë shtetas nuk duhet të ketë më pak të drejta apo mundësi se një tjetër”. Aplikimi i këtij parimi mori formën e një artikulli të veçantë në legjislacionin e BE-së, për pagë të barabartë dhe trajtim të njëjtë në vendin e punës të grave dhe burrave. Megjithëse kjo politikë ishte një element shumë i rëndësishëm për të drejta të barabarta, ajo trajtonte vetëm marrëdhëniet në vendin e punës duke shmangur kështu, jo në mënyrë të qëllimtare, marrëdhëniet e tjera të pabarabarta që ekzistojnë midis grave dhe burrave në fusha të tjera.

Duke synuar përmirësimin e drejtësisë gjinore, u shtua modeli i dytë, ai i ndërmarrjes së *veprimeve pozitive*. Ky model, synonte që të krijoheshin kushte që mundësonin arritjen e drejtësisë gjinore. Për ta ilustruar, u ndërmorën masa në favor të grave dhe vajzave, për të tejkaluar pozicionet e pabarabarta nga të cilat ato fillonin jetën e tyre në një shoqëri patriarkale. Një formë mjaft e njohur e këtyre veprimeve pozitive njihet si diskriminimi pozitiv, që synon të rrisë pjesëmarrjen e grave në politikë nëpërmjet parimit të kuotave në nivelet vendimmarrëse - parlament, pushtet vendor, etj. Ky model pati një nivel të lartë aplikimi në BE, veçanërisht gjatë viteve '80-të dhe '90-të. Masa të tilla e zgjeruan spektrin e përpjekjeve për arritjen e drejtësisë gjinore duke shënuar arritje të konsiderueshme për kohën kur u aplikuan.

Modeli i tretë që filloi të aplikohet në mesin e viteve '90-të ishte ai i *integritimit gjinor*. Ky model synonte që nëpërmjet përfshirjes së çështjeve të përkatësive gjinore në të gjitha institucionet qeveritare dhe në politikat e një vendi, të arrihet një ndërthurje e punës në drejtim të arritjes së drejtësisë gjinore midis grave dhe burrave. Më specifikisht, KE-ja shprehej se duhej “integrimi sistematik i çështjeve respektive, prioriteteve dhe nevojave të grave dhe burrave në të gjitha politikat, me synim promovimin e drejtësisë midis grave dhe burrave, duke mobilizuar të gjitha burimet dhe masat e nevojshme dhe specifike për arritjen e këtij qëllimi”. I përkufizuar në këtë mënyrë, integrimi gjinor përbënte një koncept



të avancuar që premtonte ta bënte dimensionin gjinor pjesë të të gjitha politikave të BE-së.

Dhe vërtet që integrimi gjinor, si në aspektin teorik por për më tepër në atë praktik provoi të ishte një mjet i rëndësishëm në rrugën drejt arritjes së drejtësisë gjinore. Por duhet kuptuar që aplikimi i këtij modeli kërkon një angazhim të madh nga të gjithë aktorët e përfshirë në hartimin e politikave dhe ky nuk është një mision gjithmonë i mundur. Ashtu siç trajtohet në vazhdim të këtij kapitulli, disa herë shtetet apo edhe individët në nivelet e larta vendimmarrëse, nuk janë shumë të interesuar të punojnë në këtë drejtim, nuk kanë njohuritë e nevojshme për aplikimin në praktikë, apo edhe nuk kanë mjetet e nevojshme financiare dhe burimet intelektuale për ta kthyer atë në një mjet të efektshëm.

Seksioni që vijon më pas, paraqet një përshkrim të arritjeve dhe problemeve që ende ndeshen në BE lidhur me punën për arritjen e drejtësisë gjinore.

## Të dhëna dhe fakte

Të dhënat e mëposhtme janë një përmbledhje e viteve të fundit të mbledhura nga Instituti Europian i Statistikave. Ato mbulojnë një sërë sektorësh ku puna drejt arritjes së drejtësisë gjinore nga institucionet e BE-së është fokusuar më tepër. Si një vend që aspiron për t'u bërë pjesë e BE-së, edhe Shqipëria duhet të arrijë këto standarde të drejtësisë gjinore.

Seksioni i mëposhtëm kërkon nga ju si lexues të reflektoni rreth këtyre të dhënave dhe të mendoni për mënyrat se si mund të kontribuoni në përmirësimin e këtyre objektivave.

## Shkalla e punësimit dhe e papunësisë

Përgjatë viteve të fundit ka patur një rritje të numrit të grave të punësuar në krahasim me meshkujt. Shkalla e punësimit prej rreth 59 përqind në 2007, është shumë pranë objektivit prej 60 përqind, të vendosur nga BE-ja për vitin 2010, në Lisbonë. Ajo është rritur me rreth 4 për qind gjatë pesë viteve të fundit. Megjithatë në nivel kombëtar ka dallime të mëdha nga një shtet në tjetrin. Kështu në Maltë, Itali dhe Greqi, më pak se gjysma e grave që përbëjnë forcën e punës janë të punësuar ndërsa në Danimarkë dhe Suedi këto shifra janë mbi 70 për qind. Gjatë viteve të fundit diferenca në punësim midis grave dhe burrave brenda BE-së është zvogëluar në gati vetëm 1 për qind. Por në nivel kombëtar, vende si Letonia, Bullgaria dhe Slovakia kanë përjetuar një rritje në këtë diferencë. Kjo në përgjithësi konsiderohet si një arritje e rëndësishme për BE-në. Gjithsesi, efektet e krizës financiare botërore, ende nuk mund të parashikohen. Kjo mund të bëhet në vitet që pasojnë.

Nga ana tjetër, shumë gra tentojnë të punojnë me kohë të pjesshme. Të dhënat e vitit 2007 tregojnë se rreth 32 për qind e grave në BE-27 punojnë me kohë të reduktuar, ndërkohë që vetëm 8 për qind e burrave hyjnë në këtë kategori. Është e rëndësishme të theksojmë se shumë pak gra bëjnë pjesë në këtë grup kur flitet për vende si Bullgaria, Sllovakia dhe Hungaria.

Çështje për t'u trajtuar me nxënësit:

- Si mendoni se është niveli i punësimit të grave dhe burrave në vendin tonë? Kush punon më tepër?
- Cilat janë profesionet ku gratë dhe burrat në vendin tonë janë më tepër të punësuarat?
- A dini raste kur punësimi është me kohë të pjesshme dhe kush përfshihet më tepër në këtë lloj punësimi?

## Ndarja e punëve në familje dhe shërbimet për fëmijët

Prindërimi dhe përgjegjësitë që vijnë prej tij kanë një efekt afatgjatë në tregun e punës. Kjo reflektohet në faktin që më tepër gra kujdesen për fëmijët, të moshuarit dhe për personat me aftësi të kufizuara. Numri i grave të punësuarat kur ato kanë fëmijë më të vegjël se 12 vjeç është shumë më e ulët se ajo e grave të të njëjtës moshë, por që nuk kanë fëmijë të kësaj moshe. Ndërkohë që shifrat janë krejt ndryshe kur flitet për burrat – ata që kanë fëmijë të vegjël tregojnë një nivel më të lartë punësimi krahasuar me burrat, që nuk kanë këtë përbërje familjare. Përsëri shifrat janë më pak të balancuara në disa vende të reja anëtare të BE-së si Republika Çeke, Sllovakia dhe Hungaria.

Një faktor i rëndësishëm lehtësues i pjesëmarrjes në tregun e punës, veçanërisht për gratë, është edhe mundësia për të përfituar nga shërbimet e kujdesit për fëmijët, si kopshte dhe çerdhe. Vetëm në pesë shtete, është arritur objektivi prej 33 përqind i mbulimit të këtyre shërbimeve, në Hollandë, Danimarkë, Belgjikë, Suedi dhe Spanjë, ndërkohë që pesë të tjera - Portugali, Mbretëri e Bashkuar, Francë, Luksemburg dhe Slloveni - janë shumë afër këtij objektivi. Vendet e tjera kanë ende shumë punë për të bërë në drejtim të shërbimeve lehtësuese për fëmijët. Në një masë të madhe, këto shërbime ofrohen vetëm për një kohë të pjesshme, duke mos lejuar që gratë të impenjohen në një punësim me kohë të plotë.

Shpërndarja gjinore e kohës së dedikuar punës me pagesë dhe asaj që nuk paguhet është një tjetër tregues i drejtësisë gjinore në një shoqëri të caktuar. Të dhënat tregojnë se burrat shpenzojnë më tepër kohë në punë që paguhet, krahasuar me gratë. Megjithatë, gratë shpenzojnë më shumë kohë duke punuar, nëse koha e shpenzuar në punën e paguar dhe atë që nuk paguhet, mbledhen së bashku. Ky fakt i rëndësishëm tregon se gratë janë më tepër të ngarkuara krahasuar me burrat megjithëse në pamje të parë, duket se burrat punojnë më tepër.

Ide për të reflektuar nxënësit:

- Kush kujdeset më tepër për fëmijët në familje - nëna, babai, gjyshërit apo njerëz të tjerë?
- Sa mendoni se ndikon në Shqipëri kujdesi për fëmijët e vegjël të punësimi i grave dhe burrave?
- A ka shërbime të kujdesit për fëmijët e vegjël në qytetin/fshatin tuaj? Sa të përshatshme janë ato dhe në çfarë mase përdoren nga prindërit? A janë këto shërbime publike/falas apo private/me pagesë?

## Arsimi, fushat e studimit dhe ndarja gjinore e tregut të punës

Ndërkohë që duket se përqindja e grave dhe burrave kur flitet për nivelin e arsimit, është gati e barabartë, vajzat e reja (mosha 20-24 vjeç) përfaqësojnë një numër më të lartë se djemtë/burrat e të njëjtës moshë. Gratë dhe vajzat përbëjnë rreth 59 për qind të totalit të personave që kanë mbaruar universitetin. Megjithatë numri i grave/vajzave në fushat e informatikës, inxhinierisë dhe shkencave natyrore ende mbetet i ulët krahasuar me burrat/djemtë. Gratë përfaqësojnë rreth 60 për qind të diplomuarve në shkencë juridike dhe administrim biznesi dhe në të njëjtën kohë përbëjnë numrin më të madh të të punësuarve në gazetari, shërbimet e informacionit, shkencat humane, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale, si dhe në arsim.

*Ide për të reflektuar për nxënësit:*

- *Cili është niveli i frekuentimit të shkollave nga djemtë dhe vajzat në qytetin/fshatin tuaj?*
- *Ka më tepër djem apo vajza në shkollën tuaj? Nëse përqindja është e ndryshme, pse ndodh kjo?*
- *A janë shifrat e treguara më lart të njëjta apo të ndryshme me ato në vendin tonë? Nëse janë të ndryshme pse ndodh kjo?*
- *Cilat janë profilet universitare që djemtë preferojnë të ndjekin? Po vajzat? A janë ato të njëjta apo të ndryshme?*
- *A është profili i punësimit të grave dhe vajzave në vendin tonë i njëjtë me atë të paraqitur për BE-në?*

## Dallimi/diferenca në pagesa

Ende në BE ka dallime të dukshme në pagesën e grave dhe burrave. Ky dallim - i përkufizuar si diferenca midis numrit të orëve të paguara të grave dhe burrave dhe përqindjes së pagesës për një orë punë - është vlerësuar të jetë në avantazh të burrave me rreth 18 për qind në të gjithë BE-në. Ndërkohë që në shumicën e vendeve kjo shifër është më e lartë, ndërsa në disa të tjera si Itali, Maltë, Poloni, Slloveni dhe Belgjikë është më e ulët se 10 për qind.

*Ide për të reflektuar për nxënësit:*

- *A mendoni se gratë dhe burrat në Shqipëri paguhen njëllë për të njëjtën punë?*
- *Si mendoni se paraqitet niveli i ngritjes në detyrë për gratë dhe burrat?*
- *A mendoni se njëra palë është më tepër e favorizuar ose jo?*
- *Argumentoni përgjigjet tuaja.*

## Vendimmarrja

Pjesëmarrja e anëtareve femra në parlamentet kombëtare të vendeve të BE-së ishte 24 për qind në 2008. Kjo përqindje është më e lartë se 35 në Spanjë, Belgjikë, Danimarkë dhe Norvegji dhe më e lartë se 40 përqind në Finlandë dhe Suedi. Por ishte më ulët se 15 për qind në Irlandë, Slloveni dhe Hungari dhe më pak se 10 për qind në Maltë dhe Rumani.

*Ide për të reflektuar për nxënësit:*

- *Krahasoni të dhënat e pjesëmarrjes së grave në nivelet e larta të vendimmarrjes në Shqipëri me ato të mësipërme për vendet anëtare të BE-së. A shihni ndryshim në to?*
- *Cili është grupi ku vendi ynë mund të përafrohet, bazuar në ato të paraqitura më sipër?*
- *Pse mendoni se kemi këto shifra në Shqipëri?*
- *Si mendoni se mund t'u ofrohet hapësirë dhe mundësi e barabartë për pjesëmarrje në politikë dhe vendimmarrje grave dhe burrave në Shqipëri?*

## Nismat aktuale të Bashkimit Evropian për drejtësinë gjinore

Të dhënat nga publikimet më të fundit të Eurostat-it (Statistikat Europiane) mbi vendet anëtare të BE-së, tregojnë se megjithëse ka një përmirësim të modeleve të punësimit midis grave dhe burrave, ende ekzistojnë dallime të konsiderueshme në lidhje me punët që ato/ ata kryejnë. Gratë kanë rritur nivelin e tyre të edukim-shkollimit dhe të kualifikimit profesional, por përgjegjësitë familjare mbeten faktor kryesor që ndikon në një nivel më të ulët të aktivitetit të tyre, si në sferën ekonomike, ashtu edhe atë sociale e publike. Mbi të gjitha, një dallim thelbësor është ai që lidhet me sipërmarrjen ku përkatësia gjinore duket se mbetet faktori kryesor për një nivel të ulët të përfaqësimit të grave në ndërhyrjet e politikave të ekonomisë së tregut.

Drejtësia midis grave dhe burrave ka qenë një nga parimet kryesore të BE-së që prej viteve të para të ekzistencës së tij. Megjithatë gjërat jo gjithmonë kanë shkuar në drejtimin e duhur. Deri në fund të dekadës së kaluar situata paraqitej shumë ndryshe nga sot. Edhe pse drejtësia gjinore ka qenë pjesë themelore e parimeve të Traktatit të themelimit të BE-së, ashtu si edhe në shumë politika të BE-së dhe ligje europiane, mbështetur në të njëjtën kohë edhe në një sërë vendimesh të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, përsëri pabarazitë gjinore ishin mjaft të dukshme në rradhët e vendeve anëtare. Për këtë arsye, BE ndërmori përgjatë viteve të fundit një sërë nismash për të trajtuar këto dallime dhe pabarazi, veçanërisht në pragun e zgjerimit me 10 vendet e reja anëtare. Në vazhdim janë renditur disa prej dokumenteve dhe vendimeve më të rëndësishme të ndërmarra së fundmi nga BE-ja.

- Që prej vitit 2004, Komisioni Evropian publikon një raport vjetor mbi zhvillimet lidhur me drejtësinë gjinore. Përpara këtij viti, analiza e kësaj problematike

përfshihej në një analizë të përgjithshme të aspekteve të mirëqënies sociale të vendeve anëtare.

- Më 2006, KE-ja hartoi dhe më pas adoptoi dokumentin “Rruga për të ecur drejt drejtësisë midis grave dhe burrave”. Ky është një dokument strategjik që do të bëjë të mundur koordinimin e përpjekjeve dhe nismave si midis vendeve anëtare, por edhe brenda BE-së për eliminimin e pabarazive gjinore. Dokumenti mbulon periudhën 2006-2010. Pas përfundimit të këtij harku kohor, KE-ja do të analizojë gjendjen dhe në varësi të rezultateve do të hartojë dhe adoptojë një strategji të re, nëse kjo do të jetë e nevojshme.
- Në takimin e Këshillit Evropian të mbajtur në mars 2006, shtetet anëtare të BE-së aprovuan “Paktin Evropian për Drejtësinë Gjinore”.
- Në vazhdim, 2007 ishte Viti Evropian për mundësi të barabarta për të gjithë, me drejtësinë gjinore të trajtuar si një nga shkaqet e diskriminimit.
- Instituti Evropian për Drejtësinë Gjinore u themelua nëpërmjet një vendimi të Këshillit Evropian më dhjetor 2006 dhe filloi nga puna më 2007. Ideja e krijimit të një institucioni të veçantë për çështjet e drejtësisë gjinore, tregon interesin e BE-së për të punuar në drejtim të arritjes së një trajtimi të barabartë midis grave dhe burrave.

Zgjerimi i BE-së në vitet 2004 dhe 2007 ka krijuar hapësira të konsiderueshme për politikat gjinore në vendet e reja anëtare. Nga njëra anë, përgatitjet për adoptimin e një sërë ligjesh të reja sipas direktivave të institucioneve të KE-së, direktivat dhe vendimet e Gjykatës Europiane në këtë drejtim kanë sugjeruar hapësirat e nevojshme që vendet e reja anëtare duhet t’i japin çështjes së barazisë dhe drejtësisë gjinore sidomos në pagesën dhe trajtimin e barabartë të grave dhe burrave dhe lejen nga puna për arsye të prindërimit. Kjo nga ana tjetër kërkon një përafrim të legjislacionit të vendeve të reja anëtare sipas atij të aplikuar në shtetet që kanë qenë pjesë e BE-së më parë. Përvoja në këto vende të reja anëtare, ka treguar se OJF-të dhe institucione të tjera aktive kanë luajtur një rol thelbësor në këtë proces të “transplantimit” të legjislacionit evropian. Ashtu si edhe në fusha të tjera të *acquis communautaire*, KE-ja përcakton fonde të veçanta për ta lehtësuar këtë proces si dhe ndihmon me një sërë aktiviteteve që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me drejtësinë gjinore.

Drejtësia gjinore konsiderohet si një nga kriteret për anëtarësimin në BE. Vendet që aspirojnë për anëtarësim duhet jo vetëm të aprovjnë një sërë ligjesh dhe rregullash që plotësojnë këtë kriter, por ato duhet të tregojnë që janë në gjendje të kenë strukturat dhe mjetet e nevojshme për të zbatuar këto ligje.

Përvoja ka treguar se për shumë nga vendet candidate, por edhe për ato shtete anëtare që erdhën nga një e kaluar komuniste, drejtësia gjinore nuk konsiderohet si një prioritet i madh nga politika. Gjithsesi, presioni nga Komisioni Evropian lidhur me progresin e tyre drejt anëtarësimit mund të ofrojë një mundësi të shkëlqyer për të bërë hapa përpara në drejtësinë gjinore. Duke u kërkuar qeverive që të mbledhin të dhëna të ndara sipas përkatësisë gjinore, duke aprovuar ligje të veçanta që shmangin diskriminimin gjinor dhe duke ngarkuar institucione të veçanta për zbatimin e drejtësisë gjinore, rezultatet mund të

jenë më lehtësisht të arritshme. Për shembull, 10 vendet ish-komuniste që u bënë anëtare të BE-së më 2004 dhe 2007<sup>40</sup>, kanë treguar ndryshime të dukshme në lidhje me drejtësinë gjinore. Por procesi drejt këtij objekti nuk ka qenë i lehtë. Për këtë ka një numër arsyesh, të cilat edhe pse mund të ndryshojnë nga një vend në tjetrin, janë shfaqur në çdo shtet të ri anëtar. Duke qenë se në një pjesë të madhe, vendi ynë ka shumë ngjashmëri për shkak të përvojës së kaluar komuniste, është e rëndësishme të rendisim disa prej këtyre faktorëve.

**Adoptimi i legjislacionit të ri.** Duke dashur të përshtatin ligjet për drejtësinë gjinore sipas standardeve evropiane, vendet candidate për anëtarësim në BE mund të përpiqen të përshpejtojnë këtë proces në mënyrë artificiale. Pra, pa siguruar më parë mekanizmat e nevojshëm për vënien e tyre në jetë. Kjo mund të shkaktojë një konfuzion në normat ligjore të vendit, por edhe për juristët e gjyqtarët që disa herë gjenden në situata problematike ku interpretimi i ligjit është i vështirë.

**Përkthimi i legjislacionit.** Konceptet kryesore të legjislacionit evropian disa herë përkthehen jo me të njëjtin kuptim me atë vendas. Kjo përsëri shkakton një konfuzion në trajtimin e përshtatshëm të problematikës së drejtësisë gjinore.

**Dallimet në traditat e sistemit kombëtar të drejtësisë.** Zbatimi i ligjeve dhe rregullave të BE-së varet drejtpërdrejt nga sistemi kombëtar i drejtësisë, sidomos për pjesën e zbatimit të tij. Përvoja me vendet e tjera të Europës Lindore dhe Qendrore që kanë patur një të kaluar komuniste, ka treguar se është e vështirë për praktikuesit e ligjit që të heqin dorë nga normat dhe traditat ligjore të trashëguara nga regjimi i mëparshëm. Kjo është e lidhur ngushtë me faktin që shumë prej tyre kanë qenë trajnuar përgjatë periudhës komuniste. Megjithë mbështetjen e ofruar nga BE-ja lidhur me ndryshimin e këtyre normave dhe vlerave, një ndryshim i thellë nevojitet në kulturën ligjore për të arritur zbatimin e barabartë dhe të paanshëm të ligjeve të reja.

**Mungesa e mbështetjes nga politika.** Ndërkohë që periudha e përgatitjes për hyrjen në BE ofron mundësi të mira për reforma në ekonomi dhe standarde demokratike, drejtësia gjinore nuk është se ka patur mbështetjen e mjaftueshme nga grupimet politike. Përfshirja e këtyre çështjeve në axhendën kombëtare politike vazhdon të jetë e ulët, ndërkohë që miratimi i ligjeve që lidhen në mënyrë direkte me drejtësinë gjinore dhe diskriminimin, shpesh kalon në parlament pa debate dhe pa diskutim lidhur me përgjegjësitë për zbatimin e tyre, ashtu edhe për pasojat që këto ligje do të kenë në jetën sociale dhe ekonomike të vendit. Për rrjedhojë, shpesh buxhetet për zbatimin në praktikë janë të parat që shkurohen apo pezullohen, duke lënë një vakuim ligjor dhe social në zbatimin e tyre. P.sh. Republika Çeke është ende nën presion nga BE-ja për të gjetur mënyrat e duhura dhe të nevojshme për zbatimin e legjislacionit të drejtësisë gjinore, që është miratuar nga qeveria pak para hyrjes në BE, më 2004.

**Dilema se cili është modeli më i mirë për t'u zbatuar.** Në përgjithësi, megjithëse BE-ja e prezanton institucionin e tij si "avokat mbrojtës" të drejtësisë gjinore në të gjitha

<sup>40</sup> Shih tabelën e vendeve anëtare dhe datat e pranimit të tyre në BE.

aktivitetet e veta, ende nuk ka një konsensus se si duhet arritur kjo. Edhe në fusha të tilla si punësimi dhe përfshirja sociale, ku shkëmbimi i përvojave dhe informacionit midis vendeve anëtare është shumë i prekshëm, ende vazhdon diskutimi se cila është praktika më e mirë që duhet ndjekur. Një numër strategjish ekzistojnë në vendet e vjetra anëtare të BE-së, por asnjëra prej tyre nuk mund të konsiderohet si më e mira dhe më e përshtatshme, ndërkohë që pabarazitë gjinore janë ende të prekshme dhe disa herë përkeqësohen. Pyetje të ndryshme shtrohen për diskutim në këtë pikë. Një nga më të rëndësishmet është ajo që lidhet me Strategjinë e Lisbonës, (dokumenti më i fundit i BE-së për ecurinë deri në vitin 2010), ku parashikohet që rreth 60 për qind e grave në BE duhet të jenë të punësuara aktive deri në fund të kësaj dekade. Shumë vende pyesin nëse kjo shifër është realiste apo e sajuar. Si duhet të përkufizohet pjesëmarrja në tregun e punës në këtë rast? Shembujt që vijjnë nga vendet e ndryshme anëtare tregojnë se kjo nuk është një detyrë e lehtë. Për shembull, në Hollandë gratë janë të punësuara në masën 67.5 për qind, por rreth 74.7 për qind e këtyre, (pra pjesa më e madhe) kanë një punë me kohë të pjesshme. Ndërkohë që Bullgaria nga ana tjetër, ka rreth 55 për qind të grave të punësuara, pra shumë më pak se Holanda, por vetëm 2.7 për qind e tyre punojnë me kohë të reduktuar, duke qenë se puna me kohë të pjesshme tradicionalisht nuk është diçka e zakonshme në këtë vend.

Së fundi, vlen të theksohet se ndërkohë që BE-ja ka rregulla të qarta për bashkëpunimin ekonomik midis vendeve anëtare, pjesa e mirëqënies sociale, përfshi edhe shërbimet që lidhen me to, janë lënë në dorën e qeverive kombëtare. Kjo për shkak të standardeve dhe vlerave specifike që çdo vend përfaqëson kur flitet për shërbimet që ofrohen. Kësisoj, një model i përbashkët i trajtimit të drejtësisë gjinore në gjirin e BE-së do të vazhdojë të jetë objekt diskutimi dhe debati edhe në të ardhmen.

Për shkak të arsyeve që përmendëm më lart, drejtësia gjinore vazhdon të jetë një çështje prioritare, por jo e lehtë për t'u trajtuar, sidomos nga vendet e reja anëtare, por edhe nga ato si Shqipëria, që synojnë t'i bashkohen familjes europiane. Më shumë vëmendje nevojitet për të trajtuar me kujdes dhe në vazhdimësi çështjet e përkatësisë gjinore për të siguruar standardet e nevojshme për anëtarësimin në BE, por më e rëndësishmja për të patur një shoqëri të barabartë për të gjithë individët në shoqëri, qofshin vajza apo djem, gra apo burra.

## Hapat për të ardhmen

Roli i BE-së si promovues dhe mbështetës i drejtësisë gjinore në Europën Qendrore dhe Lindore është i rëndësishëm. Zgjerimi i tij ka sjellë në vëmendje një debat të ri lidhur me politikën gjinore që duhen ndjekur nga vendet anëtare, por edhe ato si Shqipëria që synojnë të anëtarësohen. Përvoja ka treguar se progresi drejt drejtësisë gjinore - veçanërisht në vendet e reja anëtare - është ndikuar nga një zhvillim gradual i shoqërisë, institucioneve publike dhe pranimit të drejtësisë gjinore si pjesë e nevojshme dhe tepër e rëndësishme e zhvillimit të vendit. Shqipëria duket se paraqet të njëjtat tipare në këtë fushë. Megjithëse ka një ndryshim në rritje lidhur me trajtimin e drejtësisë gjinore në jetën publike dhe politike të vendit, ende ka shumë për t'u bërë. Kjo si nga politika - ligje më të mira, mbledhje e vazhdueshme dhe analizë e detajuar e të dhënave statistikore - ashtu edhe

nga vetë shoqëria - pranim më i hapur i drejtësisë gjinore dhe efekteve që lidhen me të. Përpjekjet duhet të vijin nga të gjithë aktorët në vend për të arritur një shoqëri të barabartë ku çdokush, pavarësisht përkatësisë seksuale, etnike, racore dhe moshës, të mund të hyjë si i barabartë në familjen e madhe evropiane. Vetëm kështu ne do të mund të sigurojmë një vend në familjen e madhe të Bashkimit Evropian.

## Viti Evropian për drejtësinë gjinore

Si një mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e drejtësisë gjinore dhe të aplikimit të saj nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, viti 2007 ishte caktuar Viti Evropian për këtë çështje. Një numër i konsiderueshëm aktiviteteve u zhvilluan në qytete të ndryshme të shteteve të BE-së, objektivat kryesore të të cilave ishin:

**Të drejtat** - rritja dhe ndërgjegjësimi për të drejtën e drejtësisë dhe të jo-diskriminimit si dhe për problemet e diskriminimit të shumëfishtë. Ky Vit Evropian dha mesazhin se çdo individ duhet të përfitojë trajtim të njëjtë dhe të barabartë, pavarësisht përkatësisë së tij seksuale, racore apo etnike, fetare, aftësive të kufizuara dhe moshës. Nëpërmjet aktiviteteve synohet që grupet që rrezikohen nga diskriminimi të bëhen më të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre dhe për ekzistencën e legjislacionit evropian në fushën e jodiskriminimit.

**Përfaqësimi** - të nxitet një debat për rritjen e përfaqësimit të grupeve të diskriminuara dhe të një pjesëmarrjeje të balancuar të grave dhe burrave në shoqëri.

**Respekti** - Inkurajimi i një shoqërie të larmishme. Eliminimi i stereotipave, paragjytimeve dhe dhunës, nxitja e marrëdhënieve të shëndetshme midis të gjithë anëtarëve të një shoqërie, veçanërisht midis të rinjve dhe përfshirje më të gjerë në veprimet kundër diskriminimit.

Ndërkohë që pikat e mësipërme konsiderohen si vija të përgjithshme të rrugës që duhet të ndjekin vendet anëtare drejt arritjes së drejtësisë gjinore, një sërë detyrash paraqiten edhe për vendet jo anëtare, siç është edhe rasti i Shqipërisë, por që aspirojnë të pranohen në një të ardhme të afërt. Për më tepër, detyrimet e institucioneve shqiptare kanë ardhur në rritje, duke patur parasysh faktin që është nënshkruar Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) me BE-në.

## Si të ecim në këtë rrugë sipas reformave të BE?

Dokumenti kryesor i BE-së për arritjen e drejtësisë gjinore është "Udhëzuesi për drejtësi gjinore midis grave dhe burrave" i hartuar në vitin 2006 nga KE-ja dhe më pas aprovuar nga Parlamenti Evropian. Ky dokument paraqet një mekanizëm konkret të arritjes së drejtësisë gjinore dhe punës që duhet kryer në këtë drejtim nga të gjitha vendet anëtare, përgjatë periudhës kohore 2006 - 2010. Analiza e ofruar në këtë material synon të mbështesë hapat për arritjen e objektivave të vendosur nga traktati i Lisbonës në drejtim të drejtësisë gjinore. Po ka gjithashtu edhe objektiva të tjerë shtesë që lidhen me pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës së një vendi.



## Objektivat e punësimit sipas Traktatit të Lisbonës

**Punësimi.** BE-ja synon, siç është përmendur, që rreth 60 për qind e grave dhe vajzave në moshë aktive pune, të jenë të punësuar deri në vitin 2010. Deri në vitin 2006 kjo shifër ishte 55.7 për qind, ndërkohë që ishte shumë e ulët (rreth 31.7 për qind) për gratë në moshë të mesme dhe ato mbi 55 vjeç. Gratë gjithashtu kishin një shkallë më të lartë papunësie sesa burrat (9.7 gratë kundrejt 7.8 të burrave).

Pabarazia në shkallën e pagave gjithashtu konsiderohet si problem. Gratë pagohen rreth 15 për qind më pak sesa burrat, megjithë legjislacionin ekzistues të pagave të barabarta. Shkaqet e kësaj gjendjeje lidhen me diskriminimin ndaj grave dhe pabarazitë strukturore, të tilla si ndarja e sektorëve të punësimit, modelet e marrjes në punë, mundësia për t'u arsimuar dhe trajnuar, vlerësim i njëanshëm i sistemit të pagave dhe stereotipat e punësimit.

**Gratë sipërmarrëse dhe mbrojtja sociale.** Në BE, gratë përbëjnë rreth 30 përqind të sipërmarrësve. Por ato ndeshen me vështirësi më të mëdha kur duan të fillojnë një biznes, sidomos nga ana e mbështetjes financiare. Megjithëse, gratë dhe burrat kanë të drejta dhe mundësi të barabarta për të hyrë në skemën e mbrojtjes shoqërore, në BE të dhënat tregojnë se gratë dhe vajzat kanë karriera më të shkurtra dhe gjithashtu me ndërprerje, të cilat shkaktojnë edhe mungesë vazhdimësie të mbështetjes së nevojshme sociale, si financiare ashtu edhe publike. Kjo bëhet veçanërisht e vështirë për prindërit e ndarë apo të divorcuar, gratë e moshuara dhe ato që janë të përfshira në sektorin e bujqësisë.

Këto janë disa nga fushat me prioritet të lartë nga ana e BE-së për vitet në vazhdim. Gjithsesi, fusha të tjera të fokusit në drejtim të drejtësisë gjinore përfshijnë edhe pjesëmarrjen publike dhe politike, shëndetësinë, mjedisin dhe një sërë sektorësh të tjerë, të cilët janë analizuar më në detaje në kapitujt e tjerë të këtij libri.

## STUDIME RASTI

### Studim rasti 1: Politika e punësimit e BE

Çështja e punësimit ka qenë një përgjegjësi kryesore e shteteve anëtare, ku BE-ja luante një rol të vogël mbështetës. Rreth mesit të viteve '90-të, duke parë shifrat në rritje të papunësisë, qeveritë e vendeve anëtare pranuan të bashkërendonin politikat e tyre të punësimit. Kësaj nëpërmjet disa dokumenteve të reja të hartuara nga Komisioni dhe Këshilli Evropian, udhëzues të rinj u hartuan për të ndihmuar qeveritë për aplikimin e këtyre metodave të reja. Duke qenë se punësimi në BE trajtohet nga një institucion i veçantë i quajtur Drejtoria e Përgjithshme e Punësimit dhe Politikave Sociale, ky ishte rast i mirë për drejtësinë gjinore që të përfshihej në të njëjtën drejtori.

Dhe arsyet për të zbatuar një politikë më të qartë dhe më efektive gjinore ishin mëse të mjaftueshme në atë kohë - kjo si për arsye ekonomike ashtu edhe sociale. Ndërkohë që punësimi i grave ishte përmirësuar krahasuar me dekadat e mëparshme, prapëseprapë gratë ishin më tepër të papuna (12.6 % krahasuar me 9.7 % të burrave), dhe shkalla e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës ishte më e ulët (50.2 % për gratë dhe 70.4 për qind për burrat). Gratë gjithashtu

ishin më pak të përfaqësuar në disa sektorë dhe profesione dhe shumë më tepër në disa sektorë të tjerë. Këto u konsideruan si faktorë që pengonin rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e mirëqenies sociale të shtetasve.

Tre ishin masat e marra në këtë drejtim: eliminim i boshllëqeve me bazë gjinore (përmes mbështetjes nga shteti për punësimin e grave); lehtësim i ngarkesës nga puna dhe detyrimet familjare (duke rritur shërbimet për kujdesin ndaj fëmijëve); dhe duke lehtësuar kthimin në tregun e punës të grave të shkëputura për një kohë të gjatë nga profesioni (duke përmirësuar trajnimin profesional të grave). Këto masa u zbatuan në mënyra të ndryshme nga vendet anëtare. Kjo duke patur parasysh se shërbimet sociale janë në një masë të madhe të varura nga qeveritë përkatëse. Gjithsesi, në vendet Skandinave dhe në një pjesë të mirë të Europës Perëndimore, rezultatet e aplikimit të këtyre modeleve shpejt dhanë frytet e tyre. Gratë rritën pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës, cilësia e jetës së tyre dhe familjeve të tyre u rrit, një ndarje më e mirë e përgjegjësive në familje mes grave dhe burrave lejoi një angazhim më të barabartë në jetën profesionale të grave dhe në përgjithësi, lehtësoi një rritje ekonomike të vendeve në të cilat u aplikua.

*Ky shembull megjithëse i përgjithshëm, është i vlefshëm për të kuptuar si nga ana kronologjike, por edhe ajo institucionale, marrjen e vendimeve për të sjellë ndryshim në punën drejt arritjes së drejtësisë gjinore.*

## Studim rasti 2: Ndarja e përgjegjësive në familje në Hollandë

Modelet e punësimit në Hollandë, përgjithësisht e pasqyrojnë burrin si siguresin kryesor të të ardhurave në familje. Ata punojnë me kohë të plotë gjatë gjithë jetës së tyre dhe kanë shumë pak kohë të lirë për të shpenzuar me fëmijët e tyre. Gratë punojnë me kohë të plotë derisa bëhen nëna, moment pas të cilit ose punojnë me kohë të reduktuar ose largohen krejtësisht nga tregu i punës. Edhe pse këto modele kanë filluar të ndryshojnë, përsëri pesha kryesore e punëve në familje duket se bie mbi gratë.

Një projekt i mbështetur nga Ministria e Çështjeve Sociale dhe Punësimit në Hollandë, synonte të krijonte mundësi më të mëdha punësimi për gratë, duke i fokusuar aktivitetet e tij te burrat. Mesazhi i dërguar nëpërmjet një fushate mediatike ishte i qartë dhe i thjeshtë : nëse burrat përfshihen më tepër në aktivitetet brenda shtëpisë, gratë do të jenë në gjendje të balancojnë më mirë punën dhe jetën në familje.

Fushata profesionale mediatike e organizuar për këtë projekt, zgjati rreth një vit duke përdorur sloganin “Kush bën çfarë?”. Rezultati ishte fillimi i një debati kombëtar në të gjithë vendin. Tre muaj pas fillimit të fushatës, rreth 55 për qind e popullsisë ishte në dijeni të projektit, duke marrë informacion përmes televizionit, radios, konferencave për shtyp, internetit, debateve televizive dhe aktiviteteve të tjera.

Meshkujt u përfshinë në fazat e para të planifikimit të fushatës duke sjellë në këtë mënyrë një ton të pranueshëm në publik, veçanërisht në rradhët e burrave. Për shembull, spotet televizive fillimisht u përqëndruan për të treguar justifikimet e përdorura nga burrat për të

shmanguar detyrat brenda shtëpisë. Një prej tyre tregonte një burrë të ulur në një bar me kolegët e tij, që shprehej se kështu ai mund të ruante rrethin e tij të miqve, por edhe të kishte mundësi të bisedonte për karrierën dhe punën. Burri ishte i ndërgjegjshëm që kësaj ai nuk kishte kohë të lirë për të shkuar në kopësht të merrte fëmijët, por gjithsesi gruaja e tij mund ta bënte këtë. Pra, sipas tij çdo gjë ishte e zgjidhur.

Hapi tjetër i fushatës ishte të përqëndrohej në dhënien e mesazheve motivuese dhe pozitive më tepër sesa një provokim, duke trajtuar disa nga dilemat kulturore tradicionale që ndeshen nga gratë dhe burrat. Ndërkohë që gratë pëlqejnë idenë e përfshirjes së bashkëshortëve të tyre në aktivitetet shtëpiake, po vetë ato shpesh frustrohen nga kryerja e tyre në një mënyrë “mashkullore”. Nga ana tjetër, punëdhënësit nuk parapëlqejnë që të punësuarit e tyre meshkuj të marrin përsipër detyrime familjare ekstra (kjo do të thotë punë me orar të reduktuar, punë në shtëpi, që punëdhënësit e shohin si ulje të rendimentit në punë). Spotet televizive dhe ato në radio synonin të shfaqnin kënaqësinë që burrat mund të përftonin nga shpenzimi i kohës me fëmijët e tyre në mënyrë cilësore dhe se sa kjo e përmirëson jetën e tyre, të fëmijëve dhe bashkëshorteve të tyre.

Duke përdorur gjerësisht edhe internetin si një mjet të gjerë komunikimi, burrat u nxitën që të diskutonin rreth këtyre çështjeve me kolegët dhe punëdhënësit e tyre. Rezultati ishte që shumë prej tyre arritën të bënin një “marrëveshje të ndarjes së roleve” në familje. Në vazhdim, një pjesë e konsiderueshme kompanish hartuan një strategji të qartë që lejonte të punësuarit meshkuj të kishin fleksibilitet në kohën e shpenzuar në punë dhe në shtëpi. Kjo çështje, tashmë është e pranishme si një seksion më vete në të gjitha trajnimet e organizuara nga firmat, sidomos në pozicionet e menaxhimit.

Si një hap tjetër i rëndësishëm, kjo fushatë u fokusua edhe në brezin e ri, ose e thënë ndryshe, në atë të prindërve të ardhshëm. Forume diskutimi dhe debatesh u organizuan në shkolla duke përdorur një model të përgatitur nga projekti. Të rinjtë negocionin duke marrë përsipër role të ngjashme me ato në familje, lidhur me ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në shtëpi, si dhe lidhur me procesin e ndërtimit të karrierës profesionale. Kjo mbështetej nëpërmjet këshillave dhe sugjerimeve për kombinimin e ngarkesës në punë, kujdesin ndaj fëmijëve dhe përfshirjen sociale në sferën publike të shoqërisë dhe komuniteteve ku ata/ato jetonin.

Ky rast është një shembull i mirë i përdorimit të modelit të integritit gjinor në nivel kombëtar dhe komunitar. Kjo pasi prek të gjitha shtresat e popullsisë, por edhe synon të punojë në disa nivele institucionale dhe shoqërore. Nga ana tjetër, ofron dhe disa ide të mira për t’u aplikuar gjatë orës së mësimit, si dhe për organizimin e aktiviteteve jashtëshkollore dhe atyre më profil komunitar.

### Studim rasti 3: Motivimi i vajzave në zgjedhjen e profesioneve

Një grup organizatash nga Gjermania, Italia dhe Austria dëshironin të shihnin më tepër vajza që ndërmerrnin një karrierë në politikë, në shkencat natyrore dhe në profesione teknike. Ato vendosën të kryenin një studim për të gjetur se çfarë i mbante vajzat larg

këtyre fushave dhe si mund t'i motivonin ato të përfshiheshin më tepër. Kërkuesit në secilin vend studiuan tre sektorë: politikën, mbrojtjen mjedisore dhe shkencat ekzakte. Ata vërejtën nivelin e pjesëmarrjes së vajzave në sistemin e arsimit, pritshmëritë e prindërve dhe mësuesve, për të parë ndikimin që ato kishin tek vajzat. Synimi i analizës ishte të ofroheshin udhëzime dhe sugjerime se si vajzat mund të përfshiheshin në mënyrë më të barabartë.

## Rezultatet e studimit

Rezultatet kombëtare u krahasuan duke treguar se megjithëse drejtësia gjinore ishte një objektivi i qeverive në secilin vend, struktura politike dhe arsimore e tyre nuk ishte e përshtatshme për t'u dhënë hapësira vajzave në fushat e lartpërmendura. Studiuesit gjetën se diskriminimi, ndonëse në shumë raste i fshehur vazhdonte të ekzistonte.

Për shembull, megjithë ndryshimet në rritjen e pagës për gratë, ato ende janë përgjegjëset kryesore për punët e shtëpisë. Kjo ndarje tradicionale dhe stereotipizuese gjinore, kishte një ndikim të dukshëm te të rinjtë, qofshin djem apo vajza, për veten e tyre dhe për rolin që ata/ato pritet të luajnë në shoqëri. Shpesh, të rinjtë mendonin se ata kishin të drejta të barabarta midis tyre dhe nuk ishin të ndërgjegjshëm apo nuk ishin në gjendje të vërenin diskriminimin që vinte si pasojë e përkatësisë së tyre gjinore. Në studim, vajzat shpreheshin se nuk dëshironin të trajtoheshin ndryshe nga djemtë, duke qenë se kjo i bënte të ndiheshin si qytetare të dorës së dytë dhe jepte idenë se ato duhet të bënin më tepër për të arritur në nivelin e djemve.

Për të inkurajuar dhe motivuar vajzat, qeveritë dhe organizatat pjesëmarrëse në projekt menduan që të ndryshonin politikat e tyre. Ata menduan që të merrnin në konsideratë nevojat e vajzave dhe të siguronin që vajzat të mos ndiheshin inferiore ndaj djemve në aktivitetet brenda shkollës. Vajzat kishin treguar se ato ishin të interesuara për të gjitha lëndët që kryheshin në sistemin shkollor dhe nuk shprehnin preferenca për një grup apo profil të caktuar edukativ.

Një nga gjetjet më të rëndësishme të studimit ishte se prindërit dhe mësuesit luanin një rol të rëndësishëm në formimin e interesave dhe pritshmërive të vajzave në hapat për të ardhmen. Kjo sidomos në formimin profesional. Kështu, projekti sugjeronte që mësuesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rolin që ata/ato luajnë në zgjedhjen e karrierës për nxënësit, si dhe duhet të kuptojnë se në çfarë mase shkolla mund të përforcojë dhe nxisë stereotipat gjinore, në mënyrë direkte apo jo direkte. Për shembull, djemtë nxiten për më tepër që të fokusohen në lëndët ekzakte dhe më pak në ato shoqërore, dhe e kundërta për vajzat. Kjo edhe në rastet kur nga të dy grupet interesi dhe prirjet e shfaqura mund të mos jenë pjesë e pritshmërive të mësuesve dhe prindërve. Si djemtë ashtu edhe vajzat duhet të kenë hapësirën e nevojshme, si brenda shkollës ashtu dhe jashtë saj që të analizojnë rolet dhe kapacitetet e tyre në shoqëri, pasi kjo vlen për të kuptuar më tepër impaktin që ata kanë dhe mund të kenë në të ardhmen. Arsimi shkencor dhe teknik duhet të jetë i barabartë për të dy grupet në mënyrë që të shmanget kanalizimi i hershëm i zgjedhjes së karrierës.

## Përmbledhje

Bashkimi European është një njësi ekonomike dhe politike prej 27 vendesh. Arritja e standardeve të drejtësisë gjinore është një nga kushtet e anëtarësimit për vendet që aspirojnë të bëhen pjesë e këtij bashkimi shtetesh. Edhe vendi ynë duhet të përmbushë këto standarde për të finalizuar procesin e integritit evropian dhe pjesëmarrjes në BE-në.

Drejtësia gjinore është një çështje e rëndësishme në politikat e BE-së. Gjatë viteve të fundit, BE-ja është përpjekur që përveç përmirësimit të kushteve të barabarta midis grave dhe burrave në vendin e punës, të ndër marrë nisma specifike për arritjen e drejtësisë gjinore. Integrimi gjinor tashmë është kthyer në angazhimin kryesor institucional për arritjen e këtyre objektivave. Arritja e objektivave të drejtësisë gjinore kërkon futjen e një perspektive të re në trajtimin e këtyre problemeve, duke përdorur ekspertizën e nevojshme, duke mobilizuar struktura të veçanta dhe duke vënë theksin në çështje që kërkojnë një vëmendje specifike për zbutjen dhe eliminimin e pabarazive gjinore.

Arritjet më të mëdha në fushën e drejtësisë gjinore, janë ato në drejtim të zbutjes së dallimeve në fushën e arsimit të një numri më të madh të grave dhe vajzave në vendet e BE-së. Megjithatë dallime të mëdha ende ekzistojnë në fushat specifike që burrat dhe gratë zgjedhin për të studiuar. Burrat tentojnë të përfshihen më tepër në shkencat natyrore, ndërsa gratë përbëjnë pjesën më të madhe të studentëve në fushën e artit dhe të shkencave humane. Akoma edhe në BE, disa prej sektorëve janë të ndarë në "mashkullorë" dhe "femërorë". Eliminimi i kësaj ndarjeje është edhe një nga çështjet prioritare në të ardhmen e politikave gjinore të BE-së.

Megjithë arritjet e përmendura në këtë kapitull, punësimi, dallimet në pagesa për punë të njëjtë, ndarja e punëve në familje, dallimet në profilet e arsimit dhe përfaqësimi në nivelet e vendimmarrjes, mbeten ende problematike për arritjen e mundësive dhe hapësirave të barabarta midis grave dhe burrave në vendet e BE-së. Megjithëse, në disa prej vendeve këto çështje kanë ardhur duke u përmirësuar ndjeshëm, ende në disa vende më shumë duhet të bëhet për të arritur objektivat e vendosura nga institucionet e BE-së. Edhe vendi ynë, megjithë progresin e arritur në disa nivele, duhet të krijojë më tepër lehtësira për arritjen e drejtësisë gjinore. Arritja e këtij objekti do ta bëjë më të lehtë dhe më të shpejtë pjesëmarrjen e vendit tonë me të drejta dhe detyrime të plota në familjen e madhe evropiane.

Qëllimi final është pjesëmarrja si të barabartë në një shoqëri më standarde të larta shoqërore.

## *Përkatësia gjinore dhe media*

### Hyrje

Ky kapitull trajton pasqyrimin dhe analizën e problematikave të përkatësisë gjinore nga media me qëllim për të evidentuar dobinë dhe domosdoshmërinë e fokusimit të medias në këto çështje në mënyrë të plotë e të vazhdueshme.

Ai paraqet shkurtimisht se cilat janë konceptet dhe termat kryesore, që mediat duhet të përdorin për integrimin e përkatësisë gjinore, si dhe disa prej konventave dhe dokumenteve ligjorë kombëtarë e ndërkombëtarë me rëndësi në përcaktimin e rolit të medias lidhur me pasqyrimin e rolit të gruas.

Të gjithë kemi bindjen tashmë se media luan një rol kyç në promovimin e barazisë gjinore. Për ta kryer sa më mirë këtë rol është shumë e rëndësishme që jo vetëm të zbatohen ligjet shqiptare, kodi etik i medias, por edhe ato ndërkombëtare. Statistika të shumta tregojnë hendekun e madh të pabarazisë gjinore që ekziston jo vetëm në shoqërinë shqiptare, por edhe në nivel botëror.

Gjatë këtij kapitulli do të paraqiten edhe disa stereotipa gjinore që ekzistojnë në fushën e medias për të reflektuar së bashku se si dhe pse duhen ndryshuar ato.

Ajo çka do të theksohet në vijim, lidhet drejtpërdrejt me ndikimin që ka media në paraqitjen dhe përshkrimin e rolit dhe statusit të grave e burrave në Shqipëri, si dhe në vende të ndryshme të botës.

Në përfundim të trajtimit të kësaj çështjeje nxënësit tuaj duhet të jenë të gatshëm të:

- Identifikojnë dhe listojnë konceptet kryesore që lidhen me përkatësinë gjinore dhe median,
- Identifikojnë dokumentet ndërkombëtarë që promovojnë barazinë gjinore në media,
- Listojnë dokumentet kombëtarë në përfshirjen e medias si element kyç i barazisë gjinore,
- Identifikojnë dhe interpretojnë stereotipat gjinore që përcillen në media,
- Interpretojnë mesazhet që reflekton media rreth burrave dhe grave,
- Diskutojnë dhe identifikojnë mënyra të përfshirjes së perspektivës gjinore në media.

*Disa prej besimeve të sotme mbi këtë çështje*

Kur trajtojmë çështjen e përkatësisë gjinore në media jemi të prirur të mendojmë dhe besojmë se:

- Përdorimi i imazheve femërore në marketing funksionon shumë mirë, prandaj nuk hiqet dorë prej tyre.
- Vetë gratë lejojnë që të shfrytëzohen nga mediat.
- Edhe meshkujt portretizohen shumë shpesh në mënyrë jorealiste në media.
- Vetëm gratë e bukura mund të jenë të suksesshme.
- Barazia gjinore nuk është e domosdoshme në media.
- Barazia gjinore është një perspektivë që përfshin vetëm gratë.
- Gratë në karrierë nuk janë nëna të kujdesshme.

## Koncepte kryesore

Këtu janë paraqitur disa koncepte kryesore që kanë të bëjnë me përkatësinë gjinore në media. Edhe pse këto janë koncepte të përcaktuara, çdo individ i percepton ato në mënyra të ndryshme.

**Përkatësia gjinore** i referohet përcaktimit socio-kulturor për burrin dhe gruan, pra mënyrës se si shoqëri të ndryshme në kohë dhe në hapësirë bëjnë dallimin midis burrit dhe gruas. Përkatësia gjinore i referohet mundësive dhe normave të shoqërisë që janë të lidhura me faktin e të qenit burrë apo grua, vajzë apo djalë, po ashtu edhe marrëdhënieve mes grave dhe burrave. *Ju si e perceptoni?*

**Seksi** ka të bëjë me dallimet biologjike midis meshkujve dhe femrave, të cilat janë universale dhe nuk ndryshojnë. Ai ka të bëjë me ndryshimet e mundshme në organet seksuale dhe funksionet riprodhuese.

Me **marrëdhënie gjinore** kuptojmë marrëdhëniet e pushtetit midis burrave dhe grave, të cilat shfaqen në një sërë veprimesh, idesh si ndarja e punës, rolet dhe mundësitë e ndryshme që ekzistojnë midis burrave dhe grave si dhe caktimi i aftësive, qëndrimeve, dëshirave, tipareve të personalitetit, modeleve të ndryshme të sjelljes, etj. midis burrave dhe grave.

**Socializimi** është procesi përmes të cilit individët zhvillojnë potencialin njerëzor, mësojnë mënyrën e jetesës dhe kulturën e tyre, krijojnë përvojën jetësore sociale.

**Agjentë kryesorë socializimi** për individin janë: familja, shkolla, bashkëmoshatarët dhe media.

Ju si e perceptoni rolin e secilit prej tyre? Tregoni shembuj nga përvoja juaj për rolin që ka secili prej këtyre agjentëve socializues.

**Stereotipat** janë përgjithësime, skema për cilësitë dhe karakteristikat e anëtarëve të një kategorie ose grupi social të caktuar. Karakteristikat psikologjike dhe të sjelljes të grave dhe burrave (ose rolet e tyre seksuale) interpretohen përmes një sërë thëniesh të fiksuara

dhe strikte. *Ju si i perceptoni? A mund të jepni shembuj të tyre?*

**Stereotipat gjinorë** përfshijnë cilësitë e personalitetit që mendohet se janë tipike për meshkujt dhe femrat. Ato përfshijnë gjithashtu rolet profesionale dhe sociale që konsiderohen si parësore për meshkujt dhe femrat.

*Ju si i perceptoni? Ju lutem jepni shembuj të stereotipave gjinorë.*

**Barazia gjinore** është koncepti sipas të cilit të gjitha qëniet njerëzore, pa dallim race, seksi, bindjeje fetare, niveli social-kulturor apo status politik, duhet të kenë të drejta ligjore të barabarta. *Ju si e perceptoni barazinë gjinore? A jeni ju të barabartë me njëri-tjetrin në familje, në shoqëri në komunitetin ku jetoni?*

**Këndvështrimi gjinor** ka të bëjë me trajtimin e një çështjeje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mënyrave të ndryshme sesi burrat dhe gratë ndikohen apo mund të ndikohen. *Ju si e perceptoni?*

**Diskriminimi** është një sjellje e dukshme e trajtimit ndryshe të njerëzve, jo në mënyrë të favorshme për shkak të racës, klasës, gjinisë apo statusit kulturor të tyre. *Ju si e perceptoni?*

**Diskriminimi gjinor** konsiderohet si përjashtim, pengesë dhe dallim i bërë në bazë të seksit, që ka si qëllim mohimin e ushtrimit të barabartë të të drejtave e lirive themelore të njeriut në të gjitha fushat.<sup>41</sup>

**Drejtësia gjinore** ka të bëjë me nxitjen e barazisë personale, shoqërore, kulturore, politike dhe ekonomike për të gjithë. Ajo nënkupton që të bëhet çfarë është e nevojshme për të siguruar barazi rezultatesh në përvojat e jetës së burrave dhe grave.

*Ju si e perceptoni drejtësinë gjinore? Nga ndryshon barazia gjinore nga drejtësia gjinore?*

**Fuqizimi** është një proces, përmes të cilit burrat dhe gratë që ndodhen në pozita të pafavorshme, rritin aksesin ndaj informacionit, burimeve dhe pushtetit vendimmarrës, si dhe ndërgjegjësimin mbi pjesëmarrjen në jetën komunitare, me qëllim arritjen e një niveli të caktuar kontrolli.

**Përfshirje e perspektivës gjinore apo integrim gjinor** - është procesi i (ri)organizimit, përmirësimit, zhvillimit dhe vlerësimit të proceseve politike, në mënyrë që perspektiva gjinore të mishërohet në të gjitha politikat e të gjitha niveleve prej aktorëve të përfshirë në politikëbërje<sup>42</sup>. Integrim gjinor do të thotë që barazia gjinore të bëhet pjesë e plotë e politikave. Ai nënkupton një përkufizim më të gjerë dhe më përfshirës të barazisë gjinore, duke i dhënë vlerë ndryshimeve dhe larmisë.

*Ju si e perceptoni? A mund të arrihet kjo në median shqiptare?*

**Media** përfshin mjetet e komunikimit masiv drejtuar publikut të gjerë, ndryshe "aparate"

<sup>41</sup> Përkufizimi është marrë nga Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.

<sup>42</sup> Formulimi i përkufizimit është bërë nga Seksioni i Barazisë mes Grave dhe Burrave në Këshillin e Europës.



që organizojnë proceset e prodhimit dhe të shpërndarjes së njoftimit (informacionit) dhe produkteve të imagjinatës. Janë **mjete të komunikimit në përmasa të mëdha** nganjëherë cituar edhe me termin anglisht, **mass media** ose thjeshtë **media**. Janë mjete nëpërmjet të cilave bëhet e mundur shpërndarja e dijes drejt një pluraliteti marrësish ose përdoruesish (publiku) informacioni pa dallim.

Mjetet e komunikimit masiv janë: shtypi, botimet, kinemaja, radioja, televizioni, publiciteti, interneti etj.

## Dokumente ndërkombëtarë

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948)
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)
- Platforma e Pekinit 1995
- Platforma e Komunitetit Europian për Arritjen e Barazisë Gjinore
- Standardet e BE-së
- Objektivi i tretë i Mijëvjeçarit
  
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948) neni 2, në të cilën jepen parimet bazë të barazisë dhe mosdiskriminimit, ndalon: *“dallimet e çdo lloji sipas racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, besimit, bindjeve politike dhe të tjera, origjinës kombëtare dhe sociale, pasurisë, statusit në lindje etj”*.
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) është konventë e adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 1979. CEDAW njihet si ligji ndërkombëtar për të drejtat e grave. Në nenin 5 të CEDAW-it thuhet se: *“Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme me synim që: të ndryshojnë skemat dhe modelet e sjelljes shoqërore dhe kulturore të burrit dhe gruas, në mënyrë që të arrijnë të zhdukin paragjykimet dhe praktikat zakonore ose të çdo lloji tjetër, që mbështeten në idenë e inferioritetit apo të epërsisë të njërit ose tjetrit seks apo në rolin stereotip të burrit dhe të gruas”*.
- Platforma e Pekinit e Konferencës së 4-t botërore të Kombeve të Bashkuara për Gruan, 1995 përfshiu *Dhunën ndaj gruas*, si një nga 12 çështjet kritike për t'u adresuar nga qeveritë dhe aktorët e tjerë. Gjithashtu tërhoqi vëmendjen e medias lidhur me *“produktet mediatike të dhunshme ose pornografike...që ndikojnë në mënyrë negative te gratë dhe në pjesëmarrjen e tyre në shoqëri”*.

Në vitet pas Platformës për Veprim të Pekinit diskutimi mes lidhjeve të medias dhe dhunës u fokusua në dy çështje kryesore:

- Shkalla në të cilën aspektet negative dhe stereotipizuese të imazheve të grave në media, mund të ndikojnë në dhunën gjinore në shoqëri,

- Mbulimi mediatik i incidenteve të dhunës ndaj grave.

- Standardet e BE-së lidhur me trajtimin e barabartë të grave dhe burrave janë pjesë e legjislacionit, të siguruara përmes disa neneve të Traktatit të Amsterdimit në vitin 1997.
- Neni 2 i këtij Traktati deklaron barazinë mes grave dhe burrave si një nga përgjegjësitë kryesore të shteteve palë të Komunitetit Europian.
- Neni 3 (pika 2) nënvizon se “Në të gjitha aktivitetet që lidhen me këtë nen, shtetet palë të BE-së duhet të synojnë eliminimin e pabarazive dhe të promovojnë barazinë mes grave dhe burrave”.
- Ndërsa në Platformën për Arritjen e Barazisë Gjinore (2006-2010) të Komunitetit Europian theksohen gjashtë fusha prioritare për periudhën e mësipërme:
  - pavarësia ekonomike si për gratë edhe për burrat,
  - pajtimi i jetës personale dhe profesionale,
  - përfaqësimi i barabartë mes grave dhe burrave në vendimmarrje,
  - minimizimi i të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore,
  - eliminimi i stereotipave gjinore,
  - promovimi i barazisë gjinore në politikat e zhvillimit dhe në politikat e jashtme.

Në këtë Platformë theksohet se: “Vendet që duan t’i bashkohen Bashkimit Europian duhet të kenë parim bazë arritjen e barazisë gjinore mes grave dhe burrave... Monitorimi dhe përafrimi i legjislacionit të barazisë gjinore si edhe zbatimi i tij, do të jetë një prioritet i BE-së në proceset e zgjerimit të tij”.

- Përfshirja e perspektivës gjinore në media është një nga hapat drejt përmbushjes së Objektivit të tretë të Mijëvjeçarit: Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas. Shteti shqiptar ka marrë përsipër ta përmbushë këtë objektiv deri në vitin 2015.
- Këshilli i Europës (KE) në Rekomandimin<sup>43</sup> mbi Barazinë midis burrave dhe grave (nr.84-17) thekson se: “Media luan një rol të rëndësishëm në formimin, ndërtimin e qëndrimeve dhe vlerave, si dhe gëzon një potencial të madh për të çuar drejt ndryshimit social, pra media është një mjet i fuqishëm socializimi”.

## Dokumente kombëtarë

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998) në nenin 18 të saj, përcakton se “Të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale”.

<sup>43</sup> Lanara Zoe, “Gender Equality and Media”. Greek General Confederation of Broadcasters (GSEE), 2002.

- Ligji “Për barazi gjinore në shoqëri” miratuar më 24.07.2008. Ligji bazohet në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit dhe në parimet e tjera, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga Konventa CEDAW, si dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” ndalon diskriminimin në marrëdhëniet e punës (publike dhe private). Në këtë ligj parashtrahet ndër të tjera, trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi në media për shkak të gjinisë. Në nenin 26, titulluar

*Barazia gjinore në media, sanksionohet se:*

1. Media ndihmon në rritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazinë e grave dhe të burrave:

- a) përmes raportimit jodiskriminues mbi baza gjinore,
- b) përmes përdorimit të terminologjisë neutrale në aspektin gjinor,
- c) përmes shmangies së stereotipave gjinorë në veprimtarinë e vet.

## Reflektoni dhe diskutoni rreth kësaj pjese të ligjit

2. Ndalohet transmetimi, botimi dhe publikimi i materialeve dhe i informacioneve, që përmbajnë apo nënkuptojnë dallime poshtëuese apo fyese, përjashtime apo kufizime të njëjës prej gjinive, në bazë të diskriminimit për shkak të gjinisë.

*Reflektoni dhe diskutoni mbi këtë nen të ligjit, jepni shembuj të (mos)zbatimit të këtij ligji nga media në Shqipëri.*

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje, dokument i hartuar nga qeveria shqiptare në 2007, synon të paraqesë rrugët dhe mekanizmat institucionalë për përfshirjen e çështjeve gjinore në politikat publike, për zbutjen e dallimeve gjinore dhe dekurajimin e parandalimin e dhunës në familje. Në të janë përcaktuar 8 prioritetet strategjike, ndër të cilat ai lidhur me barazinë gjinore në media si më poshtë: “Përmirësimi i rolit të medias për një mentalitet të ri, që i përgjigjet zhvillimit të kohës, lidhur me barazinë gjinore në shoqëri dhe rritjen e përfaqësimit të grave dhe vajzave në këtë profesion”.

Për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje, autoriteti përgjegjës është Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, e cila ka si qëllim të nxisë barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e gruas në jetën e vendit.

## • Kodi etik i medias shqiptare

Sipas këtij Kodi: “Media nuk duhet të bëjë publike asnjë foto, imazh apo arranzhim audio ose video, i cili shtrembëron idetë ose faktet e burimit informues, me përjashtim të rasteve të karikaturave, kartonave apo pjesëve komike.

Gazetarët nuk duhet të bëjnë të njohur emrin e një personi, i cili ka dhënë informacion në mënyrë konfidenciale, me përjashtim të rastit kur personi ka dhënë pëlqimin në mënyrë të qartë. E drejta për anonimitet mund të shkelet vetëm në raste të veçanta:

- a) Kur ka dyshime që burimi me vetëdije ka shtrembëruar të vërtetën,
- b) Kur referenca për emrin e burimit është e vetmja mënyrë për të shmangur dëme serioze dhe të pashmangshme,
- c) Kur informacioni në fjalë lidhet me planifikimin e një akti kriminal”.

- A zbatohen këto rregulla dhe kodi etik në mediat shqiptare?
- Nëse po/jo, jepni shembuj konkretë.

Dhuna dhe brutaliteti nuk duhen sensacionalizuar. Raportimi duhet të marrë parasysh gjithashtu nevojën për të mbrojtur të miturit. Krimet, terrorizmi si dhe veprimtari të tjera të dhunshme nuk duhen propaganduar.

- *Reflektoni dhe diskutoni.*

Media duhet të tregojë maturi në identifikimin e viktimave apo dëshmitarëve në krime, sidomos në rastet e dhunës seksuale, me përjashtim të rasteve kur është marrë pëlqimi i tyre për t'u identifikuar.

## Të dhëna dhe fakte

- Statistika botërore

Studimet e kohëve të fundit kanë treguar se burrat përbëjnë më se katër të pestat e citimeve apo shfaqjeve në gazeta dhe tre të katërtat e të intervistuarve në televizion.

Pabarazia gjinore identifikohet dhe në filmat e shfaqur në Hollivud, ku burrat zënë 90% të posteve ekzekutive të nivelit të lartë dhe luajnë dy të tretat e roleve kryesore në filmat kinematografikë dhe televizivë të mbrëmjes.

Në nivel botëror pabarazia në përfaqësimin e grave në media është akoma më e theksuar në disa grupe të veçanta grash. Mediat informative dhe zbavitëse rrallë shkojnë përtej asaj që quhet “spërkatje me pakica”. Gratë me ngjyrë zënë vetëm 3% të posteve drejtuese në shtyp, krijojnë vetëm 2% të lajmeve të transmetuara dhe kanë shumë më pak role kryesore në filma kinematografikë dhe televizivë. Edhe në telenovelat ditore, ku të paktën 25% e shikuesve janë gra me ngjyrë, personazhet me ngjyrë kanë një nënpërfaqësim të theksuar.

Grupi i grave punonjëse pothuajse nuk përfaqësohet në filma a televizion, shikuesit rrallë shohin kompromiset midis punës dhe familjes. Me përjashtime shumë të rralla, shumica e roleve kryesore janë gra profesioniste të klasave të larta me mundësi që shumica e grave nuk i kanë; në filma ka 19 avokate për çdo 2 mësuese, ndërsa sekretare që nuk kanë kush t'ua mbajë fëmijët nuk shihen gjëkund.

Në media, gratë përbëjnë dy të tretat e të diplomuarve në gazetari, por vetëm një të tretën e emrave që shihen në faqe të parë, një të pestën e gazetarëve televizivë dhe më pak se një të dhjetën e kryeredaktorëve<sup>44</sup>.

### • Statistika lokale

Sipas një studimi të kryer nga Grupi Shqiptar i Gazetarëve (shtator 2004), në mediat shqiptare gratë janë pesë herë më pak të përfaqësuara se burrat. I njëjti studim tregon se temat në lidhje me gruan gjatë shtatorit 2004 në mediat shqiptare kanë përfaqësuar vetëm 10% të gjithë temave të trajtuara. Në bazë të tematikës, gratë përbëjnë 45% të subjekteve mbi artin e kulturën, 7% të subjekteve mbi varfërinë, 6% mbi sportin, 30% mbi trafikun dhe edukimin 2%. Ndërsa numri më i madh i gazetarëve haset në televizione, ato përfaqësonin rreth 60 % të prezantuesve, 65 % e tyre ishin reportere në shtyp apo televizion. Ato trajtojnë më shumë tema për mjedisin, edukimin dhe janë ende në minoritet kur flitet për çështje politike (25%) dhe kriza ndërkombëtare (6%). Përfaqësimi i grave në media ulet në mënyrë të dukshme kur mosha e tyre i kalon të 35 -at.

Në vitin 2006 janë monitoruar dy gazeta të përditshme (*Shekulli* dhe *Standard*) në Shqipëri dhe një revistë javore (*Klan*) për një periudhë 15 ditore (1-15 mars 2006)<sup>45</sup>. Nga ky monitorim rezultoi se:

- Numri total i artikujve mbi gratë ishte 76 ose 23% e numrit total të artikujve të monitoruar. Numri total i artikujve mbi burrat ishte 255 ose 77% e numrit të artikujve të monitoruar.
- Artikujt mbi burrat në politikë përbëjnë rreth 67% të artikujve të monitoruar, ndërsa artikujt mbi gratë në politikë përbëjnë vetëm 12.7%.
- Sferat e influencës për gratë dhe burrat janë qartazi të ndara: për burrat është politika dhe biznesi ndërsa për gratë është moda, bukuria, shtëpia dhe kultura.<sup>46</sup>
- Çështjet gjinore zakonisht perceptohen të jenë çështje “grash”, dhe si rrjedhojë u lihet faqja e pasme e gazetave dhe revistave.<sup>47</sup>
- Në vitin 2003 në studimin “Ndjeshmëria e medias së shkruar ndaj çështjeve gjinore në Shqipëri” konstatohet se ekziston një tendencë për ta kufizuar shpjegimin e dhunës në familje vetëm në problemet ekonomike dhe periudhën e tranzicionit.

<sup>44</sup> Marrë nga “Speaking of Sex, the Denial of Gender Inequality” 1997.

<sup>45</sup> Gazetat dhe revistat e monitoruara janë skanuar imtësisht dhe artikujt e zgjedhur janë kategorizuar duke u bazuar në fjalët kyç: burrat/gratë në politikë; burrat/gratë në biznes; burrat/gratë në kulturë (art, sport, letërsi); burrat/gratë në modë/bukuri; burrat/gratë në familje, përfshirë dhe dhunën në familje.

<sup>46</sup> Aleanca Gjinore për Zhvillim, Media e shkruar në Shqipëri-një vështrim i shkurtër. Tiranë, 2006.

<sup>47</sup> Me çështje gjinore nënkuptohen çështjet që lidhen me gratë dhe vështirësitë që ato hasin çdo ditë gjatë jetës së tyre: përkujdesja për familjen dhe shtëpinë, aksesin ndaj burimeve natyrore si uji, ushqimi, banesa, etj., si dhe diskriminimi në fushën publike, arsimin dhe më shpesh: në vendin e punës.

Sipas studimit, ajo që vihet re rëndom në media është fajësimi i grave të dhunuara duke i konsideruar si shkaktare apo nxitëse. Një pjesë e mirë e artikujve nuk e shohin dhunën në familje si shkelje të të drejtave të njeriut, duke e paraqitur vetëm si lajm sensacional pa u përqëndruar në shkaqet e vërteta të problemit dhe pasojave të tij.

Në median elektronike të monitoruar nga QAGJZH-ja u konstatua se gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare të 2005, 95% e minutazhit politik ju dha kandidatëve burra, ndërsa në 6 kanale televizive vetëm në 8.6% të kronikave u paraqiten kandidatë gra.<sup>48</sup> Në zgjedhjet parlamentare të 2009, përfaqësimi ishte disi më i madh, kjo edhe për shkak të sistemit zgjedhor, tashmë proporcional, por përsëri gratë kandidatë ishin më pak të dukshme se burrat kandidatë.

Pabarazia vihet re edhe në strukturën e ndërtimit dhe funksionimit të medias edhe në vendin tonë. Kështu raporti gazetarë/gazetare është dukshëm në favor të të parëve dhe sa më lart të ngjitesh në hierarkinë e drejtimit të medias aq më i madh është ky shpërpjestim. Nga një sondazh i vitit 2006 rezulton se përqindja e femrave që punojnë si gazetare në median e shkruar është rreth 40%. Ndërsa në median vizive shumica e tyre janë thjesht prezantuese.<sup>49</sup>

### Dilema dhe stereotipa gjinorë

Ne tentojmë të pranojmë ose besojmë gjërat që shohim më shpesh në televizion. Ne nuk mund të marrim me mend ato që nuk i shikojmë kurrë (apo rrallë) të prezantuara në televizion (p.sh. gratë nuk janë ose nuk mund të jenë vendimmarrëse apo politikëbërëse derisa ne nuk i shohim kurrë në role të tilla).

Problemi nuk është vetëm se gratë nuk janë të pranishme, por edhe se cilat gra nuk janë të pranishme. Edhe këtu boshllëqet janë krejt të parashikueshme. Shpesh, ato që janë "larg syve", janë gratë e moshuara, gratë shtëpiake, me aftësi të kufizuara, të varfëra, homoseksuale, apo me ngjyrë. Megjithë ndryshimet nga viti në vit, në nivel botëror, statistikisht gratë janë ende larg përfaqësimit të barabartë në media.

Imazhet e grave që promovohen nga media ndikojnë në rolin dhe statusin e tyre në shoqëri pasi ndryshojnë mënyrën si ato shihen. Imazhet e paraqitura nga media shqiptare për gratë janë shpesh negative dhe fyese,<sup>50</sup> duke promovuar në këtë mënyrë stereotipat e

<sup>48</sup> QAGjZh, Monitorimi i medias, Tiranë, 2006.

<sup>49</sup> MPCSHB, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje 2007-2010.

<sup>50</sup> Shoqëria shqiptare i sheh gratë si dytësore në krahasim me burrat, si sende zbkuruese në jetën e tyre dhe pse pritshmëritë për sasinë e punës që kryejnë gratë janë më të mëdha se të burrave. Supozohet se një grua duhet të martohet dhe të bëjë fëmijë brenda një moshe të caktuar dhe burri i saj duhet të kujdeset ekonomikisht për atë dhe fëmijët. Nëse ajo është bukur, mund të përdorë paraqitjen e saj për të marrë atë që do: burrin,

qëllimshëm të cilët nxisin paragjykimet dhe sjellje shoqërore të rrënjosura thellë. Media e shkruar gjithashtu rrallëherë flet mbi gratë, të cilat e konsiderojnë veten të suksesshme dhe janë vërtet të tilla. Nëse një grua nuk hyn dot në kornizën e imazheve të paracaktuara, atëherë ajo nuk e meriton tërheqjen e vëmendjes së publikut.

Shumica e mediave përforcojnë kuptimet tradicionale të mashkulloritetit, feminitetit dhe roleve gjinore. Reklamat ku paraqiten prindër me fëmijë japin 4 herë më shumë nëna sesa baballarë. Në përgjithësi roli i krijimit të një familjeje të lumtur i lihet grave, rrallë shohim burra të preokupohen për shqetësimet edhe hallet e përditshme të familjes, aq më pak me aromatizuesit e rrobave.

Shpeshherë gratë përshkruhen brenda disa kornizave të ngushta dhe në mënyrë sipërfaqësore. Gratë dhe vajzat diskutohen më shpesh në lidhje me marrëdhëniet që ato kanë me të tjerët, duke mos i dhënë vendin dhe pozicionin që ato vetë kanë. Ndërsa burrat shihen dhe diskutohen më shpesh mbi gjërat që ata bëjnë.

Raportet e studiuesve thonë se revistat për femra kanë dhjetë herë e gjysëm më shumë reklama dhe artikuj që reklamojnë humbjen e peshës se sa revistat për meshkuj, dhe mbi tre të katërtat e faqeve të para të revistave për femra përfshijnë të paktën një mesazh rreth faktit se si të ndryshojnë pamjen trupore të gruas, me dieta, ushtrime apo operacione plastike. Televizioni dhe filmat përforcojnë idenë se një trup i dobët është masë vlerësimi për një femër.

## Bukuria e paarritshme

Ndoshta fakti më shqetësues është se vetëm një numër i vogël i grave arrin të realizojë vetveten si imazhet në media të bukurisë femërore, ndërsa për shumicën prej tyre ato janë të paarritshme.

Disa studiues gjeneruan në kompjuter modelin e një gruaje me përmasat e kukullës Barbi dhe gjetën se beli i saj do të ishte shumë i dobët për të mbajtur peshën e pjesës së sipërme të trupit, dhe trupi i saj do të ishte shumë i ngushtë për të mbajtur jo më shumë se gjysëm mëçjie dhe vetëm disa centimetra zorrë.

Një grua e vërtetë e ndërtuar në këtë mënyrë, do të vuante nga diarre kronike dhe përfundimisht do të vdiste nga paushqyerja.

---

karrierën dhe patjetër atë që shoqëria e sheh si të suksesshme: paratë. Gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri, vajza të reja të cilat janë këngëtare, aktore, yje televizive, ndodh që shihen si individë jo të talentuar dhe jo të moralshëm, megjithëse të admiruara nga shoqëria. Media e ndihmon këtë lloj perceptimi duke përgjithësuar gjithkënd dhe duke përfshirë shpesh vetëm imazhet dhe fjalët që e mbështesin këtë lloj përfaqësimi. Gratë e tjera të cilat punojnë shumë për të arritur diku, lihen në errësirë.

*Reflektoni dhe diskutoni:*

- *Stereotipat gjinorë që reflekton media*
- *Fushat ku gratë janë më të përfaqësuara*
- *Fushat ku burrat janë më shumë të përfaqësuar*

Imazhi i vajzave dhe grave në media ndikon në rolin dhe statusin që ato kanë në shoqëri dhe ky imazh ndryshon mënyrën sesi ato perceptohen nga të tjerët. Fatkeqësisht ky imazh është më shpesh negativ sesa pozitiv, duke promovuar kështu stereotipa të paramenduara dhe vënien në jetë të paragjykimëve sociale dhe qëndrimeve të prapambetura që janë të rrënjësura thellë.

Më poshtë përshkruhet mënyra se si media trajton gratë-politikane dhe gratë-viktima të dhunës.

#### o **Gratë politikane**

Gratë që hynë në arenën politike përbëjnë “një problem” për median. Si gra ato përpiqen të sfidojnë autoritetin mashkullor, ndërsa si gra të fuqishme dhe aktive është e vështirë të përkufizohen brenda stereotipave gjinore ekzistuese. Shpesh përfaqësuesit e medias i trajtojnë ato thjesht “si gra”, sesa si politikane. Në rastet kur gratë nuk u “binden” rregullave të sjelljeve femërore ato portretizohen në media si “gra të hekurta” apo “agresive”.

Kur flitet mbi burrat politikanë, në median e shkruar, fotoja ngjitur me artikullin është e madhe ndërsa për gratë shumë e vogël. I vetmi përjashtim gjatë periudhës së monitorimit duket se është bërë kur partia opozitare kërkoi dorëheqjen e kryetares së parlamentit. Në të gjithë artikujt e vëzhguar, kjo ishte fotoja e vetme e madhe e saj apo e grave të tjera politikane.

Shpesh, në artikujt ku përmendet një grua politikane, nuk ka një foto të saj që lidhet me artikullin, shkruhet zakonisht vetëm mbiemri i saj apo emri dy - tre herë ndërsa kontributi i saj lidhur me çështjen në fjalë lihet pa përmendur. Fokusi mbetet te burrat politikanë të cilët janë qendra e debatit, të cilët intervistohen dhe citohen në shumë raste<sup>51</sup>.

Studime të ndryshme tregojnë se ndërsa media trajton arritjet dhe përvojën e burrave politikanë, kur vjen fjala për gratë politikane fokusi është më shumë te situata e tyre familjare dhe paraqitja e jashtme. Pothuaj në të gjitha intervistat që u bëhen grave politikane atyre ju drejtohen pyetje lidhur me jetën edhe përgjegjësitë e tyre familjare, por rrallë pyeten për arritjet dhe vështirësitë me të cilat janë përballur për të arritur aty ku janë. Krejt ndryshe ndodh kur intervistohen burrat, te të cilët merret e mirëqënë ndihmesa dhe mbështetja e familjes në karrierën e tyre (ata s’mund të kenë vështirësi se kjo fushë i përket vetëm grave!) dhe fokusi i intervistës është te puna dhe kontributi i tyre politik.

<sup>51</sup> QAGjZh, Monitorimi i medias.Tiranë, 2006.



## o Gratë e dhunuara

Trajtimi i gruas shqiptare, në rastin e një gruaje të dhunuar, shpeshherë është i shoqëruar nga raste trajtesash joprofesionale dhe joetike, jo vetëm me anë të gjuhës së përdorur, por edhe nga mënyra se si portretizohen ato nëpërmjet imazheve. Vërehet se në ngjarje të rënda publike historia shpesh trajtohet si një spektakël i pashpirt, i cili i duhet servitur publikut për ta tërhequr atë për të blerë gazetën, ndërsa krimi nuk merr ndëshkimin që duhet.

Viktimat e dhunës apo të përdhunimit përshkruhen të paafta, jo vetëm për të dalë nga situata, por janë në pritje të ndonjë njeriu “të mirë” që mund t’i ndihmojë.

Ajo që vihet re rëndom në media është fajësimi i grave të dhunuara, duke i konsideruar ato si shkaktare apo nxitëse. Një pjesë e mirë e artikujve nuk e shohin dhunën në familje si shkelje të të drejtave të njeriut, duke e paraqitur vetëm si lajm sensacional pa u përqendruar në shkaqet e vërteta të problemit dhe pasojave të tij.

Artikujt me tituj ‘impresionues’ janë të shumtë. Ja një shembull “Kur dashuria tregohet me sopatë” ( 12.06.2007) - E paska vrarë sepse e paska dashur shumë. Ajo duhet të ketë bërë ndonjë gjë që e ka lënduar aq shumë sa e ka detyruar të shoqin të humbë kontrollin.

**Reflektoni** rreth titullit. **A mendoni** se është një titull paragjykses?

**Cila** janë perceptimet e para që ju krijohen?

**Përmendni** tituj të tjerë që ju kanë bërë përshtypje nga shtypi i përditshëm.

Si ndikojnë tituj të tillë tek ju, sjelljet apo qëndrimet tuaja?

Në shumicën e artikujve të publikuar në median shqiptare ne shohim se imazhet e grave prezantohen kryesisht në rolin e viktimës. Ajo është në shumicën e rasteve një personazh që ka përjetuar dhunë nga dikush tjetër (zakonisht burrat) apo është trafikuar. Në raste shumë të rralla ajo përfaqësohet si një individ që ka kontribuar në zhvillimin e shoqërisë.

*Reflektoni lidhur me rolin që luan media në raportimin e dhunës në familje. Diskutoni mbi artikuj që trajtojnë këtë problem.*

## DISKUTONI RRETH RASTIT

### Dukuria e të ashtuquajturës “supergrua” (superwoman)

Shpesh mediat e huaja dhe ato shqiptare portretizojnë të tillë gruan, që mundohet të balancojë në mënyrën më të mirë të mundshme jetën personale me atë profesionale. Përgjithësisht grua moderne në karrierë identifikohet si një supergrua. Ajo është (apo pritet të jetë) një profesioniste e suksesshme, njëkohësisht një bashkëshorte, nënë dhe shtëpiake e përsosur. Supergruaja “vishet” me fuqi për të realizuar çdo gjë në mënyrën më të mirë.

- **Reflektoni dhe diskutoni** rreth kësaj dukurie.
- **Sillni mes jush** perceptimet dhe këndvështrimet tuaja.
- **Paraqisni dhe listoni** disa tipare dhe karakteristika, që ju mendojnë se i ka një supergrua.
- **Sillni shembuj**, ku gratë cilësohen si “supergrua”.

## Roli i medias

Çdo shoqëri moderne është e pushtuar nga media dhe media është e lidhur me jetën e shoqërisë duke e ndikuar fuqishëm atë. Mediat formojnë konceptet e njerëzve mbi realitetin dhe shoqëria mund t'i përdorë ato si një instrument të rëndësishëm të kontrollit social. Procesi i globalizimit mundëson ndërhyrjen e kulturës globale dhe të ndikimit të saj në kultura kombëtare apo lokale.

“Media thjesht nuk shpërndan mesazhe të veçanta në audienca pasive. Në vend të saj, nëpërmjet lajmeve dhe argëtimit, ajo prodhon dhe shpërndan shumë burime - informacion, ide, mënyra të menduarit, hamendësime, korniza, besime, vlera, përshkrime - të cilat ne si njerëz vazhdimisht i përdorim për të kuptuar dhe menduar mbi botën, të tjerët, marrëdhëniet tona dhe vetveten. Burimet e medias i japin formë botëkuptimeve tona, të cilat na drejtojnë dhe udhëzojnë veprimet individuale, dhe gjithashtu proceset kolektive të vendimmarrjes, politikbërjes në sferën publike dhe private. Pra media mund të luajë një rol të rëndësishëm për të arritur ndryshim shoqëror dhe promovuar barazinë gjinore”.<sup>52</sup>

Ajo çfarë ne shikojmë dhe dëgjojmë në media është një seleksionim. Ai reflekton prioritetet dhe pikëpamjet e veçanta të botës. Seleksionimi (përzgjedhja) dhe prezantimi i tij në të gjitha llojet e mediave prodhon supozime rreth rolit dhe statusit të gruas.

Prandaj është shumë e rëndësishme të qenit i/e informuar për:

- Atë se çfarë shikojmë,
- Atë se çfarë media përzgjedh,
- Cilët janë faktorët dhe tendencat që ka media - ku termi media përfshin të gjitha format nga reklamat deri te produktet e teknologjisë së re.

Imazhi i femrave i prodhuar nga media ndikon në rolin dhe statusin e femrës në shoqëri.

Media është kthyer në një nga mjetet më të fuqishme të komunikimit në mbarë botën. Imazhet dhe mesazhet që transmetohen përmes medias, pasqyrojnë realitetin ekonomik, social dhe kulturor të një shoqërie. Media luan një rol thelbësor në reflektimin e stereotipave dhe roleve gjinore ekzistuese. Eliminimi i këtyre stereotipave është komponenti kryesor në arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore. Media është një nga instrumentet që mund të luajë rolin kryesor në integrimin gjinor dhe arritjen e barazisë gjinore.


<sup>52</sup> Kafiris, Krini “Gender and the Media: A wake up call” nga “Gender and Media Handbook”, Mediterranean Institute of Gender Studies, 2005, fq. 8.

Megjithëse media mund të mos jetë përgjegjëse për veprimet, qëndrimet ose sjelljet e individëve, ajo është padiskutim e plotfuqishme në formimin e opinionit publik, theksimin e çështjeve apo perspektivave që mund të jenë objekt i debateve publike. Përballë influencës që mbart sot media, është e rëndësishme të dihet se ajo ndryshon perceptimet dhe si rrjedhim ka një ndikim të jashtëzakonshëm në opinionet dhe qëndrimet tona.

Roli i medias në shoqërinë e sotme dinamike është provuar të jetë mjaft ndikues, jo thjesht si një informues për ngjarjet, por më së shumti si drejtues i fokusit, opinionformues dhe madje edukues i prirjeve dhe qëndrimeve publike të kohës.

### Rrethi i ndikimit

Duke e parë median nëpërmjet lenteve gjinore kuptojmë se si media i trajton ndryshe burrat dhe gratë dhe nga ana tjetër burrat dhe gratë tregojnë ndryshme ndaj mesazheve të medias. Kur bëjmë një analizë të këtyre mesazheve nga një perspektivë gjinore, vëmë re se si këndvështrimet tradicionale ndikojnë formimin e mesazheve që përcjell media. Me kalimin e kohës, po këto mesazhe mediatike ndikojnë mënyrën se si gratë dhe burrat vihen në marrëdhënie me njëri-tjetrin. Ky proces kthehet në **një rrethndikimi** shumë efikas.<sup>53</sup>



<sup>53</sup> Women's Media Watch 1998. 'Whose Perspective – a Guide to Gender Sensitive Analysis of the Media' Training Manual, Jamaica.

Në media nuk ka një mesazh universal. Mënyra se si merret, transmetohet dhe perceptohet nga individët varet shumë nga niveli i zhvillimit, përvoja, njohuritë, këndvështrimet, etj.

Stereotipat e medias janë të pashmangshme, veçanërisht gjatë publiciteteve dhe lajmeve për industrinë, të cilat kërkojnë një audiencë sa më të gjerë të mundshme në mënyrë që informacioni i dhënë të kapet shpejt. Stereotipat veprojnë si kode, të cilat i japin auditorit një kuptim të shpejtë e të thjeshtë (të rëndomtë) për një person apo grup njerëzish - zakonisht në lidhje me klasën e tyre, racën, përkatësinë gjinore, orientimin seksual, roleve sociale ose profesionit.

Por stereotipat mund të jenë problematikë. Ata mund:

- Të zvogëlojnë gamën e madhe të diferencave në njerëz në kategorizime mjaft të thjeshta,
- Të transformojnë supozimet rreth një grupi të veçantë në "realitete",
- Të përdoren për të justifikuar pozicionin e atyre që janë në fuqi,
- Të përjetësojnë paragjykimet sociale dhe pabarazinë,
- Në shumë raste, grupet e stereotipizuara kanë shumë pak ç'të thonë rreth asaj se si janë përfaqësuar.

Stereotipat gjinore përfshijnë pritjet që ka shoqëria se si duhet të sillen individët në bazë të përkatësisë së tyre gjinore. Këto stereotipa nuk kanë të bëjnë fare me personalitetin e individit, pikat e forta të saj apo tij, si dhe me çfarë pëlqen ai apo ajo.

Problemi kryesor i stereotipave gjinore është se shpesh kufizojnë alternativat për individët në përgjithësi.

Eliminimi i stereotipave gjinore është në fakt një obligim i të drejtave të njeriut, në mënyrë që të ketë përfaqësim të drejtë dhe të barabartë të grave dhe burrave, si një kusht parësor për një shoqëri demokratike, si dhe për zhvillimin ekonomik dhe social në një vend si Shqipëria. Si rrjedhojë, nëse institucionet e medias nuk promovojnë barazinë gjinore, ata faktikisht promovojnë diskriminimin gjinor, dhe si rrjedhojë pengojnë procesin e zhvillimit<sup>54</sup>.

Përpyekjet e medias për të ndërgjegjësuar opinionin publik, qëndrojnë në thyerjen e tabuve dhe në trajtimin e problemit të pabarazisë gjinore apo dhunës në familje si çështje që i përkasin të gjithë shoqërisë. Duke e vlerësuar rolin e medias si "formues" dhe jo vetëm "informues", mendohet se roli dhe kontributi që jep edhe mund të vazhdojë të japë media në parandalimin e një sërë problemesh sociale të tilla si: dhuna në familje apo trafikimi i grave dhe vajzave është jashtëzakonisht i rëndësishëm edhe i pazëvendësueshëm.

<sup>54</sup>QAGjZh. Media e shkruar në Shqipëri-një vështrim i shkurtër. Tiranë, 2006.

Megjithë kontributin e rëndësishëm që media ka dhënë edhe jep si në parandalimin e problemeve të ndryshme sociale, në ndërgjegjësimin e opinionit publik lidhur me to, në trajtimin e këtyrë çështjeve në formën e debeteve publike, sërish ka shumë për të bërë në drejtim të përfshirjes së perspektivës gjinore në media. Duke qenë se media është produkt i një shoqërie edhe pasqyron nivelin e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të saj edhe media në Shqipëri nuk mund t'i shpëtojë këtij realiteti. Në shumicën e rasteve media shqiptare i gjykon gratë në të njëjtën mënyrë si shoqëria. Ato përshtrohen si të varura prej burrave, të dobëta, të paafta për të kryer veprime profesionale dhe të afta vetëm për të bërë punët e shtëpisë, të paqëndrueshme sikurse edhe stereotipa të tjera sociale që shoqëria shqiptare u rezervon grave.

## Përfshirja e perspektivës gjinore në media

Ekzistojnë disa argumente për integrimin e perspektivës gjinore në media, të tilla si:

- **Argumente në fushën e drejtësisë:** eliminimi i stereotipave gjinore është në fakt një detyrim si pjesë e të drejtave të njeriut: Artikulli 5 i CEDAW-it, kërkon që shtetet që e kanë ratifikuar këtë konventë (përfshi këtu edhe Shqipëria, në vitin 1993) duhet të ndërmarrin masa të nevojshme për të eliminuar paragjykimet dhe praktikatat e bazuara në rolet e stereotipizuara të grave dhe burrave.
- **Argumente të besueshmërisë:** Nëse institucionet mediatike nuk e promovojnë barazinë gjinore (p.sh. nuk e adoptojnë këtë si një politikë), mund të thuhet se ato në fakt promovojnë diskriminimin gjinor. Institucionet mediatike që janë transparente për politikatat e tyre janë më të besueshme.
- **Argumente të eficiencës:** Barazia gjinore është në fakt një kusht kryesor për një zhvillim të plotë ekonomik edhe social të një kombi dhe media mund të jetë një mjet shumë efikas në fuqizimin e barazisë gjinore edhe kështu për promovimin e zhvillimit ekonomik edhe social.
- **Argument i aleancave:** Për shtete që kërkojnë anëtarësimin në Komunitetin Europian, është e rëndësishme të nënvizohet se një nga objektivat e Komisionit të Promovimit të Barazisë Gjinore është të promovojë ndryshim të roleve dhe stereotipave gjinore. Edhe këtu media është përmendur si një fushë prioritare.
- **Argumenti i reaksionit zinxhir:** Meqë media sjell çështje të ndryshme në vëmendje të opinionit publik dhe shpesh vendos parametra për debatet publike, ajo mund të jetë një mjet i dobishëm në zgjidhjen e një sërë problemesh gjinore në një numër ta madh sektorësh dhe hartimin e politikave. Prandaj është thelbësore sigurimi i një perspektive gjinore në mënyrën se si media është pozicionuar.<sup>55</sup>

<sup>55</sup> PNUD, Integrimi gjinor në praktikë. Tiranë, 2006.

## Bashkimi Europian kërkon më pak stereotipizime gjinore në marketing

Më datë 3 shtator 2008, anëtarët e Parlamentit Europian aprovuan *Raportin për efektet që ka marketingu në arritjen e barazisë gjinore dhe në stereotipizimet gjinore.*

Raporti i kërkon mediave të përdorë shembuj më të mirë lidhur me përkatësinë gjinore dhe thekson se shumë stereotipizime gjinore në reklama të ndryshme, kanë si qëllim fitimin financiar. Gjithashtu raporti mban qëndrim rreth portretizimit që i bëhet "trupit perfekt", pasi kjo sjell ulje të vetëvlerësimit si te burrat dhe te gratë.

Rekomandimet në raport përfshijnë *përdorimin e imazheve trupore më realiste për gratë, si dhe më shumë ndërgjegjësim institucional ndaj fyerjeve seksiste që i drejtohen burrave dhe grave.* Në nivel politikash, ky raport i kërkon vendeve të BE-së të monitorojnë se si portretizohet përkatësia gjinore në marketing si dhe i kërkon institucioneve të BE-së të monitorojnë progresin e ligjeve ekzistuese mbi diskriminimin seksual.

Ky raport i KE-së tregon se sfida për zhdukjen e stereotipave gjinore nuk mund të përballohet pa adresimin e rolit shumë të rëndësishëm të medias.

Duhet që të gjithë së bashku të mendojmë, reflektojmë dhe të veprojmë për të ndryshuar dhe zhvilluar një shoqëri të mundësive të barabarta. Mediat kanë një rol shumë të rëndësishëm në edukimin e publikut. Ato ndikojnë në krijimin e modeleve të sjelljes së publikut, në qëndrimet dhe në mentalitetin e tij. Pavarësisht faktit se mediat pasqyrojnë realitetin ekzistues apo nivelin e zhvillimit të një shoqërie, sërish përmes paraqitjes, informimit dhe modelimit të qëndrimeve dhe sjelljeve të reja, media ka fuqinë e ndryshimit dhe zhvillimit të një shoqërie në një stad më të lartë të demokracisë, të respektimit të të drejtave të njeriut edhe të mundësive të barabarta.

## Përkatësia gjinore dhe shëndeti riprodhues

### Hyrje

Konceptet e *gjinisë* dhe të *shëndetit riprodhues* janë në përgjithësi koncepte të reja që kanë filluar të përpunohen vetëm nga fundi i shekullit të 20-të. Si të tillë dhe në varësi të kontekstit ku ata përdoren, elementë të ndryshëm të tyre marrin rëndësi të veçantë në kuadrin e hartimit dhe zhvillimit të politikave dhe ndërhyrjeve që bëhen në fushat përkatëse.

Në këtë kapitull parashtrihen disa përkufizime si dhe analizohen faktorë dhe elementë që ndihmojnë kuptimin më në detaje të të dy koncepteve. Në funksion të këtij qëllimi janë përdorur edhe të dhënat statistikore.

Për ta dhënë sa më të plotë përmbajtjen e këtyre koncepteve, analiza e tyre është bërë nga perspektiva e të drejtave njerëzore, perspektivë që të jep mundësi për të planifikuar e kryer edhe ndërhyrje specifike. Nëpërmjet tyre mund të realizohen ndryshimet e kërkuara, ku padyshim shkolla apo sistemi arsimor janë të një rëndësie të veçantë, sidomos në kushtet aktuale të arsimit shqiptar dhe të mangësive që ai ka në aspekte të veçanta të tij, lidhur veçanërisht me edukimin qytetar.

Disa prej **koncepteve dhe përkufizimeve** më të rëndësishme janë:

**Përkatësia gjinore** i referohet *roleve dhe përgjegjësive sociale* të përcaktuara për gratë dhe burrat në një kulturë, vend, shoqëri dhe kohë të caktuar. Këto role, qëndrime dhe vlera, përcaktojnë sjelljet e grave dhe burrave dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Ato janë krijuar dhe mbahen apo ruhen nga institucionet shoqërore, si: familja, qeverisja, komuniteti, shkolla, institucionet fetare dhe media. Për shkak të përkatësisë gjinore, grave dhe burrave u caktohen në mënyrë të dukshme dhe strikte role të caktuara, vlera dhe karakteristika të ndryshme.

Termi **seks** i referohet karakteristikave *biologjike* me të cilat burrat dhe gratë janë të "pajisur" që në lindje dhe nuk mund të ndryshojnë, dallime këto të dukshme natyrore. Ai i referohet cilësive fizike që lidhen me tiparet e trupit të një njeriu, gjenet, kromozomet dhe organet riprodhuese. Ato nuk varen nga raca, kultura, besimi fetar, arsimimi, klasa sociale apo zona gjeografike ku individi jeton. Femrat dhe meshkujt i bën të ndryshëm nga njëri tjetri dhe një karakteristikë gjenetike, prania e kromozomit X apo Y (X i pranishëm te femrat dhe meshkujt, ndërsa Y vetëm te meshkujt). Ndryshe nga karakteristikat e lindura,

marrëdhëniet sociale mund të ndryshojnë. Synimi është të ndryshojmë marrëdhëniet sociale, për t'i shndërruar ato nga diskriminuese, në marrëdhënie që kanë në bazë barazinë dhe drejtësinë.

Koncepti seks nuk lë vend për hamendje dhe përcaktohet në lindje, në ndryshim me konceptin gjini apo përkatësi gjinore, i cili zhvillohet në kohë, ndikohet nga faktorë dhe struktura sociale, sisteme dhe institucione. Kështu që nga momenti i lindjes, vajzat dhe djemtë “orientohen” të sillen si të tillë, gra të “vërteta” apo burra të “vërtetë”. Ata përkatësisht mësohen të zhvillojnë karakteristika femërore apo mashkullore të pranueshme nga një shoqëri e caktuar. Kështu p.sh. që në fëmijëri në shumë kultura djemve u mësohet të jenë të fortë dhe të mos qajnë, pavarësisht nga situatat me të cilat ballafaqohen, kurse vajzave të jenë të urta, të përmbajtura, fjalëpaka, të varura nga meshkujt dhe t’ua dëgjojnë fjalën atyre.

Në ndryshim nga karakteristikat seksuale, aspekti gjinor mësohet me kohë, ndryshon me kohë dhe në varësi të shoqërive, kulturave, klasave shoqërore ku përfaqësuesit e të dy seksëve rriten, po ashtu dhe të edukimit që marrin, statusit ekonomik, moshës dhe besimit fetar që ndjekin. P.sh. në Shqipëri deri rreth njëzet vjet më parë, drejtimi i automjetit ishte diçka që vetëm burrat mund ta bënin. E kundërta ishte një rast i rrallë. Sot kjo gjë ka ndryshuar, në rrugët e vendit shihen shumë gra e vajza që drejtojnë makinën.

### Ndryshimi ndërmjet përkatësisë gjinore dhe seksit

Përkatësia gjinore	Seksi
Ka të bëjë me rolet <b>sociale</b> të përcaktuara për gratë dhe burrat, të cilat: <ul style="list-style-type: none"> <li>Mund të ndryshojnë në kohë të ndryshme;</li> </ul>	Ka të bëjë me karakteristikat <b>biologjike</b> që në lindje të burrave dhe grave, të cilat <ul style="list-style-type: none"> <li>Janë të përcaktuara dhe nuk ndryshojnë në kohë;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Janë të ndryshme në kultura të ndryshme;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk kanë ndryshime në kultura të ndryshme;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikohen nga shumë faktorë, si arsimimi, niveli i të ardhurave, mosha, klasa sociale, besimi fetar, etj.;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nuk ndikohen nga të ardhurat ekonomike apo faktorë socialë;</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Janë të ndryshme për burrat dhe gratë në varësi të moshës, grupeve etnike, nivelit të të ardhurave, kulturës dhe traditave, etj.;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Janë të njëjta për të gjitha gratë dhe të gjithë burrat;</li> </ul>



## Karakteristika biologjike

Karakteristika biologjike	Mashkull	Femër
Mund të ushqejë me gji		<input type="checkbox"/>
Prodhon spermë	<input type="checkbox"/>	
Ka menstruacione		<input type="checkbox"/>
Mund të lerë dikë shtatzënë	<input type="checkbox"/>	
Mund të mbetet shtatzënë		<input type="checkbox"/>
Mund të ketë mjekër	<input type="checkbox"/>	

Nga tabela më sipër kuptohet se koncepti *përkatësi gjinore*, kërkon të merren në konsideratë marrëdhëniet midis burrave dhe grave në kontekstin e një sërë faktorëve ekonomikë dhe socialë që ndikojnë në këto marrëdhënie, prandaj ne shpesh përdorim konceptin *marrëdhënie gjinore* për të përshkruar këtë ndërveprim.

Edhe në familje, ka aktivitete të cilat pritet të kryhen vetëm nga femrat ose vetëm nga meshkujt. Kjo lloj ndarje e punës në aspektin gjinor bëhet e mundur nga marrëdhëniet midis të dy gjinive dhe ato vendosen nga vetë partnerët apo pjesëtarët e familjes, role të cilat janë të mësuara. Si të tilla, pritshmëritë nga të dy sekset për të kryer të tilla punë janë të ndryshme, gjë e cila sjell që detyrimet, përgjegjësitë, të drejtat dhe marrëdhëniet që ato krijojnë të jenë po ashtu të ndryshme. Për shembull, gratë përgjithësisht janë të ngarkuara me gatimin, punët e shtëpisë, kujdesin për të moshuarit dhe fëmijët, ndërsa burrat me ndërtim, bujqësi, peshkim, gjueti, etj. Këto role ndikohen nga perceptimet, pritshmëritë dhe sjelljet që kultivohen ndryshe në kultura, etni, nivele arsimore, politike, ligjore, ekonomike, mjedisore dhe besime fetare të ndryshme.

Shpesh këto marrëdhënie janë shumë hierarkike dhe ndikohen nga “pushteti” që kanë të dy palët, pushtet që shpesh favorizon dhe privilegjon meshkujt dhe i vë femrat në pozita inferiore. Ky pushtet u jep burrave dhe grave akses dhe kontroll të ndryshëm mbi vendimmarrjen dhe pasurinë.

Me **barazi gjinore** kuptojmë që burrat dhe gratë gëzojnë status dhe kushte të njëjta dhe kanë mundësi të barabarta. Ata/ato gjithashtu, duhet të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga rezultatet e zhvillimit social. Kjo nuk do të thotë se burrat dhe gratë duhet apo duan të jenë njësoj, pasi biologjikisht ata nuk mund të jenë të tillë. Të mos qenit njësoj nuk është domosdoshmërisht gjë e keqe. Disa ndryshime janë të dëshirueshme, por një gjë është e qartë: burrat dhe gratë japin dhe mund të japin të njëjtin kontribut në shoqëri.

**Drejtësia gjinore** shkon më tej filozofisë së trajtimit të barabartë. Drejtësi do të thotë t’u japësh më tepër atyre që kanë më pak, në bazë të nevojave të tyre dhe të marrësh një varg masash të mëtejshme për të kompensuar disavantazhet historike dhe sociale, që shmangin burrat dhe gratë nga funksionimi në të njëjtin nivel. Drejtësia lidhet me mjetet, kurse barazia është rezultati final. Drejtësia çon në barazi.

Në 1994, në Konferencën Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ICDP, Kajro) dhe Programin e saj të Veprimit, thuhet se “ Seksualiteti dhe gjinia janë të lidhura ngushtë dhe

se ato ndikojnë në mundësinë e femrave dhe meshkujve të arrijnë dhe mirëmbajnë shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues. Marrëdhëniet e barazisë mes burrave dhe grave në çështjet e marrëdhënieve riprodhuese dhe seksuale, përfshijnë respektim të plotë të integritetit fizik të trupit të njeriut, kërkojnë respekt të përbashkët dhe dëshirën që të pranosh përgjegjësitë për pasojat e sjelljeve seksuale. Sjelljet e përgjegjshme seksuale, sensibiliteti dhe barazia në marrëdhëniet gjinore, fuqizojnë dhe promovojnë respekt dhe partnership midis burrave dhe grave”.

**Mosha riprodhuese** - për Shqipërinë si vend mesdhetar është përcaktuar nga 14 - 49 vjeç.

**Marrëdhënia gjinore** ka të bëjë me mënyrën sesi kultura apo shoqëria përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë dhe identifikon burrat dhe gratë në marrëdhënie me njëri -tjetrin.

**HIV** - virusi i imunodeficiencës humane

**SIDA** - sindromi i imunodeficiencës së fituar

Përkufizimi i shëndetit riprodhues, si një koncept i ri i shëndetit publik për vendin tonë, është i mbështetur në përkufizimin e OBSH-së për shëndetin dhe i miratuar në Planin e Veprimtimit të Konferencës së Kajros, 1994.

Shëndeti riprodhues është një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe shoqërore e lidhur me sistemin riprodhues, funksionet dhe proceset e tij.

Ai nënkupton aftësinë e njerëzve për t'u riprodhuar dhe lirinë e tyre për të vendosur mbi mënyrën dhe kohën e riprodhimit. Për këtë është e domosdoshme që gratë dhe burrat të jenë të informuar dhe të kenë akses në metodat e sigurta, efektive, të përballeshme dhe të pranueshme të planifikimit familjar, të cilat t'i kenë zgjedhur dhe përdorur sipas dëshirës së tyre.

*Shëndeti riprodhues përfshin këta elementë:*

- Shërbime të planifikimit familjar dhe këshillimin,
- Edukim dhe shërbime për kujdesin paranatal, lindjen, shërbimin pas lindjes përfshirë ushqyerjen me gji, kujdesin për nënën dhe fëmijën,
- Parandalim dhe trajtim të infertilitetit,
- Shërbime për abortin e sigurt, sipas ligjeve në fuqi përfshirë parandalimin dhe menaxhimin e pasojave të abortit të kryer në kushte jo të sigurta,
- Trajtim për infeksionet e traktit gjenital,
- Parandalim dhe trajtim të IST-ve dhe HIV/SIDA-s,
- Informim, edukim, komunikim mbi seksualitetin, shëndetin riprodhues dhe të qenit prind i përgjegjshëm,
- Në disa shtete përfshin edhe parandalimin e praktikave të dëmshme mbi organet gjenitale, sidomos te femrat.

## Planifikimi familjar

**Planifikimi familjar** ka të bëjë me aftësinë e individëve dhe çifteve për të patur numrin e dëshiruar të fëmijëve dhe lindjen e tyre në kohën që ata dëshirojnë.

Planifikimi familjar arrihet nëpërmjet kontracëpsionit, që përcaktohet si çdo mjet i aftë për të parandaluar shtatzëninë.

Planifikimi familjar mund të përcaktohet si tërësia e mjeteve dhe teknikave që na mundësojnë:

- Të mënjanojmë shtatzënitë e padëshiruara
- Të lindim fëmijë kur të dëshirojmë
- Të rregullojmë intervalet ndërmjet lindjeve
- Të programojmë lindjet në momentin më të mirë në raport me moshën e nënës:
  - duke mënjeluar shtatzënitë para moshës 20 vjeç dhe pas moshës 35 vjeç,
  - duke ulur numrin e shtatzënieve para moshës 20 vjeç dhe pas moshës 35 vjeç.

Është me vend të diskutohet me nxënësit për planifikimin familjar në aspektin e përmirësimit të shëndetit dhe mirëqenies së individëve, familjeve dhe në veçanti të gruas dhe fëmijës sepse:

- mënjanon shtatzënitë e padëshiruara, shtatzënitë në rrezik (shtatzënitë në moshë shumë të re ose shumë të madhe, shtatzënitë e afërta me njëra - tjetrën) dhe abortin e pasigurt,
- parandalon vdekjet amtare dhe fëmimore,
- parandalon HIV/AIDS-in dhe IST-të.

Planifikimi familjar kupton të drejtën për akses ndaj metodave të efektshme të sigurta dhe të përballeshme të kontracëpsionit.

**Metodat e kontracëpsionit** janë mjete ose metoda që lejojnë të mënjanohet shtatzënia gjatë një periudhe kohe të dëshiruar (e përkohëshme ose përfundimtare).

### *Le të diskutojmë për disa statistika:*

Studime të ndryshme tregojnë se jeta e afro 150.000 grave, që vdesin çdo vit në të gjithë botën, mund të shpëtohej nëse shërbimet e planifikimit familjar do të kishin qënë të pranishme dhe më afër tyre. Po ashtu edhe mbi 1 milion jetë fëmijësh nën 5 vjeç do të ishin shpëtuar, nëse nënat e tyre nuk do të kishin mbetur përsëri shtatzëna në më pak se dy vjet nga lindja e tyre. Vlerësohet se rreth 200 milion gra në botë duan ta shtyjnë kohën e shtatzënisë, por nuk janë në gjendje të gjejnë apo përballojnë koston e kontracëpsivëve.

Në Afrikë, më pak se 20% e të rinjve që janë seksualisht aktivë përdorin kontracëpsivë. Një nga arsytet që ata nuk përdorin kontracëpsivë është dhe kundërshtimi që partnerët e tyre i bëjnë përdorimit të kontracëpsivëve (sikurse dhe njohuritë e pakta për to, frika se mjedisi përreth apo shoqëria nuk do të mbështesë apo miratojë marrjen nga ata/ato të kontracëpsivëve, frika nga efektet anësore, etj.).

Në botë rreth 50 milion nga 190 milion shtatzënitë që ndodhin në vit, përfundojnë në abort, i cili shpesh kryhet në kushte jashtë çdo norme të lejuar dhe jo rrallë përfundon me vdekjen e gruas. Miliona gra vuajnë gjithë jetën nga pasojat e tij, përfshirë pamundësinë më vonë për të mbetur shtatzënë. Rreth 90% e këtyre komplikacioneve nga aborti mund të shmangeshin nëse gratë apo vajzat do të kishin patur akses në metodat moderne kontraceptive. Rreth një e treta e 536.000 vdekjeve të grave mund të ishin shmangur nëse ato do të kishin akses në shërbimet dhe metodat e planifikimit familjar.

Aksesi në shërbimet dhe metodat e planifikimit familjar redukton varfërinë dhe fuqizon gratë dhe vajzat. Në vendet me lindshmëri më të ulët, gratë kanë mundësi më shumë për t'u punësuar dhe më shumë mundësi për arsimim. Diferenca në arsimim midis femrave dhe meshkujve është më e vogël, kur nivelet e fertilitetit janë të ulëta dhe gratë lindin fëmijë në një moshë jo shumë të re. Nga statistikatat del në pah se çdo dollar i shpenzuar në planifikim familjar, ul koston për shërbime shëndetësore me 31%.

## Mëmësia e sigurtë

**Kujdesi për mëmësinë e sigurtë**, kupton që çdo grua duhet të ketë akses ndaj një grup shërbimesh cilësore dhe të përballeshme të shëndetit riprodhues dhe seksual, veçanërisht për kujdesin amtar dhe trajtimin e emergjencave obstetrikale, me qëllim përfundimtar pakësimin e vdekjeve dhe paaftësive. (Bazuar mbi deklaratën e Samimit botëror të Fëmijëve, Konferencën mbi Popullsinë dhe zhvillimin, Samitin Botëror për Zhvillimin Social, Konferencën e IV Botërore mbi Gruan dhe Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave).

*Qëllimi i kujdesit për shëndetin amtar është që :*

Çdo grua të ketë një shtazëni dhe lindje të sigurt dhe foshnjat të lindin të gjalla dhe të shëndetshme.

**Shëndeti i adoleshentit/es:** grupmosha 15 - 21 vjeç.

Adoleshenca, dhjetëvjeçari i dytë i jetës, në veçanti puberteti, është periudha e zhvillimit të shpejtë, kur të rinjtë fitojnë aftësi të reja dhe përballen me shumë situata të cilat janë jo vetëm një mundësi për progres, por edhe rrezik për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Kjo kohë karakterizohet nga rritja e shpejtë, ndryshime të mëdha fizike dhe theksim i dallimeve midis djemve dhe vajzave.

## Infertiliteti

**Infertiliteti** është një problem global në shëndetin riprodhues. Ai në vetvete nuk ndikon mbi shëndetin fizik të burrit apo gruas. Por duke patur parasysht konceptin e shëndetit si një gjendje mirëqenieje fizike, mendore dhe sociale, pra jo vetëm thjesht mungesë e sëmundjes apo e paaftësisë, pasojat psikologjike dhe sociale të infertilitetit nuk mund të injorohen.

*Pse duhet të diskutojmë me nxënësit për infertilitetin?*

Në aspektin gjinor, në shumë shoqëri, mundësia e gruas për të mbetur shtatzënë, lindur fëmijë dhe gjidhënia, keqinterpretohen si përgjegjësi vetëm të grave në marrëdhëniet apo aktivitetet seksuale dhe riprodhuese, duke përjashtuar burrat nga çdo përgjegjësi e tillë.

Po ashtu, në shumë kultura, mbizotëron pikëpamja se janë vetëm meshkujt ata që mund dhe duhet të jenë iniciatorë të marrëdhënieve seksuale, të përdorimit të prezervativit apo kontraceptivëve në këto marrëdhënie, duke i lënë partneret e tyre pa asnjë mundësi negocimi, pavarësisht se nga pasojat e tyre, do të vuajnë partneret femra dhe për pamundësinë e mbetjes më vonë shtatzënë do të fajësohen pa të drejtë po ato.

*Diskutoni me nxënësit për ndikimin e arsimimit të grave në marrëdhëniet vendimmarrëse në çift përfshirë dhe ato seksuale.*

*Argumente:* Pabarazia në mes burrave dhe grave në shumë fusha sjell shpesh pasoja në shëndetin seksual dhe riprodhues. Pamundësia e grave për t'u shkolluar rrit mundësinë e dominimit të burrave për marrjen e vendimeve të njëanshme në marrëdhëniet e tyre seksuale. Po ashtu dhe varësia ekonomike i bën shpesh gratë të mos kërkojnë të divorcohen megjithëse mund të ketë probleme serioze midis çiftit.

Shpesh, në familjet e varfëra ndodh që vajzat dhe gratë, qoftë ato dhe shtatzëna, janë të privuara nga marrja e ushqimeve cilësore dhe në sasinë e duhur, pasi të parët në "listë" janë baballarët dhe vëllezërit e tyre, gjë e cila i bën ato të predispozuar për sëmundje të ndryshme, si dhe ndikon në vdekshmërinë foshnjore dhe amtare.

Provohet se gratë e arsimuara janë më të predispozuar që edhe vajzat e tyre të ndjekin shkollën dhe të edukohen, duke i krijuar atyre më shumë mundësi për të qenë të afta të negociojnë me partnerët e tyre.

Pra, mund të themi se gjinia dhe shëndeti riprodhues janë shumë të lidhur me njëri-tjetrin, lidhje kjo që bazohet në faktin që shëndeti seksual dhe riprodhues i grave dhe burrave mund të përmirësohet vetëm nëse të dy palët marrin përgjegjësi dhe role të barabarta për pasojat e sjelljeve të tyre seksuale. Ndryshimet që kanë pësuar dhe pësojnë rolet gjinore e lehtësojnë këtë proces. Praktika të shëndetshme seksuale dhe riprodhuese dhe barazia gjinore arrihen vetëm kur gratë janë të mirëedukuara dhe të informuara për të drejtat dhe mundësitë e tyre për shëndetin seksual dhe riprodhues.

Programi i Veprimit të Kajros rekomandon që politikatat dhe programet duhet të: "...përmirësojnë aksesin e grave për burime të sigurta familjare dhe ekonomike, të lehtësojnë përgjegjësitë e tyre në lidhje me punët e shtëpisë, të heqin pengesat ligjore që pengojnë pjesëmarrjen e tyre në jetën publike dhe të rrisin ndërgjegjësimin social nëpërmjet programeve të efektshme për edukimin dhe komunikimin në masmedia".

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), në nenin 12 thekson: "Shteti duhet të marrë masat e nevojshme për të eliminuar diskriminimin

ndaj grave në fushën e kujdesit shëndetësor, për të siguruar, mbi bazën e barazisë së burrit me gruan mundësitë për të përfituar shërbime shëndetësore, duke përfshirë dhe ato të planifikimit familjar”.

Kontekstet e ndryshme në të cilat jetojnë gratë dhe burrat jo rrallë karakterizohen nga situata të veçanta sociale, ekonomike, kulturore dhe në jo pak raste dhe politike. Pabarazitë gjinore që shoqërojnë këto kontekste disa herë janë në disavantazh të grave dhe disa herë në disavantazh të burrave.

Duke qenë të ndërgjegjshëm se gratë dhe burrat ndërmarrin role dhe përgjegjësi të ndryshme në familje dhe në komunitet lind domosdoshmëria e përfshirjes së nevojave, interesave dhe kontributeve të tyre në hartimin, zbatimin, monitorimin e politikave të programeve dhe projekteve të ndryshme edhe në fushën e shëndetësisë.

Përfshirja e perspektivës gjinore është shumë e rëndësishme për sektorin e shëndetësisë, pasi ndikon në kujdesin e barabartë shëndetësor për të gjithë. Koncepti i barazisë në sektorin e shëndetësisë ka të bëjë më tepër me ndershmërinë dhe drejtësinë në trajtimin shëndetësor të të gjithë individëve, sesa me trajtimin e barabartë për të gjithë.

Integrimi gjinor në politika, programe e projekte si dhe buxhetimi gjinor vlerësohen si dy mjete kryesore për të arritur barazinë dhe drejtësinë gjinore në një shoqëri.

### Objektivat dhe ndërhyrjet për barazinë gjinore marrin në konsideratë:

- **Sëmundje apo probleme shëndetësore të sistemit riprodhues nga të cilat vuajnë gratë për shkak të seksit të tyre.** Në shumë raste, këto probleme mund të vijnë nga marrja e kujdesit të papërshtatshëm shëndetësor, përdorimi i praktikave tradicionale të mjekimit apo edhe nga ushtrimi i dhunës.
- **Sëmundje apo probleme nga të cilat vuajnë si gratë ashtu dhe burrat, por që hasen më tepër në një grup ose në tjetrin.** Këto janë situata ku gratë apo burrat janë më të rrezikuar si pasojë e dallimeve biologjike, të cilat kombinohen me marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit dhe aksesin e pabarabartë ndaj kujdesit shëndetësor. Situata mund të bëhet më e rëndë kur veçanërisht gratë pengohen të marrin shërbimet e nevojshme për të trajtuar ndërlikimet/sëmundjet e mundshme.
- **Sëmundje apo probleme që ndeshen në të dy grupet, por që ndikojnë më negativisht apo venë më tepër në rrezik një grup apo një tjetër.**
- **Sëmundje dhe probleme nga të cilat vuajnë të dy grupet, por që ndaj të cilave një grup apo një tjetër është më pak në gjendje që të mbrohet apo kurohet.**

## Pabarazia gjinore dhe shëndeti i grave

Marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit mes grave dhe burrave, i vendosin të parat në një disavantazh social dhe ekonomik, i cili ka një efekt të konsiderueshëm në shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Disa nga faktorët që ndikojnë në shëndetin e grave janë:

### ◆ Faktorët socialë dhe ekonomikë

Pasojat më të mëdha të këtyre faktorëve të gratë, janë ato që vijnë edhe prej varfërisë: aksesit i pabarabartë ndaj kujdesit shëndetësor, mungesë e informacionit për problemet shëndetësore, veçanërisht për shëndetin riprodhues, kequshqyerja, mungesa e arsimimit dhe pamundësia për punësim, dhuna ndaj grave, përfshirë dhe atë seksuale.

### ◆ Faktorët arsimorë

Praktika e mohimit të mundësisë për t'u arsimuar për fëmijët vajza është dukuri që edhe në vendin tonë po merr ritme të larta, veçanërisht në zonat rurale. Si pasojë gratë e pashkolluara nuk mund të marrin vendime për shëndetin e tyre dhe për atë të anëtarëve të tjerë të familjes, sidomos për fëmijët. Në mënyrë specifike, ky problem bën që vajzat e reja të kenë shumë pak informacion ndaj funksioneve seksuale dhe riprodhuese, duke i bërë ato më të prirura të bien pre e abuzimeve. Kjo mund të ketë efekte afatgjata në shëndetin e tyre seksual, riprodhues dhe mendor.

### ◆ Faktorët e punësimit

Në disa raste, gratë janë të ekspozuara ndaj një "ngarkese të trefishtë", duke qenë përgjegjëse për aktivitetet në shtëpi, për krijimin dhe sjelljen e të ardhurave dhe për aktivitetet e ndryshme që kryhen në komunitet. Megjithëse burrat janë më të prirur të vdesin si pasojë e shkaqeve që lidhen me punën, kohët e fundit ka një rritje në nivel global edhe të grave që vuajnë këto pasoja. Punët që tradicionalisht janë konsideruar si femërore, mund të kenë pasoja të ndryshme fizike dhe psikologjike në shëndetin e grave. Disa herë, në kushtet e emigracionit, gratë janë të detyruara të kryejnë punët më të rënda, p.sh. në bujqësi, gjë që e rrit ngarkesën dhe problemet e tyre shëndetësore, veçanërisht kur kjo kombinohet me një ngarkesë të madhe në punët e shtëpisë ose kur gratë janë shtatzëna.

### ◆ Faktorët mjedisorë

Këta faktorë kanë të bëjnë me kushtet e papërshtatshme të punëve që kryhen nga gratë, si ekspozimi ndaj detergjentëve që përdoren në kuzhina restorantësh, kushtet tejet të vështira në fabrikat e mëdha që prodhojnë konfeksione dhe këpucë, ku ekspozimi ndaj kimikateve që përdoren është i lartë apo në rastin e deformimeve të ndryshme trupore, pasojë e detyrimit për të bërë rrugë të gjata në këmbë për të sjellë drutë dhe ujën në shtëpi, që

lidhen me faktin se burimet e afërta nuk janë më të përdorshme për shkak të ndotjes apo erozionit ose janë shumë larg shtëpisë.

## PABARAZITË GJINORE DHE SHËNDETI I BURRAVE

### Faktorët socialë dhe ekonomikë

Edhe nga përvoja e vendeve të tjera, shpesh pranohet se shërbimet shëndetësore janë më të përdorshme nga burrat dhe se ata kanë më tepër mundësi që t'i përdorin ato. Por kjo nuk është gjithmonë e vërtetë. Ka një ndërgjegjësim në rritje lidhur me faktin që shumë burra nuk arrijnë të marrin të gjitha shërbimet e nevojshme ose që ata paraqiten për trajtim shumë vonë. Arsytet për këtë sjellje të burrave janë të shumta dhe variojnë. Shumë burra rrezikojnë shëndetin e tyre për shkak të nevojës për të shfaqur “mashkulloritetin” e tyre.

Është e gabuar të mendohet se pabarazitë gjinore ndikojnë vetëm në shëndetin e grave. Përkundrazi, është e nevojshme të merret në konsideratë edhe fakti që qëndrimet dhe sjelljet e bazuara në përkatësinë gjinore, mund të kenë ndikim edhe në shëndetin e burrave. Të dhënat tregojnë se rolet gjinore, normat dhe presioni i grupit, kanë ndikim të konsiderueshëm në shëndetin e burrave. Efektet e këtyre stereotipave shpesh përforcohen nga mungesa e shërbimeve që plotësojnë nevojat specifike të burrave.

### ◆ Faktorët arsimorë

Shëndeti dhe kujdesi për të është i lidhur shumë me arsimimin e një popullate të caktuar. Niveli i përdorimit të shërbimeve shëndetësore ka lidhje të drejtpërdrejta me nivelin arsimor të individëve. Në kushtet kur braktisja e shkollës është një dukuri që vihet re jo vetëm te vajzat, por edhe te djemtë (pavarësisht faktorëve të ndryshëm), shqetësimi që ngrihet është jo vetëm niveli i ulët arsimor i djemve, por edhe informacioni i pakët për problemet e shëndetit.

### ◆ Faktorët e punësimit

Në shumë shoqëri, ndarja seksuale e punës i ka detyruar burrat të marrin përsipër detyra që rrezikojnë shëndetin e tyre, si puna me kimikate të rrezikshme, puna në ndërtim, në miniera, etj. Punë të tilla përveçse shkaktojnë sëmundje afatgjata, mbartin dhe rrezikun e aksidenteve, duke ndikuar në vdekshmërinë shumë më të lartë në punë të burrave, krahasuar me gratë.

Burrat kanë gjithashtu një shkallë të lartë vdekshmërie nga situatat akute, si episodet kardiovaskulare apo cerebrovaskulare, prandaj trajtimi parandalues dhe akut duhet të ketë më shumë rëndësi për ta. Nuk duhet të pranohet se trajtimi afatgjatë, që është më i përshtatshëm për gratë, të plotësojë në të njëjtën mënyrë edhe nevojat e burrave. Është e



rëndësishme që të rriten shërbimet për ekzaminimin, parandalimin dhe trajtimin e llojeve të tumoreve që janë më të shpeshta te burrat.

Arsye të tjera që rrezikojnë shëndetin e burrave kanë të bëjnë me faktin që shpesh burrat nuk pranojnë të ndërpresin punën për të marrë ndihmë apo shërbim mjekësor; vendndodhja apo koha gjatë të cilës janë të hapura institucionet e kujdesit shëndetësor nuk janë të përshtatshme për ta; ose me paragjykimin që jo pak burra kanë, se qëndrat shëndetësore janë më tepër për shërbimet e nënës dhe fëmijës dhe shërbimi që ofrohet në to nuk është miqësor apo mbështetës për burrat.

### ◆ Faktorët mjedisorë

Në shumë shoqëri, siç u vu në dukje dhe më lart, ndarja gjinore e punës i ka shtyrë burrat të marrin detyra që mund të kenë rrezik për jetën e tyre. Punët, ku burrat përbëjnë shumicën, në sektorin e ndërtimit, miniera, metalurgji, transport, ushtri etj. bëjnë që ata të jenë më të ekspozuar ndaj aksidenteve apo sëmundjeve të ndryshme profesionale.

Për të gjithë këta faktorë që u përmendën, integrimi gjinor në sektorin e shëndetësisë do të përfshijë dhe fusha të tjera, sepse ai nuk mund të funksionojë i izoluar.

Diskuto me nxënësit për barazinë gjinore në:

- *shpërndarjen e kujdesit për shëndetin riprodhues,*
- *përmirësimin e shëndetit riprodhues duke rritur përgjigjen e sistemit shëndetësor ndaj nevojave të veçanta shëndetësore të grave dhe burrave,*
- *adresimin e problemeve gjinore në ofrimin e shërbimeve të shëndetit riprodhues veçanërisht në kujdesin shëndetësor parësor,*
- *përfshirjen e çështjeve gjinore në të gjitha politikat, programet dhe aktivitetet për shëndetin riprodhues.*

Diskuto me nxënësit për strategjitë për të promovuar barazinë gjinore në shëndetin riprodhues, që kanë të bëjnë me:

- *përfshirjen e politikave gjinore në programet e shëndetit riprodhues,*
- *trajnimin për ndërgjegjësimin gjinor dhe barazinë gjinore,*
- *avokatinë dhe lobimin për barazinë gjinore,*
- *aksesin për informacionin shëndetësor të ndjeshëm ndaj gjinisë.*

### Dhuna me bazë gjinore

Për herë të parë, dhuna ndaj gruas u trajtua si shkelje e të drejtave të njeriut në korrik 1993, në Konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut. Sot dhuna me bazë gjininë nuk konsiderohet vetëm një shkelje e të drejtave të njeriut. Ajo ka marrë rëndësinë e një çështjeje të shëndetit publik (OBSSH, 1997) dhe mbi të gjitha konsiderohet si prioritet i kujdesit shëndetësor. Dhuna mund të shfaqet në forma të ndryshme, përfshirë atë seksuale, në detyrimin që i bëhet qoftë dhe bashkëshortes apo partneres për të kryer marrëdhënie

seksuale, në përdhunimin, në detyrimin për një grua që të mbetet shtatzënë, sterilizimin e detyruar për të mos patur më mundësi të mbetet shtatzënë, dhunën gjatë shtatzënisë, abortin selektiv (aborti që kryejnë gratë pasi shihet që fëmija që do të lindë është vajzë), apo neglizhencën në periudhat e para të pas lindjes gjatë rritjes së foshnjave vajza, neglizhencë që shpesh çon dhe në vdekjen e tyre, shtatzënitë e shpeshta deri në pasjen e një fëmije djalë, pa marrë parasysh pasojat në shëndetin e gruas, detyrimin e përdorimit apo mospërdorimit të kontraktivëve, detyrimin që vajzat e vogla apo të reja të ushtrojnë prostitucion, trafikimin me qëllim ushtrimin e seksit, përfshirë këtu dhe meshkujt që mund të përdoren si prostituta me pagesë, etj. Forma të dhunës janë edhe detyrimi për të marrë një pajë nga nusja, sanksionet nëse kjo pajë nuk realizohet sipas “kontratës”, etj. Në disa vende, si p.sh. në Kinë, ka raste që fëmijët e lindur vajza, prindërit nuk i regjistrojnë në gjëndjen civile, duke krijuar kështu probleme më vonë në vaksinim, marrjen e kujdesit shëndetësor apo regjistrimin e tyre në shkollë.

*Pse duhet të diskutohet me nxënësit aspekti i dhunës dhe i shëndetit riprodhues:*

Një nga llojet e dhunës në familje është dhuna në çift, që shfaqet si sjellje abuzive e një personi në një marrëdhënie, me qëllim që të fitojë pushtet dhe kontroll mbi partnerin.

Ajo përfshin llojet e mëposhtme të abuzimit:

- **Taktika izolimi** (p.sh. ndalimi i daljes nga shtëpia, i përdorimit të telefonit, i komunikimit me fqinjët, etj.)
- **Frikësimi** (p.sh. kërcënim për dëmtim fizik, kërcënim për dhunë, për të dëmtuar fëmijët, etj.)
- **Abuzimi verbal dhe psikologjik** (p.sh. tallja me emrin, përqeshja, tallja me racën, me njerëzit e afërm, me paaftësinë për të bërë diçka, me gjendjen ekonomike, etj.)
- **Kontrolli ekonomik** (përpjekja për ta bërë partnerin të varur financiarisht, mosdhënia e parave, kërcënimi i partnerit në punë, etj.)
- **Shkaktimi i dëmtimeve** (p.sh. çdo sulm fizik, kufizimi i aksesit për kujdes mjekësor, ndalimi i marrjes së mjekimeve, etj.)
- **Abuzimi seksual** (p.sh. marrëdhënie seksuale të detyruara, akuza për tradhëti, etj.)

Secila prej këtyre shfaqjeve ka pasojat afatgjata fizike dhe emocionale dhe sjell dëmtime të shëndetit riprodhues, përfshirë këtu shtatzëni të padëshiruara, aborte, infeksione të traktit gjenital (IST), përfshirë dhe HIV/SIDA-n, komplikime nga shtatzënitë e shpeshta dhe me rrezik të lartë, probleme të vazhdueshme gjinekologjike apo trauma psikologjike. Gratë e abuzuara shpesh refuzojnë të marrin kontraktivë apo të përdorin shërbimet e planifikimit familjar edhe nëse këto shërbime janë shumë pranë tyre apo falas, pasi kanë frikën se mos burrat e tyre nuk do ta pëlqejnë këtë gjë dhe kjo mund të bëhet shkak për

dhunimin e mëtejshëm të tyre. Gratë e dhunuara janë në pozita shumë më të pafavorshme për të negociuar marrëdhënien seksuale të sigurtë me partnerët e tyre. Frika nga dhuna parandalon gratë apo vajzat të shkojnë të testohen për HIV-in apo të tregojnë që janë të infektuara me virusin e HIV-it, të përfitojnë nga shërbimet për parandalimin e transmetimit të HIV-it te fëmijët apo të marrin trajtime dhe këshillime për të edhe nëse e dinë se janë të infektuara. Të tilla gra shpesh pranojnë se abuzimi i zgjatut psikologjik është më i vështirë për t'u përballuar se dhimbja fizike. Gratë e dhunuara seksualisht që në fëmijëri, janë të predispozuar për të pasur marrëdhënie abuzive dhe kanë një përqindje më të lartë risku për t'u përfshirë në prostitucion apo për të përdorur droga.

Shërbimet e kujdesit shëndetësor shpesh janë pika e parë dhe disa herë edhe e vetme për gratë dhe fëmijët, viktimat të dhunës me bazë gjinore/dhunës në familje.

Qëllimi i kujdesit për shëndetin riprodhues është që njerëzit të përfitojnë kujdes shëndetësor dhe informacion edhe mbi të drejtat e tyre.

*Diskuto me nxënësit për shëndetin riprodhues dhe seksual si një e drejtë njerëzore ku përfshihen këto parime:*

- **E drejta për kujdes për shëndetin riprodhues**
- **E drejta për vetëvendosje mbi riprodhimin dhe seksualitetin**
- **Barazia gjinore**

Me të drejta riprodhuese dhe seksuale kuptohet e drejta për:

- Jetën dhe mbijetesën
- Lirinë dhe sigurinë e personit
- Barazinë dhe të qenit i lirë nga çdo formë diskriminimi
- Privatësinë
- Të drejtën e mendimit
- Të drejtën për të qenë i informuar
- Për t'u martuar apo jo dhe për të krijuar familje
- Për të vendosur kur dhe sa fëmijë të kesh
- Kujdes dhe mbrojtje shëndetësore me standardin më të lartë shëndetësor
- E drejta për të marrë pjesë në mbledhje dhe aktivitetet politik
- Për të përfituar nga progresi në shkencë
- E drejta për të qenë e/i lirë nga çdo torturë dhe keqtrajtim

Në aspektin gjinor, e drejta për **jetën dhe mbijetesën** ka të bëjë me parandalimin e vdekjeve të gratë si rezultat i shtatzënive në moshë shumë të re, në moshë të madhe, të shumta në numër apo shumë afër me njëra-tjetrën, gjë e cila mund të arrihet duke u dhënë mundësi grave për t'u arsimuar, për të patur akses në shërbime të kualifikuara shëndetësore të planifikimit familjar dhe shërbimeve gjatë shtatzënisë, lindjes dhe pas lindjes që kanë në bazë të tyre fuqizimin e statusit të grave dhe vajzave.

E drejta për **lirinë dhe sigurinë e personit** ka të bëjë me të drejtën e secilit për të qenë i lirë në jetën seksuale dhe riprodhuese, të mos detyrohet ai/a jo të dëmtojë traktin e vet seksual, sepse kështu është “në traditën” e vendit ku ai apo ajo jeton. Këto praktika barbare, në rastin e gruas, bëhen me qëllim që bashkëshorti i ardhshëm i saj të jetë i sigurtë se ajo nuk ka patur marrëdhënie seksuale me asnjë tjetër para tij. Gruaja gjithashtu i nënshtrohet sterilizimit kundër vullnetit të saj, pasi burri nuk do të ketë më fëmijë të tjerë, por as nuk pranon të përdorë vetë metoda kontraceptive apo të sterilizohet.

**Barazia dhe të qenit i lirë nga çdo formë diskriminimi** njeh të drejtën që të gjitha qeniet njerëzore në lindje janë të barabarta, kanë dinjitetin dhe të drejtat e tyre. Në rastet kur gratë dhe vajzat nuk kanë të njëjtin akses si dhe meshkujt për t’u arsimuar, punësuar, për të marrë kredi bankare apo të kenë të njëjtat të drejta trashëgimie, pronësie etj., të drejtat e tyre janë dhunuar. Po kështu, kur legjislacionet apo praktikat kulturore në fuqi kultivojnë inferioritetin apo superioritetin ndërmjet sekseve apo krijimin dhe mbajtjen gjallë të stereotipave të ndryshëm, e drejta e kujtdo për të qenë i lirë nga diskriminimi është dhunuar. Kështu, nëse një grua punon 18 orë dhe një burrë gjysmën e kësaj kohe, e drejta e gruas për të qenë e padiskriminuar është krejtësisht e dhunuar.

E drejta për **privatësi/fshehtësi** u siguron të gjithëve shërbime seksuale dhe riprodhuese konfidenciale, pavarësisht nga statusi i tyre shëndetësor, përdorim apo jo të kontraceptivëve, të qenit HIV negativ apo pozitiv.

E **drejta e mendimit** u bën të mundur individëve të ushtrojnë bindjet e tyre fetare, filozofike apo seksuale pa frikën e diskriminimit dhe dënimit, p.sh. rasti i homoseksualëve, etj.

E drejta për **të qenë i informuar dhe arsimuar** ka të bëjë me faktin se të gjithë personat kanë të drejta të barabarta për t’u arsimuar dhe informuar për shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues, të drejta dhe përgjegjësi që janë të ndjeshme ndaj gjinisë, të lirë nga stereotipat. Po të kenë akses të barabartë në arsimim si burrat dhe djemtë, gratë dhe vajzat mund të përdorin më mirë shërbimet dhe informacionin mbi shëndetin riprodhues dhe seksual.

E **drejta për t’u martuar ose jo dhe për të krijuar familje**, u krijon mundësi të barabarta burrave dhe grave për të zgjedhur vetë bashkëshortin apo partnerin e ardhshëm si dhe të zgjedhin të bëjnë apo jo fëmijë. Në disa situata apo kultura, vajzat konsiderohen si barrë për familjen e tyre dhe një investim jofitimprurës. Ato shpesh detyrohen nga familjet e tyre të martohen në moshë shumë të re, sidomos në rastet kur familjet kanë përfitime ekonomike nga kjo martesë, gjë e cila mund të ketë pasoja për shëndetin fizik apo mendor të tyre.

E **drejta për të vendosur nëse do të lindin fëmijë apo jo** u jep njerëzve mundësinë të zgjedhin vetë dhe në mënyrë të lirë nëse duan apo jo fëmijë, sa fëmijë duan dhe në çfarë kohe duan t’i lindin ata. Këtë gjë ata mund ta realizojnë duke patur informacion se si mund ta arrijnë këtë, duke përdorur kontraceptive, pavarësisht nga moshja e tyre, kontraceptive që do t’i mbrojnë ata dhe nga IST-të, sidomos kur ata e kanë filluar aktivitetin seksual shumë herët.

**E drejta për kujdes dhe mbrojtje shëndetësore** u bën të mundur njerëzve të gëzojnë dhe kërkojnë mundësi për të siguruar shërbime të specializuara dhe të standardeve më të larta të shëndetit seksual dhe riprodhues. Kështu asnjë gruaqe gjatë fazës së aktivitetit të lindjes apo nëse ka dëshirë të marrë kontraktivë ose një burri apo gruaqe që kërkon këshillim për probleme të ndryshme të shëndetit, nuk mund t'u refuzohet apo vonohet dhënia e këtyre shërbimeve.

**Të përfitosh nga progresi në shkencë ka të bëjë** me mundësinë për të patur të drejtë të përdorësh dhe të kesh akses në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues të standardeve më të larta si dhe të përfitosh nga progresi i teknologjisë në këto fusha, përfshirë mundësinë për të përdorur kontraktivë të gjeneratave të fundit, që janë të efektshëm, të sigurtë dhe me kosto të përballeshme. Kur mundësia e përdorimit të kontraktivëve nga gratë apo vajzat është shumë e vogël dhe për pasojë ato e kanë të vështirë apo të pamundur të mbrojnë veten nga shtatzënitë e padëshiruara, e drejta e tyre për të përfituar nga progresi teknologjik është çënuar. Edhe në rastin kur gratë mbingarkohen me punë shtëpie dhe kujdesjeje për pjesëtarët e tjerë të familjes, e drejta dhe mundësia e tyre për të përfituar nga progresi teknologjik është çënuar rëndë.

**E drejta për të marrë pjesë në mbledhje dhe aktivitet politik** u mundëson grave dhe vajzave të drejtën për t'u kërkuar qeverive të tyre të vendosin në qendër të politikave sociale dhe shëndetësore prioritetet e shëndetit seksual dhe riprodhues si dhe të drejtën për të formuar shoqata me qëllim promovimin e të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

**E drejta për të qenë e lirë nga çdo torturë dhe keqtrajtim** në aspektin e shëndetit riprodhues, p.sh. ka të bëjë me faktin se askush nuk duhet të detyrohet për të ushtruar prostitucion kundër vullnetit të vet ose të jetë e detyruar të jetojë në poligami. Po kështu dhe të qenit e detyruar si femër të kesh marrëdhënie seksuale me punëdhënësin tënd mashkull apo anasjelltas si dhe të punosh me orare të zgjatura shpesh pa pagesë, sepse në të kundërt mund të hiqesh nga puna, është dhunim i të drejtave njerëzore.

Çfarë ndryshimi solli Konferenca e Kajros - 1994?

Në vitin 1994, Konferenca për Popullsinë dhe Zhvillimin analizoi në detaje të drejtat riprodhuese dhe seksuale, si elementë bazë të axhendës për zhvillim. Seksualiteti i grave dhe autonomia e tyre u debatuan gjatë si një element i shëndetit riprodhues dhe si një fushë ku edhe burrat kanë përgjegjësitë e tyre konkrete dhe kanë shumë për të kontribuar.

Konferenca e IV e Grave në Pekin, më 1995, i diskutoi shumë nga këto çështje së bashku, duke theksuar nevojën për fuqizimin e grave dhe barazi gjinore, elementë këto të domosdoshëm për zhvillimin human.

*Diskuto me nxënësit për ndryshimet pas vitit 1994:*

1. Ndryshimi i parë është kalimi nga analizat e ndryshimeve në aspektin e numrave, në ato të orientuara drejt qenieve njerëzore, me fokus kryesor të drejtat njerëzore. Përjasja e bazuar në aspektin numerik, fokusohet në uljen e lindshmërisë, me qëllim kryesor ngadalësimit të shtimit të popullsisë në botë. Përjasja që ka në fokus njerëzit, në bazë të saj ka të drejtën e grave dhe të burrave për të zgjedhur, që do të thotë të bazohesh

në parimin e të drejtave njerëzore dhe jo një përqasje teknike për çështjet e popullsisë. Në mënyrë të veçantë, kjo përqasje thekson se të drejtat e grave për shëndet riprodhues dhe seksual janë çështje të të drejtave humane.

2. Ndryshimi i dytë ka të bëjë me zgjerimin drejt shërbimeve cilësore dhe të drejtave riprodhuese dhe jo vetëm dhënie kontraceptivësh dhe trajtim mjekësor të problemeve që lidhen me riprodhimin.

Qëllimi i programeve në këtë drejtim është të sigurojë mundësitë për një mirëqenie fizike dhe mendore, përfshirë të drejtën për të gëzuar një jetë seksuale të kënaqshme dhe të rregullojë fertilitetin.

3. Ndryshimi i tretë ka të bëjë me etikën e punës së atyre që punojnë në çështjet e popullsisë, e parë kjo nga këndvështrimi i një barazie të plotë gjinore.

Në qendër të kësaj etike të re është eliminimi i diskriminimit dhe fuqizimi i grave që të kenë të drejtë dhe mundësi të gëzojnë një shëndet mendor dhe fizik dhe të jenë të lira të marrin vendime për shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues. Kjo nuk mund të arrihet veçse duke fuqizuar rolin që burrat duhet të luajnë nëpërmjet sjelljeve të tyre të përgjegjshme seksuale dhe riprodhuese. Për këtë është shumë i rëndësishëm edukimi i tyre, gjë që bën të mundur që ata të marrin më shumë përgjegjësi në çështjet e shëndetit riprodhues.

4. Ndryshimi i katërt ka të bëjë me një përqasje gjithëpërfshirëse të shëndetit riprodhues.

Pas Konferencës së Kajros, çështje të tilla si: varfëria, dhuna, mjedisi, shpërndarja e të ardhurave, në kontekstin gjinor janë parë si faktorë të ndërlidhur që prekin dhe ndikojnë në çështjet e popullsisë. Në këtë kuadër, njeriu nuk konsiderohet si një qenie statike ose thjesht në kontekstin e problemeve të tij mjekësore, por merret shumë në konsideratë statusi i tij, kushtet dhe mjedisi ku jeton.

Në kuadrin legjislativ, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) është dokumenti kryesor që sanksionon parimet e pranuar në aspektin ndërkombëtar të të drejtave të grave, përfshirë të drejtën për arsim, punësim, shëndet dhe aktivitet ekonomik dhe social (artikujt 10, 11, 12, 13). Konventa CEDAW tërheq po ashtu vëmendjen në faktin se të drejtat për statusin ligjor të grave lidhen me statusin e tyre martesor, p.sh. marrja e kombësisë së burrit pas martesë, e bën gruan të varur nga burri dhe nuk i jep asaj mundësi tjetër.

Artikulli 16 i CEDAW-it ka të bëjë me çështjen e martesës dhe marrëdhënieve familjare, duke siguruar të drejta dhe detyrime të barabarta mes grave dhe burrave për zgjedhjen e bashkëshortit, të drejtën për të qenë prind, të drejtat e individit dhe ato mbi pronësinë.

**Konventa i kushton vëmendje të veçantë të drejtave riprodhuese.** Që në hyrje të saj, Konventa parashton se "Roli i gruas në riprodhim nuk mund të jetë faktor për diskriminim". Artikulli 5 i Konventës, avokon për një kuptim të "mëmësisë si funksion social" dhe kërkon një përgjegjësi të barabartë të të dy gjinive për rritjen e fëmijës.

Konventa afirmon gjithashtu të drejtat e grave për shëndet riprodhues. Kjo është konventa e parë që përmend planifikimin familjar. Artikulli 12, që ka të bëjë me shëndetin, tregon vëmendje të veçantë për shëndetin riprodhues.

Shteti është i detyruar të sigurojë këshillime për planifikimin familjar në programet e edukimit (artikulli 10.ë) dhe të garantojë në Kodin e Familjes të drejtën e gruas “për të vendosur e lirë dhe me përgjegjësi të plotë numrin dhe kohën e lindjes së fëmijëve si dhe të ketë akses në informacion, edukim dhe t’u sigurohen mundësitë për të ushtruar të drejtat e tyre” (artikulli 16.d). Megjithëse CEDAW nuk përmend shëndetin riprodhues si term, në artikullin 12 të saj parashtrohen disa dispozita që më vonë janë konsideruar si elementë të shëndetit riprodhues.

### Artikulli 12 - E drejta për shëndet

1. Shteti duhet të marrë masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në fushën e kujdesit shëndetësor në mënyrë që t’u sigurojë, në bazë të barazisë midis burrave dhe grave, mundësitë për shërbime shëndetësore, përfshirë dhe ato të planifikimit familjar.
2. Pavarësisht nga sa përmendet në paragrafin 1 të këtij artikulli, shteti do t’u sigurojë grave shërbime të përshtatshme gjatë shtatzënisë, lindjes dhe pas lindjes, si dhe ...gjatë ushqyerjes me gji.

Në maj 1999, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave adoptoi Rekomandimin nr. 24, i cili parashton “...masa për eliminimin e diskriminimit për të vënë në jetë të drejtat e grave për shëndet në standardet më të larta të mundshme” (A/54/38, pjesa I).

Ky rekomandim është shumë i rëndësishëm për shëndetin riprodhues, pasi në paragrafin 31 të tij thuhet se shtetet:

- Duhet ta vendosin çështjen gjinore në qendër të politikave dhe programeve që afektojnë shëndetin e gruas,
- Të heqin të gjitha barrierat që pengojnë aksesin e grave në shërbimet shëndetësore, arsim dhe informim, përfshirë dhe fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe në mënyrë të veçantë, të vënë në dispozicion fonde të adresuara për programet e adoleshentëve, parandalimin dhe trajtimin e infeksioneve të transmetuara seksualisht, përfshirë HIV/SIDA-n,
- Të parandalojnë shtatzënitë e padëshiruara nëpërmjet bërjes së disponueshme të metodave moderne të planifikimit familjar, edukimit seksual dhe zvogëlimit të vdekshmërisë amtare, duke bërë të mundur shërbimet e mëmësisë së sigurtë dhe kujdesit para lindjes. Të punohet gjithashtu që legjislacioni për abortin të mos jetë penalizues për gratë që e kryejnë atë,
- Të monitorojnë shërbimet shëndetësore ofruar grave, në mënyrë që t’u sigurohet atyre akses i barabartë dhe shërbime cilësore,

- T'u kërkojnë të gjithë ofruesve të shërbimeve shëndetësore të kenë në bazë të punës së tyre parimet e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për autonomi, privatësi, konfidencialitet, vendimmarrje të bazuar në informacion të mjaftueshëm dhe mundësi zgjedhjeje,
- Të sigurojnë që trajnimet e ofruesve të shërbimeve shëndetësore të përfshijnë elementë të barazisë gjinore, shëndetit të grave dhe të drejtave të njeriut, veçanërisht dhunës me bazë gjinore.

## Shëndeti riprodhues si e drejtë humane

Në Konferencën e Vjenës mbi të Drejtat e Njeriut u konfirmua se të drejtat e grave dhe vajzave janë të drejta humane. Po ashtu edhe eliminimi i çdo forme të dhunës, aq më tepër ai bazuar në gjininë e personit mbi të cilin ushtrohet dhunë duhet të jetë një detyrim dhe prioritet për çdo qeveri. Gratë dhe vajzat kanë të drejtën të gëzojnë standardet më të larta të shëndetit mendor dhe fizik gjatë gjithë jetës së tyre, gjë e cila përfshin të drejtën për shërbime shëndetësore dhe ato të shëndetit riprodhues të përshtatshme dhe të arritshme nga ato. Shëndeti dhe të drejtat seksuale dhe riprodhuese duhet të respektohen nga të gjithë në kuadrin e respektimit të dinjitetit dhe barazisë, të të qenit jo i diskriminuar, ruajtjes së privatësisë, të drejtës dhe sigurisë të personit, të drejtës për shërbime shëndetësore, përfshirë ato të shëndetit riprodhues.

Në këtë aspekt një rol të rëndësishëm merr e drejta për jetën dhe çlirimi nga çdo formë e deprivimit arbitrar ndaj jetës, si për shembull vdekshmëria amtare.

Po ashtu, të qenit i lirë nga çdo formë e dhunës apo e ngacmimit seksual është një e drejtë themelore humane. Në këtë aspekt, p.sh. askush nuk mund të detyrohet të kryejë abort apo të sterilizohet kundër vullnetit të tij/saj.

## Burimet ligjore ndërkombëtare për të drejtat riprodhuese

- E drejta për liri dhe siguri: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNj), artikulli 3; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Qytetare dhe Politike (KNDQP), artikulli 9 (1),
- E drejta për shëndet: Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESC), artikulli 12,
- E drejta për të mos qenë i diskriminuar në marrjen e shërbimeve shëndetësore dhe në familje: Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEGFDG), artikulli 12 (1) , 16 (1),
- E drejta për t'u martuar dhe krijuar familje: DUDNj, artikulli 16 (1); KEGFDG artikulli 16 (1); KNDQP, artikulli 23 (2),
- E drejta për të qenë i lirë nga ndërhyrje të jashtëligjshme dhe arbitrare në privatësinë, familjen dhe shtëpinë, KNDQP, artikulli 17 (1),
- E drejta për të përfituar nga progresi shkencor dhe eksperimentet, KNDESC, artikulli 15 (1),



- E drejta për të mos qënë i diskriminuar për shkak të seksit: KEGFDG, artikulli 1, 2; DUDNj, artikulli 2, KNDQP, artikulli 2 (1), KNDESC, artikulli 2 (2),
- E drejta e burrave dhe grave për të pasur akses të barabartë në shërbimet e planifikimit familjar; KEGFDG, artikulli 12 (1),
- E drejta për të gëzuar standardet më të larta të shëndetit mendor dhe fizik, përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues; KNDESC, artikulli 12,
- E drejta për informacion, këshillim dhe shërbime të planifikimit familjar; KEGFDG, artikulli 14,
- E drejta për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi të plotë për numrin, kohën e lindjeve dhe për të patur akses për informacion, edukim si dhe mjetet për ta ushtruar këtë të drejtë; KEGFDG, artikulli 16,
- E drejta për t'u martuar me përfshirjen tënde të plotë; KNDESC, artikulli 10, KEGFDG, artikulli 16.

## Konteksti ligjor shqiptar për shëndetin riprodhues

Në frymën e **Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet bazuar, ndër të tjera, në gjendjen sociale të tij. Objektiv i ligjit themeltar është arritja e standardeve më të larta shëndetësore, fizike dhe mendore të mundshme.

Mbështetur mbi **Konventën për të Drejtat e fëmijëve**, të nënshkruar edhe nga vendi ynë si dhe në Kushtetutën e RSH, neni 55, "...fëmijët, gratë shtatzëna, nënat, gëzojnë të drejta të barabarta përpara ligjit...", si dhe të drejtën për mbrojtje të veçantë nga shteti duke i garantuar kështu të drejtën e jetës, të drejtën për mbijetesë dhe zhvillimin e fëmijës.

Shteti shqiptar ka ratifikuar në vitin 1993 **Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave** dhe në vitin 1994, Konventën për të Drejtat e Fëmijëve.

Në maj të 1992 për herë të parë në Shqipëri **miratohen aktivitetet e planifikimit familjar** me vendimin nr. 226 të Këshillit të Ministrave, të cilat deri në atë kohë kishin qenë të ndaluara.

Ligji nr. 8045, datë 7.12.1995 **"Për ndërprerjen vullnetare të shtatzënisë"**. Ligji parashikon në nenin 1 të tij, respektimin e çdo qenieje njerëzore që në fillim të jetës. Në ligj parashikohet ndërprerja vullnetare e shtatzënisë me kërkesën e nënës, deri në 12 javë shtatzënie. Ky ligj shprehet qartë se aborti nuk duhet konsideruar si metodë e planifikimit familjar.

Ligji ndalon çdo lloj propagande dhe reklamimi, direkt ose indirekt, me fjalë ose figurë, të institucioneve, metodave, medikamenteve dhe produkteve që shkaktojnë ndërprerje të shtatzënisë, përveçse botimeve shkencore të destinuara për mjekë dhe farmacistë.

Në zbatim të këtij ligji, Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë disa rregullore dhe udhëzime si:

- Udhëzimi nr. 103, datë 22.04.1996 **“Për zbatimin e ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë”**. Udhëzimi përcakton kushtet që duhet të plotësojnë institucionet shëndetësore, që kryejnë ndërprerje të shtatzënisë për institucionet publike dhe private:
  - **dokumentacioni i unifikuar për abortet** (kartela klinike, skeda e abortit, certifikata e firmosur nga grua, që kryen ndërhyrjen),
  - lista e indikacioneve mjekësore që kërkojnë parandalimin dhe eventualisht ndërprerjen mjekësore të shtatzënisë mbi 12 javë.
- Urdhri nr. 157, datë 23.5.2007, i Ministrit të Shëndetësisë, **“Për të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private që ofrojnë kujdes dhe shërbime shëndetësore për ndërprerjen e shtatzënisë, të licencuara nga Ministria e Shëndetësisë, që të regjistrojnë të dhënat individuale për çdo ndërprerje të shtatzënisë së kryer, në kartelën mjekësore, skedën individuale të abortit dhe regjistrin e abortit”**.
- Ligji nr. 8528, datë 23.09.1999 **“Për nxitjen dhe mbrojtjen e ushqyerjes me gj”**, i cili ka si qëllim sigurimin e të ushqyerit të shëndetshëm për fëmijët duke rregulluar praktikën e tregtimit të zëvendësuesve të qumështit të gjirit, mbështetur në Kodin Ndërkombëtar të Marketingut të Zëvendësuesve të Qumështit të Gjirit.
- Ligji nr. 8876, datë 4.4.2002 **“Për shëndetin riprodhues”**. Qëllimi kryesor i ligjit është njohja dhe pranimi i të drejtave riprodhuese dhe shëndetit riprodhues të çdo individi. Ky ligj:
  - Përcakton dhe garanton mbrojtjen e të drejtave riprodhuese të çdo individi në Republikën e Shqipërisë,
  - Rregullon organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve që zhvillohen në fushën e shëndetit riprodhues, në institucionet shëndetësore, publike dhe private,
  - Siguron shpërndarjen e barabartë të burimeve, institucioneve për të arritur qëllimin e kërkuar, plotësimin e të drejtave riprodhuese,
  - Në ligj ka disa nene që mbrojnë mëmësinë e sigurtë, shëndetin për fëmijët dhe adoleshentët.

Ministria e Shëndetësisë, në zbatim të ligjit nr. 8876, “Për shëndetin riprodhues”, ka plotësuar aktet nënligjore nëpërmjet përgatitjes së rregulloreve, udhëzimeve dhe dokumentacionit të unifikuar për shërbimet e shëndetit riprodhues.

- **Rregullorja e Shërbimeve të Shëndetit Riprodhues në Kujdesin Shëndetësor Parësor**, nr. 147, datë 11.04.2003, përcakton strukturat dhe shërbimet e shëndetit riprodhues në kujdesin shëndetësor parësor; rregulloret e funksionimit të tyre dhe detyrat e stafit shëndetësor që punon në këto shërbime.
- **Udhëzimi nr. 146, datë 11.04.2003 i Ministrit të Shëndetësisë**, lidhur me ndjekjen dhe kontrollin periodik të detyrueshëm mjekësor të shtatzënisë, lindjes dhe pas lindjes, si edhe ekzaminimet dhe kontrollet që duhen kryer për fëmijët 0 - 6 vjeç.

- **Kartela e këshillimores së gruas**, e cila do të shërbejë si një dokumentacion i unifikuar për t'u përdorur nga të gjitha shërbimet shëndetësore publike dhe private për ndjekjen e gruas gjatë shtatzënisë.
- **Kartela e këshillimores së fëmijës**, cila shërben si një dokumentacion i unifikuar për t'u përdorur nga të gjitha shërbimet shëndetësore publike dhe private për ndjekjen e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve 0-6 vjeç.
- **Fletorja personale e gruas shtatzënë**, e cila sipas nenit 24 të ligjit, i jepet asaj falas.
- **Fletorja personale e shëndetit të fëmijës**, që jepet falas për çdo fëmijë të porsalindur, gjatë vizitave të kontrollit për mirërritjen dhe zhvillimin.
- **Kodi i Punës dhe vendimi nr. 397 datë 20.05.1996**, i Këshillit të Ministrave **"Për mbrojtjen e veçantë të grave shtatzëna dhe të amësisë"**. Kujdesi shëndetësor tregohet që para lindjes së fëmijës, me lindjen e tij dhe në vazhdimësi. Kjo praktikë është e lidhur me kujdesin që tregohet për nënën.

Kodi i Punës ka dispozita, të cilat sigurojnë mbrojtje të veçantë për gratë shtatzëna dhe kjo mbrojtje ka të bëjë me disa kategori të caktuara punësh, të cilat kryhen në kushte të ndryshme nga kategoritë e tjera.

- **Kodi Penal** parashikon në një seksion të veçantë veprat penale kundër shëndetit.

Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas dënohet me burgim deri në 5 vjet. Gjithashtu përbën vepër penale mjekimi i pakujdesshëm nga mjeku dhe personeli mjekësor, rastet kur si rezultat i kësaj pakujdesie pacientët janë infektuar me HIV/AIDS, si dhe mosdhënia e ndihmës mjekësore pa shkaqe të arsyeshme nga ana e personit, që me ligj është i detyruar ta kryejë këtë veprim.

Kodi Penal përmban sanksionet më të rënda për diskriminimin. Në nenin 253, thuhet se "dallimet mbi bazë origjine apo seksi të kryera nga ana e punonjësit shtetëror apo në shërbim publik, që konsistojnë në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në 5 vjet".

- **Kodi i Familjes të RSH-së**, është ndër aktet ligjore kryesore që garanton të drejtat e të miturve. Në nenin 3 të tij parashikohet se "Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë".
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 **"Për sigurimet shoqërore"** ka një kapitull të veçantë që bën fjalë për të ardhurat për barrë lindje, ku përfshihet e ardhura për barrë lindje dhe shpërblimi për lindje fëmije.
- Ligji nr.7870, datë 13.10.1994 **"Për sigurimet shëndetësore në RSH"** i ndryshuar më 2009. Sigurimet shëndetësore të detyrueshme janë një sistem jofitimprurës, që mbulojnë:

a) një pjesë të çmimit të barnave në rrjetin e hapur farmaceutik; b) shpenzimet e shërbimit nga mjeku i përgjithshëm ose i familjes, mjeku specialist, infermierët e shërbimit shëndetësor

parësor për të gjithë të sigurvearit. Sigurimet shëndetësore të detyrueshme sigurohen nga një institut shtetëror i pavarur, Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) dhe mbulojnë një pjesë të çmimit të barnave kryesore të listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe shpenzimet e shërbimit nga mjeku i përgjithshëm ose i familjes. Masa e mbulimit përcaktohet çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Ligji parashikon që të gjithë subjektet ekonomikisht aktive duhet të kontribuojnë në ISKSH. Vetë shteti kontribuon për kategoritë joaktive si fëmijët, nxënësit e shkollave dhe studentët dhe nënat me leje lindje.

- Ligji **“Për parandalimin e HIV/AIDS-it në Republikën e Shqipërisë”**, miratuar më 2002, i cili në vitin 2009 është futur në proces rishikimi për ndryshime dhe përmirësime të mundshme.
- Ligji nr. 9669 **“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”** miratuar në datë 18.12.2006 nga Kuvendi i Shqipërisë. Ky ligj përfaqëson një përpjekje serioze të shtetit shqiptar për të adresuar dhunën dhe mbrojtjen e personave brenda familjes nga dhuna. Ligji synon të ngriejë një sistem raportimi, referimi dhe trajtimi të viktimave, duke krijuar një Autoritet përgjegjës pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe ngarkuar me përgjegjësi konkrete institucione të tjera si Ministria e Brendshme, Ministria Shëndetësive, Ministria e Drejtësisë dhe njësitë e qeverisjes vendore (neni 5 -9).

Detyrimi për raportim shprehet në mënyrë eksplicite në nenin 7, pika 2 (c), ku përcaktohet se Ministria e Shëndetësisë duhet të krijojë kapacitetet e duhura për të evidentuar rastet e dhunës në dokumentacionin përkatës mjekësor dhe qendrat shëndetësore kanë detyrimin për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes. Nga ana e MSH-së janë përgatitur aktet nënligjore të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

- Ligji nr. 9970 **“Për barazinë gjinore në shoqëri”** miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 24 korrik 2008.

Qëllimi kryesor i këtij ligji është mbrojtja e qytetarëve nga çdo lloj diskriminimi që kryhet mbi bazë gjinie, garantimi i mundësive dhe shanseve të barabarta si për meshkujt edhe për femrat, për të arritur standarde sa më të larta në fushën e barazisë gjinore. Kjo do të realizohet sidomos, përmes përmirësimit të funksioneve në fushën e barazisë gjinore që do të përmbushen nga ky ligj, si dhe forcimit të mekanizmave institucionalë që do të zbatojnë kuadrin ligjor të kësaj fushe. Ligji sjell përkufizime të reja si ai i diskriminimit gjinor, integritet gjinor, kuotave dhe jep një përkufizim më të plotë të ngacmimeve seksuale në vendin e punës dhe ngacmimeve të tjera.

### Çështje për t’u diskutuar

Transmetimi i HIV-it nga nëna te fëmija: mund t’i vendosë gratë në një situatë të dyfishtë stigmat si të infektuara vetë me HIV dhe si përçuese të tij tek i porsalinduri, megjithëse infektuesi i saj mund të ketë qenë partneri ose bashkëshorti.

STI/HIV dhe problemet gjinore: Disa faktorë të lidhur me statusin më inferior të grave dhe vajzave në sferën e arsimimit, atë sociale dhe aksesit në shërbime shëndetësore, përfshirë moslejimin e përdorimit të prezervativit (femëror apo mashkullor) gjatë kontaktit seksual, mund të influencojnë në infektimin e grave dhe vajzave.

Dominanca që burrat apo djemtë shpesh shfaqin gjatë marrëdhënieve në çift apo detyrimi i grave ose vajzave për prostitucion janë çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet gjinore.

Faktorët ekonomikë, sidomos në familjet apo personat me të ardhura të pakta, janë një element shumë i rëndësishëm që mund të ndikojë në mosmarrjen e mjeteve kontraceptive apo të detyrojë gratë dhe vajzat të futen në rrugën e prostitucionit për të siguruar mjetet minimale të jetesës.

Si do ta komentoni me të rinjtë thënien e shkrimtarit të njohur Jonathan Mann se **“Shoqëritë e dominuara nga meshkujt janë rreziku më i madh për shëndetin publik në botë”**?

Në këtë koment duhen marrë në konsideratë problemet e sëmundshmërisë dhe abuzimeve të gratë dhe vajzat, si dhe pasojat që sjellin ato në shëndetin e tyre riprodhues.

### Të dhëna dhe fakte:

- Mbi 100 milion akte seksuale ndodhin në ditë, 900.000 prej të cilëve përfundojnë në shtatzëni, gjysma e të cilave janë të paparashikuara dhe një e katërta të padëshiruara.
- Çdo minutë vdes një grua gjatë lindjes, që do të thotë 1400 gra në ditë ose rreth 500.000 gra në vit.
- Në çdo minutë ndodhin rreth 100 aborte apo 150.000 aborte në ditë ose 50 milion në vit. Një e treta e tyre kryhet në kushte jo të sigurta për jetën e grave, duke bërë që çdo tre minuta të vdesë një grua nga aborti, që do të thotë rreth 500 gra në ditë ose 175.500 gra të vdesin në vit nga po kjo arsye.
- Rreth 620 raste infeksionesh të transmetuara seksualisht ndodhin çdo minutë ose 890.000 infektime në ditë dhe në vit 320 milion të tilla.
- Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, çdo gjashtë minuta një grua përdhunohet. Në një vit ndodhin 87.000 raste të tilla. Në Afrikën e Jugut, me një popullsi sa një e gjashta e SHBA-së, çdo 90 sekonda një grua përdhunohet apo 370.000 gra në vit.

Po të bëjmë një analizë të shkaqeve të sëmundshmërisë dhe vdekjeve të burrat dhe gratë do të vëmë re se një pjesë e madhe e tyre shkaktohen të gratë dhe vajzat gjatë periudhës së tyre riprodhuese. Banka Botërore në një analizë që i ka bërë shkaqeve të vdekjeve të burrat dhe gratë në moshë riprodhuese (14-49 vjeç) vë në dukje se ato janë shumë të ndryshme për të dy seksat. Për burrat, shkaqet kryesore të vdekjeve janë: HIV-i, tuberkulozi, aksidentet, dhuna dhe lufta. Ndërsa shkaqet kryesore të vdekjeve për gratë e po kësaj

moshe janë ato lidhur me vdekshmërinë amtare, sëmundjet e transmetuara seksualisht, tuberkulozi, HIV-i dhe depresioni. Këto shkaqe dokumentojnë sa të ndryshme janë jetët e të dy seksve. Ato gjithashtu tregojnë sa të dhunshëm janë burrat dhe sa shumë i lidhur është shëndeti i gruas me jetën riprodhuese.

Po të analizojmë SIDA-n nga këndvështrimi gjinor dhe të marrim në konsideratë rrugët me të cilat gratë apo vajzat mund të infektohen, një vend të rëndësishëm në të zë dhe ndërtimi biologjik i femrave, ndërtim që i bën ato më të prekshme nga infeksioni. Mundësia e transmetimit të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme është më e lartë nga burrat te gratë. Këto sëmundje, përfshirë HIV-in, transmetohen dy herë më shumë nga burrat te gratë se anasjelltas. Kjo për arsye se trakti gjenital i grave zë më shumë sipërfaqe, për rrjedhojë ka dhe mundësi më të madhe infektimi. Semenit te burrat mbart më shumë organizma patogjenë që mbeten në traktin e tyre gjenital për më shumë kohë.

Duke qënë se gratë manifestojnë më pak simptoma të infeksioneve seksualisht të transmetueshme (IST), nuk e kanë të lehtë psikologjikisht të kërkojnë ndihmë mjekësore të specializuar për trajtimin e IST-ve. Meqenëse shpesh gratë janë të stigmatizuara nga qënia të infektuara me një IST, duke i "pranuar" shqetësimet që këto simptoma mund të shkaktojnë si një pjesë e pandarë që shoqëron jetën e tyre riprodhuese, ato shpesh, në rreth 80% të rasteve, nuk e ndajnë të nevojshme apo të domosdoshme të shkojnë të vizitohen te mjeku. Në kushtet kur pasja e një IST-je rrit mundësinë për t'u infektuar dhe me HIV-in, gratë dhe vajzat bëhen në këtë mënyrë edhe viktimat më të shumta të marrjes së infeksionit HIV.

Prandaj është e domosdoshme të theksojmë vulnerabilitetin biologjik të femrave apo vajzave të reja, veçanërisht gjatë kontaktit të parë seksual, kontakt apo akt ky që në vetvete është traumatik dhe për këtë arsye rrit mundësinë e infektimit. Po ashtu, mukoza te vajzat para pubertetit është shumë më delikate dhe shumë më pak mbrojtëse ndaj infeksionit të HIV-it.

Ndër faktorët kulturorë që mund ta bëjnë një grua apo vajzë më vulnerable ndaj infeksionit HIV mund të përmendim disa të tillë, si :

- Burrat shpesh e shohin gruan si më inferiore apo në shërbim të plotësisht të nevojave të tyre. Po ashtu, edhe gratë që janë "mësuar" ta shohin veten në të tilla pozicione inferiore dhe në rolin e tyre si "plotësuese" të nevojave të burrave e kanë pak të kultivuar ndjenjën e individualitetit apo të njohjes së vetvetes si qenie që mund të jetojnë dhe të japin shumë dhe pa qenë të varura nga "pronarët" e tyre bashkëshortë apo partnerë, që kanë po aq të drejta dhe liri sa edhe bashkëshortët apo partnerët e tyre.
- Në shumë kultura, nëse je burrë dhe ke disa partnere seksuale konsiderohet e ndershme dhe e pranueshme dhe nuk stigmatizohesh për këtë veprim. Po të njëjtat parime i dënojnë gratë që vuajnë nga IST-të dhe shfaqësojnë burrat për të njëjtat simptoma apo sëmundje. Madje në disa kultura, në gjuhën popullore, IST-të shpesh cilësohen si "sëmundje grash".

- Në çiftet e martuara, në shumë shoqëri, gratë kthehen në shërbëtoreshë të bindura të burrave të tyre dhe megjithëse se ato mund ta dinë se burrat e tyre kanë marrëdhënie jashtëmartesore, jo rrallë janë të detyruara ta pranojnë këtë fakt. Brenda dhe jashtë martese, dhuna ndaj grave përdoret shpesh për të përforcuar faktin që gratë janë dhe duhet të mbeten inferiore.
- Në shumë kultura dhe shoqëri, të qenit grua e përlulur ndaj burrit, mbart shpesh në themelet e saj shumë faktorë të pabarazisë ekonomike dhe ligjore. Shpesh, gratë dhe vajzat janë të varura ekonomikisht nga partnerët e tyre deri në atë shkallë sa të mos kenë mundësi për të vendosur vetë për të blerë apo përdorur prezervativin apo kontraceptivin, që mund t'i mbrojnë ato nga infektimi me HIV-in apo sëmundje të transmetuara seksualisht.

### **Cilat janë pasojat e vulnerabilitetit biologjik dhe social të grave?**

Për shumë gra dhe vajza, një nga faktorët më të shpeshtë për t'u infektuar nga virusi HIV është të qenit e martuar. Kjo është po aq e vërtetë edhe në Shqipëri, pasi shumica e grave të infektuara e kanë marrë këtë virus nga partnerët e tyre, sidomos nga ata që kanë qenë emigrantë jashtë vendit, qoftë dhe për një kohë të shkurtër.

- Megjithëse strategjitë më të efektshme për parandalimin e transmetimit të HIV-it janë besnikëria në lidhjen në çift, duke shmangur pasjen e disa partnerëve, përdorimi i prezervativit dhe trajtimi sindromik i IST-ve, ndodh shpesh që këto strategji ofrojnë shumë pak ose aspak mundësi mbrojtjeje për gratë, sidomos për ato partneri i vetëm i të cilave është bashkëshorti apo ato të cilat janë të detyruara ta shesin trupin e tyre për të siguruar mbijetesën dhe si të tilla kanë shumë pak mundësi negocimi për një seks të sigurtë (përdorim prezervativi).
- Megjithëse ndodh që burrat e mësojnë se janë të infektuar me HIV (HIV pozitiv) dhe e dinë shumë mirë se kanë patur marrëdhënie të tjera përveçse me bashkëshortet e tyre, shpesh ata fajësojnë gratë e tyre për këtë, duke arritur deri aty sa t'i kërcënojnë partneret, të bëhen të dhunshëm ndaj tyre apo t'i përzënë nga shtëpitë.
- Infeksionet te gratë shfaqen në moshë më të re, rreth 5 deri në 10 vjet, sesa burrat. Moshë mesatare për gratë më të prekura nga infektimi me HIV-in është 15-24 vjeç, ndërsa moshë më e prekur për burrat është 30-34 vjeç.
- Gratë apo vajzat e reja e prekura janë më të shumta në numër se burrat e të njëjtës moshë. Në disa vende të Afrikës, që është kontinenti më i prekur nga HIV-i, frekuenca e infektimit është rreth 20 herë më e lartë te femrat e moshës 13 - 19 vjeç, sesa te burrat e të njëjtës moshë.
- Si pasojë, meqë femrat infektohen në moshë më të re, vlerësohet se jetëgjatësia mesatare për gratë do të ulet ndjeshëm (rreth 20 vjet për gratë dhe 10 vjet për burrat).
- Gjithashtu vlerësohet se meqë gratë infektohen në moshë më të re se burrat, në një popullsi që rritet në numër, ku çdo grupmoshë përbën një numër më të madh

popullsie se paraardhësja e saj, gratë e infektuara do t'ua kalojnë në numër burrave të infektuar.

- Për shumë arsye, gratë e infektuara kanë jetëgjatësi më të ulët se burrat; gratë kanë më pak akses për shërbime shëndetësore, janë të detyruara të punojnë, të kujdesen për familjen edhe kur janë të sëmurë, gjë e cila e keqëson situatën e tyre shëndetësore dhe më shumë. Për më tepër edhe më pas, shumë pak kujdes tregohet ndaj tyre për shëndetin.
- Në të gjitha rastet, kur gratë lenë pas jetimë apo kanë nevojë për kurim dhe kujdes, barra bie mbi vetë gratë, te nënat e tyre, motrat ose të afërmet apo kushërirat (p.sh. në Zambia 49% e kujdesit të jetimëve, për shkak të vdekjes së një apo dy prindërve, jepet nga nënat dhe vetëm 6% nga baballarët).

Në shumë vende në zhvillim, por edhe në ato të zhvilluara, vihet re një shpërndarje jo e barabartë e të ardhurave, shpesh kjo në favor të burrave si dhe një mundësi shumë e ndryshme arsimimi mes grave dhe burrave. Këta faktorë ndikojnë drejtpërdrejt në mundësitë e ndryshme që u jepen grave dhe burrave për të patur informacione mbi shëndetin riprodhues dhe trajtimin e tyre në rast nevojë. Sipas studimeve të Bankës Botërore, një rritje prej 2000 dollarësh e të ardhurave për frymë të popullsisë, shoqërohet me një rënie prej 4% të nivelit të infektimit me HIV-in. Edhe tendencat e infektimit për gratë dhe burrat janë të ndryshme në faza të ndryshme të situatës epidemiologjike të infektimit, sidomos në vendet më të prekura nga epidemia. P.sh. në Zimbabve, 25% e 18-vjeçarëve shtatzëna janë të infektuara me HIV dhe frekuenca e prekjes së grave nën 20 vjeç është 10 herë më e lartë se e bashkëmoshatarëve të tyre burra, ndërkohë që infektimi nën moshën 15 vjeç është shumë i ulët pasi nën këtë moshë dhe aktiviteti seksual është i ulët. Prandaj është e domosdoshme që programet e parandalimit të HIV/SIDA-s, ku rol të rëndësishëm luan edhe shkolla, të synojnë edukimin e adoleshentëve për mundësinë e shtyrjes së fillimit të aktivitetit seksual, si dhe përdorimin e prezervativit rregullisht që në momentin e kontaktit të parë seksual. Është e rekomandueshme edhe bërja e testit vullnetar për HIV/SIDA-n, ku të ruhet konfidencialiteti dhe fshehtësia, por në asnjë mënyrë të detyrohen njerëzit ta bëjnë atë kundër vullnetit të tyre apo të diskriminohen ata/ato që janë të infektuar me HIV-in apo të sëmurë me SIDA.

Në shumë vende parandalimi i HIV/SIDA-s është parë si një përpjekje e kombinuar e programeve për ndryshimin e sjelljeve, sidomos ato të rrezikshme (fillimi i aktivitetit seksual në moshë të re, patja e shumë partnerëve seksualë, përdorimi i drogave intravenoze, kryerja e kontakteve seksuale pa përdorur prezervativë në çdo akt seksual, frekuentimi apo qenia punonjës/e seksi dhe ushtrimi i këtij profesioni pa mjete mbrojtëse-prezervativë, etj.) promovimi i përdorimit të prezervativit në çdo kontakt seksual, programet për parandalimin, trajtimin dhe këshillimin mbi IST-të, me fokus në grupe të caktuara, si dhe në popullatën në përgjithësi.



## **Punë me nxënësit**

Bazuar në analizën e mësipërme dhe informacionin që ju keni për situatën e infektimit me HIV-in në Shqipëri, a mund të hartoni një strategji për parandalimin e përhapjes së mëtejshme të infeksionit për të dy sekset?

## Përkatësia gjinore dhe zhvillimi i karrierës

*Ky kapitull synon:*

- Të ndërgjegjësojë më tej mësuesit/et për rolin që kanë në procesin e përvetësimit nga nxënësit të koncepteve bashkëkohore të drejtimit dhe zhvillimit të karrierës së tyre të ardhshme profesionale,
- Të ndërgjegjësojë mësuesit e shkollave të mesme për rëndësinë që ka eliminimi i diskriminimeve gjinore që shfaqen gjatë procesit të zgjedhjes së profesioneve dhe orientimit, të karrierave të të rinjve/rejave në të gjitha drejtimet dhe disiplinat e reja integruese të edukimit dhe tregut të punës,
- Të motivojë mësuesit të nxisin zhvillimin intelektual, moral dhe social të nxënësve si dhe arsyetimin logjik të tyre, duke i ndërgjegjësuar ata të orientojnë aftësitë dhe dëshirat e tyre për të zgjedhur dhe filluar një karrierë pa u mbështetur në ndarjet gjinore të profesioneve apo ndjekur profilet modelues të prindërve ose mësuesve të tyre,
- Të njohë mësuesit me paketat ligjore që mbrojnë të drejtat arsimore dhe ato të punësimit të të rinjve që ndikojnë drejtpërdrejt në zgjedhjen efektive dhe progresin e zhvillimit të karrierave të ardhshme për nxënësit e tyre,
- T'i ofrojë mësuesve të dhëna statistikore rreth tregut të punës, nivelit të punësimit dhe papunësisë në Europë, veçanërisht në Shqipëri, në mënyrë që të ndërgjegjësojnë nxënësit rreth vështirësive që ata do të hasin gjatë marrjes së përgjegjësisë së zhvillimit të karrierës personale.
- Të nxisë bashkëpunimin komunikativ mësues-prindër-nxënës për të krijuar së bashku strategji të zhdukjes së stereotipave gjinorë në zgjedhjen e profesioneve të të rinjve dhe zhvillimin e karrierave përkatëse,
- Të nxisë aftësitë analitike të nxënësve lidhur me zgjedhjet objektive të edukimit profesional dhe reflektimit të aftësive të tyre drejt një karriere të suksesshme.

Zhvillimi i karrierës profesionale të të rinjve dhe të rejave në shoqërinë e sotme shqiptare po merr orientime gjithnjë e më shumë individuale në krahasim me brezat e mëparshëm të sistemit komunist apo atyre të viteve të para të tranzicionit, karriera e të cilëve ishte një orientim sa familjar aq edhe i lidhur me politikat shtetërore.

Të rinjtë dhe të rejat e sotme duke qenë në ngasje të vazhdueshme nga prurja e literaturave të të gjithë disiplinave, duke qenë të ekspozuar kundrejt imazheve mediatike të një të riu/ të reje të suksesshme, duke patur një larmi kontaktesh sociale dhe duke hyrë herët në tregun e punës, arrijnë të formësojnë një identitet të vetin lidhur me atë çka do të zgjedhin për karrierën e tyre.

Sot përkufizimi i karrierës është tejte i ndryshëm nga ai i viteve të mëparshëm. Nisur nga një përfaqje institucionale ky përkufizim përshtatet më tepër drejt gjetjeve e motivimeve personale. Përfaqësues të grupeve të ndryshme sociale e përkufizojnë karrierën sipas bazës së interesave dhe pozicioneve në të cilat ndodhen. Edhe institucionet shtetërore apo private kanë përcaktimet dhe programet e tyre për ta adresuar atë në varësi të menaxhimeve organizative dhe kontratave sociale e psikologjike që bëjnë me punonjësit e tyre.

Për shembull, institucionet e biznesit e përcaktojnë zhvillimin e karrierës si: progres nëpërmjet llojshmërisë së punëve, duke përfshirë vazhdimisht aktivitete të ndryshme më të avancuara, që rezultojnë në aftësi më të shumëllojshme dhe më të përmirësuara, në prestigj dhe përgjegjësi më të mëdha dhe të ardhura më të larta. Më parë, zhvillimi i karrierës shihej si përgjegjësi e punëdhënësit. Shumë organizata kishin programet e tyre të zhvillimit, që shënonin avancimin e një punonjësi nëpërmjet niveleve të menaxhimit. Tani gjithnjë e më shumë shihet si përgjegjësi e vetë punonjësit dhe disa herë edhe si pjesë e procesit të zhvillimit<sup>56</sup>.

Studiues të orientimit dhe menaxhimit të një karriere personale dhe profesionale e argumentojnë zhvillimin e karrierës nga dy këndvështrime:

- i pari është "...konstelacioni tërësor i faktorëve psikologjikë, sociologjikë, edukativë, fizikë, ekonomikë dhe faktorialë që kombinohen për të ndikuar në natyrën dhe kuptimin e punës përgjatë jetës së një individi",
- i dyti përfshin "... proceset jetësore psikologjike dhe të sjelljes si dhe ndikimet e ndryshme rrethanore që formojnë karrierën e dikujt përgjatë jetës. Si i tillë zhvillimi përfshin krijimin e natyrës së karrierës së një personi, stilin vendimmarrës, integrimin e roleve jetësore, shprehjen e vlerave dhe vetëkonceptimin e roleve jetësore"<sup>57</sup>.

Karriera e përkufizuar si një orientim profesional individual, është paketa e parë sociale që i riu/e reja harton dhe plotëson për veten e tij/saj, jo vetëm duke synuar rritjen e mirëqenies personale dhe të familjes, përkatësinë në një status social të dëshiruar, por

<sup>56</sup> Për më gjerë vizitoni: <http://dictionary.bnet.com/definition/Career+Development.html>

<sup>57</sup> Hansen, J. *Shaping Careers of Men and Women in Organizational Contexts*. Universal Press, Veenendaal, 2005.

duke pretenduar që profesioni i zgjedhur të përmbushë edhe ambiciet e vullnetin si dhe të japë kënaqësi të herëpashershme.

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes sesa është një i ri në gjendje të bëjë zgjedhjen e duhur të profesionit të tij në të ardhmen, gjithmonë në varësi të kushteve social-ekonomike dhe të ndikimit kulturor ku ai është rritur, duhet të marrim në konsideratë disa njohuri të përgjithshme rreth mundësive që ofrojnë profesionet dhe të drejtat për t'i ushtruar ato.

## Edukimi për të patur një karrierë

Procesi për të patur një karrierë nis me kultivimin e aftësive personale që çdo individ mbarbart dhe i zhvillon në vite në përputhje me mjedisin familjar, shkollën dhe komunitetin e biznesit në vendin ku jeton. Përpos këtyre burimeve, mjedisi shoqëror luan një rol kyç duke ndikuar në karakterin personal të çdo të riu dhe shërben më vonë hap pas hapi për të analizuar vlerën e zgjedhjes së një karriere dhe planifikimin e saj.

Modelet familjare janë të parat përfaqesja që të rinjtë kanë lidhur me idetë rreth profesioneve dhe karrierve. Profesionet e prindërve, organizimi i stilit të jetës së tyre në varësi të punës që bëjnë dhe veçanërisht shprehja e dëshirave të tyre për profesionet e ardhshme të fëmijëve, bëhen pa dashur pasqyrat e asaj çfarë të rinjtë do të projektojnë për karrierën. Jo rrallë dëgjojmë, që kur jemi fëmijë dhe më pas gjatë rritjes, fraza të tilla nga prindërit si “doktoresha e mamit”, “piloti i babit”, “arkeologjia e ardhshme” e të tjera si këto.

Sot në rolin e mësuesve dhe të prindërve duke u shprehur shpesh fëmijëve dëshirat apo vlerësimet tona për profesionet e ardhshme që ata/ato mund të zgjedhin, pa dashur kemi filluar t'i formësojmë atyre bindjen e realizimit, modelimit dhe ecurisë së profesioneve të zgjedhura nga vetë ne.

Ndodh shpesh që zgjedhja e kurseve të gjuhëve të huaja, të vallëzimit, pikturës, matematikës, sporteve të ndryshme e të tjera, ku prindërit investojnë privatisht për fëmijët dhe drejtuesit e tyre investojnë dhe mishërojnë njohuritë që kanë, dashur pa dashur i nxit të rinjtë prirje në fusha të caktuara, në të cilat ato mbase nuk arrijnë të gjejnë vetveten. Jo pak rol luajnë edhe mësuesit në ushqyerjen e ambicieve dhe talenteve të fëmijëve, madje disa herë më shumë se prindërit.

Në të gjitha shoqëritë e mbarë botës, profesionet e individëve janë të lidhura ngushtësisht me stereotipat e krijuara gjinore. Historikisht ato kanë qenë të ndara në profesione për meshkuj e për femra. Profesionet që kishin të bënin me vegla pune, automjete, makineri, asocioheshin me natyrën më të ashpër të mashkullit dhe fizikun më të fortë të tij. Inxhinieri, hidrauliku, mekaniku, bojaxhiu, shoferi, piloti, mjeku, avokati, ekonomisti etj., kanë qenë për shumë kohë emërtime profesionale vetëm mashkullore. Ndërsa mësuesja, lulishtarja, edukatorja, rrobaqepësja, sanitarja, infermierja etj., ishin përgjithësisht profesione që u përkisnin femrave, lidhur kjo zgjedhje me natyrën më të ndjeshme dhe përkujdesëse të tyre.

Interesant është fakti, të paktën për Shqipërinë, që profesione si aktore, folëse, këngëtare, balerinë, shkrimtare, poete, piktore dhe të tjera të lidhura me artin vizual e atë të të shkruarit

ishin të pranueshme për të dyja gjinitë, ndonëse femrat që i ushtronin këto profesione shiheshin me një sy tjetër në dallim nga kolegët e tyre meshkuj.

Të flasësh për karrierën e një individi do të thotë të bësh mirë dallimin midis shkollimit të një personi për të marrë njohuritë thelbësore të një profesioni të caktuar dhe investimit të mëtejshëm të tij/saj për ta përvetësuar, zhvilluar e zotëruar mirë këtë profesion. Profesionit më pas, nëse ushtrohet dhe përvetësohet në nivele e drejtime të ndërthurura transformohet në atë që quhet zhvillim karriere. Kjo e fundit është ngushtësisht e lidhur përgjatë gjithë jetës me nxënien e njohurive të reja dhe praktikimin e përditshëm të tyre. Këtu nuk duhet harruar asnjëherë se jo të gjithë individët ushtrojnë në jetë profesionin për të cilin janë arsimuar apo diplomuar. Të njohura janë dhe rastet e profesionistëve të ndryshëm, mjekë, inxhinierë apo pedagogë meshkuj e femra të suksesshëm, të cilët zhvillojnë paralelisht talentet e tyre në sporte apo arte.

Gjithnjë e më shumë pas kalimit nga një ekonomi e centralizuar drejt asaj të tregut të lirë si dhe me zhvillimin e hovshëm të industrisë kompjuterike dhe asaj kimike, fillojnë të krijohen dhe ushtrohen profesione të reja, ndërsa disa prej të vjetrave, fillojnë ta humbasin vlerën duke ia lënë vendin teknologjisë. Këto ndryshime orientojnë universitetet dhe institucionet e tjera arsimore drejt ofrimit të disiplinave të reja, me të cilat formohen më pas breza të tërë profesionistësh të rinj. Bankierët, menaxherët e biznesit, personat e burimeve njerëzore, noterët, inxhinierët e kompjuterave, programistët ekonomistë dhe ato të programeve kompjuterike, dizajnuesit e reklamave televizive e të tjera janë profesione që më parë nuk ishin të njohura, të paktën për realitetin shqiptar të tregut të punës. Në këto pozicione duket se zhvillojnë karrierën e tyre më tepër brezat e rinj, duke qenë se jo vetëm prindërit e tyre, por edhe brezat më pranë tyre, nuk patën as mundësinë dhe as kohën e duhur të merrnin njohuri të tilla dhe aq më pak t'i zhvillonin në mjeshtëri më vete.

Por cilat janë preferencat e të dy gjinive lidhur me këto disiplina të reja? Nga të dhënat e INSTAT -it<sup>58</sup> për vitin 2005, del qartë se raporti femra - meshkuj është i ndryshëm. Kështu në arsimin publik në degët me profil mësuesinë, 85 përqind e numrit të përgjithshëm të studentëve ishin femra, në shkencat mjekësore 71.3 përqind, në shkencat humanitare dhe artet 69.5 përqind. Ndërsa meshkujt zinin 71.5 përqind në fushën e studimeve inxhinierike dhe 76.3 përqind në degët me profil bujqësor dhe veterinar.

Këto të dhëna flasin qartë për preferencat e dallueshme që studentët femra e meshkuj kanë për përvetësimin e profesioneve dhe zgjedhjen e karrierave të tyre. Mjaft i dukshëm është fakti që Fakulteti i Filologji-Historisë, ai i Shkencave Sociale, i Drejtësisë, Fakulteti i Mjekësisë, i Ekonomisë dhe ai i Gjuhëve të Huaja kanë një përqindje të lartë të pjesëmarrjes femërore. Ndërkohë që fakultetet e Inxhinierisë Mekanike, Ndërtimit, Mjedisit apo të Industrisë së Minierave kanë mungesë të dukshme të pranisë femërore, meshkujt mbizotërojnë shumicën e auditorëve. Megjithatë nuk duhet lënë pa përmendur fakti që disiplina të reja si ekonomia informatike po tërheqin gjithnjë e më shumë vëmendjen e studenteve femra.

<sup>58</sup> INSTAT, Meshkuj e femra, Tiranë, 2006.

## Pabarazitë e kapitalit njerëzor dhe të promovimit në tregun e punës

Çfarë ndodh me këto profesione të reja dhe zotëruesit e tyre? Studimet sociologjike të tregut të punës shpesh synojnë të analizojnë diferencat gjinore në politikat e punësimit dhe zhvillimin e karrierës. Këto studime evidentojnë barrierat që gratë dhe vajzat ndeshin në krijimin dhe zhvillimin e një karriere, për shkak të procesit të riprodhimit biologjik dhe social ku shoqëria pret që ato të angazhohen. Koha që femrat shpenzojnë për kryerjen e aktiviteteve përkujdesëse prindërore dhe familjare shpesh e bën moshën dhe statusin e tyre social, barrierë në procesin e rekrutimit nga punëdhënës të ndryshëm. Në këtë mënyrë jo rrallë ndodh që proceset progresive të karrierave si të meshkujve ashtu dhe të femrave shihen si rrjedhoja të vendimeve të punëdhënësve brenda sistemeve strukturore të organizimit institucional të tyre.

*Sistemet strukturore* u referohen niveleve të ndryshme të organizimit, si punët, pozicionet, tregu i punës në tërësi, si dhe organizatave apo institucioneve ku një individ punon. Niveli organizativ i institucioneve të ndryshme, shtetërore edhe private, po fiton gjithnjë e më tepër vëmendje, duke qenë se organizimi është vendi i duhur ku marrin trajta dinamikat e karrierave dhe pabarazitë e vazhdueshme në vendin e punës<sup>59</sup>.

Teoricienët e kapitalit njerëzor shtrojnë disa argumente rreth shkaqeve të diskriminimit gjinor në promovimin drejt progresit në karrierë:

- Një prej këtyre argumenteve është se diferencimet gjinore në shkallët e promovimit bëhen për shkak të diferencave gjinore në angazhimin në punë, arsimim si dhe në krijimin e përvojës. Mendohet se gratë angazhohen më tepër me familjen duke lënë kështu mënjanë zhvillimin e karrierës së tyre.
- Dallimet në arsimim gjithashtu shkojnë në llogari të promovimeve. Në Shqipëri kjo vihet re më tepër në arsimin e lartë, ku sipas të dhënave të INSTAT-it për 2003, 227 meshkuj mbanin titullin "Profesor", përkundrajt 22 femrave, ndërkohë që për 2006 shifrat janë 267 meshkuj dhe 43 femra. Marrja e një titulli më shumë ofron një nivel më të lartë pagese dhe më pak angazhim të drejtpërdrejtë në auditore, më pak ngarkesë mësimore. Duket qartë se edhe në universitete, ku numri i punonjësve femra është mjaft i lartë, meshkujt mbeten më të mirëpërfaqësuar aty ku të ardhurat mujore janë më të larta.
- Gratë marrin më pak trajnime dhe kanë më pak vite përvojë brenda kompanive të ndryshme. Kjo bën që përfaqësimi i tyre në nivele menaxheriale dhe drejtuese të jetë më i ulët se ai i burrave.

Këtu duket se bëjnë përjashtim sistemet bankare, ku përgjithësisht ka më tepër gra e vajza të punësuar. Për më tepër, duke qenë se departamentet trajnuese të kapitalit njerëzor luajnë një rol tepër aktiv dhe motivues në investimin për stafin e tyre, vajzat dhe gratë e

<sup>59</sup> Hansen, J. *Shaping Careers of Men and Women in Organizational Contexts*. Universal Press, Veenendaal, 2005.

reja kanë patur mundësinë dhe kanë ecur përpara pavarësisht impenjimeve familjare. Vlen të përmendet Banka *Pro Credit*, stafi drejtues i së cilës përbëhet nga 15 vetë, 4 janë meshkuj dhe 11 janë femra.

Në administratën publike shqiptare, përsa i përket pozicioneve drejtuese një model të promovimit gjinor sjell Bashkia e Tiranës, ku ndër 16 drejtorë drejtorie, 11 janë femra dhe 5 janë meshkuj.

- Punëdhënësit i shpërblejnë kualifikimet e meshkujve më shumë se ato të femrave. Besohet se niveli i lartë i menaxhimit është një mjedis mashkullor dhe shumë burra ndihen jo komodë me praninë e femrave në domenin që e quajnë vetëm të tyrin. Punëdhënësit, por shpesh edhe vetë punëmarrësit në nivele menaxheriale i stereotipizojnë gratë si të painteresuara për t'u zhvilluar ose mundohen t'i veshin mungesë atributesh për poste të larta.

Një teoriciene e diskriminimit segregativ në punë dhe promovim e lidh këtë dallim edhe me mungesën e politikave të vlerësimit të performancës në një institucion, ku drejtuesit vetë nuk janë të qartë rreth kualifikimeve apo përvojës që do t'i duhej një personi për të zënë poste menaxheriale. Duke mos patur të tilla politika apo duke i menaxhuar jo mirë ato, këta drejtues zgjedhin për promovim persona të njëjtë me seksin e tyre, që i përkasin të njëjtës klasë shoqërore, që frekuentojnë të njëjtin mjedis, kanë kryer të njëjtin fakultet ose që kanë të njëjtat interesa kulturore apo sportive. Ata mendojnë se punonjësit e ngjashëm me ta do të marrin të njëjtat vendime dhe do të performojnë njësoj dhe po aq mirë sa dhe ata vetë.

Le të marrim në Shqipëri shembullin e sektorit të administratës publike, ku sipas të dhënave të INSTAT-it për 2006, rezulton se ajo përbëhej nga 43.3% femra dhe 56.7% meshkuj. Nga këta 28.5% ishin femra ligjvënëse, nëpunëse të larta dhe drejtuese, përkundrajt 71.5% meshkuj. Ndërkohë femrat zinin përqindjen më të lartë në pozicionet e nëpunësive të thjeshta, 56.3% kundrejt 43.7% që zinin meshkujt. Është tashmë e njohur se pozicionet e larta shoqërohen me vlerësime më të larta financiare dhe paketa të ndryshme shpërblimesh sociale e morale.

### **Ideologjia gjinore që pengon zhvillimin e karrierës femërore**

Të gjitha shoqëritë kanë ideologjitë e tyre, krijojnë dhe ruajnë të njëjtat besime rreth grupeve sociale, punësimit të tyre apo të ardhurave të përfutuara.

Në shoqëritë maskiliste tre komponentë të ideologjisë gjinore kontribuojnë në atë që quhet diskriminim gjinor në tregun e punës, i cili shfaqet në segregrimin pozicional të strukturave institucionale dhe organizative, hendekun e pagave veçanërisht në sektorin privat si dhe në politikat e rekrutimit, promovuese dhe mbrojtëse.

Këta komponentë janë:

1. supozimi që burrat kanë nevojë për të ardhura më të larta se gratë, bindje dhe besim i kultivuar prej shumë e shumë vitesh, bazuar në idenë se burri është kryefamiljari dhe përgjegjësi kryesor për burimin e të mirave materiale në çdo familje;
2. besimi në varësinë e gruas, mbështetur kjo në nivelin e lartë të papunësisë të grave në tregun e punës, femininizimin e varfërisë, gjë që i bën më pas të krijojnë varësi financiare nga partnerët e tyre;
3. mosvlerësimi i punës së grave, bazuar në faktin që shteti por edhe shoqëria nënvlerëson riprodhimin biologjik e social të grave, duke e konsideruar lindjen, rritjen dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve, të moshuarve dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes si dhe mjedisit shtëpiak, detyra të thjeshta e gjëra grash.

Gërshetimi i të tre këtyre komponentëve të ideologjisë gjinore bëhet një pengesë shumë e madhe për hyrjen e grave në tregun e punës dhe promovimin e karrierave të tyre.

### Të drejtat për edukim e zhvillim karriere

Sot çdo individ ka të drejta arsimore dhe të drejta punësimi, për t'u shkolluar, kualifikuar dhe për të zhvilluar karrierën.

### Paketa ligjore ndërkombëtare

- **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ)**

Në nenet 22-27 të kësaj deklaratë flitet për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, ndërmjet të cilave përfshihet dhe e drejta për punë, sigurim social, për pagë të barabartë për punë të barabartë, e drejta për t'u arsimuar dhe e drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore të komunitetit.

- **Platforma për Veprim e Pekinit**

U hartua dhe u miratua në Konferencën e IV Botërore për Gratë, të Kombeve të Bashkuara, më 1995. Ndër çështjet më kryesore që ajo ngriti ishin pabarazitë në të drejtën për t'u arsimuar dhe kualifikuar dhe pabarazitë në strukturat dhe politikat ekonomike të të gjitha mënyrave të prodhimit ekonomik dhe mundësitë e përdorimit të burimeve nga gratë.

- **Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)**

Në nenin 10, të kësaj konvente thuhet se "...të gjitha shtetet duhet të marrin masat e nevojshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në mënyrë që t'u sigurojnë atyre të drejta të barabarta me burrat në fushën e arsimit dhe në veçanti të sigurojnë mbi bazën e barazisë midis burrit e gruas:



a) të njëjtat kushte për të bërë karrierë dhe kualifikim profesional, për të frekuentuar shkollat dhe për t'u diplomuar në institucionet arsimore të të gjitha kategorive...b) [...]

c) eliminimin e çdo koncepti stereotip për rolin e burrit dhe të gruas në të gjitha nivelet dhe në të gjitha format e arsimit, duke inkurajuar bashkë me arsimin dhe lloje të tjera edukimi që ndihmojnë në arritjen e këtij qëllimi, e sidomos duke rishikuar tekstet dhe programet mësimore...”

Neni 11 përcakton masat që duhet të merren për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në fushën e punësimit në mënyrë që shteti të sigurojë mbi bazën e barazisë midis grave dhe burrave të drejta të njëjta dhe sidomos:

- a) të drejtën për punë si e një e drejtë e pamohueshme e të gjithë qenieve njerëzore;
- b) të drejtën për mundësi të njëjta punësimi, duke përfshirë zbatimin e kriterëve të njëjta të përzgjedhjes lidhur me çështjet e punësimit;
- c) të drejtën për të zgjedhur lirisht vetë profesionin dhe vendin e punës, të drejtën për t'u promovuar në detyrë, për siguri në punë dhe për të gjithë përfitimet dhe kushtet e punës, të drejtën për të përfituar trajnime profesionale dhe për kualifikim të herëpashershëm.

- **Platforma udhëzuese e BE për barazinë ndërmjet grave e burrave (2006-2010)**

Kjo platformë përcakton gjashtë fusha parësore veprimi për arritjen e barazisë gjinore, ku për zhvillimin e karrierës më kryesore janë:

- Eliminimi i stereotipave gjinorë në shoqëri, ku ndër të tjera bëjnë pjesë: arsimit, kualifikimi, kultura dhe tregu i punës;
- Arritja e pavarësisë ekonomike si për gratë dhe për burrat, për realizimin e së cilës hapat më të rëndësishëm janë: arritja e objektivave të punësimit të përcaktuar në Lisbonë; eliminimi i hendekut gjinor në pagesë; gratë sipërmarrëse; barazia gjinore në përkrahjen sociale dhe lufta ndaj varfërisë.

## **Paketa ligjore e Republikës së Shqipërisë**

- Në **Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (1998)**, në nenin 18 të saj, përcaktohet se “të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale”.
- Në ligjin **“Për barazinë gjinore në Shqipëri”** (nr. 9970, dt. 24.07.2008), në pjesën e 5-të adresohet trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi për shkak të gjinisë në arsim dhe kualifikim. Neni 25/1 i këtij ligji thotë që “...subjektet që ofrojnë arsimim, kualifikim e trajnim si dhe ata që formulojnë tekstet, programet dhe materialet e tjera mësimore, në të gjitha nivelet, sigurojnë mësimdhënien e

njohurive të nevojshme dhe përdorin metoda mësimdhënieje, trajnimi e kualifikimi, në mënyrë të tillë që të ndihmojnë në promovimin, nxitjen dhe formimin e edukatës së barazisë dhe në ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, të stereotipave negativë, paragjykimeve dhe praktikave zakonore ose të çdo lloji tjetër, që çenojnë parimet e barazisë gjinore”.

- **Kodi i Punës (2003)**, njeh të drejta të barabarta punësimi si për burrat dhe për gratë. Të drejta të barabarta gëzohen gjithashtu edhe për sa i përket mbrojtjes në vendin e punës, pagesës së barabartë për punë të barabartë. Ky kod nxit materialisht punëdhënësit për marrjen në punë të punëkërkueseve gra dhe vajza.
- Institucionet shtetërore shqiptare në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe organizmat ndërkombëtare që veprojnë në mbështetje të politikave gjinore kanë hartuar tashmë **Strategjinë kombëtare për barazinë gjinore dhe kundër dhunës në familje (2007-2010)**. Fushat prioritare për zhvillimin e karrierës në këtë strategji janë përcaktuar:
  - Arsimi dhe zbutja/eliminimi i stereotipave gjinorë të transmetuara nëpërmjet tij dhe fuqizimi ekonomik si një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore.

Veprimet që duhen ndërmarrë lidhur me fuqizimin ekonomik janë :

- Ndërtimi i një sistemi të ri informacioni në nivel qendror e vendor me qëllim sigurimin e aksesit [...] të marrjes së informacionit publik mbi të drejtën për punësim, informacion mbi tregun e punës, aksesin ndaj arsimit dhe formimit profesional...

Ndër veprimet më kryesore të lidhura me eliminimin e stereotipave gjinorë në arsim janë përcaktuar :

- Përmirësimi dhe rishikimi në mënyrë të vazhdueshme i programeve dhe teksteve mësimore për mënjanimin e stereotipave gjinorë.
- Përgatitja e moduleve të trajnimit të mësuesve ku të integrohet gjinia si temë specifike dhe përfshihet dialogu prind-mësues.

Në kuadrin e arsimit, si një nga prioritetet më të rëndësishme të programit të qeverisë për vitet e ardhshme, një vend të veçantë zë zhvillimi i mëtejshëm dhe konsolidimi i arsimit profesional (AP), i cili synon, mes të tjerash, inkurajimin e përvetësimit të njohurive të reja, afrimin e shkollës me botën e punës, luftën kundër përjashtimit të të rinjve nga pjesëmarrja në jetën ekonomike dhe sociale të vendit, mësimin gjatë gjithë jetës si dhe krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë.

## TË DHËNA DHE FAKTE: ARSIMI DHE PUNA NË SHQIPËRI

### Arsimi

Në fushën e arsimit tendenca e pjesëmarrjes së studentëve meshkuj e femra vazhdon të jetë e njëjtë me atë të viteve të mëparshme. Kështu nga të dhënat e INSTAT-it për 2006 rezulton se femrat në arsimin e lartë zinin 58.4 përqind të numrit të përgjithshëm të studentëve.

Po ashtu në arsimin e mesëm është rritur në favor të grave, përqindja e atyre që morën dëftesë pjekurie. Ndonëse të regjistruarat në vitin e parë përbënin 45 përqind të numrit të përgjithshëm të të regjistruarve, në përfundim gratë përbënin 54 përqind. Rënia e përqindjes së burrave që marrin diplomë pjekurie shpjegohet dhe me shkallën e varfërisë ekonomike, e cila bën që një pjesë e tyre të futen herët në tregun e punës ose të zgjedhin emigrimin.

Tendencë tjetër që vihet re është se në arsimin e mesëm profesional janë burrat ata që mbizotërojnë me 63 përqind në 2006, por me 3% më pak nga numri i të regjistruarve vitin e mëparshëm, diferencë e cila tregon se edhe gratë po preferojnë të ndjekin arsimin profesional. Po kështu në vitin 2006 përfunduan arsimin 8 vjeçar (sot 9 vjeçar) më shumë burra se gra me një raport prej 51.3 përqind me 48.7 përqind.

Problematike mbetet pjesëmarrja e grave në shkolla në zonën rurale të vendit, ku jo të gjitha vajzat vazhdojnë shkollën pasi përfundojnë arsimin e detyrueshëm. Mësueset gra zënë 66 përqind të stafit mësimdhënës në arsimin 9 vjeçar dhe 58 përqind në arsimin e mesëm. Në arsimin e lartë përqindja e grave në stafin efektiv mësimdhënës rritet nga viti në vit duke zënë 45 përqind nga 38 përqind në vitin 2000.

## Punësimi

Të punësuarit gjithsej për vitin 2006 zinin 48.8 përqind të popullsisë në moshë pune. Gjatë këtij viti kanë qenë të punësuar 935 mijë persona, nga të cilët 578 mijë burra dhe 357 mijë gra. Analiza e nivelit të punësimit sipas gjinisë në vite, tregon se gjatë periudhës 1996-2006 niveli i punësimit të grave ka qenë dukshëm më i ulët se ai i burrave.

Por ndërsa diferenca gra - burra ishte më e ulët deri në vitin 1996, për shkak se numri i të punësuarve në sektorin shtetëror ishte ende i lartë dhe femrat e punësuarat në të zinin një përqindje të konsiderueshme, diferenca vjen e rritet mbas vitit 1996, si pasojë e zvogëlimit të sektorit shtetëror dhe rritjes së numrit të të punësuarve në sektorin privat jobujqësor, ku burrat zënë peshën më të madhe. Kjo diferencë vazhdon të ruhet dhe mbetet pothuajse në të njëjtat nivele. Kështu niveli i punësimit të burrave për vitin 2006 ishte 58.8 përqind ndërsa për gratë vetëm 38.2 përqind.

Diferenca gra - burra vihet re edhe në pjesëmarrjen në nivele të ndryshme të administratës publike qendrore dhe vendore. Gratë zënë 39.3 përqind të të punësuarve në ministri dhe në institucione të tjera të larta shtetërore. Ndërsa në administratën vendore përqindja që zenë gratë është më e ulët, vetëm 31.6 përqind. Kjo pjesëmarrje është disi më e lartë në bashkitë kryesore, ku gratë zënë 45.4 përqind të të punësuarve në këto institucione. Ndërsa në komuna, pjesëmarrja e grave është vetëm 21.9 përqind dhe në administratën e prefekturave 24.3 përqind.

Për 27 vendet e BE-së niveli i punësimit në vitin 2007 për gratë e moshës nga 15 deri në 64 vjeç ishte 58.8 përqind, pjesëmarrje e ulët nëse krahasohet me pjesëmarrjen prej 73,2 përqind të burrave në tregun e punës. Vetëm rreth një e treta e totalit të personave të punësuar si menaxherë janë gra. Në po këto 27 vende anëtare të BE-së, hendeku i pagave

të grave nga ato të burrave vlerësohet në nivelin e 15 përqindshit, ndërsa e vlerësuar vetëm për sektorin privat kjo diferencë mund të arrijë deri në 25 përqind.

Progresi i përshtirjes së grave në shoqërinë europiane ka kulmuar në fushën e gjyqësorit ku gratë kanë pjesëmarrje të barabartë, madje në disa vende kanë edhe epërsi kundrejt burrave. Të tilla janë rastet e Bullgarisë me afro 76 përqind gra dhe të Rumanisë me 74 përqind në gjykatat e larta, ndërkohë që edhe gjykatëset në Hungari dhe Letoni kanë tejkaluar gjykatësit duke përbërë respektivisht 60 përqind dhe 58 përqind të numrit të përgjithshëm.

## Papunësia

Në Shqipëri, në fund të vitit 2005 numëroheshin rreth 150 mijë të papunë të regjistruar, nga të cilët mbi 11 mijë përfitonin trajtim me pagesë papunësie. Gjatë periudhës 1996-2006 vihet re një nivel më i lartë i papunësisë të gratë krahasuar me burrat. Shkalla e papunësisë në nivel vendi në fund të vitit 2006 ishte 13.8 përqind. Ky tregues paraqitet më i lartë te gratë, me 16.8 përqind kundrejt 11.8 përqind te burrat. Gjithashtu treguesi është më i lartë për grupmoshat e reja.

Në grupin e të papunëve të regjistruar, analiza sipas gjinisë tregon se gratë përbëjnë 48.2 përqind; kjo nuk shpreh nivelin e papunësisë, por faktin që gratë janë më pak të interesuara dhe të shkurajvara të regjistrohen për të kërkuar punë duke parë mundësitë e pakta që ato kanë në tregun e punës.

## Studime rasti

I ndani nxënësit/nxënëset në grupe prej 5 vetësh dhe udhëzoni të diskutojnë dhe të parashtrajnë analizat që ato/ata i bëjnë situatave të dhëna. Mundohuni të mos e orientoni përgjigjen e tyre teksa u drejtoni pyetjet.

## Rasti i parë

*Pasi të jeni njohur me situatën e krijuar, lutemi argumentoni ku dhe përse mendoni ju ka diskriminim gjinor dhe nëse ky diskriminim është pozitiv ose jo ?*

Një nga shkollat e mesme të përgjithshme të Tiranës ka bërë marrëveshje me University College Utrecht të dërgojë me bursë të paguar 4 vjeçare studentin/en më të mirë të vitit të fundit. Për përzgjedhjen e këtij/saj nxënësi/e do të përcaktohen kritere standarde për të parë se cili/cila prej tyre ka dosjen më të kompletuar. Për të dy nxënësit, si për djalin ashtu edhe për vajzën vlerësimi rezultoi maksimal. Të dy zotëronin mirë gjuhën

angleze dhe atë italiane, të dy kishin hartuar letra motivimi me objektiva shumë të qarta, por e drejta për këtë bursë iu dha vajzës. Sigurisht që ajo mbeti e kënaqur, por jo aq sa djali të cilit iu akordua një bursë 4 vjeçare për në Londër, ku ai do të ndiqte studimet në inxhinieri kompjuterike, një degë kjo e hapur vitet e fundit. Të gjithë menduan se kështu të dy mbetën të kënaqur nga shanset e ofruara, por vajza jo. Prej kohësh ajo kishte kërkuar informacion për ekzistencën e mundësive të tilla për të ndjekur studimet në shkencat kompjuterike, veçanërisht në degën që iu dha djalit, por nga drejtuesit ajo kishte marrë përgjigje negative.

*Duke menduar që secili prej tyre do të nisë rrugën drejt formimit të karrierës profesionale të ardhshme, ku mendoni ju ka patur shfaqje diskriminuese nga ana e drejtuesve të shkollës dhe përse?*

Të diskutojmë së bashku se cilët nga profesionet e mëposhtme mendoni janë më të preferuar nga të dyja gjinitë dhe përse? Diskutojini me njëri-tjetrin, me mësuesit/set por edhe me prindërit dhe jepni reagimin e tyre pas pyetjeve tuaja: sa do të më mbështesnit nëse do të zgjidhja të studioja në këtë disiplinë apo të merrja këtë profesion? Lutemi listojni profesionet sipas rëndësisë që ju i jepni secilit.

1. Infermieri dhe shërbime mjekësore e sociale
2. Shkencat kompjuterike e inxhinierike
3. Akademia
4. Punët e gjelbërta në mbrojtje të mjedisit
5. Këshilltar/e financash
6. Menaxher shitjesh
7. Epidemiolog

*Pasi të keni diskutuar profesionet e mësipërme kërkonin nga nxënësit të listojnë të tjera sipas preferencave të tyre.*

## Rasti i tretë

Në shkollën ku ju jepni mësim largohet nga posti drejtori për arsye personale. Vendi i tij mbetet vakant. Njoftoheni se Drejtoria Arsimore e Qarkut tuaj ka hapur një procedurë aplikimi konkurruese për këtë vend. Bazuar në përvojën tuaj personale prej 20 vitesh mësuese në këtë shkollë si dhe trajnimet kualifikuese që keni bërë, aktivitetet shkollore e jashtëshkollore që organizoni me nxënësit dhe të tjera cilësi pozitive, ju mendoni se jeni ju, mësuesja më e kualifikuar për këtë vend. Por të njëjtën gjë si ju mendon dhe kolegu juaj. Të gjithë kolegët ju mbështesin si ju ashtu dhe konkurrentin tuaj, por në fund vendin e fiton ai.

Nga burime të brendshme të Drejtorisë Arsimore ju është thënë si arsye për rrëzimin e aplikimit tuaj, se lënda e informatikës që kolegu juaj zhvillon është më e rëndësishme

sesa frëngjishtja juaj dhe se ai në motivimin personal ka shprehur se do të krijojë struktura të reja institucionale për të përthithur fonde për ngritjen e rrjetit të kompjuterizimit në të gjithë shkollën.

Ju ndërkohë jeni mësuese e gjuhës frënge dhe përveç transmetimit të njohurive të kësaj gjuhe te nxënësit tuaj dhe organizimit të aktiviteteve letraro-artistike të shkollës, jeni shprehur në motivimin tuaj personal se do të krijoni mundësi për binjakëzimin e shkollës tuaj me një shkollë franceze për të vendosur marrëdhënie dypalëshe dhe për të shkëmbyer përvoja disa ditëshe të nxënësve shqiptarë me ata francezë.

*Ju nuk e pranoni vendimin e Drejtorisë Arsimore, sepse kolegu juaj nuk ka shumë përvojë, ka më pak vite pune dhe nuk merr pjesë në gjallërimin e jetës kulturore dhe sportive, si dhe në aktivitetet e tjera jashtëshkollore me nxënësit.*

## Rasti i katërt

Le të trajtojmë rastin e dy të punësuarve: Arturit dhe Blerinës. I pari ka mbaruar shkollën e mesme profesionale për administrim publik, ndërsa e dyta ka mbaruar universitetin në degën e ekonomisë. Më 1991 Arturi pas përfundimit të arsimit profesional fillon punë si punonjës i thjeshtë në bashkinë e qytetit, ndërsa Blerina fillon punën si asistente financiare në një firmë konsulente biznesi, në një mjedis tepër maskulist të rekrutimit të punonjësve. Më 1994 Arturi bëhet baba, status i cili nuk e ndryshoi aspak punësimin e tij me kohë të plotë, por po atë vit ai promovohet në detyrë duke u bërë zyrtar i lartë. Një vit më vonë në 1995 Blerina bëhet financiare dhe në fillim të 96-s ajo bëhet edhe nënë. Pas katër muajve të lejes së lindjes ajo rikthehet në punë dhe fillon të punojë me katër ditë në javë në vend të pesë që punonte më parë. Në 2001, dhjetë vjet pas futjes së tyre në tregun e punës, ndërsa të dy vazhdojnë të punojnë për të njëjtin punëdhënës, Arturi është promovuar në shef departamenti (1999), ndërsa Blerina nuk ka patur asnjë promovim tjetër përveç atij të parit.

*Si mendoni ju, funksionojnë politikat e promovimit të punonjësve në të dy këto organizata dhe a mendoni ju se ka diskriminim gjinor? Si do të vepronit ju po të ishit në vend të Blerinës? Po të ishit në vendin e Arturit, a do ta merrnit ju lejen prindërore? Dhe pse?*

## Rasti i pestë

Kompania, për t'i bërë pasagjerët të ndiheshin mirë me Delta Airline, vendosi rregulla për mosshfaqjen e emocioneve negative nga ana e stjuardesave, rënien në peshë të tyre si dhe kode të reja të veshjes e paraqitjes së jashtme. Meshkujt ishin të përjashtuar nga këto rregulla. Delta u siguroi trajnime intensive stjuardesave për të kontrolluar dhe fshehur emocionet negative kundrejt pasagjerëve. Trajneret u mësuan stjuardesave se duhet ta shndërronin zemërimin me pasagjerin/en në empati ndaj tij, se duhet ta

trajtonin atë me buzëqeshje e vetëm buzëqeshje sikur të ishte miku, mikja apo fëmija i tyre. Në një prej trajnimeve atyre iu drejtua pyetja: “Çfarë mendoni se po shisni?” Njëra nga ato u përgjigj : “Po sheshim Deltën...” . “Jo - ishte përgjigja e trajneres - po shisni veten”.

*Çfarë mendoni rreth mjediseve të punës me kahje gjinore, p.sh. aty ku ka vetëm meshkuj apo vetëm femra? Si i mendoni rregullat e reja të Deltës në lidhje me vetë kompaninë, po me vetë personelin? Nëse i tërë personeli do të ishte i përbërë nga stuartë meshkuj mendoni se do të ishin vendosur të njëjtat rregulla, duke qenë se meshkujt këtë herë ishin të përjashtuar nga disa prej rregullave?*

## Rasti i gjashtë

Shumë gra e dinë që për t’u rritur në detyrë në sistemin e ri duhet të pushojnë së qeni “të këndshme”, sikurse janë mësuar të jenë (të sjellurit me femnilitet dhe edukatë), dhe të fillojnë të mendojnë në mënyrë të re. Shumë gra filluan të punojnë me këtë pjesë të softit mendor që disa vite më parë. U vu re progres i konsiderueshëm, por ka ende qoshe të fshehura, sjellje të pайдentifikuar që vijnë nga softveri që kemi lënë mënjanë. Në shumë intervista me drejtues të ndryshëm rezulton se për gratë pohohet se: “punojnë më shumë, nuk kërkojnë ofiqe të veçanta si burrat, si për shembull zyra të mëdha, makina të paguara e të tjera, nuk presin promovime të mëdha... kjo i bën ato të jenë punonjëse më të mira se meshkujt sot”.

*A nuk ju duket kjo sjellje si prej një vajze të mirë, të përpiqesh me zell të provosh vlerën tënde? Asnjëherë nuk është keq të performosh shkëlqyeshëm në punë, por mbase kjo nuk është e vetmja strategji e mirë për situatën e gruas sot. Si mendoni ju?*

## Metodologjia

**Metodologjia e zhvillimit të kurrikulës** do të jetë ndëraktive. Nxënësit/nxënëset do të trajtohen si bashkëbisedues/e dhe do të aktivizohen gjatë prezantimit të të gjitha çështjeve. Disa parime teorike mund të jepen për 20 minuta dhe më pas të organizohen luajtje rolesh, studime rasti apo biseda në grupe për të nxitur debatin dhe frymën analitike përsa i përket stereotipave gjinorë në arsim e punësim.

## Përmbledhje

Roli i mjedisit familjar në stereotipizimin e talenteve femërore e mashkullore apo adresimi i profesioneve të fëmijëve meshkuj e femra të përcaktuar nga vullneti i prindërve, është një nga identifikuesit kryesorë dhe ushqyesit e karrierave formuese të të rinjve. Modelet e prindërve, mësuesve, kolegëve apo rrethit social që të rinjtë frekuentojnë, janë pika referimi kryesore ku mund të përlligjet ndikimi i zgjedhjeve të karrierës me vullnetin e të tretëve.

Jo domosdoshmërisht orientimet familjare përbëjnë probleme për karrierën me ndarje gjinore të rinjve meshkuj e femra, por shoqëria shqiptare ka tregues të matshëm po t'i referohemi brezave të mëparshëm. Nëse të rinjtë/rejat lihen të lirë të analizojnë vetiu e të zgjedhin fushën ku ndihen më të realizuar edhe investimi i prindërve e zhvillimi i karrierës do të ishte më i frytshëm. Profesionet janë njerëzore e nuk duhet të bartin markimin e notës gjinore.

Mësuesit/set duhet të jenë më vigjilentë e të stimulojnë vazhdimisht vajzat që shfaqin aftësi e talente në ato degë të cilësuar historikisht si mashkullore, por njëkohësisht dhe meshkujt duhen nxitur të kultivojnë aftësitë në shkencat komunikative. Fizika, matematika, informatika, letërsia, sociologjia dhe filozofia janë të tëra disiplina njerëzore dhe aksesit për t'u informuar mbi to është i njëjtë, si për meshkujt ashtu dhe për femrat. Organizimi i olimpiadave, dhënia e bursave, ndjekja e kurseve private lidhur me këto disiplina etj. nuk përbëjnë dallim gjinor në vetvete, ndaj diskriminimi i ndonjërit prej sekseve në asnjë rast nuk është i përligjur.

Politikat e punësimit në të gjitha strukturat shtetërore e private po shkojnë drejt respektimit të të drejtave të barabarta e mosdiskriminimit rekrutues me bazë gjinie. Po kështu zhvillimi i karrierës nuk duhet të shihet më si ambicie mashkullore për arsye të mosangazhimit në përkujdesjen familjare dhe sociale të meshkujve.

Femrat e punësuar kanë po aq ambicie për t'u bërë profesioniste, për t'u trajnuar, rritur në përgjegjësi dhe marrë përsipër drejtim organizativ. Të qëniet nënë apo vajzë nuk ka përse të lidhet me mungesë interesi apo besim rreth shpenzimeve më të pakta mujore. Kryefamiljarët janë të dy gjinive dhe nevojat për shpenzime i kanë po të njëjta. Sigurimi i të mirave materiale bëhet si nga mashkulli ashtu edhe nga femra dhe po kështu duhet të merret përsipër edhe përkujdesja dhe riprodhimi social në sferën private. Pasuria intelektuale e të dy gjinive shkon përpos zhvillimit të karrierave të tyre. Barrierat gjinore ekzistuese pengojnë zhvillimin institucional dhe ekonomik të institucioneve e kompanive të ndryshme. Kjo reflektohet dhe në një zhvillim të ngadalshëm të ekonomisë së një vendi nëse barrierat gjinore në poste menaxheriale dhe politikat promovuese do të vazhdojnë të jenë pjesë e pandarë e politikave të punësimit.



## Përkatësia gjinore dhe mjedisi

### Hyrje

Kapitulli në vijim do të trajtojë një ndër çështjet më të zëshme të dhjetëvjeçarëve të fundit: ndikimin tonë në mjedis dhe nevojën për mirëpërdorimin e tij. Ai do të paraqesë të dhëna dhe opinione rreth ndikimit dhe përpjekjeve të ndryshme të burrave dhe grave në jetën e përditshme brenda familjes dhe në shoqëri. Si një prej sfidave të sotme të njerëzimit, mbrojtja e mjedisit ka një trajtim të gjerë dhe të shumanshëm në kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe shqiptar. Por trajtimi i tij me këndvështrim të qartë gjinor është ende në fillesat e veta.

Mjedisi është burimi i të mirave materiale, vend jetese, mësimi dhe pushimi për burrat dhe gratë, vajzat dhe djemtë. Shoqëria njerëzore gjithmonë ka pasur dhe do të ketë nevojë për bazën ushqyese të jetës: mjedisin. Me rritjen e mirëqenies, ne tentojmë të konsumojmë më shumë burime mjedisi. Ndërkohë vetëm në dy-tre shekujt e fundit, numri i njerëzve në planetin tonë është rritur përtej parashikimeve<sup>60</sup>. Këto fakte kanë nxitur debate të shumta, jo vetëm mes studiuesve, rreth faktit sesa larg është dita kur Toka të ketë arritur kufirin mbajtës maksimal<sup>61</sup> të saj.

Për shumë vite, trajtimi i problemeve mjedisore është bërë duke mos ju referuar qartazi shkaktarit parësor të tyre: njeriut. Tashmë kjo situatë mund të quhet e kaluar! Shtimi i mbetjeve në qytete, buzë lumenjve apo në plazhet tona, ndotja e ujit të pijshëm apo ngrohja e klimës janë mirëpranuar si pasoja të aktivitetit të papërgjegjshëm njerëzor. Por a mjafton vetëm kaq?

Emërtimi “njerëz” ose “banorë” mbetet shumë i pafokusuar, gati i njëjtë me mospërmendjen e tyre. Gratë dhe burrat kanë ndikime të ndryshme në mjedis. Për më tepër, ata e përdorin dhe përfitojnë në mënyrë të ndryshme prej tij. Në kushtet e kufizimit të burimeve natyrore

<sup>60</sup> Nga viti 1950 deri në 2000 popullsia e botës u rrit nga 2.5 në 6.1 miliardë njerëz. Vlerësohet se në 2025 ajo do të arrijë në rreth 9 miliardë dhe në 2050 në 10 -11 miliardë njerëz.

<sup>61</sup> Kapaciteti i mjedisit llogaritet me numrin e njerëzve që mund të mbajë një sipërfaqe e caktuar mjedisi në kushtet e përshtatshme për jetesë, pa cënuar ekuilibrat natyrore dhe të ardhmen e ekosistemeve.

si për shembull burime të caktuara të ushqimit, ujit, karburanteve, sipërfaqeve të punës apo të banimit, ata që mund të preken më shumë janë gratë dhe fëmijët. Varfëria mbetet kërcënimi kryesor për jetën në shumë prej vendeve në zhvillim<sup>62</sup>. Njëkohësisht ajo nxit dhe përshpejton degradimin e mjedisit. Ndaj trajtimi nga këndvështrimi i përkatësisë gjinore do të përmirësojë jo vetëm njohjen tonë mbi shkallën dhe ndikimin e problemeve mjedisore, por do të ndihmojë edhe për marrjen e vendimeve më të drejta sociale, ekonomike dhe mjedisore, për të tashmen dhe të ardhmen.

Në cilat aspekte të aktivitetit të punës, atë familjar dhe shoqëror mund të luajnë rol pozitiv për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, më shumë gratë? Më shumë burrat? Ditë pas dite, çdonjëri prej nesh përballet me përplasje qëndrimesh dhe dilema: shpeshherë shumë individualiste (shtëpia ime, makina ime, rehatia ime) dhe më rrallë idealiste (ndryshimi i botës dhe i shoqërisë mund të fillojë edhe nga unë!). Djemtë dhe vajzat, përmes shkollës dhe mundësive të shumta të komunikimit elektronik, priren të përkrahin më lehtë qëndrimet e reja pro mjedisit, duke i shtuar më shumë vlerë jetës së tyre dhe shoqërisë shqiptare. A është kjo e vërtetë? Çfarë mund të mësojmë prej prindërve tanë? A mund t'u «rikujtojmë» atyre jetën më pak konsumatore: më pak amballazh, më shumë riciklim, më shumë pastërti dhe pak burime mjedisi të konsumuara pakthyesmërisht?

Ky është vetëm njëri prej aspekteve ku gratë dhe burrat, si prindër dhe mësues të mirë, mund të fillojnë edukimin e vajzave dhe djemve brenda familjes që në fëmijërinë e hershme. Nëse kjo ndodh, edhe shkolla dhe shoqëria do ta kenë më të lehtë për të vepruar e jetuar më “gjelbër” dhe më denjësisht.

## Objektiva

Në fund të kësaj çështjeje, nxënësi/nxënësjat duhet të jetë i/e aftë të:

- Identifikojë rolin e ndryshëm të mjedisit dhe përdorimin e tij për gratë dhe burrat.
- Identifikojë dokumentet ndërkombëtare dhe kombëtare që japin të drejtat dhe detyrimet në përdorimin e burimeve të mjedisit.
- Rendisë shkaqet dhe veprimtaritë që dëmtojnë mjedisin prej grave dhe burrave, bazuar në rolet e ndryshme gjinore të tyre në familje dhe shoqëri.
- Rendisë rrugët për mbrojtjen dhe ripërtëritjen e mjedisit në komunitetin ku jeton me detyra konkrete për vajzat dhe djemtë, burrat dhe gratë.
- Diskutojë dhe argumentojë mbi konceptet kyç si: zhvillimi i qëndrueshëm, ndikimi në mjedis i rolit prodhues dhe riprodhues social, kontributi i rolit komunitar të grave në zgjidhjen e çështjeve mjedisore, barazia dhe drejtësia gjinore në përdorimin e burimeve natyrore, fuqizimi i grave në shfrytëzimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore, etj.

<sup>62</sup> Rreth 1/5 e popullsisë së botës jeton ende në varfëri të plotë dhe mizerje, të kequshqyer, pa ujë të pijshëm të sigurtë, pa kujdes shëndetësor dhe pa mundësi për t'u arsimuar.

- Qëmtojë dhe paraqesë raste pozitive të veprimeve në mbrojtje të mjedisit që shërbejnë si modele për të ndryshuar një stereotip gjinor të të sjellurit dhe vepruarit.

## Inventar i besimeve fillestare

Ndonëse të reja për shoqërinë, trajtimi i çështjeve të mjedisit në libra, diskutime apo media ka fituar disa tipare të caktuara, të cilat shpesh kushtëzojnë edhe qëndrimet individuale apo të grupit. Përgjithësisht, çështjet e mjedisit priremi t'i trajtojmë si çështje të rëndësishme, që ndikojnë jetën e gjithkujt në mënyrë pothuaj të njëjtë, pavarësisht klasës dhe gjinisë që i përkasim. Në një vështrim më të kujdesshëm duket qartë se kjo gjë nuk është e vërtetë. Ndryshimet sociokulturale të marrëdhënieve burrë - grua në shoqëri të ndryshme bëjnë që edhe lidhja e secilit prej tyre me mjedisin fizik të mos jetë e njëjtë.

Ne besojmë se për shumë çështje si ndotja e ajrit, uji apo tokës, shpyllëzimi dhe erozioni, ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike, duhet të veprojmë tani, përpara se të jetë vonë. Për disa prej tyre mendojmë se mund të ndikojmë drejtpërsëdrejti (mirëmenaxhimi i mbetjeve, kursimi i ujit, energjisë, etj.), ndërsa për të tjera ndjehemi të pafuqishëm për të ndryshuar rrjedhën e proceseve (shkatërrimi i habitateve të kafshëve dhe bimëve dhe zhdukja e tyre, ngrohja globale, apo aksidentet industriale).

Në vijim të këtij qëndrimi të papërcaktuar në këndvështrimin gjinor, shpesh priremi të besojmë se:

- Gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë kanë akses të njëjtë ndaj burimeve të mjedisit në sasi dhe cilësi si ajri, uji, hapësira, ushqimi, etj. Kjo gjë mund të thuhet edhe për informacionin rreth tyre. Kështu nëse një djalë apo vajzë dëshiron të përdorë transportin publik në vend të makinës, të jetë vegjetarian, të kërkojë informacion rreth ndotjes në qytetin e tij/saj, askush nuk mund ta pengojë bazuar në faktin se i takon një gjinie të caktuar.
- Në varësi nga komuniteti ku ndodhemi, besojmë se ka barazi gjinore: burimet e mjedisit mund të përdoren në mënyrë të barabartë nga të dyja gjinitë: toka punchet nga burrat dhe gratë, mjediset e punës në industritë e përpunimit të produkteve bujqësore apo blegtorale, tekstile, këpucëve shfrytëzohen nga gratë dhe burrat, transporti publik përdoret nga të gjithë.
- Mjedisi nuk njihet kufij administrativë: një komunitet apo industri që shkarkon ndotje në pjesën e sipërme të lumit ndot të gjithë rrjedhën e tij. Meqenëse ky ndikim shpesh është i panjohur dhe larg nesh, atëherë mendojmë se shteti duhet të veprojë. Shpesh ndodh që grupohemi e ngremë zërin për padrejtësi apo veprime që duhen ndërmarë. Në këto raste vërejmë më shumë burrat të diskutojnë dhe të japin zgjidhje. Për kontributin që japin gratë dhe vajzat, me të drejtë gjykojmë se është e domosdoshme përfshirja më e plotë dhe më aktive e tyre.
- Për disa vende, natyra ka qenë shumë bujare në ofrimin e burimeve mjedisore, p.sh. vendi ynë është shumë i pasur me burime ujore apo lloje bimësh me vlera mjekësore. Për shkak të menaxhimit të dobët apo pafuqisë së ligjit për të vepruar, besojmë se burime të tilla dhe të tjera si këto, mund t'i kemi pafundësisht dhe

pashtershmerisht. Kështu, pak (ose aspak) mendojmë për sasinë e ujit të konsumuar në larjen e makinave dhe oborreve, ujitjen e kopshteve, aktivitetet brenda shtëpisë, etj. Megjithatë disa prej nesh besojnë se po ta paguanin sasinë e ujit të konsumuar dhe me çmim më të lartë se sa e paguajmë sot, atëherë kjo sasi do të reduktohej. Qëndrime dhe besime të tilla kemi për mbetjet, energjinë, etj.

- Shoqëritë e zhvilluara dhe vendet në zhvillim janë përfshirë nga ethet e konsumit. Konsumi më i madh shihet si tregues i mirëqenies individuale dhe i jetës moderne. Mendojmë se i shtojmë më shumë vlerë dhe kënaqësi jetës sonë duke blerë më shumë. Besojmë se gratë dhe vajzat shpenzojnë më shumë kohë dhe para për veshje dhe kozmetikë, ndërsa burrat dhe djemtë më shumë për pajisje elektronike, makina, etj. Na pëlqen më shumë një veshje ose pajisje e markave të njohura në botë, pa menduar sa është harxhuar për prodhimin dhe transportin e saj. Dhe kjo kënaqësi zgjat shumë pak ditë ose muaj. Më pas, na duhet të endemi sërish për të gjetur një "kënaqësi" të re.
- Është fakt se sot jemi më të ndërgjegjshëm për problemet mjedisore krahasuar me disa dhjetëvjeçarë më parë. Përballja me pasojat e dëmtimit apo shkatërrimit të mjedisit, ka rritur alarmin se gjithkush duhet të veprojë tani! Deri pak kohë më parë thirrja për veprim i referohej përgjegjësisë së grave dhe burrave të sotëm ndaj brezave të ardhshëm. Sot, thirrja drejtohet për mbijetesën tonë në të tashmen.

## Koncepte kryesore

Më poshtë po rendisim disa prej koncepteve më të rëndësishme mjedisore. Meqenëse rrallë vërejmë referime të diferencuara gjinore në konceptet e mjedisit, le të përpiqemi t'i japim kuptimin ose interpretimin e duhur gjinor, ku është e mundur.

**Mjedis** - është bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotikë dhe jobiotikë që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në tokë, duke përfshirë mjedisin biofizik natyror të ajrit, të tokës, të ujërave, larminë e ekosistemeve biologjike, shëndetin e njeriut, vlerat dhe trashëgimitë kulturore, shkencore, fetare e shoqërore.

**Si mendoni ju:** A mund të konsiderohet mjedisi si **e drejtë njerëzore**?

**Ndotja e mjedisit** - është futja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e lëndëve, vibracioneve, energjisë, nxehtësisë, rrezatimit, zhurmës dhe faktorëve biologjikë në ajër, në ujë e në tokë, të cilat mund të ndryshojnë cilësitë e mjedisit dhe të dëmtojnë cilësinë e jetës.

**Si mendoni ju:** A ka **barazi dhe drejtësi gjinore** në efektet që shkakton ndotja në shëndetin e burrave dhe grave, vajzave dhe djemve?

**Dëmtimi i mjedisit** - është prishja e karakteristikave fiziko-kimike dhe strukturore të ekosistemit natyror, ulja e prodhimit biologjik dhe shumëllojshmërisë së ekosistemeve natyrore dhe antropike, prishja e ekuilibrit ekologjik dhe cilësisë së jetës të shkaktuara kryesisht nga ndotja e ujit, ajrit, tokës prej veprimtarive njerëzore ose fatkeqësive natyrore si dhe nga mbishfrytëzimi i burimeve natyrore dhe minerare.

**Si mendoni ju:** A ndikon dëmtimi i mjedisit në mënyrë të ndryshme mbi burrat dhe gratë? A mund të sillni shembuj të **përkeqësimit të gjendjes dhe statusit të grave dhe burrave** si rezultat i dëmtimit të mjedisit?

**Lëndë të rrezikshme** - janë ato lëndë, prodhimi, transporti, ruajtja, përdorimi e shkarkimi i të cilave në mjedis, si rezultat i vetive të tyre, dëmtojnë ose mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut, cilësitë e mjedisit, florën, faunën, biocenozat dhe biotopet.

**Si mendoni ju:** A ka lëndë të rrezikshme që mund të ndikojnë më shumë te gratë apo në faza të caktuara të ciklit jetësor të tyre, për shembull gjatë shtatzënisë? Cilat profesione ekspozojnë më shumë burrat ndaj lëndëve të tilla?

Normat e cilësisë së mjedisit - janë një grup kërkesash, që duhen plotësuar për një kohë të dhënë dhe në një pjesë të dhënë të mjedisit, për përmbajtjen e lëndëve ndotëse, në disa pika të veçanta të ajrit, ujërave dhe tokës, vlera e të cilave nuk duhet të kalojë vlerën kufi të lejuar.

**Si mendoni ju:** Në një mjedis prodhimi, a duhet të ketë norma të diferencuara për gratë dhe burrat apo kushte të veçanta punësimi sipas specifikave gjinore apo të individëve të caktuar?

**Burime natyrore** - janë elementët biotikë dhe jobiotikë, që përdoren ose që mund të përdoren nga njeriu për plotësimin e nevojave të tij.

**Si mendoni ju:** A ka diskriminim gjinor në përdorimin e burimeve natyrore?

Zhvillimi i qëndrueshëm - është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes dhe të së ardhmes pa shtrënguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet në mënyrë që edhe brezat e ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre.

**Si mendoni ju:** A është i rëndësishëm procesi i integritetit gjinor në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm? E ngadalëson apo e përshpejton procesin?

**Përdorimi i qëndrueshëm** - i burimeve natyrore e minerale siguron plotësimin e nevojave të sotme, pa çënuar nevojat e brezave të ardhshëm për këto burime.

**Si mendoni ju:** A mund të ketë politika gjinore specifike në menaxhimin e burimeve natyrore për të fuqizuar gruan?

## Ngjarje dhe dokumente ndërkombëtarë

Samiti i Tokës - Rio de Janeiro (Brazil), 1992,

Samiti botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm – Johaneshburg (Afrika e Jugut), 2002,

## Disa konventa ndërkombëtare për mjedisin,

Konventa e Aarhusit: Konventa "Për të drejtën e informimit, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës për çështje mjedisore".

- Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin, e njohur si Samiti i Tokës (1992), konsiderohet si një nga pikat kryesore kthesë të politikës globale ndaj mjedisit. Kjo konferencë globale është mbajtur në 20 vjetorin e Konferencës së Parë Ndërkombëtare për Mjedisin Njerëzor (Stokholm, 1972). Prej Samitit doli **Deklarata e Rios** - një grup prej 27 parimesh për të drejtuar veprimin ndërkombëtar në bazë të përgjegjësisë ekonomike dhe mjedisore. Parimi 20 i saj: *“Roli vital i grave në menaxhimin e mjedisit dhe zhvillim”,* shpreh rëndësinë e vlerësimit të barazisë dhe drejtësisë gjinore në çështjet e mjedisit.
- Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm (i njohur si Samiti Rio+10) ishte ngjarja më e madhe e organizuar ndonjëherë nga OKB-ja, që mbledhi së bashku 104 kryetarë shteti dhe qeverie nga 191 vende të botës dhe më shumë se 21 mijë pjesëmarrës. Samiti miratoi një Deklaratë politike dhe Planin e veprimit, ku përfaqësuesit e shteteve merrnin përsipër ballafaqimin me sfidat e reja dhe angazhimin për zhvillimin e qëndrueshëm. Ndër objektivat kryesore të Planit deri në vitin 2015 përmendim: zvogëlimin me 50% të popullatës që jeton me më pak se 1\$ në ditë; zvogëlimin me 50% të popullatës që jeton pa ujë të pastër dhe kushtet higjieno-sanitare bazë; zvogëlimin me 2/3 të vdekshmërisë foshnjore (të porsalindurit) dhe me 3/4 të vdekshmërisë amtare.

Në nivel ndërkombëtar ka rreth 35 konventa dhe një numër të madh protokollesh të tyre. Shqipëria është palë në rreth 20 prej tyre, ndër të cilat mund të përmendim:

- **Konventa e Vienës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit**
- **Konventa e ESPOO-s për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar**
- **Konventa për Mbrojtjen e Shumëllojshmërisë Biologjike**
- **Konventa kornizë e Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike**
- **Konventa e BERN-it për Konservimin e Florës dhe Faunës së Egër të Europës dhe Habiteteve të tyre**

Konventa **“Për të drejtën e informimit, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe të drejtën për t’ju drejtuar gjykatës për çështje mjedisore”,** u adoptua më 25 qershor 1998, në qytetin danez të Aarhusit, në kuadër të Konferencës së IV-t “Mjedisit për Europën”. Konventa e Aarhusit është një lloj i ri i marrëveshjes mjedisore. Ajo lidh të drejtat mjedisore me të drejtat e njeriut. Shqipëria është palë e kësaj konvente që në tetor 2000.

Konventa vendos një numër të drejtash për publikun (qytetarët dhe organizimet e tyre) lidhur me mjedisin. Autoritetet publike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të kontribuojnë që këto të drejta të bëhen efektive. Në përmbajtjen e saj, Konventa rregullon 3 fusha kryesore:

- Të drejtën e secilit që të marrë informacion mjedisor prej autoriteteve publike (**“aksesi në informacionin mjedisor”**). Kjo përfshin informacione mbi gjendjen e mjedisit,

politikat dhe masat e ndërmarrja, gjendjen e shëndetit të njerëzve dhe sigurinë kur ajo mund të ndikohet nga gjendja e mjedisit. Qytetarëve iu garantohet e drejta e marrjes së informacionit brenda një muaji pas kërkesës së bërë, pa qenë të detyruar t'i japin arsytet përse e kërkojnë atë informacion;

- Të drejtën për të marrë pjesë që në fazat e hershme në vendimmarrjen për mjedisin. Autoritetet duhet t'i kryejnë të gjitha veprimet e duhura për t'u mundësuar grave dhe burrave, vajzave dhe djemve dhe organizatave mjedisore për të komentuar propozimet e projekteve që kanë ndikim në mjedis, planet dhe programet e mjedisit ("**pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen mjedisore**").

- Të drejtën që t'i drejtohen gjykatës lidhur me vendimet publike që janë marrë pa u respektuar dy të drejtat e mëparëshme, si dhe legjislacioni mjedisor në përgjithësi ("**aksesi në sistemin e drejtësisë**").

### **Dokumente kombëtare**

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.**
- Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 "**Për mbrojtjen e mjedisit**" (amenduar)

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë** në kreun IV mbi "Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore" thekson se:

- Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij (neni 56).

Ndërsa në Kreun V: Objektivat sociale, shprehet:

1- Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si në plotësim të nismës dhe të përgjegjësive private, synon:

- një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm; (neni 59, pika 1.d)

- shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm; (neni 59, pika 1.dh)

Ndonëse, jo i specifikuar për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, në këtë pjesë të saj Kushtetuta shpreh qartësisht detyrimin kushtetues të shtetit për të garantuar një mjedis cilësor për të gjithë shtetasit. E drejta kushtetuese për informimin është në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Konventën e Aarhusit.

**Ligji "Për mbrojtjen e mjedisit" është ligji bazë, i cili paraqet fushat dhe drejtimit, të drejtat dhe saksionet për ruajtjen dhe mirëpërdorimin e mjedisit në Shqipëri. Ligji në fjalë përshkruan të drejtat përtej çdo njëres gjini.**

Ligji synon: a) përdorimin racional të mjedisit dhe kufizimin e shkarkimeve e të ndotjeve në të, parandalimin e dëmtimit të tij, rehabilitimin dhe shëndoshjen e mjedisit të dëmtuar; b) përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut; c) ruajtjen dhe mirëmbajtjen e burimeve natyrore, të përtëritshme dhe të papërtëritshme, administrimin racional dhe të frytshëm të tyre; ç) bashkërendimin e

veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit; d) bashkëveprimin ndërkombëtar në fushën e mjedisit; dh) nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit; e) bashkërendimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Një pjesë e rëndësishme e ligjit është e drejta për marrjen e të dhënave mjedisore.

Arsyetoni logjikën e dispozitës së mëposhtme dhe identifikoni parimet mbi të cilat funksionon kjo dispozitë?

“Publiku dhe organizatat jofitimprurëse njoftohen për gjendjen e mjedisit nëpërmjet publikimit të të dhënave nga organet shtetërore dhe nga personat fizikë e juridikë, si dhe duke kërkuar të dhëna pranë organeve shtetërore.”

Nëse një organizatë në mbrojtje të të drejtave të grave, paraqet një kërkesë për informacion mjedisor pranë Ministrisë së Mjedisit apo të Shëndetësisë, përpikuni të argumentoni bazën ligjore ku mbështetet kjo e drejtë.

## Të dhëna dhe fakte

1. Në vitin 1920, disqet e orëve ngjyroseshin me radium me bazë shkëlqyese. Punëtorët, të gjitha gra dhe vajza, i lëpinin furçat për t'i shkëlqyer dhe merrnin kështu sasi të vogla radiumi. Ai depozitohej në kockat e tyre dhe shkaktonte kancer të kockave nga 8 deri 40 vjet më vonë. Kjo demonstroi qartë faktin se rreziku për kancer rritet me rritjen e dozave të radiumit<sup>63</sup>.
2. “Asgjë, veç një vrasës” (*origjinali në anglisht: Nothing but a murderer*) është mënyra se si Alice Hamilton e përshkruante Charles Ketteringun e *General Motors*, “gjeniu” që shpiku benzinën me plumb. Lufta e Hamiltonit nuk pati sukses dhe benzina me plumb u fut në përdorim masiv. Vetëm së fundi, shumë shtete përfshirë edhe vendin tonë, e kanë hequr atë nga përdorimi.
3. Libri i Rachel Carsonit<sup>64</sup> “Pranverë e heshtur” (*origjinali në anglisht: “Silent Spring”*) i publikuar në vitin 1962, ishte thirrja e parë për ndërgjegjësimin mjedisor. Libri pohonte efektet e dëmshme të pesticideve, sidomos për shpendët, duke akuzuar

<sup>63</sup> “Vajzat e radiumit” (*origjinali në anglisht: The Radium Girls*), vdisnin nga kanceri i shkaktuar nga rrezatimi. Walter Lippmann punoi me Alice Hamilton për ta sjellë rastin e tyre në publik. Vendimi i gjyqit iu dha të drejtën për përkujdesje mjekësore dhe kompensim familjeve të tyre. Alice Hamilton (1869-1970) ishte themeluese e mjekësisë së sëmundjeve profesionale në SHBA dhe gruaja e parë e Shkollës Mjekësore të Harvardit. Si një shkencëtare e njohur, ajo punoi shumë me gazetarët për t'i ndihmuar të kuptojnë natyrën e industrive të reja të rrezikshme.

<sup>64</sup> Rachel Louise Carson (1907-1964) ishte biologe detare, shkrintare, shkencëtare dhe ambientaliste. Ajo trajtoi ndërlidhjet në mjedis: ndonëse pesticidet synonin të luftonin një organizëm të caktuar, përdorimi i tyre kishte ndikim edhe në organizmat tjerë përfshirë edhe njeriun. Ajo u bë anëtare e Akademisë së Shkencave të SHBA-së dhe më 1980. Presidenti amerikan e dekoroi me Medaljen e Lirisë (post mortum).



- industrinë kimike për shpërndarjen e të dhënave jo të sakta. Libri i Carsonit, me bujën e tij të jashtëzakonshme pasoi ndalimin e DDT-ve.
4. Më 22 prill 1970, 20 milionë njerëz nga tërë SHBA-ja, të prirë nga senatori Gaylord Nelson marshuan dhe protestuan duke kërkuar futjen e problemeve mjedisore në axhendën politike të vendit. Sot, kjo ditë njihet si Dita e Tokës. Një vit më vonë, më 1971, u formua njëra nga lëvizjet më të mëdha mjedisore në botë, **Greenpeace**.
  5. Periudha 1980-1990 ishte shumë tronditëse. Katastrofat treguan anën e dobët të teknologjisë industriale. Midis tyre janë: helmimi masiv në Bophal të Indisë, katastrofa me reaktorin bërthamor në Çernobil të Ukrainës, rrjedhja nga anija kozmike "Challenger" dhe Exxon Valdez në SHBA. Hollimi i shtresës së ozonit nga fluorokarbonet u konsiderua seriozisht edhe nga politikanët më konservatorë të kohës si Ronald Reagan e Margaret Thatcher. Shkencëtari Dr. Joe Farman zbuloi "vrëmën e ozonit" mbi Antarktidë (1978) dhe tre vjet më vonë shkencëtarët zbuluan edhe "vrëmën e ozonit" mbi Arktik. Zërat lidhur me ngrohjen globale u bënë gjithnjë e më të fortë dhe më bindës.
  6. Gazetarja dhe ambientalistja Ken Saro-Wiwa u ekzekutua në vitin 1995 për shkak të kundërvënies me zë të lartë praktikave të industrisë së naftës në Nigeri. Saro-Wiwa udhëhoqi një fushatë kundër dëmeve mjedisore të shkaktuara nga puna e kompanive shumëkombëshe të naftës. Qeveria diktatoriale e Nigerisë, dhe partneri i saj Shell Oil, u bënë përgjegjës para komunitetit ndërkombëtar për vrasjen e saj.

## Dilema dhe paradokse

**Dilema 1:** Mungesa e ushqimit mbetet një prej tipareve më të shprehura të varfërisë. Pamjet e dhimbshme të grave dhe fëmijëve të paushqyer të disa vendeve në Afrikë pushtojnë mediat kohë pas kohe. Ndërkohë, në vendet e zhvilluara flitet gjithnjë e më shumë për ushqimet *bio*, të prodhuara nga bujqësia organike. Ato reklamohen e shiten më çmime më të larta, sepse nuk përmbajnë mbetje të pesticideve apo lëndëve kimike të përdorura për plehërimin e tokës. Por sasia e prodhuar është shumë e vogël dhe e pamjaftueshme për të ushqyer të gjithë popullsinë e botës.

Përdorimi i pesticideve ka sjellë rritjen e sasisë së prodhimit bujqësor dhe ka përmirësuar ushqimin e popullsisë në mbarë globin. Por, ndërmjet të tjerash, ato kanë efekte shëndetësore. Sipas UNEP-it<sup>65</sup> (2002), çdo vit ndodhin rreth 20000 vdekje dhe 1 milion raste të sëmundjeve prej pesticideve të përdorura. Burrat dhe gratë kanë shkallë të ndryshme ekspozimi ndaj pesticideve gjatë procesit të prodhimit bujqësor. Te gratë, efektet shëndetësore janë më të shprehura. Për shembull, pesticidet me bazë klori si DDT-të rrisin rrezikshmërinë për kancerin e gjirit. Te gratë që ushqejnë fëmijët e tyre me gji, përqëndrimi i DDT-ve mund të jetë deri në 12 herë më i lartë sesa kufiri maksimal i lejuar. Ndaj gjendemi përballë dilemës nëse duhet nxitur bujqësia organike apo prodhimi intensiv?

<sup>65</sup> UNEP (United Nations Environmental Programme): Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin

Diskutoni dhe shprehni mendimin tuaj:

- *A mendoni se mungesa e ushqimit është problem madhor për shumë shoqëri të pazhvilluara apo shtresa të varfra të shoqërive në zhvillim?*
- *Nga mungesa e ushqimit ndikohen më shumë gratë dhe fëmijët. Listoni argumente pro dhe kundër këtij fakti.*
- *Përse edhe prodhimi intensiv nuk e zgjidh problemin e varfërisë në nivel global?*

**Dilema 2:** Ngrohja globale edhe efektet e saj mbi ndryshimet klimatike janë një ndër diskutimet globale më të rëndësishme. Nëse vazhdon ky ritëm i shkarkimeve të gazeve serë<sup>66</sup> në atmosferë, pasojat e ndryshimeve klimatike të tilla si zona më të nxehta e më të thata, vende të përmytura nga rritja e nivelit të deteve, zhdukja e llojeve të kafshëve dhe bimëve, etj. brenda 30 - 50 vjetëve të ardhshme do të jetë katastrofike për të gjithë njerëzimin. Perspektiva gjinore është shumë e shprehur në të gjitha aspektet e ndryshimeve klimatike. Më shumë për këtë drejtim mund të lexoni në paragrafin **Më shumë informacion**, të këtij kapitulli.

I gjithë komuniteti ndërkombëtar është angazhuar në zvogëlimin e shkarkimeve duke vendosur shtetet përballë presionit të marrjes së masave të kushtueshme për përmirësimin teknologjik. Vendet në zhvillim si Kina dhe India janë kundër kufizimeve të tilla, meqenëse ato kufizojnë edhe zhvillimin ekonomik të tyre. A është paradoks politika e këtyre vendeve për të investuar në teknologji ndotëse apo është e padrejtë kërkesa e vendeve të zhvilluara për të frenuar zhvillimin e këtyre vendeve në zhvillim?

Diskutoni dhe shprehni mendimin tuaj:

- *Bazuar edhe në informacionin shtesë të këtij kapitulli, listoni disa prej aktiviteteve që mund të ndikohen prej ndryshimeve klimatike të kryera në rolin prodhues dhe atë riprodhues për gratë dhe vajzat?*
- *Qëmtoni dhe sillni në klasë disa pasoja të ndryshimeve klimatike të cilat vijnë nga profile gjinore të shprehura. Për shembull, si mund të ndikohen gratë dhe burrat nga zhvendosjet ose migrimet si rezultat i përmytjeve apo i thatësirës në zona të caktuara?*

---

<sup>66</sup> Përparimi teknologjik, ndërtimet e fabrikave të mëdha, zhvillimi i industrisë përpunuese dhe zhvillimi i mekanikës bujqësore dhe transportit çuan në rritjen e ndotjes dhe në prodhimin e gazeve serrë, siç është dioksidi i karbonit, oksidet e azotit, freoni dhe metani. Këto gaze kapin rrezatimin diellor, duke rritur në këtë mënyrë temperaturën e atmosferës së Tokës. Kjo dukuri është quajtur "efekti serrë".

## HAPËSIRË PËR TË DEBATUAR

**Debat 1 - Tendencë dhe fenomen:** *“Jetë moderne = konsumatorizëm!”.*

Kalimi i një pjese të mirë të kohës së lirë në qendrat e reja të biznesit, plot me dyqane dhe supermarkete është bërë pjesë e rutinës së fundjavës apo pasdrekeve. Afrimi i festave apo fundvitit sjell një atmosferë të përgjithshme blerjesh ku njerëzit shpenzojnë kohë dhe të holla për të blerë çdo gjë që lipset apo jo, përdoret apo dhurohet. Numri i çantave të pazarit të mbushura shihet si shprehje e mirëqënies, që përforcohet intensivisht prej reklamave mbi prodhimet më të reja dhe moderne. Mediat dhe posterat nëpër dyqane me femra dhe meshkuj tërheqës, me skena gëzimi dhe hareje që paraqesin momente konsumi, na ndjellin të blejmë më shumë ushqime apo rinovojmë para kohe garderobën, interierët e shtëpisë, etj.

Konsumi është mekanizmi që shton fitimin dhe rrit biznesin. Ndaj firmat prodhuese dhe tregtuese kryejnë studime të hollësishme mbi tendencat dhe shijet e konsumatorëve: të grave, të vajzave, të burrave, të djemve, në grupmosha dhe vende të ndryshme. Kjo tendencë ka rritur jo vetëm ekstravangacën tonë konsumiste, por edhe ka dëmtuar dhe shkatërron vazhdimisht mjedisin. Le të pyesim vetëm për një detaj të sjelljes sonë “moderne”:

*“Sa herë ju ka ndodhur të keni qenë të dyzuar për të marrë me vete një çantë bezeje për pazar, që të mos përdorni qeset plastike që ofrohen me zemërgjërësi pa pagesë që nga shitësit ambulantë deri te dyqanet më luksoze?”*

- *Sillni këndvështrimin tuaj rreth stereotipave gjinore lidhur me sjelljen konsumatore.*
- *Cila gjini mund të kishte prirje për të thyer këto stereotipa dhe ndryshuar mënyrën konsumatore të jetës. Ndani mes jush kënde shikimi fokusuar mbi faktet për të dyja gjinitë.*

**Debat 2 - A kontribuojnë dhe deri në çfarë mase.... në përmbushje të drejtave të grave...**

Shumë nga organizatat për mbrojtjen e mjedisit drejtohen nga gra dhe kanë shumë aktiviste dhe vullnetare që kontribuojnë në to.

- A bazohet kjo te fakti se gruaja është më e prekshme ose e ndikuar nga problemet mjedisore?
- Ndonëse është e pranuar se orientimi aktiv në mbrojtje të mjedisit nuk është predispozitë gjenetike, çfarë tiparesh e bëjnë gruan të jetë e përfshirë aktivisht në aktivitete për një mjedis më cilësor?

## MË SHUMË INFORMACION

### Roli i grave në menaxhimin e mjedisit

Që në fillimin e historisë njerëzore, gratë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen,

përdorimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Roli i tyre shpesh është qartësisht i ndryshëm nga ai i burrave: p.sh. në disa aktivitete në bujqësi, kujdesin për blektorinë, grumbullimin e bimëve dhe produkteve të tjera në natyrë, sigurimin dhe menaxhimin e ujit për përdorim shtëpiak, prodhimin e produkteve të ndryshme për tregtim, etj. Përmes këtyre aktiviteteve, roli i tyre në kujdesin dhe mirëmbajtjen e familjes dhe të komuniteteve ku jetojnë është i pazëvendësueshëm.

Përvoja shumë e gjerë është njëkohësisht njohuri dhe dije për mirëmenaxhimin mjedisor të burimeve që përdorin. Numri i grave në vendimmarrjen mjedisore është shumë i ulët. Njohuritë dhe aftësitë e grave dhe vajzave shpesh nënvlerësohen gjatë planifikimit dhe vendimmarrjes.

Barazia dhe drejtësia gjinore nuk janë vetëm çështje e të drejtave themelore të njeriut apo e drejtësisë sociale. Ato shtrihen edhe në fushën e çështjeve mjedisore. Disa studime kanë treguar se drejtësia gjinore është kusht themelor për zhvillimin ekonomik të vendit dhe përparimin e shoqërisë.

Në dokumentin e Rios (1992) ka 145 referenca për rolet specifike dhe pozitën e grave lidhur me mjedisin dhe zhvillimin. Ai vlerëson se gratë dhe vajzat janë njëri prej nëntë grupeve kryesore për të arritur objektivin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në Platformën e Pekinit për Veprim (1995) ka një kapitull të veçantë «Gratë dhe Mjedisi», i cili përmban tre objektiva strategjike:

1. Përfshirjen aktive të grave në vendimmarrjen mjedisore në të gjitha nivelet.
2. Integrimin e çështjeve dhe perspektivës gjinore në politikat dhe programet e zhvillimit të qëndrueshëm.
3. Fuqizimin ose ngritjen e mekanizmave në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për të vlerësuar ndikimin e politikave të zhvillimit dhe atyre të mjedisit mbi gratë dhe vajzat.

## SHËNDETI I NJERËZVE DHE MJEDISI

### Informacion shtesë për Dilemën nr.1

Në produktet ushqimore bimore, të prodhuara nga kultura të rritura me ndihmën e një sasive të madhe të plehrave joorganike apo pesticideve si dhe në zona të ndotura mjedisore, si fushat anës rrugëve me trafik të dendur apo ato pranë qendrave të mëdha industriale, janë gjetur elementë të rrezikshëm ku përfshihen:

- metalet e rënda, të cilat kanë depërtuar nëpërmjet tokës;
- nivel i lartë plehrash joorganike artificiale, që nuk kanë mundur të dekompozohen plotësisht;
- konservantë të ndryshëm kimikë.

Ka shumë faktorë që ndotin ushqimin që ne marrim:

- mbjellja e drithërave dhe rritja e bagëtive në zona industriale shpesh shoqërohet me përdorime antibiotikësh dhe hormonësh në ushqim;
- përdorimi i praktikave të pasigurta në ushqimin e bagëtive (p.sh. epidemia e lopës së çmendur është shkaktuar nga ushqimi i bagëtisë me pjesë kafshësh të infektuara);
- rritja e kulturave të drithërave në mënyrë intensive;
- përdorimi i tepruar i plehrave inorganike dhe i pesticideve;
- shiu acid;
- ndotja e ajrit nga aktivitetet industriale.

Një burim tjetër i rrezikshëm, pasojat e të cilit ende nuk janë studiuar plotësisht, janë bimët dhe kafshët e modifikuara gjenetikisht, të cilat janë paraqitur si një zgjidhje afatshkurtër në plotësimin e nevojave ushqimore botërore.

## PERSPEKTIVA GJINORE NË NDRYSHIMET KLIMATIKE

### Informacion shtesë për Dilemën nr. 2

Pabarazitë gjinore në aksesin e burimeve natyrore duke përfshirë edhe pabarazitë në shërbimet e ndryshme, informacionin dhe teknologjinë thellohen edhe më tej nga pasojat e ndryshimeve klimatike. Gratë përbëjnë përqindjen më të madhe të komuniteteve të varfra, të cilat kanë varësi shumë të madhe ndaj burimeve natyrore lokale që mund të preken prej ndryshimeve klimatike. Aksesin e kufizuar në përdorimin e burimeve dhe mospërfshirja në vendimmarrje i bëjnë ato edhe më të prekshme.

Gratë në zonat rurale mbajnë peshën kryesore për mbajtjen e familjes, sigurimin e ushqimit, të ujit dhe druve për ngrohje dhe gatim. Thatësitat dhe përmbytjet, erozioni dhe shpyllëzimet shtojnë punën, përgjegjësinë dhe përpjekjet e tyre.

Për shkak të roleve gjinore të ndryshme, gratë kanë më pak mundësi për të lëvizur apo zhvendosur, ndaj ato vlerësohen si më të prekura prej katastrofave natyrore si përmbytje, zjarre, rrëshqitje të tokës, etj.

Strategjitë adaptuese ndaj ndryshimeve klimatike duhet të jenë të ndjeshme nga ana gjinore, në mënyrë që t'i përgjigjen efektivisht krizave mjedisore dhe humanitare të shkaktuara prej ndryshimeve klimatike. Masat ndërhyrëse duhet të marrin parasysh ndikimet specifike gjinore në zonat e ndikuara lidhur me energjinë, ujin, sigurimin e ushqimit, aktivitetin bujqësor dhe peshkimin, biodiversitetin, shëndetin, industrinë, vendbanimet urbane, etj.

Gratë dhe vajzat nuk janë vetëm viktimat e pasojave të ndryshimeve klimatike, por edhe aktore në veprimet konkrete. Njohuritë dhe përvoja e tyre mund të përdoren në hartimin e planeve dhe strategjive ndërhyrëse. Puna e përditshme dhe përgjegjësitë e tyre në mbajtjen e familjeve dhe mbarëvajtjen e komuniteteve të tëra, i bëjnë ato faktor kyç për suksesin e çdo investimi të planifikuar.

## BIBLIOGRAFI

- A.Baban, *Dhuna ndaj gruas në Shqipëri*. Tiranë 2003.
- Adolfsen, A.M. *Working Women, Managing Men. Authority and Earnings in Relation to Gender, Personality, Human and Social Capital of Dutch ACS Alumni of Utrecht University*. 2007
- Anastasi, A. & Bozo, A. *Mjetet ligjore që ofron ligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" dhe ndikimi i tij në luftën kundër këtij fenomeni*. Raporti është i vlefshëm në [www.qag-al.org](http://www.qag-al.org)
- *Barazia gjinore në procesin e integritit evropian. Shifra dhe Fakte*. QAGjZh, Tiranë 2008.
- Bhasin K. *Të kuptosh përkatësinë gjinore*, Qendra e Gruas, Tiranë 2001
- *Deklarata Universale për të drejtat e njeriut (1948)*, <http://www.un.org/Overview/rights.html>
- *Dhuna në familje në fokusin e medias, udhëzues*. QAGJZH, Tiranë 2008
- *Dhuna në familje, paraqitja e situatës aktuale në Shqipëri*, MPÇSSHB-QAGJZH, Tiranë 2006
- *Diskriminimi i gruas në tregun e punës*, studim mbështetur nga Soros, Tiranë 2004.
- *Dokument për politikën e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar*. Tiranë, 2004.
- *Equality between women and men in the European Union (Employment and Social Affairs)*. European Commission. Directorate-General for Employment, Social Affairs and Equal Opportunities. Unit G1. August 2005.
- Gjermani, E & Bregu M. *Monitorimi i shtypit mbi dhunën në familje, 2001&2002*, Tiranë 2003.
- Hansen, J.(2005), *Shaping Careers of Men and Women in Organizational Contexts*. Universal Press, Veenendaal.
- Haxhiymeri, Gjermani, Olah, *Udhëzues i Integritit Gjinor*, mbështetur nga UNDP Albania, 2004.
- INSTAT, *Femra dhe Meshkuj*, 2005, 2006 .
- *Integrimi gjinor në praktikë*, PNUD, Tiranë 2006
- *Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave*, Tiranë 2001.
- Lanara, Z. *Gender Equality and Media*. Greek General Confederation of Broadcasters (GSEE), 2002.
- Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, *Për barazinë gjinore në Shqipëri*.
- Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, *Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*. [www.seeline-project.net/NM/AlbaniaNM.htm](http://www.seeline-project.net/NM/AlbaniaNM.htm)
- *Media e shkruar në Shqipëri - një vështrim i shkurtër*, QAGjZh, Tiranë, 2006
- *Ndarja e jetes private dhe publike* (Plaku A., Picari B., Pino S., Danaj S., Gjermani E., Shtraza I.) AGJZH, Tiranë 2008

- *Për një zbatim më të mirë të ligjit në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje nga organet e drejtësisë.* QNL, Tiranë, 2005.
- *Përkujdesja si punë e papaguar* (Danaj E., Plaku A., Çavo Z., Ekonomi M.) QSA, Tiranë, 2008
- *Përmbledhje esesh për përkatësinë gjinore.* Botim i Qendrës së gruas dhe PNUD-it. Tiranë, 2005
- *Platforma udhëzuese e BE-së për barazinë ndërmjet grave e burrave (2006-2010),* Botim i QAGjZh, Tiranë, 2008.
- Raporti monitorues i medias, *Small arms light weapons (SALW)*, 2007.
- Reskin, B & Padavic, I. *Women and Men at Work.* Pine Forge Press. London, 1994.
- *Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe dhunën në familje (2007-2010),* Ministria e Punës, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta.
- *Të jesh grua... në Shqipëri pas viteve 1990,* Përmbledhje artikujsh, Botim i Qendres AGJZH, Tiranë 2007.

*Zbatimi i Konventës CEDAW,* <http://www.un.org/womenwatch/cedaw/cedaw.htm>

